



MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AKPT

AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

PLANI I PERGJITHSHËM VENDOR BASHKIA LIBRAZHD (2016-2030)

5. VLERESIMI STRATEGJIK MJEDISOR

KY DOKUMENT U PERGATIT NGA:

Bashkia Librazhd, A & E Engineering, Cooprogetti S.C.R.L



Lexhip Shkurti Rshkurt

TABELA E PËRMBATJES

1. HYRJE.....	10
1.1 Qëllimi i Raportit.....	10
1.2. Autoritetet Përgjegjëse.....	13
1.3. Ekipi i Konsulencës.....	14
1.4. Konceptimi i përmbatjes së VSM-së	14
1.4.1. Përkufizime për VSM	14
1.4.2. Rëndësia e VSM	16
1.4.3. Evidentimi i problematikës së zbatimit të VSM-së	18
1.5. Koncepti i zhvillimit urban dhe Plani i Përgjithshëm Vendor.....	20
1.6. Përmbatja e Planit të përgjithshëm vendor.....	20
2. Metodologjia dhe përmbajtja e raportit mjedisor të VSM.....	21
3. Analiza e VSM-së dhe sistemi GIS.....	25
4. Korniza Ligjore dhe Institucionale.....	27
4.1. Baza ligjore Shqiptare.....	27
4.2. Direktiva VSM e BE-së.....	28
4.3. Direktiva të tjera të BE-së.....	29
4.4. Strategjia 2020 e BE-së	29
4.5. Konventa Arhus, Konventa Espoo dhe Protokollin i Kievit	30
4.5.1. Konventa Arhus	30
4.5.2. Konventa ESPOO	30
4.5.3. Protokollin i Kievit	30
4.5.4. Axhenda Territoriale e B.E.-së 2020 (Territorial Agenda)	31
4.5.5. Harta Leipzig për Zhvillimin e Qendrueshëm Urban	33
4.5.6. Politika e Përbashkët Bujqësore 2014-2020	34
4.5.7. Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin	35
4.5.7.1. Në përgjithësi	35
4.5.7.2. Mbrojtja, ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror	37
4.5.7.3. Shndërrimi i Bashkimit në një ekonomi “të gjelbër” dhe konkurrese	37
4.5.7.4. Presione mjedisore dhe rreziqe për shëndetin dhe mirëqënien	38
4.5.7.5. Përfitimet e legjislacionit mjedisor	38

4.5.7.6. Përmirësimi i bazës së dijeve dhe të dëshmive për politikën mjedisore	38
4.5.7.7. Investime në politikën mjedisore dhe klimaterike	39
4.5.7.8. Inkuadrimi i distancës mjedisore në politika	39
4.5.7.9. Forcimi i qëndrueshëm i qyteteve	39
4.5.7.10. Përballja e sfidave ndërkombëtare mjedisore dhe klimaterike	40
4.6. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. (VSM).....	40
5. Analiza e situatës së sotme të kushteve mjedisore të territorit të bashkisë Cërrik.....	41
5.1. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Cërrik.....	41
5.2. Topografia	43
5.3. Gjeologjia dhe Tektonika.....	45
5.3.1. Ndërtimi Gjeologjik	45
5.3.2. Kushtet Gjeologo – Inxhinierike	46
5.3.3. Makrozonimi dhe mikrozonimi sizmik.....	46
5.3.3.1. Tektonika dhe neotektonika.....	46
5.3.3.2. Thyerjet e reja dhe tërmetet.....	47
5.3.3.3. Erozioni dhe fenomene të tjera	47
5.4. Kushtet Klimaterike.....	48
5.5. Kushtet hidrogeologjike të Bashkisë Cërrik.....	49
5.5.1. Hidrografia.....	50
5.6. Boniteti i tokave	51
5.7. Popullsia dhe veprimtaria e saj.....	51
5.8. Infrastruktura.....	53
5.9. Shtrirja hapësinore e Bashkisë.....	56
5.10. Zona të trashëgimisë kulturore e historike.....	58
5.11. Mjedisi biologjik (Flora, fauna, ekosistemet, biodiversiteti dhe monumentet e natyrës).....	68
6. Analiza e problematikës mjedisore, burimeve ndotëse dhe efekti i tyre në territor dhe në shëndetin e njeriut.....	70
6.1. Cilësia e ajrit.....	70
6.2. Zhurmat/ akustika.....	72

6.3. Regjimi hidrik.....	72
6.4. Sipërfaqet e eutrofizuara.....	87
6.5. Rezervuaret dhe kapaciteti mbajtës i tyre.....	88
6.6. Menaxhimi i mbetjeve.....	90
6.7. Zonat problematike të ndotura, “hot spot”-et.....	91
6.7.1. Sipërfaqet ujore të ndotura.....	92
6.7.2. Sipërfaqet e eutrofikuara.....	93
6.7.3. Mbetjet ujore dhe ujrë të zeza.....	94
6.7.4. Erozioni.....	94
7. Korniza ligjore e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.....	95
7.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME.....	96
7.1.1. Objektivat strategjikë të PPK:.....	96
7.1.2. Objektivat Specifikë të planit të Përgjithshëm Kombëtar.....	96
7.1.3. Objektivat e planit të Përgjithshëm Vendor.....	97
7.2. Objektivat dhe Vizionet Prioritare të Bashkisë Cërrik.....	97
7.2.1. Objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Cërrik.....	97
7.2.2. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV)	98
7.3. Skenarët e zhvillimit.....	99
7.3.1. Vizioni i Bashkisë Cërrik.....	100
7.3.2. Analiza SWOT. Krahasimi skenarëve 00,01, 02.....	103
7.3.3. Bashkërendimi midis skenarit Zero dhe fushave të veprimit dhe të vlerësimit të objektiveve të VSM.....	106
7.3.4. Analiza e skenarëve 01 dhe 02.....	109
7.3.5. Analiza SOFT.....	113
7.4. Kriteret përjashtuese të zbatimit të PPV-së konform VSM-së.....	115
8. Objektivat Kombëtare dhe Ndërkombëtare për një zhvillim të Qëndrueshëm – përfshirja e objektiveve në plan.....	118
8.1. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Nivel Kombëtar.....	118
8.2. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar.....	124

8.3. Objektivat Mjedisore, treguesit dhe synimet.....	128
8.4. Objektivat Mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Cërrik.....	129
8.5. Harmonizimi i objektivave të Mjedisore të VSM/kombëtare/ndërkombëtare me PPV.	131
8.6. Veprimtaritë e propozuara në lidhje me objektivat dhe projektet strategjike të PPV-së dhe koherenca me objektivat e VSM-së.....	133
8.7. Vështirësitë e takuara gjatë hartimit të VSM-së.....	138
9. Identifikimi i ndikimeve të mundshme Mjedisore, Parashikimi, Vlerësimi dhe Masat e duhura për Trajtimin e tyre.....	140
9.1. Matrica funksionale midis objektivave të PPV-së dhe elementëve përbërë të Mjedisor - Bashkia Cërrik.....	142
9.2. PARAQITJA ANALITIKE E NDIKIMEVE MJEDISORE TË PPV	147
9.3. PARASHIKIME TË NDIKIMEVE MJEDISORE TË PPV-SË	164
9.4. TRAJTIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	173
9.5. VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË FAKTORËT MJEDISOR TË PPV.....	178
9.5.1. Ndikime në terren	179
9.5.2. Ndikimet në ajër	180
9.5.3. Ndikime mbi faktorët klimatikë	180
9.5.4. Ndikime mbi ujërat	181
9.5.5. Ndikime mbi mbetjet	182
9.5.6. Ndikime në mjedisin akustik/zhurmat	183
9.5.7. Ndikimet në trashëgiminë kulturore dhe historike.....	183
9.5.8. Ndikime mbi peisazhin	183
9.5.9. Ndikimet mbi popullsinë dhe në asetet e saj.....	184
10. Pasojat e mundshme ndërkufitare në mjedis dhe shëndet publik.....	185
11. MONITORIMI.....	186
12. KONKLUZIONE.....	203
13. REFERENCA.....	205
14. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE	207

LISTA E FIGURAVE

Figura.1. Pozicioni i Bashkisë Librazhd në rajon (Burimi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura 2. Relievi topografik i territorit të bashkisë Librazhd. (Burimi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura 3. Harta e rajonazimit sizmik (Burimi: Instituti i Sizmologjisë. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura 4. Harta e sistemit hidrik (Burimi: Instituti i Hidrologjisë. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura. 5. Harta e zonave bujqësore (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura. 6. Harta e përdorimit të tokës (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura. 7. Rrjeti ifrastrukturës sipas kategorive (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Figura 8. Harta e shpërndarjes së monumenteve të Natyrës.

Figura. 9. Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Librazhd (www.google maps)

Figura 10. Vendbanime të hershme dhe koridoreve historike Burimi: Bashkija Librazh Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l

Figura. 11. Analiza mjedisore e Bashkisë Librazhd. Burimi: Bashkija Librazh Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l

Figura nr. 12. Harta e mbetjeve bashkia Librazhd

Figura nr.13. Zonat me kushtëzim mjedisor Bashkia Librazhd

Figura nr. 14. Qyteti i Librazhdit dhe Lumi Shkumbin (R. Shkurti)

Figura nr. 15. Pamje nga Qyteti, Mjedisi natyror, hidrik, alpin dhe historik i territorit të Bashkisë Librazhd (R. Shkurti).

LISTA E TABELAVE

Tabela nr.1. Struktura territoriale dhe demografike e Bashkisë Librazhd (Census 2011)

Tabela nr. 2. Numri i popullsisë dhe Shpërndarja sipas grup moshave-Bashkia Librazhd.

Tabela nr.3. Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative

Tabela nr. 4. Shpërndarja e popullsisë sipas censusit dhe gjendjes civile 2011

Tabela nr. 5. Shpërndarja e popullsisë sipas Gjendjes civile

Tabela nr.6. Kategorizimi i zonave të mbrojtura-Bashkia Librazhd

Tabela nr.7. Klasifikimi i cilësisë së ujrave të ëmbla natyrorë në lidhje me parametrat e përgjithshëm (Classification of the quality status for general parameters of fresh Waters (Bratli, 2000).

Tabela nr. 8. Klasifikimi i gjendjes cilësore të ujrave natyrore të ëmbla në lidhje me metalet e rënda, sedimente dhe organizmat peshq/Classification of the quality status for micropopullants in Waters, sediment and fishes (according Norwegian Institute for Water Research – NINA) (Bratli, 2000)

Tabela nr. 9. Vlerat e disa parametrave të ujit të lumenjëve / Some parameteres of eater quality in rivers

Tabela nr.10. Vecoritë kryesore hidrologjike të lumjenjëve më të mëdhenj shqiptar/Hydrographic features of some big Albanian rivers (Pano et al. 1984; Kabo 1900-1991)

Tabela nr. 11. Të dhënat e disa parametrave të cilësisë ujore të lumit Shkumbin/Ëater quality (mg/l) of Shkumbin river.

Tabela nr. 12. Vlerësimi i cilësisë së ujrave me anë të Bioindikatoreve

Tabela nr. 13. Statusi ekologjik i lumit Shkumbin përcaktuar me anë të katër indekseve të ndryshme biotik (FSHNT-2014).

Tabela nr. 14. Klasifikimi i cilësisë së ujrave sipas vlerave mesatare të përmbatjes së fosforit total, nitrates azotit amoniakal dhe nitriteve sipas UNECE (1992)

Tabela nr. 15. Lidhja midis Projekteve Strategjike të parashikuar në Planin Strategjik dhe objektivave të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Tabela nr. 16. Efektet mjedisore të zbatimit të Planit të përgjithshëm Vendor.

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku nr. 1. Grafiku i shpërndarjes së popullsisë sipas gjendjes civile 2012-2013.

Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike e Ph në lumin Shkumbin. (www.qpmt.al).

Grafiku nr. 3. Paraqitja grafike e oksigjenit të tretur në lumin Shkumbin. (www.qpmt.al).

Grafiku nr.4. Paraqitja grafike e BDO₅ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Grafiku nr. 5. Paraqitja grafike e P total në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Grafiku nr.6. Paraqitja grafike e vlerave të NH₄ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Grafiku nr.7. Paraqitja grafike e përmbatjes së NO₃ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Grafiku nr.8. Paraqitja grafike e përmbatjes së NO₂ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Grafiku nr.9. Përmbatja e Mn (µg/l) në lumin Shkumbin

Grafiku nr. 10. Përmbatja e Fe (µg/l)në lumin Shkumbin

Grafiku nr.11. Përmbatja e Zn (µg/l)në lumin Shkumbin

Grafiku nr.12. Përmbatja e Cu (µg/l)në lumin Shkumbin.

Grafiku nr.13. Përmbatja e TSS (mg/l) në lumin Shkumbin.

Grafiku nr.14. Përmbatja e DO (mg/l) në lumin Shkumbin

Grafiku nr.15. Përmbatja e NO₃-N (mg/l) në lumin Shkumbin

Grafiku nr.16. Përmbatja e NO₂-N (mg/l) në lumin Shkumbin.

Grafiku nr.17. Përmbatja e NH₄⁺-N (mg/l) në lumin Shkumbin.

Grafiku nr.18. Përmbatja e PO₄³⁻ (µgP/l) në lumin Shkumbin.

AKRONIME

AKM – Agjensia Kombëtare e Mjedisit

AKPT – Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

ASPT – Average Score Per Taxon

BE – Bashkimi European

CE – Këshilli i Europës

CO₂ – Dyoksid Karboni

Cu – Baker

DKU - Direktiva Kuadër e Ujit

EC – European Council

EPSO – European Plant Science Organisation

EPT – Ephemeroptera –Plecoptera – Trichoptera

EU – European Union

Fe – Hekur

FSHNT – Fakulteti Shkencave Natyrore Tiranë

GIS – Geographic Information System

GPS – Global Positioning System

INSTAT – Instituti i Statistikave Republika e Shqipërisë

KESH – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

MAIS – Macroinvertebrate Aggregated Index for Stream

MM – Ministria e Mjedisit

Mn – Mangan

NBO - Nevojë Biokimike për Oksigjenin

NH₃- Amoniak

NKO - Nevojë Kimike për Oksigjenin

NO_x – Okside Azoti

O₂ – Oksigjen

PMK – Grimcat e Pluhurit

PPK – Plani i Përgjithshëm Kombëtar

PPV – Plani i Përgjithshëm Vendor

P_{total} – Fosfori Total

SEA – Strategic Environmental Assessment

SKZHI- Strategjia Kombetare per Zhvillim te Integruar

SO₂ – dyoksid Squfur

SPVB – Strategjia dhe Plani i Veprimit per Biodiversitetin

SWRC – Stroud water Research Centre

TSS- Trupa ne Suspension

UNECE – United Nacional Economic Commision for Europe

VKM – Vendimi i Këshillit të Ministrave

VNM – Vlerësim i Ndikimit Mjedisor

VSM – Vlerësim Strategjik Mjedisor

WFD – Water Framework Directive

WHO – Organizata Botërore e Shëndetësisë

ZM - Zonë e Mbrojtur

Zn - Zinku

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

1. HYRJE

1.1 Qëllimi i Raportit

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë humane që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit” sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifik, ato i nënshtrohen një procedurë të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedor (VSM).

Raporti i Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të VSM për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd (PPV/2017-2030)

Hartimi i Raportit të VSM për Programe Plane Zhvillimore dhe Projekte të mëdha është detyrim ligjor.

Vlerësimi Strategjik Mjedor është një nga kërkesat për aprovimin e çdo plani të përgjithshëm vendor (PPV) në Shqipëri, bazuar në *Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar*, si dhe në përputhje me specifikimet e Ligjit 91/2013 për *“Vlerësimin strategjik Mjedor”* dhe ligjin 10440/2011 për *Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”.

Ligji 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedor ka ratifikuar direktivën e BE 2001/42/EC (EU Directive 2001/42/EC, Mbi Vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe Programeve në Mjedis)e njohur si direktiva VSM (SEA Directive), e cila kërkon hartimin dhe miratimin e një seri planesh e programesh për një proces Vlerësimi Mjedor në nivel strategjik. Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi është ndërthurja e kërkesave mjedisore në përgatitjen e planifikimeve dhe në procesin e vendimmarrjes, në përmirësimin e planeve që bëjnë të mundur mbrotjen dhe zhvillimin e mjedisit, sikurse dhe rritja e pjesmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes për problematika të lidhura me mjedisin. Ky proces ka të bëjë me përgatitjen e Raportit Strategjik Mjedor dhe miratimin e tij nga autoritetet përkatëse të Shtetit Shqiptar. Përgatitja e Raporti të Vlerësimit Strategjik Mjedor për bashkinë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Librazhd si pjesë argumentuese dhe shoqëruese e PPV, ka mbajtur në konsideratë kërkesat e nenit 7 të ligjit 91/2013 për fazat nëpër të cilat duhet të kaloj procesi si dhe kërkesat e nenit 10, po të njëjtit ligj, lidhur me përmbatjen si dhe gjithë informacionin që duhet të përmbaj ky raport studimor.

Mbështetur në referencat ligjore të sipërcituara VSM përfshinë këto kërkesa:

1. Përmbledhje të informacionit bazë të përdorur për hartimin e Raportit të VSM;
2. Përmbatja dhe objektivat kryesore të planit të Përgjithshëm Vendor dhe lidhjet e tij me planet dhe programet e tjera;
3. Një përshkrim i metodikës së zbatuar në hartimin e Raportit të Vlerësimit strategjik Mjedisor;
4. Aspekte të rëndësishme të kushteve ekzistuese mjedisore dhe shëndetsore si dhe zhvillimet e mundshme në rast se ky plan nuk aplikohet;
5. Karakteristikat mjedisore dhe shëndetsore të zonës të cilat mund të impaktohen në mënyrë të konsiderueshme nga zbatimi i planit të PPV të hartuar nga grupi i konsulencës.
6. Çështjet mjedisore që janë të përfshira në implementimin e planit dhe të programit.
7. Objektivat mjedisore të vendosura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe ato që janë të rëndësishme për planin apo programet dhe mënyrën sesi këto objektiva dhe çështje të tjera mjedisore janë marrë në konsideratë në realizimin e këtij plani apo program;
8. Pasojat mjedisore më të qënësishme, ku përfshihen ato mbi shëndetin publik, florën dhe faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, cilësinë e ujit dhe të ajrit, peisazhin, trashëgiminë natyrore, trashëgiminë kulturore, asetet materiale, etj, si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve, ku këto efekte duhet të përfshijnë edhe efekte anësore, kumulative, sinergjike, efekte afat shkurtër, të mesëm apo të gjatë; të përhershme apo të përkohshme, pozitive apo negative;
9. Masat që duhen të ndërmerren për të evituar, parandaluar, reduktuar çdo impakt mbi mjedisin dhe shëndetin, që mund të nevojiten gjatë zbatimit të planit apo programit;
10. Një përshkrim të arsyeve të përzgjedhjes së alternativave së bashku më përshkrimin se si është kryer vlerësimi, duke përfshirë këtu edhe vështirësitë e hasura në grumbullimin e informacioneve, të metat teknike dhe mungesa e njohurive;
11. Identifikimi i investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor të propozuar;
12. Masat e marra për monitorimin e pasojave mjedisore dhe shëndetësore në vënien në zbatimin të planit apo programit;
13. Pasojat e mundshme ndërkufitare në mjedis dhe shëndet publik; si dhe
14. Një përmbledhje jo teknike të informacionit të grumbulluar.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Plani i Përgjithshëm Vendor për numrin e madh dhe diversitetin e problematikave që trajton kërkon konsultim me një gamë të konsiderueshme materiali të dokumentuar. Pra bëhet fjalë për studimin e planeve, programeve, raporteve, projekteve, studimeve dhe literature teknike nga sektor të ndryshëm të ekonomisë, social, etj. Ky dokumentacion që u siguroi nga bashkëpunimi me Bashkinë Librazhd, institucione të tjera publike, kërkime në internet së bashku me materialet që posedonte grupi i punës shërbeu si suport për hartimin e raportit të VSM.

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd përbën dokumentin e parë të këtij lloji që hartohet për këtë qëllim, dhe si i tillë besohet se do të mundësojë që zhvillimet e ardhshme hapësinore vendore të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin vendor mbi Mjedisin si dhe direktivat e konventat ndërkombëtare.

Proçesi i hartimit të VSM sipas metodologjisë së konceptuar kalon në disa faza që mundësojnë shkrimin e një produkti që të pasqyrojë saktë impaktin në mjedis të PPV të hartuar nga grupi i punës dhe që të mundësojë implementimin e tij sa më të qëndrueshëm nga pikpamja ekologjike (Mjedisore).

Mbi bazën e faktit të domosdoshmërisë së hartimit të raportit të VSM për Planin e përgjithshëm Vendor (PPV) për Bashkinë Librazhd u realizua faza para-vlerësuese, që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave bazike për mjedisin dhe analiza e planeve dhe programeve të tjera përkatëse nga nivele të ndryshme vendimarrëse. Mbi këto të dhëna u identifikuan një tërësi të dhënash shqetësuese por njëheraz dhe të rëndësishme për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm në hapësirën e shtrirjes së bashkisë së Librazhd. Ndër çështjet më të qënësishme të identifikuara konstatojmë: menaxhimi i mbetjeve të ngurta, cilësia e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, trajtimi i ujrave të zeza, mbrotja dhe zhvillimi i biodiversitetit, pyjeve dhe zonave të mbrojtura, trashëgimia natyrore dhe kulturore, modele të shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës, cilësia e ajrit, etj. Vlerësimi i gjendjes aktuale mjedisore dhe ballafaqimi i zhvillimit të tij në përputhje me planin e Përgjithshëm vendor u trajtua në bazë të tre skenarëve mjedisore të cilat zhvillohen në koherencë me alternativat (skenarët) e PPV dhe që analizohen në fazën vlerësuese të VSM, përkatësisht **alternativa (skenari) zero**, alternativa e të mos bërit asgjë, pa ndërhyrje strukturale strategjike në relief, **alternativa (skenari) 01** që parashikon maksimizimin e zonave të transformimit dhe zonave në rritje brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të konsoliduar, si ato banuese ashtu edhe ato prodhuese me një sistem, të përqendruar fuqishëm tek infrastruktura lidhëse. Si dhe **alternativa (skenari) 02** që parashikon maksimizimin e ndërhyrjeve me karakter ekologjik ambiental dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban dhe ambiental në tërësi, në mënyrë të veçantë me qëllim të zvogëlimit të presioneve antropike, duke favorizuar rigjenerimin e ndërtesave në një sistem me performancë më të mirë të energjisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH D

Gjithashtu kjo fazë përgatitore u shoqërua me përcaktimin e **objektivave mjedisore, qëllimet dhe treguesit** në mënyrë që të parashikohen ndikimet, por dhe njëkohësisht të përshkruhen hollësisht mundësitë e minimizimit apo eliminimit të impaktit negativ të PPV - 2030 në mjedis.

Objektivat Mjedisore të analizuar ndahen në **katër grupe**:

I - Biodiversiteti, peisazhi dhe shfrytëzimi i tokës,

II - Menaxhimi i mbetjeve të ngurta,

III - Mbrojtja e ujit dhe

IV - Ndryshimi i klimës dhe efikasiteti i energjisë.

Ato në pjesën më të madhe karakterizohen nga qëllimi për ta përmirësuar gjendjen aktuale të mjedisit në Bashkinë Librazhd, pjesa më e madhe e treguesve dhe e objektivave janë të matshëm dhe ato duhet të shfrytëzohen herë pas here për ta mbikëqyrë përparimin e arritjes së objektivave të caktuara.

1.2. Autoritetet Përgjegjëse

Ky Raport i Vlerësimit Strategjik Mjedor (VSM) është hartuar nga grupi i ekspertëve mjedor me kërkesë të grupit të konsulencës *A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l*, për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd (PPV), duke respektuar kërkesat e ligjit Shqiptar. Këndvështrimet e shprehura në këtë raport nuk janë domosdoshmërisht këndvështrime të grupit të konsulencës së PPV-së, por as dhe të Bashkisë Librazhd. Raporti është hartuar në konsultë me grupin e punës së PPV-së dhe në bazë të relacionit teknik mbi Planin e përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit të Bashkisë Librazhd të hartuar nga specialistët përkatës.

Autoriteti përgjegjës për VSM është Bashkia e Librazhd. Raporti është përgatitur në kuadrin e plotësimit të dosjes së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd, i cili do t'ju dorëzohet autoriteteve përkatëse për miratim konform Legjislacionit Shqiptar.

Grupi i punës:

-  Prof. Asoc. Dr Rexhep Shkurti Ekspert Mjedor, Biolog, vendim Nr.6 Nr.21 regj
-  Masimo Fadel urbanist Team leader
-  Entela Cano inxhinieri Hidroteknike
-  Arber Buzi project coordinator, arkitekt
-  ANTONELLA FAGGIAN ekonomiste urbane

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- ✚ MEFAIL HALILAJ Planifikues transporti
- ✚ DRITAN BUZI inxhinier transporti
- ✚ NAZMI DASH! GIS Expert)

1.3. Ekipi i Konsulencës

Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Librazhd është ideuar dhe drejtuar nga kompanitë konsulente *A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l*, të cilat kanë nëshkruar kontratën përkatës me Ministrinë e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të planifikimit të Territorit, konform Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *“Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar dhe në akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe referuar VKM nr.671, datë 29.07.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”*

Ekipi i Konsulencës përbëhet kryesisht në pjesën më të madhe të tij nga specialist urbanistik, arkitekt urban, etj. Pjesë e këtij ekipi janë bërë edhe disa ekspertë vendas dhe të huaj, me një eksperiencë dhe reputacion në fushën e mjedisit.

1.4. Konceptimi i përmbatjes së VSM-së

1.4.1. Përkufizime për VSM

Një nga vizionet më moderne për vlerësimin e ndikimit në mjedis është institucioni i Vlerësimit Strategjik Mjedor, i cili zbatohet përmes hartimit të një studimi mjedor, në fazën primare të një plani strategjik zhvillimi, në nivel politik, projekti, programi, d.m.th jo të një projekti individual. Ky studim mjedor quhet Vlerësim Strategjik Mjedor (VSM) dhe në Evropë gjen zbatim vetëm në plane dhe programe - dhe jo në politika - në përputhje me Direktivën 2001/42 KE. Në literaturën ndërkombëtare referimi i parë për Vlerësimin Strategjik Mjedor, sipas Noble (2010), kryhet nga Wood (1989), i cili e përmend si vlerësim mjedor të politikave, planeve dhe programeve, i cili ka një karakter strategjik në lidhje me atë të projekteve individuale.

VSM merr parasysh objektivat e përgjithshme të zhvillimit të një vendi apo rajoni, efektet kumulative të planifikimit strategjik të propozuar, problemet globale mjedisore, duke lidhur planifikimin strategjik me to (p.sh. efekti serë), por edhe gjithë çështjet e tjera të zhvillimit të qëndrueshëm, për të cilat janë zhvilluar strategji evropiane dhe kombëtare dhe janë vendosur objektiva konkrete p.sh. reduktim të ndotësve serë, menaxhim të integruar të burimeve ujore në nivel baseni, menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, etj

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHË

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të ndikimeve mjedisore të një politike, të një plani apo programi, duke përfshirë një raport me rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit dhe me konkluzionet e studimit, me qëllim për të ndihmuar në vendimmarrje të një planifikimi strategjik (Therivel dhe Partidario, 1996). Përkufizime të tjera të rëndësishme që janë dhënë në literaturën ndërkombëtare po paraqiten si më poshtë:

- VSM është një vlerësim i parë i skenarëve alternativë dhe i propozimeve që kanë lidhje me planet e propozuara apo tashmë të miratuara, me programe dhe politika, në kuadër të një vizioni më të gjerë strategjik mjedisor dhe të një sërë objektivash që duhen plotësuar. Qëllimi është që ky vlerësim të drejtojë për nga përzgjedhja e alternativave më të mira, me qëllim që në planifikim të arrihet efekti i dëshiruar (Noble, 2000).
- VSM përbën një proces kompleks dhe të strukturuar, që ka si qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të propozimeve strategjike (të politikave, planeve, programeve) dhe propozimin e masave të mundshme për të trajtuar ose ndaluar efektet apo masat të karakterit parandalues për shmangien e shfaqjes së ndikimeve apo nxitjen e ndikimeve/efekteve pozitive të propozimeve strategjike në mjedis. Ky proces përfshin edhe një raport me shkrim me rezultatet e konsultimeve. Rezultatet e këtij procesi përdoren nga autoritetet kompetente gjatë vendimmarrjes për zbatimin e planifikimit strategjik (Risse et al., 2003).
- VSM përbën një proces sistematik për vlerësimin e ndikimeve mjedisore nga politikat, planet dhe programet e propozuara, me qëllim për tu siguruar se merren parasysh, qysh në një fazë të hershme të procedurës së vendimmarrjes, çështjet mjedisore të propozimeve të tyre, në kombinim me parametra ekonomikë dhe socialë (Sadler & Verheem, 1996). Ky përkufizim thekson se VSM përbën një proces të tërë - merr pjesë paralelisht me procesin e planifikimit strategjik - dhe nënvizon se rezultatet e VSM merren parasysh në vendimet përfundimtare mbi planifikimin strategjik (Glasson et al, 2012.). Theksohet se ky përkufizim është ndër të parët që është dhënë për VSM dhe mbulon plotësisht objektin e tij, dhe referohet në pjesën më të madhe të punimeve dhe artikujve shkencorë që kanë si objekt VSM.
- VSM përbën një mjet të rëndësishëm i cili ndihmon që faktorët mjedisorë të përfshihen në marrjen e vendimeve në nivel strategjik dhe për rrjedhim, ofron një përpjekje efikase në arritjen e qëllimit për një zhvillim të qëndrueshëm (Therivel dhe Partidario, 1996). Siguron integrimin e çështjeve mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes, siguron një kuadër për vazhdimësinë e veprimeve në nivel të propozimeve strategjike, kontribuon në politikën e zgjeruar të planifikimit dhe ka potencial të identifikojë ndikime të mundshme mjedisore që në fazat e hershme, para se të zhvillohen planet strategjike dhe programet (Desmond, 2007).
- VSM vlerëson ndikimin e politikave, planeve dhe programeve në nivel strategjik, si rrjedhim, kërkohen metodologji të ndryshme të vlerësimit mjedisor të ndikimeve në

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

lidhje me ato të Studimeve të Ndikimeve Mjedisore të projekteve individuale dhe ka shumë vështirësi, pasi p.sh. nga një plan apo një program mund të gjenerojnë shumë projekte të ndryshme në zbatim të tyre (Dalal-Clayton & Sadler, 2003). Gjithashtu, ndarja ndërmjet politikave, planeve dhe programeve është shpeshherë fluide dhe e paqartë, pasi nuk ka kufijë të qarta ndarës ndërmjet tyre dhe në lidhje me propozimet që ato bëjnë. Në qoftë se merret parasysh akoma edhe ekzistenca e një numri të madh projektesh dhe programesh mbi tema të ndryshme p.sh. energjia, transporti, turizmi, akuakultura, industria etj dhe shpesh herë ka mbivendosje në propozimet e tyre, atëherë është e kuptueshme se po zhvillohet një kompleksitet edhe në vlerësimin përkatës të ndikimit të tyre në mjedis përmes VSM (Fischer, 2003). Së fundi, VSM, në varësi të fushës së tyre të zbatimit, ndahen në VSM të bazuara në politika d.m.th në thelb në politika qeveritare, VSM sektoriale për planet dhe programet përkatëse p.sh. për turizmin, zhvillimin industrial, menaxhimin e zonave bregdetare apo zonat malore, promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, etj, dhe VSM hapësinore që kanë lidhje me nivele të ndryshme të planeve ose programeve hapësinore që kanë referencë në zona të veçanta gjeografike në të cilat zbatohen planet dhe programet në fjalë (Noble, 2010).

1.4.2. Rëndësia e VSM

VSM kërkohet që të mbulojë një "boshllëk" të institucionit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve, dmth, VSM kanë mundësinë të mbulojnë disa të meta të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis. (Therivel & Partidario, 1996):

- VSM janë të dobishme për shkak se ato kontribuojnë në konfigurimin e një kuadri strategjik – plani ose programi - më miqësor për mjedisin, brenda të cilit do të ndërtohen në të ardhmen projekte të ndryshme zhvillimore dhe projektete infrastrukturës (Wood, 2003). Është karakteristike, ndërsa në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shqyrtohen ndikimet mjedisore të një veprimi të planifikuar zhvillimi, me qëllim minimizimin e tyre, me VSM ngrihen pyetje me karakter parandalues, në lidhje me cilat alternativë zhvillimi është më e mirë dhe cilat objektiva duhet të plotësohen në të ardhmen (Noble, 2010).
- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nuk marrin parasysh efektet kumulative që rezultojnë nga projekte të tjera dhe aktivitetet në zonën e studimit, të cilat mund të jenë në fazë ndërtimit apo funksionimit (Glasson et al., 2012), ndërsa VSM kanë mundësinë të vlerësojnë ndikimet kumulative.
- VSM kanë mundësi për të vlerësuar në mënyrë mjedisore propozimet alternative të planeve dhe programeve, në mënyrë që zgjidhet për çdo herë ajo që është më miqësore me mjedisin, ndërsa Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shpesh herë nuk mund të merren me

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

projekte alternative apo masa alternative për trajtimin e ndikimeve, sepse variantet e skenarëve alternativë kufizohen nga hartimi i projektit në nivel strategjik, i cili është paraprirë në kohë (Glasson et al., 2012).

- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis shumë herë është i nevojshëm të hartohet në një periudhë kohore të shkurtër, ose përshkak të kufizimeve financiare, ose që të mos vonohet ndërtimi i projektit të propozuar. Kjo ndihmon për të reduktuar materialin e mbledhur të informacionit dhe cilësisë së analizës së tij. Përkatësisht e reduktuar dhe e dobët mund të jetë edhe përfshirja e qytetarëve në procesin Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Glasson et al., 2012). Përkundrazi, VSM për shkak se shqyrtojnë planet dhe programet që kanë natyrë strategjike, paraqesin plotësinë paraqitjen e të dhënave mbi mjedisin ekzistues.
- Nga ana tjetër, kur një VSM është hartuar në stadet fillestare të procedurës së vendimmarrjes dhe i cili përshkruan gjithë potencialin e mundshëm të zhvillimit të një rajoni, përmes planifikimit strategjik të tij, atëherë sigurohen zgjidhje alternative, mirren në konsideratë ndikimet kumulative, sigurohet përfshirja e qytetarëve në këto procedura dhe vendimet për projekte të veçuara merren përmes një mjedisi parandalues, i cili është paracaktuar përmes VSM (Therivel, 2004). VSM mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm, pasi shtrihon parimet dhe teknikat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në një nivel më strategjik. Kjo do të nënkuptonte adaptimin e problematikës së parametrave mjedisorë në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet: të politikave, të planeve dhe të programeve (Arce & Gullon, 2000). Si rrjedhim, studiohen pasojat mjedisore dhe masat për ti përballuar ato në nivel strategjik, ndërsa ka dhe transparencë më të madhe në procesin e vendimmarrjes dhe një përfshirje më efektive të qytetarëve. Por që një VSM të mund të përshkruhet si "i qëndrueshëm", duhet të mos ketë si qëllim të vetëm minimizimin e ndikimeve të një plani apo programi në mjedis, por të formësojë veprimet dhe objektivat e tyre, në mënyrë të tillë që ato të plotësojnë kriteret e objektivat afatmesme të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Gjithashtu, VSM merr në konsideratë projektet afat-gjatë dhe të një shkalle më të madhe, kështu ai mund të përqendrohet në rrugë të ndryshme ose alternative që çojnë në arritjen e objektiveve specifike mjedisore të planeve ose programeve. Për më tepër, shqyrtimi i zgjidhjeve alternative nga VSM, sipas Noble (2000), përbën kusht kyç për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, pasi gjatë njohjes së zgjidhjeve alternative, kërkohet përfshirja e elementëve socioekonomike dhe biofizike, por edhe mirëkuptimi i lidhjes së tyre të ndërsjellë dhe të ndërvarur. Për të përcaktuar se cilat nga zgjidhjet alternative kanë më shumë gjasa për të kontribuar në qëndrueshmërinë, është e nevojshme të përcaktohen kriteret në bazë të të cilave merren vendimet e zbatimit të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

planifikimit strategjik. Këto kritere janë të lidhura kryesisht me besueshmërinë e procesit të VSM p.sh. në çështjet e konsultimit, por dhe të materialeve të informimit që përdoren. Përveç kësaj, VSM inkurajon konsultimet në mes të palëve të përfshira dhe institucioneve, dhe forcon pjesëmarrjen publike akoma edhe në konsultimin e vet projektit ose programit të propozuar. Përmes konsultimeve të kryera me palët e interesuara, si pjesë e procesit të VSM, është e mundur të identifikohen çështje, nevoja, shqetësime, vlera dhe ide nga ato grupe dhe pjesë të shoqërisë që mund të preken nga një politikë e veçantë, një plan ose një program (Dalal-Clayton & Sadler, 1999).

Përveç sa më sipër, Von Seht (1999) thekson përfitime edhe më konkrete nga zbatimi i VSM të cilat kanë lidhje me sa më poshtë:

- Rrit ndjeshëm promovimin e parimit parandalues në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve.
- Detyron planet dhe programet strategjike për të shqyrtuar akoma edhe më shumë zgjidhje alternative, skenarë dhe propozime.
- Rrit shanset për vlerësimin e efekteve kumulative, ndikimeve sinergjike dhe indirekte, në krahasim me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve.
- Lidh ndikimet e pritura me problemet rajonale dhe globale të mjedisit.
- Forcon transparencën dhe besueshmërinë e proçeseve vendimmarrëse, pasi nxit konsultimet dhe kontribuon në ndërgjegjësimin social.
- Ofron më shumë besim tek investitorët e mundshëm dhe të kushtëzuar, kontribuon në hartimin e Studimeve më të mira të Ndikimeve në Mjedis, ndërsa njëkohësisht në disa raste është i mundur edhe reduktimi i kohës së nevojshme për lejen mjedisore të disa projekteve dhe aktiviteteve.

1.4.3. Evidentimi i problematikës së zbatimit të VSM-së

VSM përballlet me një numër çështjesh teknike dhe proçedurale, probleme të natyrave të ndryshme. Në lidhje me çështjet teknike, projektet e ardhshme të zhvillimit të një zone, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i një plani ose programi, mund të jenë të shumta dhe për këtë arsye, vlerësimi i ndikimit në mjedis krijon një kompleksitet analitik. Informacioni mbi kushtet mjedisore aktuale dhe sidomos të ardhmen - pasi hetohet evolucioni i mjedisit të zonës së studimit, pa miratimin e planit ose programit të propozuar - është zakonisht i kufizuar, siç edhe informacioni mbi natyrën, shkallën dhe pozicionimin e saktë të projekteve të ardhshme të propozuara, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i planeve dhe programeve (Von Seht, 1999). Shpesh, numri i madh i alternativave në projektet e propozuara kontribuon negativisht në kompleksitetin e VSM. Përveç kësaj, VSM përbën një institucion relativisht të ri, në mënyrë të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

veçantë në Shqipëri, fakt që do të thotë se nuk ka përvojë të veçantë për adresimin e çdo problemi apo zhvillimin e metodologjisë së përshtatshme për përgatitjen e VSM.

Përveç problemeve teknike, të rëndësishme, dhe në veçanti të vështira, paraqiten aspektet procedurale të proceseve vendimmarrëse. Politikën, planet dhe programet paraqiten përgjithësisht me një mënyrë relativisht abstrakte dhe evoluohen vazhdimisht. Për shkak të kësaj dinamike të tyre, është i domosdoshëm studimi i vazhdueshëm i ndikimeve të tyre në mjedis, gjatë gjithë rrjedhës së proceseve vendimmarrëse, fakt i cili e bën Strategjinë e Studimit të Ndikimeve në Mjedis akoma edhe më të vështirë. Përveç kësaj, nuk ka kufijë të qartë për ndarjen e politikave të ndryshme, planeve dhe programeve, domethënë, nuk mund të ketë ndarje të plotë të objekteve midis tre planeve, një për transport, një për energjinë dhe një për përdorimin e tokës, pasi ekzistojnë marrëdhënie të ndikimit të ndërsjellë në mes tyre. Gjithashtu, vihet re se efektet e një politike varen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mënyra me të cilën u dha interpretimi në politikë, me qëllim zbatimin e saj, realizimin e saj. Në fund të fundit vendimi është një politikë procesi, fakt që do të thotë se palët e vendimmarrjes nuk do të marrin parasysh vetëm efektet mjedisore nga zbatimi i një politike, i një plani apo një programi, por do të përlogarisin dhe vet interesat e tyre, si edhe ndikimet në nivel politike (Glasson et al., 2012).

Përveç çështjeve të mësipërme, Noble (2003) argumenton se është veçanërisht e vështirë për tu studiuar efektiviteti i një VSM, pasi ai, në një masë të madhe, varet jo vetëm nga efektet e tij dhe nga mënyra se si ai ndikon vendimmarrjen me mbrojtjen e mjedisit, por edhe nga cilësia e procesit të përgjithshëm, siç përcaktohet nga proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimet. Akoma edhe sistemet e ndryshme dhe kuadri institucional i VSM në çdo vend, formësojnë kritere të ndryshme për vlerësimin e efektivitetit të tij, të cilat përcaktohen nga direktivat përkatëse dhe kuadri ligjor (Noble, 2003).

Si rrjedhim krahasimi midis VSM të ndryshme të vendeve të ndryshme nuk është menjëherë i mundshëm dhe kjo krijon ngatërresë/komplikim në shkëmbimin e pikëpamjeve dhe përvojave, në mënyrë që të realizohet zhvillimi i tyre shkencor. Le të shënohet në këtë pikë se në rastet kur ka çështje të ndotjes ndërkufitare dhe menaxhimit të burimeve natyrore, krijohet nevoja e zbatimit të një VSM ndërkufitare, me gjithë vështirësitë që ai përfshin (Morrison-Saunders dhe Arteve, 2004).

Një pikëpamje e ngjashme shprehet edhe nga Fischer (2002a, 2002b), i cili pas një kërkimi dhe studimi mbi VSM të përgatitura për politika, plane dhe programe, arrin në përfundimin se kërkojnë një kërkim dhe studim të mëtejshëm çështjet e mëposhtme:

- Referenca në lidhje me çështje social-ekonomike në VSM e projekte.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Aftësia që VSM për plane dhe programe të kërkojnë skenarë alternativë që të kenë lidhje me zhvillimin dhe rritjen e sektorëve të tjerë përveç atij që po studiohet.
- Mënyra integritit të plotë të VSM në projektin për të cilin po përgatitet.
- Nevoja e pjesëmarrjes së publikut në VSM për programet - pjesëmarrja publike është zakonisht vetëm në VSM për projekte.

Së fundi, sipas Therivel (2004), ka disa çështje në Direktivën Evropiane 2001/42 që kanë nevojë për sqarime p.sh. referohen faktorët mjedisor të biodiversitetit, të florës dhe faunës, por cilat janë dallimi i qartë midis këtyre tre faktorëve të mjedisit? Gjithashtu, çfarë saktësisht nënkupton me shprehjen "asete"? Dhe pse ato, ashtu siç edhe shëndeti i njeriut hynë në VSM dhe nuk miratohen dhe parametra të tjerë social ekonomike? Për më tepër, shkalla e detajit në përshkrimin e projektit apo programit të propozuar, në situatën ekzistuese mjedisore, në objektivat dhe fizibilitetin e projektit ose programit, e kombinuar me referencën e nevojshme në projekte dhe programe të tjera me të cilat ka lidhje, mbetet të përcaktohet nga përvoja e ardhshme e studiuesve dhe ndoshta në varësi të llojit të projektit apo programit të propozuar dhe shkallën e aplikimit të tij. Për më tepër, edhe detaje të tjera të tilla si p.sh. cilat organizma dhe institucione duhet të marrin pjesë në konsultime, por edhe se ku me saktësi ndalon referimi i skenarëve alternativë, mbetet të përcaktohet përsëri nga aplikimi i VSM në praktikë (Therivel, 2004).

1.5. Koncepti i zhvillimit urban dhe Plani i Përgjithshëm Vendor

Njësitë e organizuara vendore janë të ngjashme me organizmat në atë ç'ka konsumojnë, burimet natyrore dhe të energjisë, proceset e përpunimit dhe nxjerrjen e mbeturinave. Shoqëria e organizuar në format e saj transformon materialet e papërpunuara pjesë e mjedisit, lëndët djegëse dhe ujin, në mjedisin e ndërtuar, biomasës të njeriut dhe të mbeturinave. Sipas Wolman metabolizmi urban është një metodë për analizimin e komuniteteve përmes kuantifikimit të inputeve - të ujit, ushqimit dhe energjisë, në outputet - ujëra të zeza, mbetje të ngurta dhe ndotës të ajrit dhe mjedisit tërësor, duke ndjekur transformin e këtyre tre flukseve në territor. Tre janë sfidat me të cilat përballen zonat urbane: 1) *menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë*; 2) *largimi i ujërave të zeza* dhe 3) *kontrollin e ndotjes së ajrit*. Në legjislacion shqiptar koncepti i Metabolizmit bazohet në përcaktimet e Nenit 2 të VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", gjithashtu në nenin 53 përcaktohet detyrimi i hartimit të Analizës Metabolike dhe asaj të Thelluar si pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Relacioni i grupit të konsulentëve të PPV është përqëndruar në analizën e Fluksit të energjisë, fluksit të ujit, fluksit të ushqimit dhe fluksit të mbetjeve, duke identifikuar hyrjet dhe daljet për

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

secilin fluks, të cilat krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionoj si një i tërë.

1.6. Përmbatja e Planit të përgjithshëm vendor

Qëllimi primar i projektit për hartimin e Planit të Përgjithshëm vendor është rritja e kapaciteteve të menaxhimit dhe shfrytëzimit të hapësirës së bashkisë duke hartuar dhe implementuar plane dhe programe rregulluese.

Përgatitjen e planeve të fizibilitetit strategjik, programeve rregullatore dhe investimeve kapitale në përputhje me ligjet e miratuara, standardet kombëtare, të mbështetura nga qeveritë lokale bashkiake. Zbatimi i konsultimit të vazhdueshëm publik për informimin dhe edukimin e aktorëve lokal, në lidhje me rëndësinë e planifikimit bazuar në treg, të menaxhimit urban të hapësirës dhe mjedisit.

Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014, Datë 31.07.2014, *“Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar dhe në akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe referuar VKM nr.671, datë 29.07.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”*, një ndër analizat e para që zhvillohet në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi, është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë, konkretisht për territorin e bashkisë Librazhd. Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bërë duke i strukturuar ato në disa kategori kryesore. Ato janë ndarë në plane apo strategji të nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor. Prej secilit dokument, janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore, të cilat mund të kenë implikime në hartimin e Planit të ri të Përgjithshëm Vendor të bashkisë së re Librazhd.

SKENARI 00 siguron ruajtjen e gjendjes aktuale të territorit, pa ndërhyrje strukturale strategjike në relief.

SKENARI 01 parashikon maksimizimin e zonave të transformimit dhe zonave në rritje brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të konsoliduar, si ato banuese ashtu edhe ato prodhuese me një sistem, të përqendruar fuqishëm tek infrastruktura lidhëse.

SKENARI 02 parashikon maksimizimin e ndërhyrjeve me karakter ekologjik ambiental dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban dhe ambiental në tërësi, në mënyrë të veçantë me qëllim të zvogëlimit të presioneve antropike, duke favorizuar rigjenerimin e ndërtesave në një sistem me performancë më të mirë të energjisë.

2. METODOLOGJIA DHE PËRMBAJTJA E RAPORTIT MJEDISOR TË VSM

VSM është një metodë sistematike për marrjen në konsideratë të efekteve të planeve dhe programeve strategjike si dhe për reduktimin e disa presioneve ekzistuese ose të parashikuara mbi mjedisin në zonën ku ato do të zbatohet. Metodologjia e hartimit të VSM është në përputhje me ligjin 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili është në përputhshmëri

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

me direktivën e BE 2001/42/CE “Mbi Vlerësimin e efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis” si dhe me ligjin 10440/2011 si dhe dokumentet në nivel BE , por edhe qasje të tjera të suksesshme që janë përdorur sot në vlerësime Planesh të ngjashme në Evropë, duke pasur si qëllim një kornizë të kuptueshme vlerësimi që identifikon pikat kritike dhe thelbësore që duhen drejtuar në vlerësimin e impakteve të mundshme në mjedis të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd.

VSM mund të konsiderohet si mjeti i përshtatshëm për të arritur në vendime të drejta mbi planifikimin për çështjet si:

- Integrimi e konsideratave mjedisore në planet strategjike/planifikimin territorial si dhe në procesin e vendimmarrjes për investimet në zonën në studim.
- Vlerësimin e alternativave të planeve të zhvillimit dhe në kontributin për orientimin e rritjes, përdorimit të tokës dhe zgjedhjeve për investimet e infrastrukturës.
- Përmirësimi i komponentëve mbrojtës të Planit ndaj mjedisit.
- Ndikimet sasiore dhe cilësore mbi burimet natyrore dhe kapacitetet mbajtëse të këtyre burimeve me qëllim pranueshmërinë e implementimit të qëndrueshëm të planit të Përgjithshëm Vendor në bashkinë Librazhd.

Ky raport i VSM ka për qëllim sigurimin e një mjeti të nevojshëm që mund të kuptohet nga të gjithë, si nga publiku ashtu edhe nga autoritetet kompetente, në përputhje me **parimet e transparencës dhe konsultimeve efektive me publikun në procesin e vendimmarrjes**, që nënvizohet edhe në ligjin 91/2013 dhe në direktivën e BE 2001/42/EC.

Prandaj VSM synon që në çdo fazë të zbatimit të prioriteteve, projekteve të propozuara në PPV të identifikoj rrezikun potencial mjedisor dhe ndërkohë të propozoj masat e duhura që duhen ndërmarrë sipas fazave dhe etapave vepruese për reduktimin, minimizimin apo eliminimin e rreziqeve apo presioneve të zhvillimit ndaj mjedisit.

Ky studim VSM-je është kryer në lidhje të ngushtë me Planin e Përgjithshëm vendor të Bashkisë Librazhd, i cili përmban tre komponentë kryesore:

- A. Zhvillimi social ekonomik i infrastrukturës
- B. Organizimi hapësinor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban
- C. Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Kështu që VSM duhet që patjetër të përfshij këto tre komponentë bazë të PPV-së që në relacionin përkatës janë zbërthyer në objektiva specifike dhe projekte konkrete që materializojnë Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd. Por njëkohësisht VSM-ja synon përputhshmërinë midis elementëve struktural të PPV-së dhe kërkesave mjedisore për mbrotjen dhe zhvillimin e saj, të materializuara nëpërmjet objektivave, veprimtarive konkrete, masave të parashikuara dhe monitorimit mjedisor.

Struktura metodologjike e hartimit të VSM-së në lidhje me Planin e përgjithshëm Vendor të bashkisë Librazhd përmban këto element dhe njëpasnjëshmëri veprimi për prodhimin e produktit përfundimtar që është Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Struktura metodologjike e VSM në lidhje me veçoritë e PPV së bashkisë Librazhd dhe në përputhje me Legjislacionin Shqiptar

Verifikimi situatës aktuale dhe kushteve mjedisore të Bashkisë librazhd

Shënim: Ky vlerësim bazohet në konsiderimin e të gjithë faktorëve të mjedisit, të strukturës hapsinore si pjesë atraktive për komunitetin, në njehsimin e impaktit të profilit social dhe ekonomik si dhe në evidentimin e presioneve të akumuluar mbi mjedisin.

<u>Mjedisin natyror dhe shëndetin human</u>	<u>Struktura hapsinore</u>	<u>Profili social ekonomik</u>	<u>Presionet mbi mjedisin</u>
1. Biodiversiteti, fauna, flora. Pyjet dhe Natyra; a. Biodiversiteti, fauna dhe flora; b. Zonat e mbrojtura dhe natyrore; 2. Trupat ujore; Burimet ujore, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore 3. Toka; a. Gjendja e tokës	1. Përdorimi i tokës dhe modele zhvillimi; a. Ndarja e përgjithshme e përdorimi i tokës b. Struktura e vendbanimeve 2. Akset dhe rrjeti i transportit; 3. Energjia;	➤ Demografia dhe shpërndarja hapsinore populsisë; ➤ Ekonomia dhe punësimi; a. Bujqësia b. Industria c. Turizmi d. Sektori publik	1. Rritja urban/mjedis dhe zona e gjelbër; 2. Kufizimet e furnizimit me ujë; 3. Depozitimi i mbetjeve të ngurta dhe ujrave të ndotura; 4. Ndotja sipërfaqësore dhe nëntokësore; 5. Mbetjet e rrezikshme 6. Impakti i zhvillimit të industrisë;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

4. Klima dhe cilësia e ajrit; a. Kushtet klimaterike b. Ndotja dhe cilësia e ajrit 5. Menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura; a. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta b. Ujrat e zeza dhe ato urbane 6. Ndotja akustike;	4. Peisazhi dhe trashëgimi kulturore; a. Struktura e peisazhit b. Trashëgimia kulturore	➤ Perspektiva e investimeve dhe infrastruktura;	7. Presioni mbi tokën, biodiversitetin, monumentet e natyrës, llojet, trashëgiminë kulturore, etj.
--	--	--	---

Konsultimi me Grupet e interesit dhe konsiderata për planin e përgjithshëm të zhvillimit Vendor

Konsiderata për objektivat e qëndrueshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe strategjia mjedisore e vendit

Zhillimi i objektivave përkatës për VSM Bashkia Librazhd

Analiza e skenareve të propozuar kundrejt objektivave të VSM



Procesi i VSM përfshin si të dhënat bazë të Vlerësimit Strategjik Mjedor por dhe ato të parashikuara dhe të rivlerësuara të PPV-së. Proçesi është karakterizuar nga një ndërveprim midis ekipit të konsulentëve, personave të interesuar si dhe me zhvillimin e planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe presupozon vlerësimin e alternativave të parapara nga grupi i konsulentëve në funksion të materializimit të qëllimit kryesor trilateral të mishëruar në qëllimin e PPV-së, nëpërmjet zbatimit të objektivave sipas fushës së aplikimit.

Testimi i objektivave të planifikimit të Përgjithshëm Vendor në të tre drejtimet e parashikuara dhe që zbërthehen në objektiva specifik dhe projekte sipas njërës nga 5 fushat e Planifikimit Teritorial Vendor në ballafaqim me objektivat e VSM-së përbën konceptin kryesor të proçesit dhe është shumë e rëndësishme të theksojmë që komponentët e Planit të Përgjithshëm Vendor do të testohen në kapitullin për vlerësimin përkundrejt objektivave të VSM-së në të cilin trajtohen çështjet që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm duke relatuar dhe masat, indikatorët përkatës dhe struktura përgjegjëse për njehsimin e vlefshmërisë së tyre në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm mjedor.

Struktura e Raporti të VSM-së synon që të siguroj kohezion midis elementëve të trajtuar dhe që t'i shërbej qëllimit final për të cilin është ndërmarrë studimi, pra pasqyrimin ndërveprues dhe mundësinë e implementimit të qëndrueshëm nga pikpamja mjedisore e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Librazhd.

3. Analiza e VSM-së dhe sistemi GIS

Proçeset e zhvillimit të territorit, ekonomike, sociale dhe mjedisore janë në thelb hapësimore dhe është e vështirë që të kuptohen pa marrë parasysh dimensionin e tyre gjeografik. Marrëdhënia midis njeriut dhe mjedisit nuk mund të paraqitet pa një pozicion, sepse mjedisi

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

përshkruhet nëpërmjet marrëdhënieve topologjike ndërmjet objekteve fizike (p.sh. toka ose përbërja e saj në një pozicion të dhënë, ndotja ajrit në një copë tokë), po ashtu aktivitetet njerëzore ndikojnë në mjedis në mënyrë hapsinore.

Sistemet GIS në vendet e zhvilluara, kanë provuar që nga ndërtimi i tyre dhe aplikimi në planifikimin e territorit mund të ofrojë teori, metoda dhe aplikime që mbështesin disa kategori detyrash:

- Prodhon dhe mirëmban informacionin gjeografik;
- Mbështet aksesin e informacionit nga shumë përdorues (p.sh. infrastruktura e të dhënave hapësinore);
- Zgjidh problemin hapësinor (analiza hapësinore dhe modelim mjedisor);
- Mbështet vendim-marrjen e përbashkët (vendim-marrje në grup);
- Mbështet pjesëmarrjen e publikut.

GIS mund të konsiderohet si një nga mjetet më të avancuara që ekzistojnë në fushën e planifikimit, vendim-marrjes dhe menaxhimit, duke qenë i aftë të zgjidhë probleme komplekse – problem hapësinor – duke ruajtur balancën midis objektivave ekonomike, mjedisore dhe sociale. GIS është një mjet themelor, që nëse shfrytëzohet siç duhet, mund të ofrojë mbështetje efektive për planifikimin hapësinor dhe vendim-marrjen, kjo për arsye se, komponenti gjeografik i problemit është përcaktues kur synohet zhvillimi i qëndrueshëm. Prandaj teknologjitë gjeohapësinore duhet të jenë udhëheqese në implementimin teknik të platformave të hapura dhe të integruara për analiza të informacionit, zgjidhje problemesh në grup, planifikim dhe vendim-marrje.

Rritja e disponueshmërisë së të dhënave hapësinore dhe zhvillimet në shkencën e GIS na mundësojnë kryerjen e proceseve të “planifikimit informacional” (analiza, dizënjim, vlerësim, vendim, manaxhim dhe komunikim). Adoptimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin territorial dhe proceset e zhvillimit si dhe përdorimi i metodave GIS për të mundësuar dhe lehtësuar këto procese, ka patur zhvillime të rëndësishme në botë.

GIS përfaqëson kombinimin e përmbajtjes së të dhënave dhe manaxhimit të tyre, me pozicionin hapësinor dhe teknikat e analizës për të lehtësuar kuptimin e objekteve të botës reale dhe lidhjen midis tyre. Një sistem GIS i përparuar kërkon dy komponentë kryesorë; pajisjet dhe programet, të kombinuara me një të tretë, njeriun. GIS i kombinuar me “*Remote Sensing*” mund të prodhojë harta dixhitale të përdorimit/mbulimit të tokës, harta të fenomeneve të rrezikshme etj. Sidoqoftë rezultatet e GIS nuk janë të limituara vetëm në harta, përdorimi i tij mund të prodhojë database GIS me tematikë të dedikuar dhe ajo që është më e rëndësishmja, të dhëna

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

vlerësimi. Potenciali i GIS për të siguruar informacion të qëndrueshëm dhe sasior nëpërmjet një formati të kuptueshëm, e ka vendosur atë në një pozicion kyç në hartimin e politikave të bazuara në zhvillimin e qëndrueshëm.

4. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Hartimi i VSM-së është mbështetur në një paketë tërësore ligjore të miratuar në lidhje me Mjedisin nga qeveria Shqiptare dhe mjaft ligje e direktiva të BE dhe Ndërkombëtare.

4.1. Baza ligjore Shqiptare

- Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- Ligji Nr.10448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 107/2014, Datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Ligji Nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;
- Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis”;
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;
- Ligji Nr.8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen ndaj zjarrit”;
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, date 11.05.2009;
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Ligji nr. 8752, datë 26-3-2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;
- Ligji nr. 9244, datë 2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”;
- Ligji nr. 9426, datë 2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”;
- Ligji nr. 9817, datë 22-10-2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”;
- Ligji nr. 10257, datë 25-3-2010 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

- Ligji nr. 69, datë 2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore";
- Ligji nr. 130, datë 2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752/2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji nr. 131, datë 2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244, datë 2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore";
- Ligji nr. 9700, datë 26-3-2007 "Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimi Ndërkufikar";
- Ligji nr. 111 i vitit 2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore";
- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit";
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor";
- V.K.M. nr.587, datë 07.07.201 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike";
- V.K.M Nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore";
- VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit";
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor";
- Vendimi Nr. 99, datë 18.02.2005 i K.M. "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve";
- Udhëzim, Nr.6, datë 27.11.2007 "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta".

4.2. Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi Vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktive vlen për një gamë të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Direktiva (2001/42/EC) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatitjen e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjitik, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);

- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Përkatësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të analizës për të përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e analizës bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura e VSM-së mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM-së përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM-së. Raporti VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme, të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

4.3. Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. VSM-ja ka lidhje të ngushta veçanërisht procedurale me Direktivën VNM, me që vlerësimi i mjedisit për sektorët të caktuar duhet patjetër të jenë të vendosur në kornizën e projekteve të parapara në VSM. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM-së. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

4.4. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Prioritetet strategjike janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHË

4.5. Konventa Aarhus, Konventa Espoo dhe Protokoli i Kievit

4.5.1. Konventa Aarhus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen...,1998) "Nga palët në këtë Konventë kërkohet të hartojnë dispozitat e nevojshme me qëllim që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive të shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet të bëjnë përgatitjet që t'i mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyetimin për atë vendim;
- Të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.

4.5.2. Konventa ESPOO

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisin, 1991) përcakton detyrimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Gjithashtu ai formulon detyrimet e përgjithshme të shteteve për të njoftuar njëri tjetrin dhe për t'u këshilluar me njëri tjetrin lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

në shqyrtim dhe që kanë mundësi të kenë ndikime të rëndësishëm të disfatorshme në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

4.5.3. Protokoli i Kievit

Protokoli i Kievit është dokument i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik Mjedisor, meqë konsiderohet si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike. Protokoli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësim i Strategjik i Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit, prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokoli gjithashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit.

4.5.4. Axhenda Territoriale e B.E.-së 2020 (Territorial Agenda)

"Axhenda Territoriale e Bashkimit European e vitit 2020", në vazhdim të Axhendës Territoriale që filloi në vitin 2007, është diskutuar në vitin 2011, në Hungari dhe i përket planifikimit të zhvillimit hapësinor. Ka marrë parasysh zhvillimet e fundit të cilat përshkruhen në raportin "Territorial State and Perspectives of the European Union", si edhe raportin e pestë të Komisionit European "Kohezioni Ekonomik, Social dhe Territorial" dhe për "Europën Strategjike 2020" dhe kishte si fokus objektivin e ri të Bashkimit European, që është Kohezioni Territorial. Në bazë të Axhendës në fjalë, ofrohen orientime strategjike për zhvillimin hapësinor, për promovimin e inkuadrimin të dimensionit hapësinor në politika të ndryshme dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes, dhe për sigurimin e zbatimit të "Europës Strategjike 2020", në përputhje me parimet e kohezionit hapësinor. Objektivat që përcaktohen (nga B.E.-ja) për "Europën Strategjike 2020", janë promovimi i një zhvillimi të zgjuar, të aftë dhe pa përjashtime, i cili do të arrihet dhe do të duhet të përlogaritet edhe dimensionin e tyre hapësinor, sepse ekzistojnë mundësi të shumta zhvillimi, në analogji me çdo zonë.

Për me tepër, kohezioni territorial forcon parimin e solidaritetit duke patur si objektiv konvergencën e ekonomive ndërmjet tyre të zonave më të frytshme me zonat në të cilat zhvillimi është i vonuar. Diversiteti i territoreve konsiderohet se çon drejt zhvillimit, ndërsa territoret me mundësi plotësuese mund të bashkojnë forcat dhe përparësitë e tyre krahasimore, duke krijuar në këtë mënyrë kushtet për zhvillim të mëtejshëm. Që të arrihet objektivi i B.E.-së për një zhvillim "të zgjuar" dhe pa përjashtime, do të duhet të ekzistojë bashkëpunim ndërmjet zonave të ndryshme të B.E.-së në të gjitha nivelet përkatëse

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

hapësinore. Nëpërmjet zhvillimit të plotë territorial, mund të realizohet kohezioni social, qendrueshmëria dhe konkurrenca. Nëpërmjet kohezionit territorial, mund të arrihet zhvillimi i qendrueshëm ekonomik dhe të ekzistojë kohezioni si ekonomik ashtu edhe social. Për këtë arsye, është e nevojshme të zhvillohen kushtet e përshtatshme, me qëllim që të sigurohen shanse të barabarta për qytetarët e B.E.-së.

Me qëllim që të realizohet “Europa Strategjike 2020” për zhvillimin dhe punësimin, e cila filloi në vitin 2010 në nivelin e B.E.-së, janë vënë pesë objektiva bazë që i përkasin: punësimit të grupmoshave 20-64, afërsisht rreth 75%; kërkimit dhe zhvillimit për të cilin propozohet B.E.-ja të investojë 3% të GDP së saj; veprimit kundrejt ndryshimit klimaterik, nëpërmjet reduktimit të emetimeve të gazrave serë, të sigurimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe të rritjes së efikasitetit energjik rreth 20%; dhe së fundmi, trajnimit dhe më konkretisht, reduktimit të përqindjeve të braktisjes së parakohshme të shkollës (nën 10%) dhe plotësimit të përqindjes më të madhe (të klasës prej 40%) për kategorinë e grupmoshës 30-34 dhe luftimit të varfërisë dhe të përjashtimit social, me synim reduktimin e përqindjes.

Përveç objektiva të sipërpërmendura, për më tepër, janë vënë edhe disa prioritete territoriale për B.E.-në, me qëllim zhvillimin territorial, kështu që propozohet:

- Promovimi i një zhvillimi policentrik dhe të barabartë territorial të B.E.-së, nëpërmjet reduktimit të pabarazive të mëdha rajonale në territorin europian, me përballjen e atyre pengesave që ndeshen në zhvillim, fakt i cili inkurajohet edhe nga qytetet e zhvilluara të Europës, të cilat mund të bashkëpunojnë me qytetet e tjera, duke krijuar rrjete me mënyrë novative, për promovimin e mirëqenies ekonomike.
- Inkurajimi i zhvillimit të plotë ndërmjet qyteteve dhe fshatrave, i cili promovon edhe përpjekjet e qyteteve për të qënë mekanizma zhvillimi, duke krijuar mjedise tërheqëse, që të tërheqin investime dhe për pasojë, edhe njerëzit që do të jetojnë në to do të kenë më shumë mundësi. Propozohet bashkëpunimi i qyteteve që do të kontrubojë në zhvillimin e periferive të qyteteve, por edhe përmirësimi i kalueshmërisë së qendrave urbane nga zonat agrare.
- Plotësimi territorial i funksioneve ndërkufitare dhe ndërshtetërore në Periferi mund të përbëjë faktor të rëndësishëm për forcimin e konkurrencës mbarëbotërore. Kështu, do të promovohen peisazhet natyrore dhe zonat me bukuri të veçantë, elementët e trashëgimisë kulturore, ndërsa rrjetet e qyteteve dhe për pasojë, edhe tregjet e punës do të mund të përdoren lirshëm pa ndarjen e rreptë të kufijve brenda dhe jashtë zonave.
- Sigurimi i konkurrencës mbarëbotërore, e cila mund të forcohet me ekzistencën e ekonomive të forta lokale, por edhe me zhvillimin e sektorëve të plotë mbarëbotërorë të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

ekonomisë, synon në forcimin si të tregut mbarëbotëror ashtu edhe të atij lokal (zhvillimi i produkteve lokale, përmirësimi i ekonomive lokale, etj.), me vlerësimin paralel të kapitalit social, zhvillimin e novacionit dhe të strategjive të tjera të rëndësishme që shkojnë drejt këtij drejtimi.

- Përmirësimi i lidhshmërisë territoriale ndërmjet personave, komuniteteve, sipërmarrjeve synon nevojën për akses të thjeshtë në transportet rrugore, hekurudhore dhe ajrore, por edhe në infrastrukturat dhe rrjetet e tjera teknike, ndërsa mbështetet përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe reduktimi efikas i emetimeve të dioksidit të karbonit.
- Menaxhimi dhe lidhja ndërmjet periferive të elementëve të rëndësishëm ekologjikë, lokalë dhe kulturorë është një element i domosdoshëm për zhvillimin e qendrueshëm dhe mund të arrihet me mbrojtjen dhe promovimin e elementëve të mjedisit, por edhe të trashëgimisë kulturore, duke marrë parasysh veçantitë gjeografike të çdo zone.

4.5.5. Harta Leipzig për Zhvillimin e Qendrueshëm Urban

Në kuadrin e politikës europiane për qytetet, ndër dokumentat e rëndësishëm janë Strategjia Tematike për Mjedisin Urban e vitit 2006 dhe Harta Leipzig për Qytetet e Qendrueshme Europiane e vitit 2007. Drejtimet e dy teksteve të sipërpërmendura, në mënyrë të përmbledhur i referohen politikave dhe programeve të plota të zhvillimit urban; parimit të qytetit “kompakt” (compact city); dhe kthimit të planifikimit urban të qyteteve, me qëllim ristrukturimin e rrjetit infrastrukturor të tyre, të hapësirave publike dhe të rezervës ndërtimore, përmirësimin e disa fenomeneve të rëndësishme sociale, parandalimit të “konflikteve” të përdorimit të tokës, etj.

Në Hartën Leipzig për Qytetet e Qendrueshme Europiane të vitit 2007 propozohet politika e zhvillimit të plotë urban. Bëhet fjalë për një proces, në kuadrin e të cilit duhet të ekzistojë koordinim ndërmjet enteve territoriale, sektoriale dhe hapësimore të politikës urbane. Një rëndësi e veçantë duhet t’i jepet pjesëmarrjes së të interesuarve dhe faktorëve ekonomikë, por edhe publikut të gjerë. Për zhvillimin e plotë urban, mund të hartohen programe, të cilat mund të:

- ❖ Përshkruajnë cilat janë pikat e dobëta dhe të forta në një qytet dhe cilat janë objektivat zhvillimore që mund t’i japin një shtysë zonës urbane.
- ❖ Koordinojnë planet e ndryshme komunale, sektoriale dhe teknike dhe politikat, me synim të sigurojnë investimet përkatëse që do të ndihmojnë në zhvillimin e zonës urbane.
- ❖ Koordinojnë përdorimin e burimeve.
- ❖ Koordinojnë barazinë ndërmjet zonave urbane dhe agrare, ndërmjet qyteteve të vogla

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

dhe mesatare dhe qyteteve të tjera brenda zonave mitropolitane.

Që të arrihen objektivat e sipërpërmendur, propozohen tri veprime konkrete: sigurimi i hapësirave tërheqëse publike me cilësi të lartë, me theks ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike, por edhe planifikimin e saktë të infrastrukturave të ndryshme; modernizimi i rrjeteve të infrastrukturave, si të furnizimit me ujë, të përpunimit të ujërave të zeza, të transporteve, por edhe përdorimi i drejtë i burimeve natyrore; dhe promovimi i metodave të novacionit dhe më konkretisht, të teknologjive të mëparshme të informacionit dhe komunikimit, me synim instalimin e sipërmarrjeve të reja, por edhe përmirësimin e sektorëve të arsimit, të punësimit, të shërbimeve sociale të shëndetit.

Vëmendje e veçantë do të duhet t'u jepet lagjeve të qyteteve që përballen me probleme ekonomike (papunësi, përjashtim social, etj.), nëpërmjet zbutjes së pabarazive, e cila do të arrihet me promovimin e kohezionit social, dhe me përmirësimin e mjedisit të tyre natyror dhe të infrastrukturave të tyre. Më konkretisht, për theksimin e dizavantazheve të zonave urbane, propozohet zbatimi i masave të përmirësimit të mjedisit, nëpërmjet:

- ❖ Përmirësimit të rrjetit ekzistues të banesave në lagjet “e varfëra” përsa i përket planifikimit, kushteve natyrore dhe performancës energjike.
- ❖ Forcimit të ekonomisë lokale nëpërmjet vlerësimit të produkteve lokale dhe sigurimit të vendeve të punës me krijimin e sipërmarrjeve të reja.
- ❖ Promovimit të mjeteve dhe mënyrave të trajnimit për të rinjtë, nëpërmjet organizimit të programeve dhe seminareve të trajnimit, me qëllim që të jenë në gjendje të kërkojnë vende të reja pune.
- ❖ Promovimit të transporteve urbane në aspektin ekonomik të përballueshëm, të cilat do të jenë edhe më efikase, me qëllim që t'u jepet e drejta banorëve të zonave në fjalë të kenë shanse të barabarta aksesit – kjo propozohet të arrihet nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të qarkullimit në këto zona, ndërsa do të propozohen edhe rrjete të përshtatshme për qarkullimin e këmbësorëve dhe të biçikletistëve.

4.5.6. Politika e Përbashkët Bujqësore 2014-2020

Politika e Përbashkët Bujqësore (P.P.B.), e cila u themelua në vitin 1962, lidh sektorin e bujqësisë me Europën. P.P.B. e re (pas vitit 2013) duhet të përballlet me më shumë probleme, si rritja e rëndësishme e popullsisë me tokën në lidhje me prodhimin e ushqimeve, ndryshimi klimaterik dhe nevoja për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtja e natyrës dhe ruajtja e qëndrueshmërisë në ekonominë bujqësore. Kështu, reforma e P.P.B. duhet të përballlet me tre probleme serioze, forcimin e sigurisë ushqimore,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

sfidën e ndryshimit klimaterik dhe krijimin e vendeve të punës në zonat agrare me synim zhvillimin e tyre.

P.P.B., në kuadrin më të gjerë të mbështetjes së zhvillimit agrar, duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave të mëposhtëm: në forcimin e konkurrencës në sektorin e bujqësisë; në sigurimin e menaxhimit të qendrueshëm të burimeve natyrore; në promovimin e veprimeve në lidhje me luftimin e ndryshimit klimaterik; dhe në arritjen e zhvillimit të ekuilibruar në ekonominë agrare, në të cilin përfshihet edhe krijimi dhe ruajtja e vendeve të punësimit. Për arritjen e objektivave të sipërpërmendur, P.P.B. propozon veprimet e mëposhtme:

- Provovimin e kalimit të dijeve dhe novacionit në bujqësi, në pyllëtarë dhe në zonat agare. Propozohet forcimi i lidhjeve ndërmjet bujqësisë, pyllëtarisë, kërkimit dhe novacionit, menaxhimit të përmirësuar mjedisor dhe efikasitetit të sektorëve të sipërpërmendur të ekonomisë, trajnimit dhe formimit profesional të fermerëve.
- Forcimin e qendrueshmërisë së shfrytëzimeve bujqësore dhe të konkurrencës në të gjithë sektorët e bujqësisë, nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit ekonomik të shfrytëzimeve bujqësore, rristurimit të shfrytëzimeve bujqësore, modernizimit të metodave të bujqësisë, trajnimit të përshtatshëm të fermerëve në objekte të specializuara.
- Promovimin e organizimit të rrjetit të ushqimeve, nëpërmjet përmirësimit të konkurrencës së produkteve me krijimin e sistemeve të cilësisë dhe promovimin e tyre të përshtatshëm; dhe menaxhimin e rrezeve që paraqesin shfrytëzimet bujqësore.
- Zëvendësimin dhe ruajtjen e ekosistemeve që lidhen me sektorët e bujqësisë dhe të pyllëtarisë, si zonat në rrjetin Natura 2000 dhe zona të tjera me vlerë të lartë natyrore, përmirësimin e menaxhimit të ujërave, nëpërmjet menaxhimit të duhur të ilaçeve për mbrojtjen e bimëve etj. dhe parandalimin e erozionit të tokës.
- Promovimin e efikasitetit të burimeve (ujë, energji) dhe marrjen e masave, me qëllim që të reduktohen emetimet e dioksidit të karbonit dhe të gazrave të tjerë serë, me qëllim që të kufizohet fenomeni i ndryshimit klimaterik, i cili ndikon edhe në sektorët e bujqësisë dhe të ushqimeve.
- Promovimin e zhvillimit ekonomik në zonat agrare dhe në veçanti krijimin e sipërmarrjeve të vogla dhe vendeve të punës, promovimin e zhvillimit lokal, forcimin e përdorimit të teknologjive të reja të informacionit dhe telekomunikacioneve në zonat agrare.

4.5.7. Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin

4.5.7.1. Në përgjithësi

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Që në fillimete dhjetë vjeçarit të 1970, në Europë ekziston angazhimi për çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Kështu, për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e cilësisë së ajrit atmosferik dhe të ujërave, me mirëmbajtjen e burimeve natyrore dhe të bio shumëllojshmërisë, me menaxhimin e mbetjeve dhe në përgjithësi me aktivitete që kanë pasoja të pafavorshme dhe përbëjnë sektorë bazë veprimi si në nivel europian ashtu edhe kombëtar, ndeshen angazhime nga politika europiane, me qëllim që të minimizohen pasojat mjedisore dhe të sigurohet zhvillimi i qendrueshëm i modelit social europian. Objektivi Bashkimit Europian është promovimi i zhvillimit të qendrueshëm me qëllim afatgjatë zhvillimin e barabartë që të sigurohet zhvillimi ekonomik dhe progresi social, ndërsa paralelisht të ekzistojnë masa edhe përmbrojtjen e mjedisit.

Zhvillimi i legjislacionit europian mjedisor fokusohet në ndryshimin mbarë botëror klimaterik, në reduktimin e ndikimeve mjedisore të transporteve, në promovimin e modeleve të qendrueshme prodhuese dhe konsumatore, në menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore, në reduktimin e kërcënimeve ndaj shëndetit publik, në luftimin e varfërisë dhe të izolimit social, si edhe në masat që lidhen me shoqërinë e dijes, mjetet financiaro-ekonomike, komunikimin, si edhe me politikat e nevojshme. Në bazë të strategjisë së re që u propozua për Europën e vitit 2020, Europa mund t'ia dalë mbanë nëse vepron në mënyrë kolektive, si "Bashkim" dhe ta shndërrojë ekonominë e saj në një ekonomi të zgjuar, të qendrueshme dhe pa përjashtime, kudo të ekzistojnë nivele të larta punësimi, prodhueshmëri edhe kohezioni social. Koordinimin e politikës mjedisore do ta marrë përsipëriniciativa emblematiske "Një Europë që përdor në mënyrë efikase burimet", propozime bazë të së cilës janë reformimi i politikës së përbashkët bujqësore, i politikës së përbashkët të peshkimit, i politikës për kohezionin, rishikimi i rrjeteve ndëreuropiane të transporteve, rishikimi i legjislacionit për ndjekjen dhe paraqitjen e raporteve në lidhje me emetimet e gazrave serë, ecuria për një ekonomi me emetime të ulëta të karbonit deri në vitin 2050, rishqyrtimi i lëndëve të prioritetit që përmenden në direktivën – kuadër për ujërat, etj.

Deri më sot janë zbatuar shtatë Programe Veprimi për Mjedisin, të cilat kanë përcaktuar formulimin e politikës europiane për mjedisin. Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin është konsideruar si kuadri bazë politik për zbatimin e politikës mjedisore dhe përcakton prioritetet e Bashkimit Europian (B.E-së.), deri më 31 Dhjetor 2020 (2013-2020). Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin thekson te nëntë objektiva prioriteti që duhet të arrijë B.E.-ja. Këto objektiva paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon (Vendimi 1386/2013/B.E., 2013):

- Mbrojtja, ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror të Bashkimit.
- Shndërrimi i Bashkimit në një ekonomi të gjelbër dhe konkurruese me nivele të ulëta të emetimeve të gazrave karbonikë dhe përdorimit efikas të burimeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Mbrojtja e qytetarëve të Bashkimit nga presionet mjedisore dhe rreziqet për shëndetin dhe mirëqenien.
- Maksimizimi i përfitimeve të legjislacionit mjedisor të Bashkimit nëpërmjet përmirësimit të zbatimit.
- Përmirësimi i bazës së dijeve dhe dëshmive për politikën mjedisore të Bashkimit.
- Sigurimi i investimeve në politikën mjedisore dhe klimaterike si edhe përballja e kostos së jashtme mjedisore.
- Përmirësimi i inkuadrimin të distancës mjedisore dhe të kohezionit të politikave.
- Forcimi i qëndrueshëm i qyteteve të Bashkimit.
- Rritja e efikasitetit të Bashkimit përsa i përket përballjes së sfidave ndërkombëtare mjedisore dhe klimaterike.

4.5.7.2. Mbrojtja, ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror

Për mbrojtjen, ruajtjen dhe forcimin e kapitalit natyror të Bashkimit, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin deri në vitin 2020 ka si objektiv mbrojtjen e bioshumëllojshmërisë dhe të ekosistemeve të ndjeshme. Synon zëvendësimin e të paktën 15% të ekosistemeve të nënvlerësuar. Për më tepër, në përputhje me **Direktivën – Kuadër 2000/60/E.K.** për ujërat, do të duhet të mbrohen edhe ujërat e brendshëm sipërfaqësorë, kalimtarë, bregdetarë dhe nëntokësorë, me qëllim që të ekzistojë ujë i mjaftueshëm sipërfaqësor dhe nëntokësor me cilësi të mirë. Një parametër tjetër, i cili është i rëndësishëm për kapitalin natyror të B.E.-së, është reduktimi i presioneve që kanë ujërat detarë. Dhe për ujërat detarë, objektiv përbën ruajtja e gjendjes së mirë mjedisore, duke marrë masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar, për zëvendësimin, aty ku është e mundur, të ekosistemeve detare, për bashkëpunimin ndërshtetëror etj. Së fundmi, në lidhje me forcimin e kapitalit natyror, në vazhdim i referohemi reduktimit të ndotjes atmosferike dhe të ndikimeve që kjo ka në ekosisteme mbrojtjes së mjaftueshme të tokave të B.E.-së; përballjes së ndotjes me elementë ushqyesë dhe në veçanti me azot dhe fosfor; dhe së fundmi, menaxhimit të drejtë të sipërfaqeve pyjore, nëpërmjet mbrojtjes së tyre nga zjarret, fenomenet natyrore, etj.

4.5.7.3. Shndërrimi i Bashkimit në një ekonomi “të gjelbër” dhe konkurruese

Për shndërrimin i Bashkimit në një ekonomi “të gjelbër” dhe konkurruese me nivele të ulëta të emetimeve të gazrave karbonikë dhe përdorimit efikas të burimeve, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin siguron se deri në vitin 2020, do të jenë arritur objektivat që ka vënë Bashkimi Europian në lidhje me klimën dhe energjinë, ndërsa do të jenë bërë përpjekje të rëndësishme përsa i përket reduktimit të emetimit të gazrave serë me synim ruajtjen e rritjes së temperaturës mesatare të planetit; do të jenë reduktuar pasojat mjedisore të sektorëve të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

mëdhenj të ekonomisë dhe do të jetë rritur efikasiteti gjatë përdorimit të burimeve natyrore, ndërsa do të jepen stimuj në nivel tregu, me qëllim që të inkurajohen investimet e sipërmarrjeve dhe të novacionit dhe të theksohet zhvillimi i gjelbër; do të jenë reduktuar ndërhyrjet totale mjedisore të prodhimit dhe të konsumimit, kryesisht në sektorët e ushqimit, të strehimit, por edhe të lëvizshmërisë, nëpërmjet ndryshimeve strukturore në prodhim, në teknologji, në novacion; dhe së fundmi, do të bëhet menaxhimi i sigurt i mbetjeve, me qëllim reduktimin e NDIKIMEVE në shëndet dhe në mjedis, nëpërmjet reduktimit të prodhimit të mbetjeve (si për frymë, ashtu edhe në çmime absolute) dhe të kufizimit të gruposjes së lëndëve jo të riciklueshme, ndërsa, nëse zbatohen kërkesat e Direktivave të Bashkimit Europian, në lidhje me mbetjet dhe hapësirat e gruposjes së tyre, do të reduktohet edhe ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, e tokës dhe e atmosferës.

4.5.7.4. Presione mjedisore dhe rreziqe për shëndetin dhe mirëqënien

Me qëllim që qytetarët e Bashkimit Europian të mbrohen nga presionet mjedisore dhe rreziqet për shëndetin dhe mirëqënien, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin siguron (deri në vitin 2020) përmirësim të rëndësishëm në mbrojtjen si të ajrit të jashtëm në B.E., me qëllim që të ekzistojë përjasje e niveleve që propozon Organizata Botërore e Shëndetësisë (O.B.SH.), ashtu edhe në atë brendshëm në përputhje me orientimet e kësaj organizate; reduktim i rëndësishëm i ndotjes akustike dhe sërish duke patur synimin për t'iu afruar niveleve të O.B.SH.-së; ekzistenca e standarteve të rrepta për ujin e sigurt të pijshëm dhe ujëra të sigurtat notimi për qytetarët e B.E.-së; përballje efikase përsa i përket minimizimit të rreziqeve si për mjedisin, ashtu edhe për shëndetin, nga përdorimi i lëndëve të rrezikshme kimike që përmbajnë produktet, ato që përmenden më sipër sigurohen me legjislacionin përkatës të B.E.-së dhe kanë si synim një mjedisi jo toksik; mungesa e ndikimeve të dëmshme në shëndetin e njeriut, por edhe në mjedis, nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve; përballje efikase e shqetësimeve që lidhen me nanomateriale por edhe të tilla; dhe së fundmi, progres i rëndësishëm përsa i përket përshtatjes ndaj ndikimeve të ndryshimit klimaterik.

4.5.7.5. Përfitimet e legjislacionit mjedisor

Me qëllim që të maksimalizohen përfitimet e legjislacionit mjedisor të Bashkimit, nëpërmjet përmirësimeve të rëndësishme për zbatimin e tij, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin siguron (deri në vitin 2020) akses të thjeshtë të publikut në informacionet që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të legjislacionit mjedisor të B.E.-së; rritje të pajtueshmërisë me veprime konkrete legjislative përsa i përket mjedisit; imponim të legjislacionit mjedisor të B.E.-së në të gjitha nivelet e administratës dhe sigurim të konkurrencës së barabartë në

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

tregun e brendshëm të Europës; krijim të marrëdhëniesve të besimit të qytetarëve përsa i përket të drejtës mjedisore të B.E.-së dhe të zbatimit të saj; dhe së fundmi, lehtësim të ruajtës së parimit të mbrojtjes efikase të qytetarëve të B.E.-së.

4.5.7.6. Përmirësimi i bazës së dijeve dhe të dëshmive për politikën mjedisore

Me qëllim që të përmirësohet baza e dijeve dhe e dëshmive për politikën mjedisore të B.E.-së, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin synon (deri në vitin 2020), krijimin e politikave dhe të interesuarve të tjerë, të cilët kanë në dispozicionin e tyre më shumë të dhëna për hartimin dhe zbatimin e politikave në lidhje me mjedisin dhe klimën, ndërsa do të duhet të kenë kuptuar tashmë pasojat mjedisore nga aktivitetet e njeriut; ekzistencën e mirëkuptimit të madh për problemet e ndryshme mjedisore dhe për rreziqet klimaterike dhe këto të mund të vlerësohen dhe të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme; forcimin e kontaktit ndërmjet shkencës dhe politikës në sektorin e mjedisit, ndërsa do të duhet të përfshihen edhe qytetarët për të patur akses në të dhënat dhe të jenë pjesëmarrës në veprën shkencore; dhe forcimin e ndikimit të B.E.-së në komunitetin ndërkombëtar, përsa i përket lidhjes shkencë – politikë, me qëllim përmirësimin e dijes rreth çështjeve të politikës ndërkombëtare mjedisore.

4.5.7.7. Investime në politikën mjedisore dhe klimaterike

Për sigurimin e investimeve në politikën mjedisore dhe klimaterike dhe përballjen e kostos së jashtme mjedisore, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin propozon arritjen e objektivave të politikës për mjedisin dhe klimën, deri në vitin 2020, në mënyrë efikase nga ana ekonomike dhe me mbështetje analoge nga financimi i mjaftueshëm; kërkon rritjen si të financimit publik ashtu edhe atij privat, në shpenzime që kanë të bëjnë me mjedisin dhe parametrat klimaterikë; dhe siguron vlerësim të saktë në vlerën e kapitalit natyror dhe të shërbimeve që kanë të bëjnë me ekosistemet, ndërsa përllogarit edhe koston e përkeqësimit të tyre, faktorë që ndikojnë në hartimin e politikës.

4.5.7.8. Inkuadrimi i distancës mjedisore në politika

Për përmirësimin e inkuadrimin të distancës mjedisore në politika, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin ka si objektiv, deri në vitin 2020 të zbatohen politika sektoriale në nivelin e Bashkimit Europian dhe të shteteve anëtare, që t'u shërbejnë objektivave mjedisore dhe klimaterike që lidhen me to. Kështu, propozon inkuadrimin e kushteve dhe stimuljeve që lidhen me klimën dhe mjedisin, me rishqyrtim paralel edhe të politikave tashmë ekzistuese; kërkon kryerjen e vlerësimeve për pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike si në nivelin e B.E.-së, ashtu edhe në nivel kombëtar, për të siguruar kohezionin dhe efikasitetin e tyre; kërkon

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

zbatimin e plotë të Direktivave për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit dhe për Vlerësimin e ndikimeve në Mjedis; kërkon vlerësimin e informacioneve që nxirren nga vlerësimi i zbatimit të planit mjedisor, me qëllim përmirësimin e pasojës dhe të kohezionit të tij; dhe dëshiron menaxhimin e kompromiseve që mund të rezultojnë në të gjitha politikat, me qëllim që të maksimalizohen sinergjitë dhe të reduktohen, sa më shumë të jetë e mundur, pasojat negative në mjedis.

4.5.7.9. Forcimi i qëndrueshëm i qyteteve

Për forcimin e qëndrueshëm të qyteteve, Programi i të Bashkimit, Plani i Shtatë i Veprimit për Mjedisin siguron (deri në vitin 2020), zbatimin e politikave të programatizimit dhe planifikimit të qëndrueshëm urban në pjesën më të madhe të qyteteve të Bashkimit, të cilat nënkuptojnë pastrimin e ndërtesave për vlerësimin e performancave mjedisore të qyteteve, duke marrë parasysh pasojat ekonomike dhe sociale, si edhe kujdesin, me qëllim që qytetet të informohen në lidhje me financimin për masat e mbrojtjes së qëndrueshmërisë urbane dhe të kenë akses në të. Është i nevojshëm zgjerimi i iniciativave ekzistuese që mbështesin novacionin dhe praktikatat me të mira në qytete, si edhe gjithashtu krijimi i rrjetit dhe shkëmbimet ndërmjet tyre, me qëllim që të inkurajohen qytetet të promovojnë pozicionin e tyre lider në zhvillimin urban të qëndrueshëm.

4.5.7.10. Përballja e sfidave ndërkombëtare mjedisore dhe klimaterike

Me qëllim që të rritet efikasiteti i Bashkimit, përsa i përket përballjes së sfidave ndërkombëtare mjedisore dhe klimaterike, Programi i Shtatë i Veprimit për Mjedisin duhet (deri në vitin 2020) të sigurojë inkuadrim të plotë të rezultateve të Konferencës së Rios në politikat e B.E.-së dhe kontributin efikas të B.E.-së në përpjekjet dhe iniciativat botërore, që kanë si objektiv krijimin e një ekonomie "të gjelbër" dhe pa përjashtime, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm; mbështetje efikase e përpjekjeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare që bëhen për përballjen e problemeve mjedisore dhe klimaterike, me objektiv zhvillimin e qëndrueshëm; dhe reduktim i ndikimeve të konsumimit në mjedis, nëpërmjet zhvillimit të përpjekjeve për një përqasje botërore drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Për këtë qëllim, kërkohet miratimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat mbulojnë sektorët e prioritetit pa përjashtime të ekonomisë së "gjelbër" dhe të kenë si kusht të domosdoshëm ratifikimin e marrëveshjeve bazë shumëpalëshe mjedisore shumë më përpara se viti 2020, me qëllim që të ruhen angazhimet për vitin 2020. Për më tepër kërkohet bashkëpunimi me shtetet-partnere në mënyrë më strategjike, me qëllim që të promovohen praktikatat më të mira në legjislacionin e brendshëm mjedisor dhe në konvergjencë të vendeve gjatë negociatave shumëpalëshe mjedisore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

4.6. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. (VSM)

Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” nënvizon rëndësinë e integritetit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Raporti VSM-së identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i planit ose programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Projekti i dokumenteve VSM është një objekt për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesat e posaçme për rastet e këshillimeve ndërkufitare. Ligji përcakton qartë qëllimin dhe fushën e veprimit të tij.

Shkalla në të cilën plani ose programi krijon kuadrin për zbatimin e projekteve dhe veprimtarive të veçanta me ndikim në mjedis, të cilat specifikohen në shtojcat 1 dhe 2 të ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

5. ANALIZA E SITUATËS SË SOTME TË KUSHTEVE MJEDISORE TË TERRITORIT TË BASHKISË LIBRAZHD

5.1. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Librazhd.

Bashkia Librazhd sipas ndarjes së re territoriale është rikonceptuar në vitin 2015. Bashkia e Librazhdit, është pozicionuar në Qarkun e Elbasanit, me një sipërfaqe totale 1 404,87 km². Kufizimet hapësinore të bashkisë Librazhd janë: në veri Bashkia Bulqizë, në jug Bashkia Prenjas, në perëndim Bashkia Elbasan dhe Tiranë dhe në lindje ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM). Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit me 10,158 banorë. Qyteti i Librazhdit, që është edhe qendra më e rëndësishme urbane Bashkisë është i ndërtuar në një terren kodrinor me pjerrësi mesatare, i cili ndërpritet nga përrenj të vegjël, por me shpate të thepisur, që sjellin ujin nga lartësitë dhe e derdhn atë në lumin Shkumbin. E gjithë forma e terrenit ku është ndërtuar Librazhdi, është “modeluar” nga bashkëveprimi i këtyre përrenjve me kodrën. Janë pikërisht fashat natyrore të këtyre përrenjve, që e ndajnë qytetin në sektorë banimi, në të cilët mbizotërojnë këto tipologji banimi:

- “apartamente banimi kolektive 4-5 kate”
- “vila individuale ose disa-familjare”
- “qyteti organik-spontan në kodër”
- “vargëzim i hapur apartamentesh 5 katëshe në kodra”

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Koordinatat e bashkisë Librazhd janë: **X = 44 42 670.618805** dhe **Y = 45 61 222.827519**. Lartësia 249 m mbi nivelin e detit.

Organizimi i sotëm i Bashkisë Librazhd përfshin në strukturën hapsnore të saj ish Bashkinë Librazhd dhe njësitë administrative Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis dhe Orenjë. Popullsia totale është 44,181 (censusi 2011, 31,892) banorë, me sipërfaqja shtrirje 793.36 km².

Qendra administrative e Bashkisë, qyteti i Librazhd është një qytet i shpallur si qendër administrative në vitin 1958 dhe si qytet më 18 Shkurt 1960 me dekret Nr. 3060 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërsë. Librazhdi ka një pozicion të lidhur me rrugën “Via Egnatia” një nga nyjet më të rëndësishme midis Konstandinopojës dhe Romë. Gjurmët e zhvillimit takohen që në periudhën e Gurit të Vjetër (Paleolit). Materialet arkelogjike të periudhës së Mezolitit dhe Neolitit tregojnë për historinë ekonomike, shoqërore të këtij vend banimi. si ri dhe nuk mbart ndonjë trashëgimi kulturore të spikatur nga e kaluara. Në 50 vitete e fundit qyteti është karakterizuar nga një dinamizëm zhvillimi kulturor, ekonomik, tregëtar, industrial, etj. Ndërkohë që nuk mund të konstatohet e njëjta gjë në lidhje me zhvillimin e turizmit, ekoturizmit, shfrytëzimin e burimeve hidrike, promovimin e e pasurive natyrore dhe historike si vlera atraktive për potencial ekonomik.

Bashkia Librazhd sipas ndarjes aktuale territoriale ka nën administrimin e saj një qytet (Qyteti Librazhdit) dhe 52 fshatra.

Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Librazhd	Qyteti Librazhd	31,892	44,181	793.36
Qendër Librazhd	Fshatrat; Librazhd Qëndër, Arrëz, Babje, Dorëz, Dragostunjë, Kuturman, Gizavesh, Librazhd Katund, Marinaj, Qarrishtë, Spathar, Togëz, Merqizë, Semes			
Hotolisht	Fshatrat; Hotolisht, Dardhë, Vulçan, Buzgarë, Kokrevë, Vehçan, Xhyrë, Çerçan			
Lunik	Fshatrat; Lunik, Prevall, Dranovicë, Kostenjë, Letëm, Zgosht, Koshorisht			
Stëblevë	Fshatrat; Stëblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Sebisht, Moglicë, Prodan			
Polis	Fshatrat; Polis, Mirakë, Gostimë, Sheh, Gurëshpatë, Vilan			
Orenjë	Fshatrat; Orenjë, Floq, Gurakuq, Ballgjin, Rinas, Zdrajsh Verri, Zdrajsh, Neshtë, Mëxixë, Funarës			

Tabela nr.1. Struktura territoriale dhe demografike e Bashkisë Librazhd (Census 2011)

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD


Aktivitet kryesore të zhvilluara në qytetin e Librazhdit janë tregëtia, zejtaria, industria e përpunimit të rrushit, drurit, etj.

Ndërkohë që territori aktual i Bashkisë që përfshin disa njësi administrative paraqitet mjaft i larmishëm në relief, kulturë, traditë, zhvillim, biodiversitet, vlera kulturore dhe historike, të cilat nuk janë kthyer plotësisht në element të atraksionit dhe zhvillimit social-ekonomik. Sipërfaqet pyjore janë mjaft të zhvilluara dhe përbëjnë një nga elementët më të qënësishëm për zhvillimin rajonal.

E pozicionuar në zonën midis Bashkisë Prrrenjas dhe Elbasan si pjesë e korridorit VIII, nga linja hekurudhore, nga shtrati i Lumit Shkumbin dhe mjaft lumenj të tjerë më të vegjël (Rrapuni, Gostime, etj), kjo bashki duhet konsideruar si një njësi me rëndësi në rajon. Njësia administrative Librazhd, gjithashtu merr rolin kryesor administrativ në bashki, pasi në territorin e saj është pozicionuar institucioni administrativ i bashkisë, dhe të gjitha aktivitetet dhe njësitet operuese kryesore duke e bërë një qendër dytësore rajonale me mjaft rëndësi.

Shtirja e Bashkisë është karakteristikë e zonave neotektonike në pjesën kontinentale. Bashkia shtrihet në dy nivele strukturale: Zona e horsteve formuar nga malet rrethuese të luginës dhe grabeneva që është pellgu i Librazhdit dhe më gjerë. Pellgu i Librazhdit është krijuar në miocen. Ndërkohë që në pliocen – Kuaternar është formuar relievi kodrinor i Librazhdit. Struktura gjeotektonik e maleve e kodrave si dhe pellgut të Shkumbinit është sinklane. Zona e bashkisë përfaqëson një trevë me rëndësi historike dhe kulturore. Midis gjurmëve historike ajo çka përbën më të qënësishme dhe burim rivitalizimi të zonës në aspektin turistik është rruga Egnatia, ku përgjatë lumit Shkumbin si në Mirak, Babje gjenden gjurmë të rëndësishme. Por dhe në njësitet administrative ka plot gjurmë të kulturës së Kandravisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD



**Figura.1. Pozicioni i Bashkisë Librazhd në rajon (Burimi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l.
Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l.)**

5.2. Topografia

Nga pikpamja gjeografike, Bashkia Librazhd shtrihet në Krahinën Malore Qendrore, në pjesën jugore të saj. Kjo bashki në pjesën më të madhe të territorit të saj, mbizotërohet nga relievi malor e kodrinor, e rrethuar nga malet e Shebenikut, të Çermenikës dhe Polisit. Pika më e lartë e këtij teritori është maja e Shebenikut, me lartësi 2,253 m.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD




Figura 2. Relievi topografik i territorit të bashkisë Librazhd. (Burimi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Luginat kryesore janë ato që përshkohen nga lumi i Shkumbinit të sipërm dhe Rrapunit. Lumi kryesor është Shkumbini, së bashku me degën e tij kryesore Rrapunin dhe përrenjtë si ai i Radinices, Lingajcës, Bushtricës, Shehës së Hotolishtit, Shehës së Librazhdit, dhe përrenjtë perëndimor të rrjedhjes në kufirin e poshtëm të bashkisë.

Sipas mënyrës së strukturimit tektonik relievi i bashkisë ndahet:

- **Reliev strukturor- eroziv**

Ky tip relievi lidhet me strukturat më të reja mbizotëruese që është ajo e tektonikës shkëputëse në formacionet e reja të Tortonianit. Format më kryesore të këtij tipi relievi janë: rrëpirat e shkëputjeve tektonike, vargjet malore e kodrinore, luginat, gropat etj. Shpatet e kodrave kanë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

pjerrësi të vogël deri të mesme, ndërsa në krahë pjerrësia sa vjen dhe rritet, ato janë të shkallëzuara për arsye të shkëputjeve tektonike paralele sekondare.

- **Reliev erozivo-denudues.**

Lidhet me proceset erozivo-denuduese. Përhapja e këtij relievi dhe intensiteti i madh i tij është i lidhur me kushtet tepër të volitshme natyrore për zhvillimin e proceseve të erozionit. Krahas faktoreve natyrore ndikim të madh ka aktiviteti i njeriut.

- **Reliev Lumor**

Relievi lumor përfaqësohet nga përrrenjt malore të tipit erozional. Kryesisht ata janë përrrenj në thellim, në grykëderdhjen e tyre kanë formuar freskoren të tipit aluvialo-proluvial, duke krijuar territore të rrafshëta 4-5⁰.

5.3. GJELOGJIA DHE TEKNOTIKA

5.3.1. Ndërtimi Gjeologjik

Në ndërtimin gjeologjik të zonës së marrë në studimin tonë, takojmë këto formacione:

1. **Shkëmbinjtë magmatike**

Shkëmbinjtë magmatike të përfaqësuar nga ultrabaziket e masivit të Kutermanit, depozitimet konglo-brekçioze të Titonianit, depozitimet e Tortonianit «suits Librazhdi», dhe depozitimet e reja të Kuaternarit.

2. **Shkëmbinjtë ultrabazike**

Dalin në pjesën jugore e jugperëndimore të qytetit të Librazhdit (në krahun e majtë të rrjedhjes së lumit Shkumbin). Shkëmbinjtë ultrabazike përbëjnë bazamentin (dyshemenë) e depozitimeve të Gropës së Librazhdit. Shkëmbinjtë ultrabazik përfaqësohen nga këto lloje shkëmbore: harzburgite të serpenitizuara, dunitë të serpenitizuara, serpentinite dhe rrallë piroksenite.

- **Depozitimet konglo- brekçioze të Titonianit (J_3^{th})**

Kanë përhapje të kufizuar në zonën tonë e konkretisht në pjesën jugperëndimore të saj. Ato vendosen trasgresivisht mbi shkëmbinjtë ultrabazik të Masivit të Kuturmanit dhe shkëmbinjtë efuzive.

- **Depozitimet e Tortonianit (N_1^{2t})**

Kanë përhapje mjaft të madhe në zonën e marrë në studim. Ato zënë pjesën qendrore të qytetit të Librazhdit, në veri, lindje dhe veriperëndim të këtij qyteti. Trashësia e depozitimeve Tortoniane shkon nga 200-250m, trashësia maksimale arrin deri në 550m.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- **Depozitimet Kuaternare**

Depozitimet kuaternare që përfaqësohen nga aluvione e proluvione kanë përhapje të kufizuar, takohen gjatë gjithë luginës së lumit Shkumbin dhe në dy anët e tij, ndërsa në pjesët e ulëta të shpateve dhe në kodrat depozitimet kuaternare paraqiten si deluvione.

- **Depozitimet aluviale;**
- **Depozitimet aluviale-proluviale;**
- **Depozitimet deluviale.**

5.3.2. Tektonika

Në rajon është e zhvilluar tektonika diznjuktive e karakterizuar kryesisht nga faljet dhe mbihipjet. Tektonika rrudhosëse nuk vërehet. Më e theksuar është tektonika në formë faljesh e cila ka ulur blloqet e depozitimeve të Kretakut të Sipërm e të Neogjenit, me amplitude 1-10 deri 100-150 m.

5.3.3. Kushtet Gjeologo – Inxhinierike

Rajoni i studiuar sipas përbërjes litologjike ndahet:

- Shkëmbinjë magmatike;
- Shkëmbinjë ultrabazike (dunite, harzburgite, lercolite);
- Konglo-brekçiet ofiolitike (ultrabazike, vullkanite, gelqerore);
- Shkëmbinjë mollasike : konglomerate, ranore, alevrolite;
- Depozitimet e shkrifta (Dherat);
 - Dherat me kohezion – Suargjilat, argjilat;
 - Dherat pa kohezion - rërat, zhavoret.

5.3.4. Klasifikimi gjeoteknik i shkëmbinjëve

Për klasifikimin gjeoteknik të shkëmbinjve si kritere kryesore janë marrë përbërja litologjike e shkëmbinjve dhe vetitë fiziko-mekanike të tyre. Në bazë të këtyre treguesve është bërë bashkimi i grupeve të shkëmbinjve të analizuar në paragrafin e mësipërm në zona, sipas të cilave rajoni i studjuar u nda në:

- **Zona e shkëmbinjve të fortë;**
- **Zona e shkëmbinjve mesatarisht të fortë;**
- **Zona e shkëmbinjve të shkrifët;**
- **Shkëmbinjte e fortë;**
- **Shkëmbinjte mesatarisht të fortë;**

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Përfaqësohen nga shkëmbinjtë mollasike të Tortonianit, të cilët janë ndërthurje shtresash konglomeratesh – ranoresh – alevrolitesh, që dalin në pjesën më të madhe të sipërfaqes së hartës tonë. Vendosen transgresivisht dhe me mospajtim këndor me depozitimet më të vjetra (magmatikët).

Fenomenet Gjeodinamike

Nga proceset gjeodinamike që janë prezent në zonën e studiuar përmendim:

- ❖ Tektonikën, neotektonikën;
- ❖ Erozionin;
- ❖ Rreshqitjet;
- ❖ Sizmitetin.

5.3.5. Tektonika dhe neotektonika

Qyteti i Librazhdit dhe rrethinat e tij bëjnë pjesë në zonen tektonike "Mirdita". Struktura e ultësirës ndërmallore të luginës së Shkumbinit ka formë sinklinale. Sinklinali është prekur shumë nga tektonika shkëputëse sidomos në krahët, duke marrë pamje shkallore. Pjesa juglindore është vendosur mbi të ashtuquajturin masivi ultrabazik i Kuturmanit (në formë antiklinale) në krahun lindor të tij të përmbysur. Zhvillim të konsiderueshëm në zonë, kanë edhe lëvizjet neotektonike me aktivitet në vazhdim.

5.4. Sizmiteti

Librazhdi ndodhet në afërsi të thyerjes tektonike lindje-perendim Lushnje-Elbasan-Diber. Si e tillë kjo zonë është goditur herë pas here nga tërmete të fuqishme.

Sipas rajonizimit sizmik të Shqipërise, qyteti i Librazhdit futet në zonën me intensitet tërmetesh 7-8 ballë, kjo duhet vlerësuar vazhdimisht nga projektuesit e ndërtuesit.

Qyteti i Librazhdit dhe zona përreth tij, ndodhet në brezin e fuqishëm sizmik Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug. Nga ky brez sizmo-aktiv edhe në ditët e sotme, sipas hartës së tërmeteve maksimal të pritshëm, janë gjeneruar tërmete me magnitudë maksimale të pritshme $M_{max}=6.5-7.0$.

Qyteti i Librazhdit dhe zona përreth tij është prekur nga disa tërmete të fuqishëm, që kanë patur vatrat e tyre në brezin sizmologjik Elbasan-Dibër (tërmetet që kanë ndodhur në rajonin Dibër-Çermenikë-Prrenjas) dhe që kanë shkaktuar dëme edhe në qytetin e Librazhdit dhe hapësirën përreth tij.

Sipas hartës së rajonizimit sizmik të vendit, Librazhdi përfshihet në një zonë ku brenda 100 viteve të ardhshëm mund të priten tërmete me intensitet $I_{max} = 8$ ballë MKS-64 për kushte mesatare trualli.

Bazuar në klasifikimin e trojeve dhe vlerave të koeficientit sizmik, është e qartë se për të gjitha strukturat deri në lartësinë e 8 kateve, duhet aplikuar $k_1=0.16$ për të gjitha ndërtimet I; $k_1=0.22$ për të gjitha ndërtimet në troje të kategorisë së II dhe $k_1=0.26$ për të gjitha ndërtimet në troje të kategorisë së III.



Klima e territorit të Bashkisë është mesdhetare para-malore dhe malore. Pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit, lartësia absolute mbi nivelin e detit dhe largësia nga deti Adriatik ka mundësuar natyrën kontinentale të klimës e cila duket në dimrin e ftohtë e të lagësht dhe në verën e shkurtër, të nxehtë e të thatë. **Klima** është e ndryshme. Në luginë ajo është e butë. Në ngrehinat malore dhe shpatet e tyre, bëhet më e ftohtë në dimër dhe e freskët në verë. Klima e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

zonës së Librazhdit në tërësinë e saj është mesdhetare paramalore e malore me element kontinental.. Zona karakterizohet nga një regjim intensiv reshjes ku mesatarja gjithë vjetore është 1364 mm nga të cilat pjesa më e madhe është në stinën e dimrit. Era lokale karakteristike është ajo e lindjes. Temperatura mesatare është 13.4 grade Celsius, temperatura maksimale e regjistruar është 40.7°C më 14.9.1957 dhe temperatura minimale është regjistruar në vitin 1968 -15.5°C. Temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është 5.5°C në Janar dhe më e ngrohtë 24.5°C në Gusht.

Numri i ditëve me reshje është një parametër tjetër i rëndësishëm i cili shpreh regjimin e reshjeve. Numri i ditëve me reshje më shumë se 1 mm që vrojtohen gjatë një viti është mesatarisht 95.6 ditë. Shpërndarja gjatë vitit e numrit të ditëve me reshje është praktikisht e njëjtë me atë të sasisë së reshjeve. Muaji me numrin më të madh të ditëve me reshje është muaji Nëntor, ndërsa muaji me numër më të vogël të ditëve me reshje është muaji Korrik.

Një indikator me përdorim të gjerë në ndërtim, hidroteknikë, agrokulturë, etj, është edhe intensiteti me të cilin bien reshjet. Në këtë kuadër treguesi kryesor dhe më i përdorshëm është maksimumi 24 orë i reshjeve si dhe vlerat e pritura për periudha përsëritje të ndryshme. Vlera më e lartë e reshjeve të vrojtuar, të rëna brenda 24 orëve, është 135.7 mm/24orë. Kryesisht vlerat më të mëdha të maksimumeve 24 orëshe të reshjeve vrojtohen gjatë periudhës vjeshtë dhe pranverë të vitit, por nuk përjashtohen rastet kur edhe në stinën e ngrohtë të vitit të vrojtohen vlera të larta të reshjeve që bien brenda 24 orëve. Bashkia e Librazhdit për shkak të relievit karakterizohet, sidomos në zonat malore nga numri i madh i ditëve me dëborë trashësia e së cilës mund të arrij nga disa cm deri në 1.1.m.

5.6. Kushtet hidrogeologjike të Bashkisë Librazhd

Bazuar në ndërtimin gjeologjik dhe aftësinë ujëmbajtëse, në rajonin e Librazhdit klasifikojmë këto komplekse ujëmbajtëse:

❖ Kompleksi ujëmbajtës i shkëmbinjve të shkrifët - me ujëmbajtje mesatare.

Kompleksi ujëmbajtës i shkëmbinjve të shkrifët - me ujëmbajtje mesatare, përfaqësohen kryesisht nga depozitimet aluviale të cilat janë të përhapura në të dy krahët e lugines së lumit Shkumbin.

❖ Kompleksi ujëmbajtës i shkëmbinjve kompaktë, ku dallohen:

- Me ujëmbajtje mesatare deri të lartë jo uniforme;
- Me ujëmbajtje mesatare
- Me ujëmbajtje të ulët deri mesatare, jo uniforme

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Në këta shkëmbinj bëjnë pjesë:

- ✓ Shkëmbij të ultrabazike - Dunite, lercolite, harburgite, serpentinite.
 - ✓ Shkëmbinj të Jurasikut të mesëm (σ_{J_2}) shtroja metamorfike, amfibolite, paragnejse, rreshpe kuarc-mikore.
 - ✓ Shkëmbinj të Jurasikut të mesëm – të sipërm (β_{J_2}) - Shkëmbinj efuzive, diabaze, dhe lloje të tjera piroklastike.
- ❖ **Kompleksi ujëmbajtës i shkëmbinjve praktikisht pa ujë, ku dallohen:**
- Shkëmbinj të shkrifët pa ujë;
 - Shkëmbinj kompaktë pa ujë

5.6.1. Hidrografia

Zona ka një rrjet hidrografik shumë të pasur ka një sistem ujrë të shtrirë në rreth 2700 km. Lumi kryesor që e përshkon është Shkumbini që furnizohet nga disa degë sikurse janë: Rrapun, Zalli i Qarrishtës, Zalli i Gurakuqit, Bushtrica, Hotolishti, Gostima, përroi i Gorës, përroi i Madh, përroi i Zajës etj. Lumi i Shkumbinit furnizohet nga pellgu i tij që ka një sipërfaqe 2444km², gjatësi 181km dhe lartësi mesatare 753m.

Shkumbini është baseni ujor më i madh i zonës. Ka gjerësi mesatare deri 29 m. Ka brigje të lartë nga 4-10 m, me gjerësi deri 120 metër, të veshur me bimësi. Shtrati është Zallishtë. Rruga kalon në VL të tij. Urat kryesore janë ato në *Librazhd*, *Bushtricë* e *Qukës*.

Sistemi i liqeneve të pranishme është mjaft i larmishëm. Në rrjetin hidrik statik të bashkisë rëndësi kanë liqenet e parkut kombëtar Shebenik- Jabllonicë (ky park shtrihet pjesërisht edhe në bashkinë Prrenjës, njësi administrative Rrajcë). Liqenet e këtij parku janë të tipit akullnajor. Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajorë të vegjël me bukuri madhështore, të cilët ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra mbi nivelin e detit. Janë gjithashtu dy lumenj që rrjedhin përmes zonës së Parkut me një gjatësi prej 22 km, përfshirë në veri lumin e Qarrishtës që bashkohet me lumin Rrapun dhe në jug lumin e Bushtricës që bashkohet me lumin Shkumbin.




Figura 4. Harta e sistemit hidrik (Burimi: Instituti i Hidrologjisë. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

5.7. Rrëshqitjet dhe rrëzimet shkëmbore.

Në sipërfaqen në studim rrëshqitjet dhe rrëzimet shkëmbore janë prezente në disa sektore. Ato ndodhen në shpatet e luginave të përrrenjëve dhe në anët e rrugës nacionale Librazhd – Prrrenjas dhe Librazhd – Elbasan, por në shpatet e maleve apo kodrave që formojnë luginë e Shkumbinit. Janë të përmasave të vogla dhe rrafshin e rrëshqitjes e kanë zakonisht midis depozitimeve sipërfaqësore të deluvioneve dhe atyre konglomeratike të tortonianit. Shpesh këto rrëshqitje dëmtojnë shtëpi ndërsa rrëzimet e rrjedhjet shkëmbore prekin sidomos aksin e rrugës nacionale. Shkaqet kryesore të ndodhjes të rrëshqitjeve apo rrëzimeve janë terreni mjaft i zhveshur dhe i pjerrët (Murrash), mungesa e pritave dhe mos sistemimi i ujrave sipërfaqësore.

5.8. Boniteti i tokave

Bashkia Librazhd ka një sipërfaqe të konsiderueshme toke. Karakteristikë themelore e kësaj zone është se pjesa më e madhe e sipërfaqes së tokës është kodrinore dhe malore dhe shumë më pak është fushore (gropa midis maleve dhe përgjatë luginës së lumit Shkumbin).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Përbërja pedologjike karakterizohet nga tre breza: ai i tokave të hirta kafe, i tokave e kafenjta dhe i tokave e murrme pyjore në lartësitë e mëdha. Në brezin e dytë bëjnë pjesë ato të nëntipit të kuqërremtë me përmbajtje të vogël lëndësh organike. Një pjesë e tyre janë rezultat i shpyllëzimeve të cilat tashmë kanë filluar të popullohen nga flora natyrale barishtore, shkurre dhe drunore. Ndërkohë që një pjesë e mirë janë kthyer në vreshtari apo kultivuar me drurëfrutor autokton apo të introduktuar.




Figura. 5. Harta e zonave bujqësore (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Bashkia Librazhd disponon zyrtarisht rreth 9 500 ha tokë bujqësore, por nga të dhënat faktike, këto toka mund të shkojnë në rreth 13 500 ha, përkatësisht;

➤ Vreshta	80	ha
➤ Pemët frutore dhe plantacione	64	ha
➤ Kullota	31	ha
➤ Modele komplekse kultivimi	5900	ha

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH D

- Land kryesisht zënë nga bujqësia 7421 ha

Problematike është mospërputhja e të dhënave të bonitetit me gjendjen faktike të pjellorisë së parcelave. Ndryshimi është në favor të tokave të kategorive me të larta. Psh në të dhënat kategoria është V, kur duhet të jetë VI ose VII. Kjo është sipas studimeve të drejtorisë lokale dhe prodhimtarisë së kulturave bujqësore.




Figura. 6. Harta e përdorimit të tokës (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Analiza e përdorimit të tokës është bërë në nivel bashkie duke u bazuar në funksionet që zhvillohen në të. Zonimi i territorit është bërë duke përdorur kriteret e mëposhtme të ndarjes së territorit, si:

- Zonë me funksion banimi;
- Zonë me aktivitet ekonomik tregëtar;
- Zonë me funksion të përzier industrial;
- Zonë me funksion industrial prodhuese;
- Zonë bujqësore;
- Zonë natyrore.

5.9. Popullsia dhe veprimtaria e saj.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Bashkia e Librazhdit ka një popullsi të vogël e cila paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në zonë.

Popullsia e Bashkisë Librazhd është pjesë strukturale dhe funksionale e zhvillime demografike që karakterizojnë hapësirën territoriale të Qarkut të Elbasanit, ku paraqen dinamika të ngjashme me ato të kryeqytetit, pra ku popullsia në moshë pune është rreth 45% dhe koeficientet e varësisë së moshës së ulët dhe të lartë përqëndrohen në vlerat mesatare kombëtare (përkatesisht 30% dhe 15%).

Shpërndarja sipas grupmoshave dhe gjinisë është e ngjashme me atë të qarkut Elbasan, pasi në të dy rastet meshkujt përbëjnë rreth 49,7% të popullsisë së përgjithshme (50% për qarkun e Elbasanit). Bashkisë Librazhd si aktivitet kryesore ka: për zonat rurale bujqësia, blegtoria, vreshtari (por që tashmë janë pothuajse të abandonuara), aktivitet tregëtarë të thjeshta. Këto vitet e fundit janë aktivizuar dhe disa burime veprimtarie alternative sikurse është ajo hidrike, turizmi malor, etj.

Referuar të dhënave të marra nga Censusi i viti 2011				
Numri i popullsisë dhe Shpërndarja sipas grup moshave				
Njësitë Administrative	Nr. Total i popullsisë	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç
Librazhd	6937	1611	4784	542
Qëndër	8551	1981	5684	886
Hotolisht	5706	1379	3808	519
Polis	3385	679	2175	431
Orenjë	3883	928	2554	401
Lunik	2621	596	1699	326
Stëblevë	809	127	552	130
Totali	31892	7301	21256	3235

Tabela nr. 2. Numri i popullsisë dhe Shpërndarja sipas grup moshave-Bashkia Librazhd.

Nr	Njesia Administrative	Banore
1	Njësia Administrative Qender	11609
2	Njësia Administrative Polis	5238
3	Njësia Administrative Hotolisht	7206
4	Njësia Administrative Lunik	4430
5	Njësia Administrative Orenje	5230
6	Njësia Administrative Stebleve	1800

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

7	Njësia Administrative Librazhd	10990
	Shuma si bashki	46503

Tabela nr.3. Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative

Nr	Njësia administrative	Censusi 2011	Gjendja civile 2011	Ndryshimi	Ndryshimi %	Sipërfaqja km ²
1	Stëblevë	809	1198	-389	-32%	123
2	Lunik	2621	3715	-632	-21%	103
3	Polis	3385	5011	-1626	-29%	91
4	Orenjë	3883	5210	-1327	-25%	102
5	Librazhd	6937	9760	-2823	-29%	2
6	Librazhd Qendër	8551	11234	-2683	-24%	198
7	Hotolisht	5706	6926	-1220	-18%	175
	Totali	31892	43054	-10070	-23.88%	794

Tabela nr. 4. Shpërndarja e popullsisë sipas censurit dhe gjendjes civile 2011


Shpërndarja e popullsisë sipas Gjendjes civile		
Njësitë Administrative	Nr. Total i popullsisë	Nr. i familjeve
Përrenjas	8936	2524
Stravaj	3028	857
Rrajcë	10431	2776
Qukës	10840	2903
Totali	33235	9060

Tabela nr. 5. Shpërndarja e popullsisë sipas Gjendjes civile

Pjesa më e madhe e popullsisë së bashkisë së Librazhdit është e përqëndruar në zonën urbane dhe rurale përreth qendrës së bashkisë sikurse është njësia administrative Librazhd Qendër, Hotolisht dhe në disa fshatra të afërt të njësive Polis, Orenjë, etj. Kjo do të mundësonte hartimin e një politike menaxheriale sidomos në fushën e infrastrukturës dhe të menaxhimit të mbetjeve efikase qoftë në mënyrën e realizimit dhe të rezultateve që përfitohen qoftë në aspektin ekonomik por sidomos në atë mjedisor. Aktiviteti kryesor i popullsisë së bashkisë është në zonën urbane industria ushqimore, konservuese, ndërtuese dhe social-ekonomike, ndërkohë që zonat rurale primar kanë bujqësinë dhe blegtorinë por dhe vreshtarinë, pemtarinë, etj. Aktualisht konstatohet ekzistenca e një raporti të zhdrejtë midis aseteve ekzistuese të çdo njësie formuese të bashkisë, nevoja të banorëve dhe mënyrës së shfrytëzimit të tyre. Popullsia dhe raporti i saj me mjedisin është kontradiktor pasi nuk ekzistojnë plane territoriale shfrytëzimi

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

dhe menaxhimi. Fakt është se lugina që është relativisht më e populluar është impaktuar negativisht nga aktiviteti i popullsisë në mënyrë direkte dhe indirekte.



Grafiku nr. 1. Grafiku i shpërndarjes së popullsisë sipas gjendjes civile 2012-2013.

Ajo ç'ka konstatohet nga studimi i dinamikës së popullsisë është prania e migrimit të brendshëm Brenda bashkisë apo drejt bashkive të tjera. Kjo është e lidhur direkt me mundësinë e punësimit dhe zgjerimin e veprimtarive prodhuese. Aktualisht nuk ekzistojnë plane territorial të mirëfillta për shfrytëzimin e kapaciteteve natyre të zonës të lidhur me shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës në mënyrë direkte apo indirekte ç'ka do të mundësonte vazhdimin e popullimit. Ndërkohë që shfrytëzimi i natyrës pa kriter sidomos i pyjeve për qëllime aspak komunitare ka shtuar ndjeshëm stresin mjedisor, kufizuar burimet e ekzistencës, ka tjetërsuar mjedisin deri në rrezikim të qëndrueshmërisë së tij për shkak të relievit, shtimit të erozionit dhe shkarjeve.

5.10. Infrastruktura.

Bashkia Librazhd ka akses shume të mirë me rrugët me rëndësi kombëtare që kalojnë në territorin e saj. Superstrada Tiranë - Korçë, boshti qendror jugor Rruga E8 52 (rrugë ndërkombëtare), e cila nis nga Tirana, kalon në librazhd deri në kufirin me Maqedoninë. Sipas analizës së infrastrukturës rrugore në Bashkinë Librazhd ka rrugë lineare të cilat shtrihen në periferi të qytetit si dhe mbizotërojnë në njësitë administrative me karakter rural. Gjendja e infrastrukturës rrugore nuk është e mirë, vetëm 30 % rrugë të shtruara. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, pra rrugë në të cilat nuk janë bërë shumë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

investime.




Figura. 7. Rrjeti ifrastrukturës sipas kategorive (Burimi: Bashkia Librazhd. Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l)

Furnizimi i pershtatshem i furnizimit me uje, kanalizimet, dhe hapesira e pershtatshme e banimit jane tregues jo monetare te nje standardi te caktuar jetese. Ne vitin 2001, sigurimi i ujit dhe i kanalizimeve ishin te dy ne nivele mjaft te pershtatshme ne zonat urbane, ndersa ne zonat rurale teper te pamjaftueshem (uji 5,6 dhe kanalizimet 3,2 here mepak).

Përsa i përket të dhënave lokale vërehet përsëri epërsia e bashkisë së Librazhdit në të cilin gati tërësia e banesave janë të furnizuara nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit direkt në brendësi të banesës (98,0%), llojet e tjera të furnizimeve paraqesin përqindje të papërfillshme.

Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga bashkia Librazhd lidhur me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha (KUB) vihet re që bashkia e vjetër Librazhd ka një mbulim të mirë me këtë shërbim. Bashkia është e pajisur me pusetat përkatëse dhe siguron një shtrirje të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

plotë në kufirin e vjetër të bashkisë. Përsa i përket njësive të tjera administrative, ku shërbim është shtrirë me anë të kolektorëve kryesor, pjesa më e madhe e këtyre njësive e sigurojnë këtë shërbim me anë të puseve të krijuara nga vetë banorët. Vetë rrjeti KUB është i amortizuar përveç zonave ku janë kryer ndërhyrje rishtazi nga bashkia. Relievi tepër i pjerrët në pjesën më të madhe të bashkisë ka ndikuar në krijimin e këtyre pusëve vetëm në zonat ku është e domosdoshme drenazhimi, për pjesën tjetër ajo kryhet në forma natyrale.

E njëjta situatë vërehet dhe për rrjetin ekzistues elektrik. Njesia e administrative ose bashkia e vjetër librazhd, siguron një mbulim të mirë të këtij rrjeti dhe është i pajisur dhe me shtyllat përkatëse. Nga observimet në terren vihet re që për problemin e amortizimit të këtij rrjeti nuk ka patur ndërhyrje.

Një tjetër element për tu analizuar është lloji i ngrohjes i përdorur nëpër banesa, pasi ky i fundit është një tregues i mirëfilltë i mirëqenies së banorëve, krahas sistemit të furnizimit me ujë.

Për sa i përket llojit të ngrohjes të përdorur qarku i Elbasanit paraqet përqindje të papërfillshme të çfarëdolloj sistemi me përjashtim të sobave (85% të banesave) dhe në bashkinë Librazhd ku 88,8% e banesave ngrohen nepermjet sobave, 2,5% e banesave ngrohen me ngrohës elektrik dhe 3,5% me kondicioner, përqindjet e tjera janë shumë të ulëta.

Organizmi funksional i sipërfaqes së hapësirës së qytetit është:

- Zona e banimit, e cila përfshin funksionet e banimit, shoqërore, shërbime, gjelbërim dhe rrugë të brendshme) ka qenë e parashikuar të jetë 16 ha
- Zona ekonomike është parashikuar të jetë 10 ha.
- Zona e parkut dhe e terreneve sportive është menduar të jetë 7 ha.
- Rrugët dhe sheshet 4 ha
- I gjithë territori brenda vijës së verdhe të kufirit të banimit, është 37 ha.
- Korridoret rrugore ndahen në:
 - Rrugë për transportin e rëndë
 - Rrugë për transportin e rëndë dhe të lehtë
 - Rrugë të transportit të lehtë
 - Rrugë të transportit të brendshëm
 - Rrugë për Transportin hekurudhor dhe këmbësor

5.11. Mjedis biologjik (Flora, fauna, ekosistemet, biodiversiteti dhe monumentet e natyrës)

Bashkia Librazhd nga pikpamja mjedisore paraqitet me një biodiversitet shumë të pasur tipike për zonat me klimë mesdhetare kodrinore të përfaqësuar nga nënzona mesdhetare kodrinore qendrore, nënzona mesdhetare qendrore paramalore dhe nënzona mesdhetare malore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Kushtet klimaterike, pedologjike dhe lartësia mbi nivelin e detit ndikojnë në larmishmërinë morfologjike dhe strukturale të biodiversitetit, ekosistemeve, habitateve, peisazheve natyrore të hapësirës së bashkisë. Në territorin e Bashkisë takohet 4 brezat bimor por mbizotërohet nga zona e dushqeve dhe ahut, por jo më pak influente është zona e kullotave alpine. Larmishmëria takohet më shumë në zonat rurale sikurse janë Stëbleva, Kuturmani, Dardha, Xhyra, Polisi, etj., por jo më pak e gjelbëruar është dhe ish bashkia Librazhd (qyteti) me bimësi dekorative.

Territori ka një florë mjaft të pasur e cila përfaqësohet me 1857 lloje bimore spontane të cilat përbëjnë 58% të florës së Shqipërisë dhe 16% të florës së Europës duke bërë që Bashkia Librazhd të konsiderohet një nga më të pasurat në vend në lidhje me biodiversitetin.

Bimësia e luginës përbëhet kryesisht nga dushqet dhe më pak nga shkurretat mesdhetare, këto të fundit më të pranishme përgjatë grykës së Shkumbinit. Duke filluar nga rrepat (gj. Platanus), shëlgjet (gj. Salix, vidhi (Ulmas caepstris) dhe për të vazhduar më lart me Dushqet (bunga, bungëbuta, shparthi, qarri, ilqe, dushku, përralli) (gj. Quercus petraea, Quercus pubescens, Quercus frainetto, Quercus cerris, Quercus ilex, Quercus robur, Quercus coccifera), mbizotëruar nga qarri (Quercus cerris), panjë (gj. Acer), gështenja ((gj. Castanea. Sp), etj, me shkurret e shkozës (Carpinus sp.), lajthisë (Coryllus avellana), dëllinjës (Juniperus sp.), mështekna (Betula alba), vërri (Alnus glutinosa), thana (Cornus mas) lajthia (Corillus avellana), frashëri (Gj. Fraxinus), kulpra (Clematis vitalba), manaferra (Rubus fructicus), trëndafil të egër (Rosa canina) dhe shpesh masive bushi (Buxus sempervirens). Në drejtim të lindjes shkurret mesdhetare bëhen më të rralla, dhe llojet gjithnjë të blerta zëvendësohen nga llojet gjetherënëse. Më kryesorët e këtij brezi janë mareja (Arbutus unedo), shqopa (Erica arborea), driza (Paliurus aculeatus), dëllinja (Juniperus sp.) etj. Ahishtet gjenden kryesisht në lartësi, të pastra (Fagus sylvatica), të zhvilluara mirë, dhe në shpatet e pjerrëta me kundrejtim jugor dhe perëndimor të përziera edhe me halorë ose dhe me fletorë të tjerë. Në anë të lumit takohen bimët e rrapit (Platanus orientalis) dhe të shëlgut (Salix alba). **Bimësia** në luginë është e larmishme. Shkurret zotërojnë deri në lartësinë 800 metër. Pastaj vijnë pyjet, si ato të Qarrishtes e Llangës, të Shebenikut që janë të përzier pishë (Gj. Pinus sp.) dhe ahu (Gj. Fagus sp.). Edhe krahu i malit të Polisit ka pyje masive ahu mbi lartësinë 800 metër deri 1450m. Pjesë e konsiderueshme dhe me mjaft vlera natyrore dhe ekonomike është bimësia shkurre – drunore e kultivuar (jo më pak prezente dhe e rëndësishme është bimësia bujqësore, perimore, foragjere) si arrat (Gj. Junglans), Qershitë (Gj. Cerasus sp.), shegë (Gj. Punica sp.), mollët (Gj. Malus sp.), lajthitë (Gj. Corillus), ftonjtë (Gj. Cydonia sp.), fiku (gj. Ficus sp.), mani (Gj. Morus sp.), dardhat (Gj. Pirus sp.), kumbullat (Gj. Prunus), hardhitë (Gj. Vitis sp.), etj.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Padyshim që pjesa më e rëndësishme e kësaj bashkësie është flora, fauna, monumentet e natyrës, hidromonumentet, ekosistemet dhe habitatet e shumëllojshme. Bashkia mbizotërohet nga pyjet, toka bujqësore dhe më pak zona urbane. Gjenden të gjitha katet bimore dhe mbulesa bimore zë rreth 72 % të territorit të Bashkisë Librazhd.

Referuar informacioneve zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Rrjetit të zonave të mbrojtura të vitit 2014 të përgatitur nga *Drejtoria e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura, sektori i zonave të mbrojtura, në territorin e bashkisë së re Librazhd ndodhen Zonat e mbrojtura si më poshtë:*

- **Parku Kombëtar Shebenik – Jabllanicë**, kategoria II, me sip. 33,927.7 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.640, datë 21.05.2008;
- **Parku Natyror Rajonal Kuturman**, kategoria IV, me sip. 3,600.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri shpallur me Rreg. MB nr.1, datë 27.7.1977;
- **Parku Natyror Rajonal Polis**, kategoria IV, me sip. 45.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- **Parku Natyror Rajonal Dardhë - Xhyrë**, kategoria IV, me sip. 400.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Në territorin lindor të bashkisë shtrihet Parku Kombëtar **Shebenik – Jabllanicë**, me vlera të larta mjedisore dhe i pasur me monumente natyrore.

Pjesa më e rëndësishme është Parku kombëtar Shebenik- Jabllanicë që përbën një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm të bashkisë së Librazhdit. Përveç këtij parku, treva numëron edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë. Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë dhe dispozitat e Ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", Qeveria e Shqipërisë në vitin 2008 shpalli ekosistemin e maleve të Shebenik-Jabllanicës Park Kombëtar me një sipërfaqe prej 33 927, 66 ha.

Në Parkun kombëtar ndër llojet kryesore të bimësisë përmendim, ahun (*Fagus Sylvatica*), bredhin (*Abies Alba*), lloje të ndryshme të dushkut (*Quescus*), lloje me prezencë më të rrallë si plepi (*Populus tremula*), shelgu (*Salix purpurca*), panja (*Acer platanoides*), si dhe bimë barishtore insektngrënëse, manushaqja e dukagjinit (*Viola ducadjinika*), e rrallë dhe e rrezikuar si dhe genista endemike (*Genista hassertiana*). Parku ka drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështekna, arneni, bushi, panjë, shelg, lajthi, shkozë, mëllezë, vidh, vodhëz të egër, qersh të egër, boronicë, gorricë, dardha të egër, trëndafil të egër, çaji i mali, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve.

Edhe fauna e zonës është mjaft e pasur. Speciet kryesore të faunës janë: ariu i murrmë, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lalës, shqiponja, skifteri. Më të rrallë janë: zardafi, derri i egër,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

kaprolli, dhia e egër, rrëqebulli, gjeli i egër, trofta e malit. Klima e Parkut është në kategorinë e klimës mesdhetare, me temperatura mesatare vjetore ndërmjet 7°C dhe 10°C. Reshjet mesatare vjetore janë midis 1.300 mm dhe 1.800 mm.

Kufijtë e këtij “Parku kombëtar” janë si më poshtë vijon:

Veri: Pika e takimit të rrugës automobilistike Librazhd-Steblevë me rrugën Librazhd- Dorëzi, me koordinata $X = 44\ 41\ 509.41/Y = 45\ 64\ 276.59$, ura e Lumit Rapun, pranë fshatit Zagost, shkalla e Lunikut, fshati Llanga, Fushë Studa. Kufiri verior ndjek rrugën e fshatit Borovë, në kuotën 887 m, përroin e Zallit të Klenjës, ndërpret rrugën automobilistike Steblevë-Klenjë, në kuotat 1 328 m, 1 462 m, 1 484 m, 1 654 m, 1 778 m, pika kufitare me kuota 1 980 m (Shkëmbi Shqipes) ($x = 44\ 60\ 524.30/Y = 45\ 80\ 064.18$);

Lindje: Kuota 1 980.0 m (Shkëmbi Shqipes), me koordinata $X = 44\ 60\ 524.30/Y = 45\ 80\ 064.18$, vijon përgjatë kufirit shtetëror, në kuotat 2 071 m, Maja e Radacit (2 081 m), 2 069 m, Qafa Kruqit, 2 132 m, Shpella Ariut, 2 030 m, Qafa Kokelit (1 883 m), 1 922 m, 1 948 m (Maja Reti Kurorës), 2 020 m, (Maja Varri Marikës), 2 133 m (Maja e Kallkanit), 2 189 m, 1 709 m, 1 611 m, 1 594 m, Qafa Rinas 1 404 m, me koordinata $X = 44\ 65\ 215.85/Y = 45\ 53\ 644.62$.

Jug: Kuota 1 404 m, me koordinata $X = 44\ 65\ 215.85/Y = 45\ 53\ 644.62$, ndjek kurrizin dhe rrugën këmbësore, në drejtim të Qafa Policës, në kuotën 1 366 m (Maja Kyqi Mjet), kalon te Qafa e Gjashtë Lisave, ndjek rrugën për këmbësorë dhe kuotat 1 379 m, 1 376 m (Maja Skurës), me koordinata $X = 44\ 95\ 13.84/Y = 45\ 53\ 516.22$;

Perëndim: Kuota 1 376.3 m (maja Skurës), me koordinata $X = 44\ 95\ 13.84/Y = 45\ 53\ 516.22$), zbrit kurrizin, ndërpret lumin e Bushticës, vijon në kuotat 1 147 m, 1 054 m (Maja Trestenikut), 1 143 m (Maja Varri i Plakës), 1 063 m, ndjek rrugën për këmbësorë për në fshatin Bozgarë-Kokrevë, në kuotën 783 m, ndërpret përroin e Hotolishtit, ngjitet kurrizit, në kuotat 767 m, 744 m, 1 100 m, 505 m, 916 m, kalon përgjatë rrugës Dorëzi-Librazhd, deri te pika e takimit me rrugën automobilistike Librazhd-Steblevë, me koordinata $X = 44\ 41\ 509.41/Y = 45\ 64\ 276.59$.

Jo pak e rëndësishme është dhe zona e Polisit. Sipëfaqja aktuale është 45.00 ha. Kjo zonë përmbledh shumë habitate: pyje (ahishte e pishnaja), kullota subalpine dhe alpine, liqene akullnajore, kanione, ujëvara, guva, maja etj.. Takohen lloje endemike dhe subendemike bimësh. Zona përbën një bërthamë dhe biokorridor shumë të rëndësishëm për rruazorët e mëdhenj si ariun (*Ursus arctos*), ujkun (*Canis lupus*), rrëqebullin (*Felis lynx*), dhinë e egër (*Rupicapra rupicapra*), derri (*Sus scrofa*), lepur (*Lepus europeus*), etj. Konsiderohet edhe si zonë e rrugëkalimit të shpendëve migrator rrëmbenjs (Gj. *Accipiter*, Gj. *Corvus*, Gj. *Pirrohocvorax*, Gj. *Falco*, Gj. *Scrolopacides*, Gj. *Aquila*, Gj. *Alectoris*, Gj. *Hiudinidea*, etj), pra përbën një biokorridor me rëndësi.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Koordinatat e saj janë:

- a) Veri: $X = 44\ 43\ 740.16 / Y = 45\ 56\ 060.68$;
- b) Lindje: $X = 44\ 43\ 936.09 / Y = 45\ 54\ 36.38$;
- c) Jug: $X = 44\ 43\ 394.80 / Y = 45\ 55\ 276.98$;
- d) Perëndim: $X = 44\ 43\ 172.31 / Y = 45\ 55\ 721.96$.

Zona e mbrojtur e rëndësishme nga pikpamja e mjedisit është ajo Dardhë-Xhyrë. Sipëfaqja aktuale është 400.00 ha. Zonë me vlera të larta biodiversiteti, pyje të virgjër të dominuar nga ahu, por takohen dhe drurë të tjerë. Bimë endemike e subendemike. Zona përfaqëson një kombinim të pyjeve të dushkajave dhe të ahisteve. Dushkajat dominohen nga qarri (*Quercus cerris*) që përziehet me bungën (*Quercus petraea*) dhe në vëndet e dëmtuara me mëllezën (*Ostrya carpinifolia*), dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*) etj. Në çeltirat e krijuara mbas prerjes së drureve të qarrit përhapen masivisht individë të badhrës (*Asphodelus albus*) si dhe shfaqjen masive të dëllinjës së kuqe (*Juniperus oxycedrus*) dhe të qumështores (*Euphorbia myrsinites*). Pyjet e ahut (*Fagus sylvatica*) në gjendje thuajse të virgjër. Në të çarat e shkëmbinjve takohen *Geranium macrorrhizum*, *Asplenium trichomanes*, *Saxofraga paniculata*, *Athamanta macedonica*, *Achillea frasi*, *Origanum vulgare*, *Salvia glutinosa*, *Digitalis ferruginea*, *Tanacetum macrophyllum* etj. zona konsiderohet bërthamë dhe biokorridor i rëndësishëm i gjitarëve të mëdhenj, duke fituar dhe vlera e rëndësi rajonale/balkanike.

KOORDINAT JANË:

- a. Veri: $X = 44\ 48\ 617.51 / Y = 45\ 50\ 743.60$ deri te kuota 1207.0 m ($X = 44\ 49\ 997.95 / Y = 45\ 50\ 008.17$);
- b. Lindje: Kuota 1207.0 m ($X = 44\ 49\ 997.95 / Y = 45\ 50\ 008.17$), kuota 1152.0 m, ndjek rrugën këmbësore, kuotat 1452.0 me 1537.0 ($X = 44\ 50\ 944.41 / Y = 45\ 47\ 320.26$);
- c. Jug: Kuota 1537.0 m ($X = 44\ 50\ 944.41 / Y = 45\ 47\ 320.26$), qafa Kumbullës deri te maja Guri i Varrit të Lenës (1773.5m) ($X = 44\ 49\ 133.47 / Y = 45\ 48\ 777.71$);
- d. Perëndim: Maja Guri i Varrit të Lenës (1773.5 m) ($X = 44\ 49\ 133.47 / Y = 45\ 48\ 777.71$), kuota 1734.0 m, përgjatë pyllit të Bërzështës deri te pika me koordinata ($X = 44\ 48\ 617.51 / Y = 45\ 50\ 743.60$).

Zona e Kuturmanit ndodhet në Qarkun e Elbasanit dhe në rrethin e Librazhdit. Sipëfaqja aktuale është 3,600.00 ha.

Kategoria I	Rezervë rreptësisht natyrore/rezervë shkencore		
Kuturman	3.600	Librazhd	05.11.1977/1983
Polis	45	Librazhd	15.01.1996
Stravaj	400	Librazhd	15.01.1996
Sopot	300	Librazhd	15.01.1996

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Qarishtë	318	Librazhd	15.01.1996
Dardhë-Xhyre	400	Librazhd	15.01.1996

Tabela nr.6. Kategorizimi i zonave të mbrojtura-Bashkia Librazhd

Është pjesërisht i dëmtuar dhe i tejshfrytëzuar, megjithë këtë zona paraqet vlerat e përfaqësimit të gjërë të pyllit të dushkut, të florës dhe faunës së tij. Është përdorur si rezervat për gjuetinë e derriit të egër (Sus scrofa), lepurit, thëllëzës, etj.. Zona ka rëndësi edhe për zhvillimin e ekoturizmit për komunitetin si dhe për përfitime ekonomike nga përdorimi i qëndrueshëm.

Koordinatat janë:

- Veri:** Pika e trakimin me lumin e Shmilit ($X = 44\ 34\ 208.66/Y = 45\ 69\ 364.16$), ndjek kanali ujitës të Kuturmanit deri te pika me koordinata ($X = 44\ 37\ 165.93/Y = 45\ 68\ 448.81$);
- Lindje:** Pika me koordinata ($X = 44\ 37\ 165.93/Y = 45\ 68\ 448.81$), vazhdon përsëri përgjatë kanalit ujitës të Kuturmanit, në përroin e Burgjes, kuota 502.0 m, qafa Gurës, kuota 532.0 m, në krah të lumit të Rapunit deri në afërsi të pikës së takimit të lumit Shkumbin me atë të Rapunit ($X = 44\ 41\ 189.94/Y = 45\ 62\ 185.72$);
- Jug:** Pika e takimit të lumit Shkumbin me atë të Rapunit ($4441189.94L/4562185.72V$), vijon në krahun e djathët të rrjedhës së lumit Shkumbin dhe përgjatë rrugës automobilistike Elbasan-Librazhd, deri në afërsi të pikës (Mirakë) me koordinata ($X = 44\ 35\ 650.33/Y = 45\ 59\ 485.44$);
- Perëndim:** Pika (Mirakë) me koordinata ($X = 44\ 35\ 650.33/Y = 45\ 59\ 485.44$), ngjitet kurritit mbi fshatin Mirakë, ndjek rrugën automobilistike të fshatit, qafa Barit, kuota 1083.0 m, përgjatë përroit të Gjzhës, kuota 1098.2 m deri te pika e takimit me lumin e Shmilit ($X = 44\ 34\ 208.66/Y = 45\ 69\ 364.16$).

Territori i Bashkisë paraqet larmishmëri faune, shoqërimesh bimore, habitatesh, ekosistemesh, zona të mbrojtura, peisazhore, zona strikte, biomonumente, hidromonumente, gjeomonumente, etj. pra diversiteti natyror është i konsiderueshëm dhe përbën një nga faktorët që rrit ndjeshëm atraksionin turistik të zonës. Jo pak ndikim në këtë atraksion kanë dhe vlerat historike e kulturore të zonës, çka krijojnë një sinergji multifunksionale me impakt pozitiv të ndjeshëm në dinamikën e Bashkisë dhe funksionalitetin e saj.

Mjedisi biologjik është mjaft i pasur por për nga vlerat shkencore dhe rëndësia citojmë.

➤ Monumete të Natyrës

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD



Figura 8. Harta e shpërndarjes së monumenteve të Natyrës.

1. Mështekna e Qarishtës
2. Pylli i Stravajt
3. Druri i Bizgës
4. Vrima e Dardhës së Ariut
5. Vrima e Stërçokave
6. Shpella e Hasanit
7. Shpella e Shkëmbit të Bletës
8. Pusi i Faqes së Madhe
9. Shpella e Kosharishtit
10. Shpella e Pishkashit
11. Shpella e malit të Letmit
12. Sofra e Skënderbeut
13. Burimi i Studnës
14. Gurra e Kosharishtës
15. Liqenet e Rajcës
16. Liqeni i Floqit
17. Liqeni i Shebenikut
18. Liqeni i Varrit të Plakës

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

19.Rrapi i Bërzeshtës

20.Rrepet e Gurakuqit

21.Mani i Çupit

22.Rrapi i Hotolishtit

23.Rrapi i Taksimit

24.Rrapi i Gizaveshtit

25.Ahet e Fushë Gurrës

26.Pylli i Barkmadhit Kostenjë

➤ **Hidromonumente si:**

➤ Burimi i Studnës

➤ Gurra e Kosharishtës

➤ Liqenet e Floqit

➤ Liqenet e Shebenikut

➤ Liqeni i Varrit të Plakës

➤ **Gjeomonumente**

➤ Vrima e Dardhës së Ariut (Polis)

➤ Vrima e stërqokave (Polis)

➤ Shpella e Hasanit (Dardhë)

➤ Shpella Shkëmbi i Bletës (Dardhë)

➤ Pusi i Faqes ë Madhe (Polis)

➤ Shpella e Kosharishtit

➤ Shpella e Malit të Letmit

➤ **Monumente të propozuara**

➤ Kanioni Rinas (gjeomonument) (mali i Ostrovicës)

➤ Shkëmbi i Gurakuqit (gjeomonument)

➤ Rrapi i Shehut (Bio)

➤ Pylli i Potlit (Bio)

➤ Liqeni i Floqit (Hidromonument) 3.5 ha

➤ Gurra e Malit (hidromonument)

➤ **Flora e zonës tipizohet me loje të tilla si:**

➤ Aesculus hippocastanum L (gështenja e kalit)

➤ Aconitum lamarcki (Akoniti i Lamarkut)

➤ Agrimonia eupatoria (Rodhëza)

➤ Alyssum marcgraffi (serica)

➤ Dryopteris filix-mas (fier mashull)

➤ Crocus cvijicii (Shafrani i Cvijicit)

➤ Crepis baldacci (Krepi i Baldacit)

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- *Chelidonium majus* (Latrapeci)
- *Betula pendula* (Mështekna)
- *Juniperus oxycedrus* (dëllinja e kuqe)
- *Juniperus communis* (dëllinja e zezë)
- *Galium intricatum* (ngjitësja e ngatërruar)
- *Juglans regia* (arra)
- *Galium kernieri* (Ngjitësja e Kernierit)
- *Juniperus foetidissima* (Bërsheni)
- *Leontopodium alpinus* (ylli i alpeve)
- *Lilium albanicum*
- *Malcolmia illyrica* polis
- *Narthecium scardicum*
- *Nymphaea lutea* (Lekoni i Verdhë)
- *Nymphaea alba* (Lekoni i bardhë)
- *Ostrya carpinifolia*
- *Origanum vulgare* (Rigoni)
- *Oxitropus prenja*
- *Paris quadrifolia*
- *Pinus heldreichii*
- *Picea excelsa* (Hormoqi)
- *Pinus sylvestris* (Hartina)
- *Pedicularis brachyodonta*
- *Sideritis syriaca* (Caji i malit)
- *Salvia officinalis* (sherebela)
- *Stachys albanica* (sarusha Shqiptare)
- *Ramonda serbica*
- *Sambucus nigra* (Shtogu)
- *Satureja montana* (Trumza)
- *Sesleria robusta* p
- *Taxus baccata*
- *Tilia platyphyllos* (Blini)
- *Trifolium pilczii* (Tërfili i Pilcit)
- *Ulmus glabra* (Hithës)
- *Ulmus campestris* (Vidhi)
- *Viola ducaginica* shebenik
- *Valeriana officinalis* (Haraqinë)
- *Viscum album* (Veshtull)

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- Vincetoxicum huteri (Qenmbytëse)
- **Shoqërime bimore karakteristike**
- Festucopsis – Pinetum leucodermis
- Betuletum Albae
- Hypericetum Haplophilloides
- Leontopodietum Alpini
- Festuca paniculata – Lilium albanicum
- Myriophyllo – Nupharetum
- Gentiana lutea – Pinetum peucis
- Carpinus orientalis – Fraxinus ornus
- Populetum Tremula
- Fagus sylvatica – Sanicula europaea
- Juglando – Platanetum orientalis
- Juglando – Platanetum orientalis
- Fagus sylvatica – Abies alba

Qendra e bashkisë karakterizohet nga bimësia dekorative. Flora barishtore në tërësinë e saj është mjet e zhvilluar për shkak të kombinimit të faktorëve ekologjik, reshjeve, variacionit të temperaturave, pedologjisë, etj.

Fauna është pasqyrim i gjendjes së florës dhe shoqërimeve bimore. Në përgjithësi takohen larmishmëri gjitarësh por si më të rëndësishëm dhe që duhen evidentuar për nga statusi përmendim ariu (Ursus arcos), Ujku (Canis lupus), Rrëqebulli (Felix lynx), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), dhelpra (Vulpes vulpes), Capreolus capreolus, etj shpendë të zonave kodrionore e malore, zvarrikë të ndryshëm, amfibë, etj., pra fauna është mjaft e pasur dhe atraktive. Sigurisht pasuria natyrore faunistike shtohet nga kafshët e kultivuara sikurse janë tufat e dhenëve e dhive, lopët, pulat, etj.

Larmishëria e natyrës moderohet pozitivisht dhe për disa shkaqe të tjera të lidhura me:

- Territori i bashkisë përshkohet nga *lumi Shkumbin*, që bashkë me pellgun e tij ujëmbledhës, është një lumë i rëndësishëm dhe me prurje ujore të konsiderueshme, që ndikon në zonë, si në drejtimin e vaditjes së tokave bujqësore, peshkim apo përdorim për prodhimin e energjisë elektrike.
- *Rrjeti infrastrukturor kombëtar rrugor dhe hekurudhor*. Rrjeti rrugor kombëtar dhe hekurudhor kalon në pjesën perendimore të bashkisë dhe stacionohen në zonën ish industriale të qytetit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- *Zona e tokave bujqësore*, e cila edhe nën efektin e vaditjes nga lumi dhe përrenjtë, ka një cilësi të mirë produktive.
- Vlen për t'u përmendur korridori i vjetër rrugor “Egnatia”, i cili përshkon bashkinë, dhe konsiderohet si një element kryesor me vlera historike që ka ndikuar në ngjizjen e vendbanimeve të hershme në zonë.




Figura. 9. Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Librazhd (www.google maps)

5.12. Zona të trashëgimisë kulturore e historike.

Vështrim i shkurtër historik

Historia e krijimit të qytetit të Librazhdit si një qendër urbane (zanafilla e tij fillon që në vitin 1929), i ka fillesat në vitet 60' të shekullit të kaluar, kur me krijimin e stacioneve të motosharrave dhe çeljen e minierave për shfrytëzimin mineral të zonës, dilte si domosdoshmëri strehimi i punonjësve për këto ndërmarrje.

Por historiku i krijimit të vendbanimeve të para në këtë territor, i ka fillesat në kohë më të hershme.

Banorët e hershëm Ilirë që kanë banuar trevat e Librazhdit kanë qenë Kandavët, me qendër banimi rreth masivit malor Polis – Bërzeshtë - Babje dhe me gjasë kryeqendra në Babje. Shkëmbimet ekonomike dhe lëvizjet ushtarake kandavët i kryenin duke përdorur “Rrugën e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Kandavise”. Ky emër i kësaj rruge vazhdoi të dëgjohej deri para shek. I pk. Romakët filluan ta zgjerojnë e ta drejtojnë këtë rrugë mbi trasenë e së parës dhe i vunë emrin “ Via Egnatia”.

Përgjatë luginës së lumit Shkumbin, janë identifikuar rreth 20 vendbanime të lashta, mure të vjetër dhe kala, të cilat kanë shërbyer si “qyteza”, “kala”, “gradishta”, “gradec”, “vila-vilëza” sipas emrave që u japin banorët vendas. Disa prej tyre janë: Kalaja e Orenjës, Kalaja e Zdrajshës, Kalaja e Zabelit të Madh, Kalaja e mbi Carjet e Gjedit, Kalaja në Funarës, Kalaja në Malin e Prevallit, Gradeci mbi Gurin e Prasit (Lunik), Qyteza në Shapkë (Librazhd Katund), Maja e Pazares në Dragostunjë, Qyteku në Mirakë, Qyteza e Xhyrës, Qyteza e Qukësit, Gradishta në Dritaj (Manastirec), Muret mbi Bërzeshtë, Vila mbi Gurrat e Brëzeshtës, Vila në Polis, etj.



Figura 10. Vendbanime të hershme dhe korridoreve historike Burimi: Bashkija Librazh Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l

Emri i vjetër i Librazhdit ka qene Libaros. Lugina e Shkumbinit, ku edhe vetë qyteti i Librazhdit ndodhet, ka qenë që në kohë të lashtë një nga rrugët me të përshtatshme natyrale për komunikimin midis pjesës bregdetare të Ilirisë së Jugut dhe brendësisë së Ballkanit. Pa hyrë në Babie, janë gjetur gjurmët e një stacioni të vogël të kohës Romake. Stacioni më i madh në këtë pjesë ka qenë në Rrafjet e Spatharit, ku janë gjetur gjurmë banesash të shpërndara në një sipërfaqe prej disa hektarësh. Spathari ndodhet në mesin e distancës nga stacionet e Tabernas

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

(Qukës) dhe Treiecto (ura e Haxhi Beqarit). Ura e Kamares (Mirakë) është një fragment i rëndësishëm i rrugës së vjetër Egnatia. Në këtë krahinë, janë zhvilluar ngjarje të shumta historike, disa prej të cilave kanë vlerë njohëse për historinë e Shqipërisë dhe shumë të tjerë janë pjesë vetëm e historisë lokale.

6. ANALIZA E PROBLEMATIKËS MJEDISORE, BURIMEVE NDOTËSE DHE EFEKTI I TYRE NË TERRITOR DHE NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ky kapitull trajton gjendjen mjedisore aktuale si rezultante e zhvillimeve të ndryshme social-ekonomike, demografike, infrastrukturore, urbane, etj.




Figura. 11. Analiza mjedisore e Bashkisë Librazhd. Burimi: Bashkija Librazh Punoi: A&E Engineering & Coprogetti S.c.r.l

6.1. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit është e lidhur drejtëpërsëdrejti me shëndetin e njerëzve. Indikatorët e cilësisë së ajrit janë grimcat e pluhurit (PM), që janë përzierje aerosolesh të ngurta dhe/ose të lëngta, që përfshijnë një diapazon të gjerë në grimca dhe përbërje kimike, por praktikisht vlerësohen PM10 dhe PM2.5 që emetohen direkt si grimca primare ose formohen nga emetimet e SO₂, Nox, NH₃, NMVOX.

Bashkia në tërësinë e konfiguracionit të saj karakterizohet nga parametra optimal të ajrit. Kjo është e lidhur me gjeografinë, relievin, klimën, biodiversitetin dhe impakti i ardhur nga veprimtaria e popullatës. Sigurisht që kryeqendra e bashkisë ku është përqëndruar aktiviteti më i lartë social ekonomik por dhe pozicionimi në grabenën e kodrave rrethuese tregon një cilësi të ajrit jo dhe shumë të mirë, por jo dhe tepër shqetësuese. Faktorëve ndikues rrethanor objektiv ju bashkangjiten dhe faktor subjektiv që kanë të bëjnë me politikat menaxhuese sikurse është sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, sistemi i kanalizimeve jo efikas, efikasiteti i infrastrukturës, planifikimi i jetës social-ekonomike etj. Këta faktorë të kombinuar me kushtet klimaterike e impaktojnë negativisht cilësisë e ajrit në këtë hapësirë. Ndërkohë që pjesa tjetër paraqitet shumë më mirë. Sipas hulumtimeve në terren, mbështetur në metoda alternative vlerësimi apo duke përdorur njësi ekuivalente kohë/funksion rezulton se në zonat rurale cilësia e ajrit është e mirë dhe shumë e mirë.

Si pjesë problematike në lidhje me cilësinë e ajrit do të konstatojmë segmentin rrugor përgjatë luginës së Shkumbinit, kryesisht në raport me Qytetin e Librazhdit, ku gjendja e rrugëve sekondare, numri i automjeteve qarkulluese, gjendja e tyre teknike dhe komuniukimi me zonat rurale shkakton rritje të ndjeshme të grimcave të pluhurit (PM10 dhe PM2.5). Ndërsa parametrat e tjerë të gazeve të emetuar konsiderohen si pjesë e çdo rrjeti qarkullues kombëtar apo lokal.

Ndërkohë që si burime ndotëse të ajrit evidentohen ndërtimet kryesisht në periferi të qytetit të Librazhdit, zonat me aktivitet ekonomik, zona e ish ndërmarjeve industriale sikurse stacioni i trenit, fusha e grumbullimit të drurit, fabrika e duhanit, fabrika e pijeve, zona e ish parkut, të cilat janë të pasistemuara dhe trajtohen si pika të pa aseksueshme nga komunitetit. Ndërkohë që në zonat rurale faktor impaktues të cilësisë së ajrit janë zjarret e shpeshta, të shumta dhe të pakontrolluara, shfrytëzimi masiv i pyjeve (Polis), depozitimi dhe zbërthimi natyror i mbetjeve të biodegradueshme, etj. Problematikë paraqet mungesa e infrastrukturës rrugore (sidomos në zonat rurale me rrugë të shumta ekzistuese por pothuajse të pa asfaltuara të gjitha) ku ngrihen sasira të konsiderueshme pluhuri. Por shqetësim për cilësinë e ajrit përbëjnë dhe përdorimi i mjeteve motorike të amortizuara që emetojnë sasira të konsiderueshme gazesh (kjo është më e evidentë në zonat rurale ku qarkullimi bëhet brenda njësive administrative dhe shpesh mund të

jenë dhe mjete të pa kontrolluara e koalidura). Kështu në bazë të vëzhgimeve, analizave të tërthorta kalkulimeve problematika në lidhje me zonat e sipërcituara si shqetësuese për cilësinë e ajrit konstatohet se janë mbi limitin sipas standartit ditor të BE ($50\mu\text{g}/\text{m}^3$) dhe ku numri i ditëve të lejuara është 35. Të lidhur me faktorët e sipërcituar jo shumë e mirë në zonat urbane është dhe gjendja e NO_2 , SO_2 , O_3 , CO dhe BTEX. Por kryesisht ndotës të ajrit me këto komponime apo element janë makinat, zjarret, djegja e biomasave, djegje e mbeturinave në vend depozitime hapsinore apo kazanët e grumbullimit, pluhra dheu dhe ndërtimet. Vlerësohet se si ndotës real për tu vlerësuar dhe konsideruar problematik janë PM10, PM2,5 dhe SO_2 të lidhura me burimet gjeneruese (fakt është se zona përdor në mënyrë intesive drurin si burim ngrohje me impakt të rëndësishëm në cilësinë e ajrit) dhe mungesën e masave alternative.

6.2. Zhurmat/ akustika.

Efektet e zhurmave pasqyrohen në sjellje dhe shëndetin human por dhe më gjerë të mjedisit biologjik. Ndotja akustike shkakton dëmtime fiziologjike, akustike, agresivitet, stres, shqetësimi gjumi, humbje dëgjimi, ndryshim sjellje riprodhuese apo ushqyese në faunë.

Shurmat janë permanente sidomos përgjatë shtratit të lumit Shkumbin që përshkohet nga aksi i korridorit 8. Zona urbane është e ndjeshme nga burimet e ndryshme të zhurmave që gjenerohen në saj të aktiviteteve të ndryshme kryesisht ndërtuese, tregëtore dhe social-ekonomike.

Shqetësimi burimi i zhurmave përbën për qendrën e bashkisë, pra qytetin e Librazhdit ku gjenerohen nga industria ndërtimore, sistemi i transportit, gjendja dhe numri i mjeteve motorike, lokalet etj. Ndërkohë që një burim real sidomos për biodiversitetin dhe koridoret biologjike është aksi i korridorit 8, që gjeneron zhurma të ndjeshme. Problemi bëhet i ndjeshëm për faktin e prezencës së zhurmave në intervalin ditë/natë dhe tejkalimi i kufirit të BE (55/45 dB). Në zonat rurale situata akustike është shumë më e mirë. Si problematikë paraqiten sharrat (shfrytëzimi i pyjeve të Polisit) të cilat nuk respektojnë kërkesat ligjore (kujtojmë se disa nga këto veprojnë apriori ligjit) duke ndikuar në regjimin faunistik me pasojë shqetësime më të ndjeshme riprodhuese ose duke operuar në biokoridoret. Subjekte të tilla shfrytëzojnë pyjet në mënyrë masive, shpesh pothuajse gjatë gjithë vitit, pa respektuar apo u konsultuar me specialist për kriteret e funksionimit të ekosistemeve, biokoridorëve fiziologjike, ushqyese, riprodhuese, etj.

6.3. Regjimi hidrik

Bashkia Librazhd për vetë relievin karakterizohet nga sipërfaqe ujore të konsiderueshme për shkak të prezencës së lumit Shkumbin, por dhe të mjaft burime të tjera më të vogla që rrjedhin

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

nga shpatet formuese të tij, për shkak të aftësisë ujëmbajtëse të pellgut të Shkumbinit si dhe nga mjaft sipërfaqe ujore natyrale të tipit karstik.

Zona ka një rrjet hidrografik shumë të pasur ka një sistem ujrë të shtrirë në rreth 2700 km. Lumi kryesor që e përshkon është Shkumbin që furnizohet nga disa degë sikurse janë: Rrapun, Zalli i Qarrishtës, Zalli i Gurakuqit, Bushtrica, Hotolishti, Gostima, etj. lumi Shkumbin është i gjatë 181 km, me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 2444 km², dhe lartësi mesatare mbi nivelin e detit 753m. Prurja mesatare shumëvleçare e lumit Shkumbin është 61.5m³/sec. Ai transporton mesatarisht 5.8 milion ton lëndë të ngurta në vit. Mineralizimi i ujtave është 317 mg/l. Lumi Shkumbin është baseni ujor më i madh i zonës. Ka gjerësi mesatare deri 29 m. Ka brigje të lartë nga 4-10 m, me gjerësi deri 120 metër, të veshur me bimësi. Shtrati është Zallishte.

Sistemi i liqeneve të pranishme është mjaft i larmishëm. Në rrjetin hidrik statik të bashkisë rëndësi kanë liqenet e parkut kombëtar Shebenik- Jabllocinë (ky park shtrihet pjesërisht edhe në bashkinë e Përrenjasit, njësi administrative Rrajcë). Liqenet e këtij parku janë të tipit akullnajor. Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajore të vegjël me bukuri madhështore, të cilët ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra mbi nivelin e detit. Janë gjithashtu dy lumenj që rrjedhin përmes zonës së Parkut me një gjatësi prej 22 km, përfshirë në veri lumin e Qarrishtës që bashkohet me lumin Rrapun dhe në jug lumin e Bushtricsë që bashkohet me lumin Shkumbin.

Hulumtimet konstatojnë se sipërfaqet ujore liqenore natyrale dhe artificiale kanë një trend në rritje të shkallës së ndotjes së tyre. Kjo është e lidhur me:

- a. Mënyrën e menaxhimit të tyre spontan, pa kritere hidroteknike.
- b. Ndërhyrja antropogjene në mjedisin kufizues duke shkatërruar zonat tampone të cilat shkarkojnë më shumë ndotës mekanik, kimik, organik, etj
- c. Mos krijimi i ballancave të duhura midis kapacitetit mbajtës, atij shfrytëzues dhe efektit kohë.
- d. Ndërhyrja në mjedisin rrethues biologjik por dhe më gjerë duke ndryshuar habitatin natyror dhe duke devijuar apo kanalizuar disa nga burimet furnizuese.
- e. Zhvillimi i një bujqësie agresive në kimikate e pesticide, çka ka shtuar në mënyrë të ndjeshme ngarkesën ujore në nitrate, kimikate, pesticide, etj.
- f. Shtimi i fenomenit të erozionit ka shtuar depozitimet inerte në sipërfaqet ujore dhe është çekuilibruar ballanca aerobike-anaerobike duke stimuluar fenomenin e eutrofizimit.
- g. Raporti midis qendrave të banuara dhe zonave ujëmbajtëse është në disfavor të cilësisë së ujit për shkak të mënyrës së menaxhimit të veprimtarisë urbane si rrjet kanalizimesh dhe përpunues.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- h. Mënyra e shfrytëzimit të minierave të Hekur Nikelit (që shkarkojnë në pjesën e sipërme të rrjedhjes së lumit Shkumbin);
- i. Shkarkimet e pakontrolluara të ujrave të zeza dhe të përdorura nga zonat rurale që kufizojnë shtratin lumor;
- j. Shkarkimet ilegale të mbetjeve të ngurta familjare, industriale, tregëtare, etj;
- k. Shfrytëzimi për inerte apo çfarëdolloj tjetër që pakëson aftësinë filtruese dhe zbërthimin; biologjik, çka akumulon ndotje në rrjedhje e mëposhtme duke ndikuar në iktiofaunën e tij.
- l. Prezenca në mënyrë permanente e turbulencës cka modifikon ndjeshëm parametrat e lumit dhe përpasoj biologjinë e tij, duke rrezikuar disa specie deri në zhdukje.
- m. Mos ruatje e bimësisë ujore për gjatë shtratit të lumit dhe në shpatet mbrojtëse e shoqëruar me fenomenin e tharjes masive të rrepave, kryesisht me moshë të madhe.

Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin, që formon dhe grabenen më tipike të zonës. Së dyti, ka mjaft burime ujore malore që dergjen në të dyja shpatet e kufizuese të lumit Shkumbin. Dhe së treti janë burimet ujore statike, pra liqenore, rezervuarët të cilat krijojnë impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko-kimik dhe organoleptik të përshtatshëm (të vlerësuar në burim) për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonominë e njësive.

Metodologjia e analizës së gjendjes së trupit ujqor është bazuar në” forca shtytëse - presione – gjendja – impakti – përgjigjet (F S H P S I P).

Sipas analizave të vlerësimit të gjendjes së trupit ujqor, kryesisht të lumit Shkumbin që përfaqëson arterien më të rëndësishme por dhe fluentin ujëmbledhës të pothuajse tërësisë hapësinore të bashkisë rezulton se gjendja paraqitet si më poshtë (pika e monitoruar është në Rrapun dhe Mirakë).

Fenomeni i erozionit është rritur ndjeshëm dhe sipas studimeve rezulton se për një periudhë 8 vjeçare deri në 2015 ndryshimi është -1.7cm me trend rritje, ndërsa në zonën e Mirakës së pjesë e shtratit të Lumit Shkumbin është akoma i madh përkatësisht -14.7 cm, pra gati 1.84cm/vit, që konsiderohet një erozion i shkallës së lartë (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar-2015).

Ndërsa analiza fiziko-kimik e parametrave hidrike të ujrave të rrjedhshme (vlerësuar në pjesën fundore të lumit në raport me bashkinë) tregon se:

- Përmbatja e oksigjenit të tretur 9.5 mg/l pra e cilësisë së mirë (norma >7).
- Përmbatja e lëndëve organike e shprehur në nevoja biologjike për oksigjen ose NBO_5 është shumë e ulët dhe klasifikohet e cilësisë së dytë, ndërsa pjesa midis Drogostunjës dhe Murrashit klasifikohet si e cilësisë së tretë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- Përmbatja e nevojës kimike për oksigjen. NKO që është tregues i ndotjes kimike dhe organike për shkak të shkarkime të ujrave të zeza, urbane, sanitare me ngarkesë 6.75 mg/l
- Përmbatja e fororit total është 0.063mg/l duke qenë vlerë në normë dhe ujrát konsiderohen të cilësisë së mirë.
- Përmbatja e nitriteve është 0.016mg/l duke pësuar një rritje të lehtë për shkak të shkarkimeve bujqësore.
- Përmbatja e NH_4 (amoniakut) është 0.105, pra është ujë i cilësisë së dytë, gjendje e mirë.
- Përmbatja e nitrateve NO_3 , vlerësohet i cilësisë shumë të mirë nën normën e lejuar <0.8 mg/l.


Duke e marrë pikën monitoruese si pikë fundore të bashkisë lumi shkumbin në këtë segment konsiderohet i cilësisë së dytë me tendencë rritje. Ndërsa të gjitha burimet ujore të mësipërme vlerësohen të cilësisë së parë, pra shumë të mirë. Ujrat nëntokësore janë më të ekspozuara potencialisht ndaj ndotësve për shkak të strukturës gjeologjike, aftësisë infiltruese, mungesës së shtresës ekranizuese, shkarkimeve urbane, bujqësore dhe blegtoriale të pakontrollura por dhe të vendndodhjes së aktiviteteve impaktuese pa studime hidrogjeologjike paraprake. Sipas analizave të elementëve kimik dhe anioneve e kationeve vlerësuese ujrat nëntokësore të zonës konsiderohen shumë të mirë.

Ndotja ujore mund të jetë e drejtëpërdrejtë dhe e tërthortë. Ndotja e drejtëpërdrejtë ka të bëjë me shkarkimet direkt në trupin ujqor të ndotësve. Burimi kryesor i ndotjes së ujqit mund të klasifikohet si i brëndshëm, industrial dhe agrikultural. I brëndshëm përfshin humbjet e ujërave nga shtëpitë dhe ndërtesat komerciale .

Temperature e ujqit në lumin Shkumbin varion nga 25.2-26.8°C në rrjedhjen e sipërme dhe të poshtme në muajin Korrik deri në 11.47- 16.45 °C në Tetor. pH varion nga 7.85-8.75. Luhatjet stinore janë të vogla nga 0.04-0.9. Sipas direktivës kuadër të ujqit për normat e lejuara të ujrave të ëmbla (pH = 6.5-8.5) konsiderohen ujra neutral me tendencë alkaline.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID


Duke konsideruar shtratin e lumit Shkumbin në vlerësimin fiziko-kimik rezulton se:



Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike e Ph në lumin Shkumbin. (www.qpmt.al).

Alkaniliteti është 165-198 mol/l, luhatjet stinore variojnë nga 8-15 mol/l.


Përmbajtja e oksigjenit të tretur luhatet nga 4.12-4.85-6.4 mg/l. luhatjet stinore janë të konsiderueshme 8-15 mg/l. sipas standartit të DKU konsideohen ujra të cilësisë së varfër.



Grafiku nr. 3. Paraqitja grafike e oksigjenit të tretur në lumin Shkumbin. (www.qpmt.al).


Vlera e përmbatjes së BDO₅ luhatet nga 0.6-4.01 mg/l. pra ujrato e pjesës së sipërme konsiderohen të cilësisë shumë të mirë ndërsa në pjesën e poshtme (poshtë qytetit të Librazhdit) konsiderohen të moderuar.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID



Grafiku nr.4. Paraqitja grafike e BDO₅ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).


Vlera e përmbatjes së nevojave kimike për oksigjen NKO luhetet nga 0.36-0.84 mg/l. Përmbatja e fosforit total luhaten në lumin Shkumbin nga 0.03-0.16mg/l. konsiderohen si ujra të cilësisë së mirë në lidhje me përmbatjen e fosforit.



Grafiku nr. 5. Paraqitja grafike e P total në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Përmbajtja e amoniakut në lumin Shkumbin luhetet nga 0-0.05-0.22 mg/l. gjendet mbrenda parametrave normale.



Grafiku nr.6. Paraqitja grafike e vlerave të NH_4 në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).

Vlerat e përmbatjes së nitrateve luhaten nga 0.9-4-8 mg/l. sipas standarteve të DKU konsiderohen ujra të cilësisë së varfër.




Grafiku nr.7. Paraqitja grafike e përmbatjes së NO_3 në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).


Lëndët pezull kanë luhatje të madhe nga njëra pikë në tjetrën. Vlerat minimale dhe maksimale variojnë nga 9.6-74.4 mg/l.

Vlerat e përmbatjes së nitriteve luhaten nga 0-0.02-0.07 mg/l. vlera limite e përmbatjes së nitriteve sipas DKU I përcaktojnë ujrën e Shkumbinit si ujë të cilësisë së moderuar.


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID




Grafiku nr.8. Paraqitja grafike e përmbatjes së NO₂ në lumin Shkumbin (www.qpmt.al).



Grafiku nr.9. Përmbatja e Mn (µg/l) në lumin Shkumbin




Grafiku nr. 10. Përmbatja e Fe ($\mu\text{g/l}$) në lumin Shkumbin




VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID


Grafiku nr.11. Përmbatja e Zn ($\mu\text{g/l}$) në lumin Shkumbin




Grafiku nr.12. Përmbatja e Cu ($\mu\text{g/l}$) në lumin Shkumbin.



Grafiku nr.13. Përmbatja e TSS (mg/l) në lumin Shkumbin.




Grafiku nr.14. Përmbatja e DO (mg/l) në lumin Shkumbin




Grafiku nr.15. Përmbatja e NO₃-N (mg/l) në lumin Shkumbin.

NO₂-N, mg/L




Grafiku nr.16. Përmbatja e NO₂-N (mg/l) në lumin Shkumbin.

NH₄⁺-N, mg/L



Grafiku nr.17. Përmbatja e NH₄⁺-N (mg/l) në lumin Shkumbin.

Fosfatet PO_4^{3-} , $\mu g P/L$



Grafiku nr.18. Përmbatja e PO_4^{3-} ($\mu gP/l$) në lumin Shkumbin.

Kategoria	Parametri	Klasa e cilësisë mjedisore				
		I sh. i mirë	II i mirë	III mesatar	IV i keq	V Sh. i keq
Ushqyesit	P total ($\mu g/L$)	< 7	7-11	11-20	20-50	> 50
	Klorofila a ($\mu g/L$)	< 2	2-4	4-8	8-20	> 20
	Disku Secchi (m)	> 6	4-6	2-4	1-2	< 1
	Prodhim parësor ($g C/m^2 \cdot vit$)	< 25	25-50	50-90	90-150	> 150
	Azoti total ($\mu g/L$)	< 300	300-400	400-600	600-1200	> 1200
Lëndët organike	TOC ($mg C/L$)	< 2.5	2.5-3.5	3.5-6.5	6.5-15	> 15
	Najyra ($mg P/L$)	< 15	15-25	25-40	40-80	> 80
	Oksigjeni (mg/L)	> 9	6.4-9	4-6.4	2-4	< 2
	Oksigjeni (%)	> 80	50-80	30-50	15-30	< 15
	Disku Secchi (m)	> 6	4-6	2-4	1-2	< 1
	COD_{Mn} ($mg O_2/L$)	< 2.5	2.5-3.5	3.5-6.5	6.5-15	> 15
	Fe ($\mu g/L$)	< 50	50-100	100-300	300-600	> 600
	Mn ($\mu g/L$)	< 20	20-50	50-100	100-150	> 150
	Alkaliniteti (mmol/L)	> 0.2	0.05-0.2	0.01-0.05	< 0.01	0.00
	pH	> 6.5	6.0-6.5	5.5-6.0	5.0-5.5	< 5.0
Grimcat e ngurta	Turbullia (FTU)	< 0.5	0.5-1	1-2	2-5	> 5
	Lëndët pezull (mg/L)	< 1.5	1.5-3	3-5	5-10	> 10
	Disku Secchi (m)	> 6	4-6	2-4	1-2	< 1
Bakteret fekale	Baktere koliform (nr. për 100 ml)	> 5	5-50	50-200	200-1000	> 1000

Tabela nr.7. Klasifikimi i cilësisë së ujrave të ëmbla natyrorë në lidhje me parametrat e përgjithshëm (Classification of the quality status for general parameters of fresh Waters (Bratli, 2000).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Tipi i mostrës	Metali	Klasa e cilësisë mjedisore				
		I	II	III	IV	V
		Lehtësisht i ndotur	Mesatarisht i ndotur	Ndodje e theksuar	Ndodje e rëndë	Ndodje tepër e rëndë
Ujëra (në µg/L)	Bakër	< 0.6	0.6-1.5	1.5-3	3-6	> 6
	Zink	< 5	5-20	20-50	50-100	> 100
	Kadmium	< 0.04	0.04-0.1	0.1-0.2	0.2-0.4	> 0.4
	Plumb	< 0.5	0.5-1.2	1.2-2.5	2.5-5	> 5
	Nikel	< 0.5	0.5-2.5	2.5-5	5-10	> 10
	Krom	< 0.2	0.2-2.5	2.5-10	10-50	> 50
	Merkur	< 0.002	0.002-0.005	0.005-0.01	0.01-0.02	> 0.02
Sedimente (në mg/kg peshë të thatë)	Bakër	< 30	30-150	150-600	600-1800	> 1800
	Zink	< 150	150-750	750-3000	3000-9000	> 9000
	Kadmium	< 0.5	0.5-2.5	2.5-10	10-20	> 20
	Plumb	< 50	50-250	250-1000	1000-3000	> 3000
	Nikel	< 50	50-250	250-1000	1000-3000	> 3000
	Arsenik	< 5	5-25	25-100	100-200	> 200
	Merkur	< 0.15	0.15-0.6	0.6-1.5	1.5-3	> 3
Peshk (në mg/kg peshë të freskët)	Merkur	< 0.2	0.2-0.5	0.5-1	1-2	> 2

Tabela nr. 8. Klasifikimi i gjendjes cilësore të ujrave natyrore të ëmbla në lidhje me metalet e rënda, sedimente dhe organizmat peshq/Classification of the quality status for micropollutants in Waters, sediment and fishes (according Norwegian Institute for Water Research – NINA) (Bratli, 2000)

River, station	Dissolved oxygen, mg/l	COD mg/l	BOD mg/l	Ammonium mg/l	Nitrate mg/l	Silica mg/l	P _{tot} mg/l
Shkumbini 1	8.32	0.52	1.11	0.092	1.20	18.0	0.11
Shkumbini 2	6.69	1.20	4.30	0.30	0.70	23.0	0.10
Devolli	7.77	1.88	1.78	0.05	0.70	13.0	0.03
Osumi	6.29	3.20	5.06	0.13	0.50	20.0	0.05
Semani	8.80	1.76	3.21	0.05	0.52	27.0	0.03

Tabela nr. 9. Vlerat e disa parametrave të ujit të lumenjëve / Some parameteres of eater quality in rivers

Lumi	Gjatësia km	Pelgu km ²	Prurja mestatare m/s	Moduli i prurjes l/s/km ²	Raporti i prurjes Maks/Min	Mineralizimi mg/l
Shkumbini	181	2'441	61.5	25.2	13.2	317
Semani	281	5'649	95.7	16.9	13.7	440

Tabela nr.10. Vecoritë kryesore hidrologjike të lumjenjëve më të mëdhenj shqiptar/Hydrographic features of some big Albanian rivers (Pano et al. 1984; Kabo 1900-1991)

	COD		BOD		P _{tot}		NO ₃ ⁻	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998	1997	1998
Shkumbini 1	1.5	0.48	1.1	1.1	0.9	0.6	0.08	1.15
Shkumbini 2	1.5	0.64	0.74	1.51	0.32	0.47	0.3	0.05
Shkumbini 3	2.0	0.64	1.48	1.7	0.45	0.45	1.01	0.05

Tabela nr. 11. Të dhënat e disa parametrave të cilësisë ujore të lumit Shkumbin/Èater quality (mg/l) of Shkumbin river.

❖ **Krahas cilësive fiziko kimike janë vlerësuar dhe indikatorët e biomonitorimit për vlerësimin kompleks të gjendjes së trupit uhor.**

Së pari gjatë monitorimit të ujit të Shkumbinit ne kemi vlerësuar dhe gjendjen e komunitetit të diatomeve (Bacillariophyta) të cilët konsiderohen si komuniteti i parë biologjik që i pergjigjet presionit eutrofikues.

Në rrjedhjen e sipërme të lumit Shkumbin 93% e llojeve të gjetura përbëhen nga diatome, ku vetëm dy prej tyre ***Fragilaria ulva var. biceps*** (48%) dhe *Nitzschia pale* (12%) janë mbizotëruese. Po kështu në rrjedhjen e poshtme diatometë zënë 65% të mbizotëruar kryesisht nga ***Fragilaria ulva var. biceps*** (50%). Ndër këto shoqërime rreth 27% e zënë algat blu të gjelbra (Cyanophyceae), si dhe algat e gjelbra (Chlorophyceae).

Së dyti ndërsa në lidhje me biomonitorimin e lumit Shkumbin janë instaluar disa stacione vëzhgimi në gjatësinë e tij. Sipas DKU lumi Shkumbin bën pjesë në tipologjinë e lartësisë

“I lartë” mbi 800m, dhe tipologjinë e masës së shtrirjes **“E madhe”** 1000-10,000km², si dhe ekorajonin e V (Ballkani Perëndimor) (WFD 2000/60/EC)

Stacioni i Mirakës me lartësi 172 m mbi nivelin e detit, i përket zonës së parë sipas DKU (0-200m). tipologjia e lumit është epirhithron si dhe mikrohabitati dominant është mesolital (0-20m). Stacioni i përket nënzonës Mesdhetare Kodrinore Qendrore me temperature që variojnë nga 11-15°C.

Stacioni i dytë është i Elbasanit me lartësi 93.3.m, që i përket zonës së parë të lartësisë sipas DKU (0-200m), tipologjia e lumit është epipotamon si dhe mikrohabitati dominant është mesolital (6-20m). Stacioni i përket nënzonës Mesdhetare Kodrinore Qendrore me temperaturë mesatare që varion nga 11-15°C.

Stacioni i tretë është i Peqinit me lartësi 19.2m, që i përket zonës së parë të lartësisë sipas DKU (0-200m), tipologjia e lumit është epipotamon si dhe mikrohabitati dominant është mikrolital (0-6m). Stacioni i përket nënzonës Mesdhetare Fushore Qendrore me temperaturë mesatare që varion nga 15-17°C.

Indeksi i perdorur	Lumi Shkumbin
--------------------	---------------

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

EPT – Richness (4 klasa)	St. 1	<i>“ Cilësi e mirë”</i>	(Kl. II)
	St. 2	<i>“I pastër”</i>	(Kl. III)
	St. 3	<i>“ Cilësi e mirë”</i>	(Kl. II)
ASPT (4 klasa)	St. 1	<i>“ I pastër”</i>	(Kl. I)
	St. 2	<i>“Pjesërisht i pastër”</i>	(Kl. II)
	St. 3	<i>“I Pastër”</i>	(Kl. I)
SWRC (4 klasa)	St. 1	<i>“I mirë”</i>	(Kl. II)
	St. 2	<i>“ I pastër”</i>	(Kl. III)
	St. 3	<i>“I Mirë”</i>	(Kl. II)
MAIS (3 klasa)	St. 1	<i>“I Mirë”</i>	(Kl. I)
	St. 2	<i>“I pastër”</i>	(Kl. II)
	St. 3	<i>“I pastër”</i>	(Kl. II)

Tabela nr. 12. Vlerësimi i cilësisë së ujrave me anë të Bioindikatoreve

LUMI	INDEKSI	STACIONI	KLASIFIKIMI I STATUSIT EKOLOGJIK				
			KLASA V	KLASA IV	KLASA III	KLASA II	KLASA I
			I KEQ	I VARFËR	I MODERUAR	I MIRË	I LARTË
Shkumbin	EPT - Richness	ST 1					
		ST 2					
		ST 3					
	ASPT	ST 1					
		ST 2					
		ST 3					
	SWRC	ST 1					
		ST 2					
		ST 3					
	MAIS	ST 1					
		ST 2					
		ST 3					

Tabela nr. 13. Statusi ekologjik i lumit Shkumbin përcaktuar me anë të katër indekseve të ndryshme biotik (FSHNT-2014).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Matja	P- PO_4^{3-} $\mu\text{g/L}$		N- NO_3^- mg/L		N- NH_4^+ mg/L		N- NO_2^- mg/L	
Stacioni	Vlera mes.	Klasa	Vlera mes.	Klasa	Vlera mes.	Klasa	Vlera mes.	Klasa
DEVOLL								
1	41.81	III	0.44	I	0.08677	II	0.03078	<1 mg/L
2	34.99	III	0.40	I	0.05956	I	0.02342	<1 mg/L
3	38.38	III	0.52	I	0.04176	I	0.02495	<1 mg/L
SHKUMBIN								
1	23.46	II	0.45	I	0.05601	I	0.02113	<1 mg/L
2	117.99	IV	0.56	I	0.12396	II	0.05171	<1 mg/L
3	44.62	III	1.04	I	0.04483	I	0.08645	<1 mg/L

Tabela nr. 14. Klasifikimi i cilësisë së ujrave sipas vlerave mesatare të përmbatjes së fosforit total, nitrateve azotit amoniakal dhe nitriteve sipas UNECE (1992)

6.4. Sipërfaqet e eutrofizuara

Pozicioni gjeografik, relievi, dinamika stinore dhe vjetore klimaterike nuk favorizojnë eutrofizimin normal të sipërfaqeve ujore të zonës. Por fakti se në territorin e bashkisë Librazhd gjenden disa ujëmbledhës (rezervuar) artificial apo/dhe natyral, si dhe ndërhyrja sistematike e kontrolluar apo/dhe e pakontrolluar e faktorit antropogjen në kombinim me faktorët abiojen mundëson shfaqjen e fenomenit të eutrofizimit. Mbështetur në klasifikimin tipologjik të ujrave sipas shkallës së ndotjes mund të konstatojmë se gjendja e ujrave në Bashkinë e Librazhdit paraqitet si më poshtë:

Klasifikimi tipologjik i ujrave sipas shkallës së ndotjes në Bashkinë e Librazhdit paraqitet:

- Ujrat sipërfaqësore të lumit Shkumbin (vlerësuar në pjesën e territorit të bashkisë Librazhd) i shkallës së II ndërsa zona e përshkruar si me predispozitë hot spot klasifikohet e klasës së III, me shkallë të mesme eutrofizimi, madje në disa pika (zona e poshtme e Qytetit) me tendencë drejt klasës së IV).
- Zona e Rrapunin në pjesën e poshtme në kategorinë e III.
- Të gjitha ujrat e tjera sipërfaqësore furnizuese të lumit i përkasin kategorisë së parë dhe pjesërisht (rrjedhja e poshtme) kategoria e II.
- Ujrat e qëndrueshme (jo rrjedhëse) kategorizohen në klasën e II dhe të III të gjendjes ujore .
- Ndryshimi i strukturës së basenit të Shkumbinit nga -1.7 deri në 14.7 cm (8 vite).
- Tjetërsim deri në asgjësim të florës dhe faunës ujore duke impaktuar negativisht biotën dhe ekosistemet ujore.

6.5. Rezervualet dhe kapaciteti mbajtës i tyre.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Bashkia Librazhd në territorin e saj përmban këto rezervuare (vlerësuar nga kapaciteti i shfrytëzimit, sepse ka dhe shumë të vegjël që nuk krijojnë impakt apo raport të konsiderueshëm me mjedisin):

- a. Rezervuari i Librazhd katund me kapacitet të vlerësuar 40 000m³
- b. Rezervuari i Hotolishtit me kapacitet të vlerësuar 45 000m³
- c. Rezervuari i Dardhës me kapacitet të vlerësuar 40 000m³
- d. Rezervuari i Fushë Studen me kapacitet të vlerësuar 70 000m³

Pra kapaciteti i ujëmbledhësve të krijuar në Bashkinë e Librazhdit është 195 000m³ duke vlerësuar dhe ujëmbledhësit më të vegjël në total kapaciteti ujëmbledhës i territorit të bashkisë shkon në 230 000m³ ujë.

Rezervuarët artificial aktualisht paraqiten me tendë eutrofizimi për shkak të mbushjes me inerte, lëndë organike dhe mos qarkulimit kohor të masës së shfrytëzueshme.

6.6. Menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve ka të bëjë me pakësimin e gjenerimit të tyre në origjinë, riciklimin, mënyrën e grumbullimit dhe të trajtimit sipas tipologjisë së tyre. Ky përfaqëson një nga problemet më serioze për kryeqendrën e bashkisë por dhe për njësitë administrative të cilat kanë shtrirje shumë të madhe dhe praktikisht nuk mund të krijohet lehtë një sistem i integruar i menaxhimit të tyre. Problemi në planin organizativ dhe realizues është më i thjeshtë në kryeqendrën e bashkisë dhe në disa fshatra përreth me urbanizim më të koncentruar. Fakti i gjenerimit të tyre me tipologji heterogjene, grumbullimi i padiferencuar, mos menaxhimi i sistemit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit, shkakton impakt të ndjeshëm mjedisor për komunitetin dhe mjedisin në tërësi. Vlerësohet se mesatarisht gjenerohen një sasi mbetjesh të ngurta të vlerësuar në 466 kg/banor/vit, llogaritur me 4.700.000 kg mbetje vjetor. Pozicioni gjeografik dhe hidrologjia e zonës nuk favorizojnë krijimin e pikave grumbulluese të përshtatshme. Pjerrësia e zonës, aftësia infiltruese, prezenca e ujrave nëntokësore të shumta dhe njëkohësisht e burimeve sipërfaqësore nuk favorizojnë depozitimin tradicional të mbetjeve të ngurta.

Regjimi klimatik i zonës me reshje të shumta dhe intesive mundëson zhvendosje mekanike dhe krijimin e rrjedhjeve me ngarkesë që kalojnë në rrjedhjen e lumit Shkumbin duke tjetërsuar parametrat fiziko-kimik të tij. Kohë qëndrimi në pikat e grumbullimit, ekspozimi ndaj fenomeneve atmosferike, kontakti afat gjatë me ajrin, mundësia për zhvendosje të lirë, mos siguri i kërkesave të kërkuara për mjedise landfilli rritin ndjeshëm rrezikun mjedisor dhe antropogjen. Problematika e konstatuar ka të bëjë me faktin se mbetjet nuk diferencohen, grumbullohen në kosha jo të mirëmbajtur dhe mund të qëndrojnë relativisht gjatë në to duke

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

ndikuar në cilësinë e ajrit, me mënyrën e transporti dhe venddepozitimin e tyre si dhe më pas me përpunimin e thjeshtë mekanik të mbulimit pa asnjë lloj trajtimi. Ndërkohë që për njësitë administrative hedhja e tyre bëhet pothuajse tërësisht spontane.




Figura nr. 12. Harta e mbetjeve bashkia Librazhd

Tipologjia e mbetjeve të ngurta të prodhuara është:

- Mbetje shtëpiake
- Mbetje sanitare
- Mbetje industriale
- Mbetje ndërtimore

Në kryeqendrën e Bashkisë vëllimi i mbetjeve tejkalon kapacitetin e lejuar ndërkohë që në zonat rurale shkakton tjetërsim estetik të peisazhit përpos pasojave që vijnë si rezultat i pamundësisë së biodegradimit natyral.

Mbetjet ekzistuese përbëjnë rrezik për:

- Ndotjen e ujrave nëtokësore;
- Emetimin e gazrave të dëmshme me efekt serë;
- Bëhen burim i sëmundjeve dhe epidemive;

- Tjetërsojnë peisazhin;

6.7. ZONAT PROBLEMATIKE TË NDOTURA, “HOT SPOT”ET

Një nga problematikat e ndotjes mjedisore është krijimi i zonave të ndotjes që njihen si Hot Spot. Për shkak të gjenerimit në rritje të prodhimit të mbetjeve të ngurta dhe depozitimi i pakontrolluar i tyre kryesisht me origjinë industriale, urbane, bujqësore, teknologjike, etj janë krijuar zona të ndjeshme mjedisore. Praktikisht zonat më problematike ndodhen atje ku përqëndrimi i popullsisë është më i lartë, pra kryesisht në zonat urbane, qytete, kështu si pika më të ndjeshme të ndotjes mjedisore nga ky proces vlerësohet **vend grumbullimi i mbetjeve urbane të qytetit Librazhd**. Kjo është e lidhur me:

- ❖ **Së pari mbetjet urbane të gjeneruara nga aktiviteti familjar apo shërbimet sociale** të cilat kanë ngarkesë mekanike, kimike, fizike, bakteriologjike, organike, etj
- ❖ **Së dyti mbetjet me origjinë spitalore** të cilat përmbajnë përpos elementëve të zakonshëm edhe mbetje profesionale apo kirurgjikale që ngarkesës fizike të tyre i shtojnë potencën dhe aktualitetin e infeksioneve të ndryshme.
- ❖ **Së treti Mbetjet industriale dhe ndërtimore** përbëjnë një burim në rritje të ndotjes. Kjo është e lidhur me shtimin e veprimtarive industriale dhe ndërtimore të cilat karakterizohen nga gjenerimi i mbetjeve me ngarkesë fizike dhe me ngarkesa kimike specifike (lëndë kimike, solucione, kimikate, përmbatje elementesh kimikë, etj) të konsiderueshme çka krijon premisa për zhvillime procesesh agresive me emetime ajrore, infiltrime tokësore dhe nëntokësore, ndotje ujore sipërfaqesore dhe nëntokësore, me krijimin e aromave të pakëndshme, etj. duke impaktuar negativisht fenomenin e aerobiozës.

Këto mbetje në mënyrën e grumbullimit, transportit, depozitimit dhe trajtimit të tyre krijojnë zona me ndjeshmëri mjedisore dhe komunitare të lartë. Praktikisht depozitimi i tyre është problematik sepse:

- ❖ Së pari lidhet me pozicionin dhe mënyrën e depozitimit të tyre me hedhje sipërfaqësore në një zonë në dalje të qytetit, pjesa veriore dhe në raport me rrjedhjet ujore të shoqëruara me pjerrësi.
- ❖ Sipas studimit të realizuar rezulton se banorët e qyteti të Librazhdit gjenerojnë një sasi të konsiderueshme mbetjesh të ngurta të vlerësuar në 466kg/banor/vit, llogaritur me 4 700 000 kg mbetje vjetor (vlerësimi merr në konsideratë numrin e popullsisë).
- ❖ Pozicioni gjeografik dhe hidrologjia e zonës nuk favorizojnë krijimin e pikave grumbulluese të përshtatshme. Pjerrësia e zonës, aftësia infiltuese, prezenca e ujrave nëntokësore të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

shumta dhe njëkohësisht e burimeve sipërfaqësore nuk favorizojnë depozitimin tradicional të mbetjeve të ngurta.

- ❖ Kohë qëndrimi në pikat e grumbullimit, ekspozimi ndaj fenomeneve atmosferike, kontakti afat gjatë me ajrin, mundësia për zhvendosje të lirë, mos siguri i kërkesave të kërkuara për mjedise landfilli rritin ndjeshëm rrezikun mjedisor dhe antropogjen.
- ❖ Regjimi klimatik i zonës me reshje të shumta dhe intesive mundëson zhvendosje mekanike dhe krijimin e rrjedhjeve me ngarkesë që kalojnë me infiltrim në strukturën e tokës duke tjetërsuar parametrat fiziko-kimik të saj por dhe të ujrave nëntokësore.
- ❖ Mbetjet e ekspozuara në vendgrumbullim tërheqin shpendët që ushqehen me to, shpesh tufa shpendësh që siç dihet përmbajnë shumë krimba zorrësh, një numër të madh baktere fekalesh koliform (*coliform*) dhe baktere kamfilobakter (*camphylobacter*), të cilat për një kohë të shkurtër mund të kontaminojnë burimet ujore. Evidencat sugjerojnë se shpendët, dhe jo ujërat e trajtuara të kanalizimeve, janë përgjegjëse për kamfilobakterin në ujin e pijshëm dhe ujin për larje. Gjithashtu ekziston rreziku i infektimit të njerëzve nga Gripi i Shpendëve (*CDC Avian Influenza*). Këto zona gjithashtu tërheqin kafshët parazitare që mbartin sëmundje, përfshi minjtë e kanaleve, të cilët janë në vetvete transmetues të sëmundjeve. Prandaj janë të domosdoshme masat për reduktimin e ndikimeve nga shpendët dhe kafshët parazitare dhe më në përgjithësi rehabilitimi i vendgrumbullimit të mbetjeve në bashkinë Librazhd.

6.7.1. Sipërfaqet ujore të ndotura

Bashkia e Librazhdit karakterizohet nga sipërfaqe ujore të konsiderueshme për shkak të prezencës së lumit Shkumbin dhe furnizuesëve kryesor të tij si Rrapuni, Bushtrica, Gostima dhe mjaft burime të tjera më të vogla që rrjedhin në të dy shpatet formuese të tij, por jo vetëm në territorin e Bashkisë Librazhd por edhe më lart që përkon me Bashkinë Përrenjas. Praktikisht si sipërfaqe ujore më e ndotur paraqitet rrjedhja e lumit **Shkumbin** dhe ajo **Rrapun** që mund ti konsiderojmë si **pika ujore “hot spot-e”**. Kjo lidhet me faktin se:

- I gjithë sistemi i kanalizimeve urbane (familjare, sociale, spitalore, tregëtare, etj) derdhen direkt në shtratin e lumit Shkumbin duke patur ngarkesa kimike, fizike e bakteriologjike mjaft të lartë çka krijon një zonë nga Dragostunja deri në kthesat e Murrashit mjaft kritike dhe me ndotje të lartë. Kujtojmë se vetë Shkumbini karakterizohet nga shkallë e lartë turbullimi për shkak të **tre faktorëve kryesor**:

- Veprimtaria industriale e pakontrolluar në strukturë menaxhuese sipërfaqësore të minierave që ushtrojnë aktivitet kryesisht në zonën e Bashkisë Përrenjas dhe pjesërisht Librazhd;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- Prezenca e dukshme e fenomenit të erozionit shkaktuar për vetë natyrën e relievit por dhe si pasojë e ndërhyrjes agresive të njeriut qoftë për hapje rrugësh të pa studjuara gjeologjikisht, ndërtime spontane, shpyllëzime masive, etj;

- Shtimi dhe përdorimi i metodave tradicionale në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

- Aktiviteti agrokimik (përdorimi i pesticide dhe plehra kimike), zhvendosja masive e dherave me ngarkesë kimike përbëjnë faktor me impakt në ndotjen ujore sipërfaqësore.

Ndërkohë si pikë me shkallë të lartë ndotje paraqitet pjesa fundore e zonës së Rrapunit për shkak të shkallës së lartë të erozionit dhe raportit të afërt me pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane.

Së fundi ndjeshmëria e saj zone është rritur për shkak të ndërtimit të hidrocentralit të Rrapunit i cili ka ndryshuar debitin ujor dhe mundësinë për vetfiltrim dhe pastrim duke krijuar një hot spot të dytë potencialisht në rritje.

6.7.2. Mbetjet ujore dhe ujrat e zeza

Komuniteti dhe shërbimet e aktiviteteve ekonomike, gjenerojnë mbetje ujore të patrajtura me tipologji të ndryshme:

- Mbetje ujore shtëpiake;
- Mbetje ujore industriale;
- Mbetje ujore sanitare;

Problemi kryesor ka të bëjë me sistemin e kanalizimeve dhe destinacioni përfundimtar i tyre. Secila tipologji mbetje e lëngët nuk i nënshtrohet paratrajtimit në burim por kalojnë direkt në sistemin e kanalizimeve, ndërkohë që ky rrjet jo vetëm nuk është i mirë por dhe kapaciteti i tij nuk i përgjigjet ritmit të ndryshimit demografik dhe aktiviteteve të instaluar. Ndërkohë që në zonat rurale trajtimi i mbetjeve ujore dhe ujrave të zeza nuk ekziston dhe shkarkimi i tyre bëhet me anë të gropave septike ose direkt në rrjedhje të lirë. Kjo krijon predispozitë për infeksione të ndryshme.

6.7.3. Toka dhe erozioni

Toka e zonës paraqet strukturë komplekse dhe me relieve variacionale nga fushore në kodrinore deri malore. Një pjesë e tyre janë rezultat i shpyllëzimeve të cilat tashmë kanë filluar të popullohen nga flora natyrale barishtore, shkurrore dhe drunore. Ndërkohë që një pjesë e mirë janë kthyer në vreshtari apo kultivuar me drurëfrut autokton apo të introduktuar.

Por krahas këtij fenomeni me impakt pozitiv, konstatohet shpyllëzime masive jo vetëm nga prerja por dhe mënyra e transportit duke hapur rrugë kalimi me rrëshiqte, ç'ka ka rritur

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

ndjeshëm erozioni dhe njëheraz pamundësi rigjenerimi të biodiversitetit duke kërcënuar seriozisht llojet endemike apo subendemike me status. Erozioni vepron në kundërshtim me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Ky është i lidhur me mos mirëmbatjen apo dhe shkatërrimin e veprave me karakter inxhinierik e agronomik për parandalimin e erozionit sidomos në zonat hidrike dhe me pjerrësi të madhe, si dhe nga ndërtimi i HEC-ve në shtratin e lumit Stravaj (7), Lingajca (2) dhe Bushtricë (7).

Në tërësinë e faktorëve që ndikojnë në fenomenin e erozionit sikurse janë faktorët klimaterike, tokësor, relievi, vegjetacioni, etj, rezulton se faktori antropogjen ka ndikuar së tepërmi në ndryshimin e mjedisit vegjetativ sidomos në zonat larg qendrave të banuara, në mos disiplinimin dhe menaxhimin e ujrave sipërfaqësore e nëntokësore, në mbishfrytëzimin e kullotave, në hapjen e rrugëve pa studime gjeologjike paraprake, etj.

Erozioni i ndjeshëm në zonë është i lidhur me:

- Degradimi i mbulesës natyrore (mbikullotje, zjarre, shpyllëzime)
- Modifikimi i topografisë (qendra urbane, ndërtimi i rrugëve)
- Politika e administrimit të ujrave (kanalizime, vepra hidrike, barriera, etj)

Si dhe mos marrjen e masave të lidhura me:

- Ruatja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të rrezikuara nga erozioni nëpërmjet pyllëzimit, ndërtimit të brezave mbrojtës, ndërtimit të barrierave, etj
- Ndërhurja topografike duke ndërtuar taraca dhe mure mbrojtëse
- Modifikimi natyral i profilit të rrjedhjes së ujrave sipërfaqësore
- Parandalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve
- Ndërtimi veprave mbrojtëse
- Parandalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve

Një tjetër fenomen i konstatuar është fragmentarizimi i tokës dhe uzurpimi i tokës aktive për sipërfaqe ndërtimi banese apo çdo lloj objekti tjetër me karakter ekonomik apo depozitues (magazina).

6.7.4. Mjedisi biologjik.

6.7.4.1. Biodiversiteti, fauna, flora, ekosistemet dhe pyjet.

Sikurse është përmendur më lart territori i bashkisë Librazhd është shumë i pasur në mjedis biologjik. Problematika e hasur ka të bëjë me mënyrën e menaxhimit, shfrytëzimit të natyrës dhe krijimit të ballancave të qëndrueshme.

Në lidhje me biodiversitetin si çështje të ndjeshme madje të konsideruara si hot spot i akumuluar është shfrytëzimi masiv dhe pa krite i pyjeve (kryesisht në zonën e Polist, dardhës, Lunikut, etj) dhe mënyra e menaxhimit të burime hidrike nga ndërtimi i hidroçentraleve ku praktikisht gjendjen në stade të ndryshme pune:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

➤ Rrjedha e lumit Gostimë (Gaferr)	7 HEC-e ish-komuna Polis
➤ Rrjedha e lumit Gurakuqit	9 HEC-e ish-komuna Orenjë
➤ Rrjedha e lumit Sheh Librazhd	6 HEC-e ish-komuna Qendër
➤ Rrjedha e lumit Lunikut	5 HEC-e ish-komuna Lunik
➤ Rrjedha e lumit Rrapun Qarrishtë	9 HEC-e ish-komuna Qendër
➤ Rrjedha e lumit She Hotolisht	5 HEC-e ish-komuna Hotolisht
➤ Rrjedha e lumit Gurrëshpatë	2 HEC-e ish-komuna Polis
➤ Rrjedha e lumit Stebleve	2 HEC-e ish-komuna Stebleve
➤ Rrjedha e lumit Borove	2 HEC-e ish-komuna Stebleve
➤ Rrjedha e lumit Gurrëkuqe	1 HEC ish-komuna Qendër
➤ Rrjedha e lumit Fushë-Gurrë Zdrajsh	1 HEC ish-komuna Orenjë

Praktikisht konstatohet një shfrytëzim pa kriter madje i tejskajshëm me ndërhyrje drastike në regjimin hidrik duke devijuar gati në 100% të totalit ujëmbajtës për në veprat hidrike të ndërtuara (kujtojmë se 33% e regjimit ekzistues ujqor nuk duhet prekur), por dhe koha e shfrytëzimit në ditë pune vjetore. Kjo ka sjellë pasoja të rënda për mjedisin biologjik (florën dhe faunën akuatike). Problematike paraqitet biodiversiteti i lumit Shkumbin për shkak të mënyrës së shfrytëzimit dhe depozitimit të inerteve, derdhjeve urbane, bujqësore dhe industriale të kontaminuara të cilat modifikojnë parametrat fiziko-kimik dhe mikrobiologjik të trupit ujqor duke kërcënuar ekosistemet ujqore dhe lloje të caktuara sikurse është trofta e malit. Vlen të konstatojmë gjendjen e rrapishtë përgjatë rrjedhjes së lumit Shkumbin ku gati 15-17% e drurëve ekzistues kryesisht me moshë të madhe janë tharë.

Për shkak të mungesës së informacionit, mos zbatimit të ligjit impakt të ndjeshëm negativ ka pësuar gjatë këtyre viteve dhe zonat e mbrojtura, ku është ndërhyrë me prerje, shfrytëzim dhe kontaminim, me dëmtim apo grumbullim pa kriter shkencor të florës karakteristike dhe specifike të zonës, me gjuetinë e paligjshme në kohë dhe lloje duke kërcënuar ekzistencën e disa llojeve të gjitarëve që vlerësohen në vetëm disa ekzemplar. Megjithatë duhet të theksojmë se ka një trend ndryshimi të lidhur kryesisht me biologjinë e kultivuar qoftë bujqësore, pemtari, vreshtari, etj, por njëkohësisht ka filluar organizimi për një mirëmenaxhim të zonave të mbrojtura apo specieve mbi bazën e shërbimit të njësisë së mbrotjes së zonave të mbrojtura.

7. KORNIZA LIGJORE E PLANIT TË PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

PPK është pjesë e Sistemit të Integruar të Planifikimit (SPI) dhe harmonizohet me proceset kryesore që orjentojnë vendimmarrjen për përcaktimin e drejtimeve strategjike dhe shpërndarjes së burimeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Shtrirja për një periudhë 15 vjeçare e kornizave orientuese të PPK dëshmon për rëndësinë e këtij dokumenti në sigurimin e një zhvillimi afatgjatë e cilësor të territorit përmes harmonizimit të dokumentave më të rëndësishëm ekonomikë e politikë të vendit.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030", vjen si detyrim për zbatimin e kësaj kornize ligjore ku edhe përcaktohet si dokumenti referues i detyrueshëm për të gjitha planet që hartohen në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 16 të ligjit Nr. 107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcaktohet:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin referues të detyrueshëm për të gjitha planet që hartohen në Republikën e Shqipërisë.

2. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit janë:

a) Përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve për një zhvillim të qëndrueshëm e të balancuar të territorit;

b) Krijimi i kushteve territoriale për zhvillimin rajonal;

c) Drejtimi i krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike kombëtare;

ç) krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimi i efekteve të sistemeve të banimit e veprimtarive ekonomike dhe mbrojtja e zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra e sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;

d) Orientimi i objektivave për planifikimin rajonal, ndërvendor e vendor;

dh) Bashkërendimi i punës, harmonizimi dhe orientimi i objektivave sektorialë të zhvillimit me efekt në territor;

e) Përputhja me orientimet dhe udhëzimet e dokumentit të perspektivës europiane për zhvillimin hapësinor.

7.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar bazohen në objektivat e planifikimit të qëndrueshëm të dokumentave më të rëndësishëm të planifikimit European si Axbenda Evropiane e Territorit 2020, Strategjia Evropa 2020 , Vizioni Territorial i Evropës 2050 , etj.

7.1.1. Objektivat strategjikë të PPK:

I. Integrimi shumëdimensional në kontekstin europian;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- II. Krijimi dhe forcimi i një pozite ekonomike të fortë dhe konkurruese të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut;
- III. Sigurimi i integritetit fizik dhe territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqiptar;
- IV. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për njerëzit, duke promovuar rritje ekonomike, eliminuar pabarazitë hapësinore, hequr barrierat e aksesit në ekonomi, infrastrukturë dhe dije.
- V. Promovimi i të "drejtës për qytetin"
- VI. Krijimi i bazave për zhvillim rajonal

7.1.2. Objektivat Specifike të planit të Përgjithshëm Kombëtar

Që burojnë nga Ligji nr. 107, datë "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar janë:

- a) Përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve për një zhvillim të qëndrueshëm e të balancuar të territorit;
- b) Krijimi i kushteve territoriale për zhvillimin rajonal;
- c) Drejtimi i krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike kombëtare;
- ç) Krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimi i efekteve të sistemeve të banimit e veprimtarive ekonomike dhe mbrojtja e zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;
- d) Orientimi i objektivave për planifikimin rajonal, ndërvendor e vendor;
- dh) Bashkërendimi i punës, harmonizimi dhe orientimi i objektivave sektorial të zhvillimit me efekt në territor;
- e) Përputhja me orientimet dhe udhëzimet e dokumentit të Perspektivës Europiane për Zhvillimin Hapësinor.

7.1.3. Objektivat e planit të Përgjithshëm Vendor

Në nenin 20 të ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcaktohet:

1. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:

- a) Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
- b) Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;
- c) Drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- ç) Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- d) Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- dh) Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike dhe shërbimet publike, sipas këtij ligji;
- e) Rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

2. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

7.2. OBJEKTIVAT DHE VIZIONET PRIORITARE TË BASHKISË LIBRAZHD

7.2.1. Objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Librazhdit

Bazuar në punën e grupit të projektimit në bashkepunim edhe me autoritetet vendore dhe të qarkut, janë shtruar qëllimet strategjike të cilat më pas janë zbërthyer në objektiva. Këto janë frut i analizave të informacionit të grumbulluar gjatë seminareve ku me kontributin e të gjithë aktoreve pjesëmarrës janë përcaktuar prioritetet dhe vizioni i ardhshëm i qytetit të Librazhdit.

- Fuqizimi i sektorit privat në Librazhd me fokus kryesor magazinimin dhe tregëtinë rajonale;
- Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Librazhdit;
- Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet, si elementi më i domosdoshëm për rritjen e kapaciteteve të komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale;
- Rikonceptimi i mënyrës së menaxhimit të territorit në bashkinë Librazhd bazuar në pjesëmarrjen demokratike dhe transparente të gjithë aktorëve të fushës së zhvillimit me qëllimin kryesor zhvillimin ekonomik të qytetit;
- Përmirësimi i kualitetit të banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Librazhdit;
- Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin qytetarit si "klient";

7.2.2. Objektivat e Planit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHDI

Ky plan rregullues duhet të përcaktoj strukturën më të favorshme të zhvillimit të ardhshëm të qytetit të Librazhdit. Kjo strukturë duhet të respektojë në maksimum vlerat natyrore dhe historike të territorit ku ndodhet qyteti. Përveç kësaj objektivat kryesore që duhet të mbahen parasysh gjatë hartimit të Planit janë si më poshtë:

- Shfrytëzimit të **avantazheve që vijnë si rezultat i rajonit** ku është vendosur Librazhdi si edhe **rivitalizimit dhe bërjes së lexueshme të elementëve qytetformues**;
- Rikonceptimit të “makrostrukturës” së qytetit përmes konceptimit dhe **krijimit të “fashës së pajisur” multifunkionale** që do të mbështes tezën e “Librazhdit qytet Rajonal”. Kjo do të kërkoj kryesisht ndërtimin e strukturave të reja me këtë përjasje;
- Realizimit të **lidhjeve sa më optimale të qytetit me superstradën dhe përcaktimi i funksioneve dhe kufinjve në qasjen direkte me të**;
- **Rritjes së gamës së funksioneve ekzistuese** në qytet, me fokus kryesor rritjen e hapësirave publike, të gjelbra dhe argëtuese;
- Identifikimit të hapësirave të nevojshme për **vendosjen e bizneseve** brenda territoreve të qytetit dhe në zona të reja;
- **Integritit të vendbanimeve të parregullta** në periferi me pjesën tjetër të qytetit ;
- Identifikimit të mekanizmave të nevojshëm teknike / urbanistike dhe administrative për përmirësimin e **hapësirave të brendshme të njësive të banimit**;
- Përcaktimit të mekanizmave të nevojshëm urbanistike për **sigurimin e banesave sociale**;
- Përcaktimit të përdorimeve sa më optimale për sipërfaqet e pashfrytëzuara brenda vijës kufizuese ekzistuese, si edhe të zonave apo objekteve ish-ekonomike të cilat aktualisht janë jashtë funksionit;
- Identifikimit të hapësirave të reja të shtrirjes së qytetit dhe të përcaktimit të destinacioneve të tyre;
- Përcaktimit të skemës së përgjithshme të rrjetit rrugor dhe mënyrës së funksionimit me synim kryesor lehtësimin e lidhjeve nga sektori në sektor;
- Përcaktimit të kufirit të sipërm (në kodra) të rritjes së qytetit;
- Përcaktimit të një “lidhësi lumor” që do të shërbej për të “afruar” qytetin me lumin si elementi kryesor qytetformues;
- Bashkërendimit të skemës së re të zhvillimit të qytetit me rrjetin e përgjithshëm të infrastrukturave (ujësjelles, kanalizime, furnizim me energji elektrike, telefoni);
- Përcaktimit të qartë të njësive strukturore të qytetit sipas të cilave do të hartohen studimet urbanistike pjesore për të gjitha pjesët e qytetit; dhe formulimit të qartë për secilën prej tyre të kushtëzimeve urbanistike, treguesve urbanistike e shërbimeve sociale të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të studimeve urbanistike pjesore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

7.2.3. Vizioni i Bashkisë

Bashkia Librazhd është e pozicionuar në korridoret më të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare, me historinë e tij, bukuritë natyrore të pakrahasueshme, biodiversitetin e rrallë e të larmishëm, vlerat etnografike dhe folklorike, mikpritjen, qetësinë dhe ajrin e pastër. Nëpërmjet hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor synohet që Bashkia Librazhd të jetë vendi i mundësive të shumta për zhvillimin ekonomik dhe turistik duke u mbështetur në elementët e mëposhtëm:

- ❖ Aksesit dhe lidhja shumë e mirë me rrjetin kombëtar dhe korridoret më të rëndësishme ndërkombëtare;
- ❖ Toka bujqësore do të trajtohet si resurs primar për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, për rritjen e punësimit në këtë sektor dhe rritjen e mirëqenies.
- ❖ Librazhdi si pikë stacionimi historike;
- ❖ Ekzistenca e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe mjaft zonave të mbrojtura në të dyja anët e lumit Shkumbin;
- ❖ Shtrirja dhe aksesueshmëria e luginës së Shkumbinit si vendosje mbis dy shtrirjeve varg malore;
- ❖ Traditat kulturore – historike;
- ❖ Potencialet që ofron Bashkia për popullsinë vendase.

Tabela nr. 15. Lidhja midis Projekteve Strategjike të parashikuara në Planin Strategjik dhe objektivave të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Projektet strategjike	OBJEKTIVAT E PLANIT TË PËRGJITHSHËM KOMBËTAR							
	Objektivat e përgjithshme	Planifikimi dhe zhvillimi i territorit	Politikat	Sistemi Urban	Sistemi Natyror	Sistemi Bujqësor	Sistemi Ujor	Sistemi Infrastruktural
01.U	✓	✓	✓	✓				
02.U	✓	✓	✓	✓				
03.U	✓	✓	✓	✓				
04.U	✓	✓	✓	✓				
05.N	✓	✓	✓	✓	✓			
06.N	✓	✓	✓		✓			
07.N	✓	✓	✓		✓			
08.A	✓	✓				✓		
09.A	✓	✓				✓		
10.W	✓	✓					✓	
11.I	✓	✓	✓					✓
12.I	✓	✓	✓					✓

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

13.I	✓	✓	✓					✓
------	---	---	---	--	--	--	--	---

7.3. SKENARËT E ZHVILLIMIT

SKENARI 00 *siguron ruajtjen e gjendjes aktuale të territorit, pa ndërhyrje strukturale strategjike në relief.*

Për elementet e Sistemit Urban, parashikohet ekskluzivisht ndërhyrja në brendësi e zonës urbane ekzistente, veçanërisht në zonat e braktisura dhe në brendësi të zonave të konsoliduara, bazuar në cilësinë e ndërtimit dhe efikasitetit të ulët të energjisë. Në mënyrë të ngjashme në lidhje me komponentin e sistemit infrastrukturor nuk janë parashikuar ndërhyrje të mëtejshme, përveç mirëmbajtje dhe përmirësim të rrjetit ekzistues.

Rizhvillimi i sektorit të ndërtimit dhe të energjisë, bëhet kështu motorri dhe parakushti për densifikimin e strukturës urbane. Ndërhyrjet e reja, përveç ndërhyrjeve të mirëmbajtjes të strukturave të ndërtimeve urbane ose transformimit të zonave të braktisura, parashikojnë mundësinë e rritjes së potencialit për ndërtim në krahasim me indekset ekzistuese, që do të realizohen në këto njësi ose do të transferohen në zona të tjera të lira të përfshira brënda perimetrit urban.

Për Sistemin Bujqësor, nuk janë parashikuar ndërhyrje infrastrukturale në zonë apo jashtë saj.

Për elementin e Sistemit Natyror nuk janë parashikuar ndërhyrje infrastrukturale në zonë për një shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve të peizazhit dhe pyjeve.

Për elementet e Sistemit Ujor nuk janë parashikuar ndërhyrjet e rizhvillimit dhe rritja e burimeve ujore kryesore të mjedisit dhe peizazhit, veçse ai i prodhimit.

Rritja e qytetit Vëllimet e prodhuara nga përmirësimi cilësor i ndërtesave densifikojnë sistemin urban; ndërtesat më të degraduara mund të zëvendësohen në tërësi në ndërtesa të reja miqësore me mjedisin, në përputhje me treguesit lokal. Pësia e përfitimeve përcaktohet në përpjestim me vëllimet ekzistuese dhe në raport me përmirësimet mjedisore dhe energjetike

SKENARI 01 **parashikon maksimizimin e zonave të transformimit dhe zonave në rritje brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të konsoliduar, si ato banuese ashtu edhe ato prodhuese me një sistem, të përqendruar fuqishëm tek infrastruktura lidhëse.**

Objektivi i këtij skenari është rimëkëmbja e sistemit të përgjithshëm urban, dhe zgjidhja e gjendjes kritike lokale. Për të bërë sa më të qëndrueshme ndërhyrjet e parashikuara skenari parashikon zbatimin në fazë dhe ecurinë e kohës.

Periodikisht është përcaktuar një sasi volumetrike ndërtimi që është ndarë në bazë të tendencave demografike, sipas kërkesës për ndërtim, etj, në përputhje me objektivat dhe performancës minimale të kërkuar.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me komponentin e sistemit infrastrukturor janë parashikuar ndërhyrje të mëtejshme përveç se, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të rrjetit ekzistues.

Në Sistemin Bujqësor, janë planifikuar ndërhyrje në infrastrukturën e zonës dhe veçanërisht në integrimin dhe zgjerimin e strukturës ekzistuese.

Për komponentin e Sistemit Natyror janë parashikuar ndërhyrje infrastrukturore në këto hapësira ose veçanërisht për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peizazhit dhe pyjeve.

Për komponentin e Sistemit Ujor janë parashikuar ndërhyrje për rihvillimin dhe vlerësimin e burimeve ujore të mjedisit dhe peizazhit, si dhe ato në lidhje me prodhimin.

Rritja e Qytetit. Vëllimet e reja janë të vendosura në hapësirat e transformimit të parakohshëm, ku bëhet i mundur krijimi i një sistemi të përshtatshëm të infrastrukturës dhe paralelisht bonifikimi i zonave të degraduara dhe mbushja e hapësirave ekzistuese urbane bosh.

Politikat shoqëruese. Zgjerimi i hapësirës së ndërtuar lejon forcimin e pikave të saj qëndrore, rikualifikimin e hapësirave urbane dhe ndërtimin e vendbanimeve të reja me teknika moderne.

SKENARI 02 parashikon maksimizimin e ndërhyrjeve me karakter ekologjik ambiental dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban dhe ambiental në tërësi, në mënyrë të veçantë me qëllim të zvogëlimit të presioneve antropike, duke favorizuar rigjenerimin e ndërtesave në një sistem me performancë më të mirë të energjisë.

Këto ndërhyrje, sjellin një përmirësim të përgjithshëm të bilancit të ekosistemit dhe mund të zbatohen gjithashtu edhe në zonat e gjelbra. Në veçanti, çdo veprim i rigjenerimit të ndërtesave dhe trashëgimisë së sistemit urban është i barabartë me një bonus volumetrik (kompensimi i vëllimit) që nuk mund të ndërtohet në të njëjtin vend, por i zhvendosur brenda zonave të transformimit të jashtëm.

Të drejtat e zhvillimit të zonave të transformimit janë të lidhura me politikat e rigjenerimit urban të hapësirës së ndërtuar. Ndërhyrjet e testuara sizmike dhe të efikasitetit të energjisë gjenerojnë indekset volumetrike për ti lëvizur në zonat e pazhvilluara në brendësi. Në veçanti:

- Proçeset e rigjenerimit të energjisë të ndërtesave ekzistuese.
- Transferimi në Bashki të hapësirave për shërbime publike
- Zhvendosja e ndërtesave nga zonat me rrezik hidrogeologjike

Në mënyrë të ngjashme, për sa i përket sistemit komponent infrastrukturor, janë planifikuar përmirësime të rrjetit aktual, në veçanti, për sa i përket lidhjes së brendshme midis qyteteve dhe fshatrave dhe drejt bashkive fqinje.

Për komponentin e **Sistemit Bujqësor** janë planifikuar ndërhyrje infrastrukturore në këtë sistem dhe duke vënë theksin në integrimin dhe zgjerimin e strukturës ekzistuese.

Për komponentin e **Sistemit Natyror** janë planifikuar ndërhyrjet infrastrukturore në zonë ose specifike për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peizazhit dhe pyjeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Për komponentin e **Sistemit Ujor** janë planifikuar rihvillimi dhe vlerësimi i burimeve ujore nga ana e mjedisit dhe e pejzazhit.

Rritja e Qytetit. Zonat e transformimit kanë një potencial ndërtimi që mund të zhvillohet vetëm me ndërhyrjet e rigjenerimit urban. Qyteti rritet me një sistem të dyfishtë që në njërin anë ndërhyrjet në zonën e ndërtuar dhe nga ana tjetër konsiston në mbushjen e zonave të brëndshme bosh, me përjashtim të zgjerimit në hapësirat e zonave të gjelbra. Në veçanti, zonat e ndërhyrjeve të brëndshme, përgjegjëse për akomodimin e volumit të kompensimit, do të duhet të jenë të pajisura me indeksin e dyfishtë, e para paraqet kuotën e vëllimit të hapësirës, dhe e dyta vlerëson volumin që duhet të fitohet nga proceset e rigjenerimit dhe organizimit territorial. Realizimi i ndërhyrjeve në hapësirën e transformimit të brëndshëm është subjekt i arritjes së indeksit maksimal.

Politikat shoqëruese. *Ripërteritja urbane lejon shtrirjen e kontrolluar të hapësirës së ndërtuar dhe lejon konsolidimin e saj në zonat qendrore.* Krijimi i hapësirave urbane të reja për komunitetin bën të mundur kualifikimin e sistemit urban dhe shërbimeve urbane. Në veçanti, në zonat e prekura nga transformimi, dhe me kufizime hidrogeologjike, parashikohet mundësia e transformimeve që synojnë realizimin në përputhje me kërkesat mjedisore dhe llojin e strukturave që mund të minimizojnë çdo risk, që ka të bëjë me përmbytjet

Politikat shoqëruese. Kursimi i krijuar, nga ndërhyrjet e koordinuara mbi ndërtesa, gjeneron burime për rihvillimin e përgjithshëm të sistemit urban dhe hapësirave publike. Zonat jashtë atyre të ndërtuara ekzistuese, nuk parashikohet të ndërtohen dhe kontribuojnë në përmirësimin ekologjik të zonës urbane, duke favorizuar një ekuilibër ekosistematik më të mirë të territorit.

7.3.1. ANALIZA SWOT KRAHASIMI SKENARET 0, 1, 2.

Analiza Swot E Skenarëve Zhvillimore

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA
---------------	----------------

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

SISTEMI URBAN: SKENARI 00 - SKENARI 01 <i>Rritja e një strukture të vendbanimeve të konsoliduara të cilat njohin kufij dhe disfunksione. Zgjerimin e ofertës së shërbimeve publike dhe private jo efikas dhe modern;</i> SKENARI 02 <i>Lehtësim i presionit të vendbanimeve; Vendbanimet dhe zonat urbane të konsoliduara;</i>	SISTEMI URBAN: SKENARI 00 Mungesa e investimeve në sektorin industrial, në zonën urbane dhe infrastrukturës dhe të shërbimeve të tipit publik dhe privat; SKENARI 01 <i>Rritja e presionit të vendbanimeve, sasia e banesave të papërdorura;</i> SKENARI 02 Mungesa e investimeve në dy sektoret, në industrinë e ndërtimit dhe industrinë përpunuese;
SISTEMI NATYROR: SKENARI 00 - SKENARI 01 - SKENARI 02 <i>Ulja e nivelit të ndotjes dhe resurseve mjedisore Maksimizimin e vlerave mjedisore, peizazhit, ekologjike dhe natyrore;</i>	SISTEMI NATYROR: SKENARI 00 Vazhdimi i procesit të ndotjes të resurseve mjedisore; SKENARI 01 <i>Rritja i procesit të ndotjes dhe resurseve mjedisore;</i> SKENARI 02 Mungesa e një sistemi të organizuar të mjedisit të qëndrueshëm urban dhe natyror. Mungesa e investimeve;
SISTEMI BUJQESOR: SKENARI 00 - SKENARI 01 <i>Mbajtja e konsoliduar dhe e përhapur e ekonomisë bujqësore;</i> SKENARI 02 <i>Forcimin e ekonomisë të konsoliduar dhe të përhapur bujqësore;</i>	SISTEMI BUJQESOR: SKENARI 00 Aktivitetet bujqësore, por pa një organizim dhe një strukturë efikase; SKENARI 01 Aktivitetet bujqësore, por pa një organizim dhe një strukturë efikase SKENARI 02 -
SISTEMI UJOR: SKENARI 00 - SKENARI 01 - SKENARI 02 <i>Lehtësimi i presionit të vendbanimeve në rrjetin hidrografik të dendur;</i>	SISTEMI UJOR: SKENARI 00 Vazhdimi i procesit të ndotjes së burimeve ujore; SKENARI 01 <i>Rritja e procesit të ndotjes së burimeve ujore;</i> SKENARI 02 Mungesa e një sistemi të organizuar të mjedisit të qëndrueshëm urban dhe ujor; Mungesa e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

	investimeve;
SISTEMI INFRASTRUKTUROR: SKENARI 00 - SKENARI 01 Kjo përmirëson vendndodhjen strategjike me kryeqytetit dhe qendrave të mëdha; SKENARI 02 Lehtësimi i presionit të vendbanimeve në mjedis;	SISTEMI INFRASTRUKTUROR: SKENARI 00 Kushtet strukturale të infrastrukturës së komunikimit dhe qasja e një nivelit të ulët; SKENARI 01 Rritja e presionit të infrastrukturës dhe vendbanimeve në mjedis SKENARI 02 Mungesa e investimeve në sektorin e infrastrukturës. Mbajtja e një pozicioni të prapambetur dhe rritja në nivelin e përjashtimit
MUNDESITE	RISQET
SISTEMI URBAN: SKENARI 00 - SKENARI 01 Rizhvillimit dhe përmirësimi i kapitalit dhe qendrave urbane dhe fshatrave. SKENARI 02 Shfrytëzimi i zonave të prodhimit / artizanale ekzistuese dhe përmirësimin e zonave ekzistuese ose të braktisura;	SISTEMI URBAN: SKENARI 00 Reduktimi i mëtejshëm i cilësisë së qendrave urbane dhe vendeve publike si të qendrat më të mëdha edhe tek fshatrat. Rritja e nivelit të papunësisë SKENARI 01 Nevojë për të rritur investimet e duhura; SKENARI 02 Reduktimi i mëtejshëm i cilësisë së qendrave urbane dhe vendeve publike; Rritja e degradimit të mëtejshëm i lidhur me vendet bosh dhe aktivitetet që nuk janë në përdorim (degradimi territorial dhe ekonomik); Rritja e niveleve të papunësisë;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

SISTEMI NATYROR: SKENARI 00 - SKENARI 01 - SKENARI 02 Potenciali turistik për zonën kodrinore dhe për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm; Potenciali i lidhur me vlerat mjedisore, të pranishme natyrore dhe ekologjike;	SISTEMI NATYROR: SKENARI 00 Nivelet në rritje të ndotjes që rrjedhin nga aktivitetet industriale, aktivitetet minerare dhe kushtet e florës dhe faunës; SKENARI 01 Rritja e presionit mbi mjedis, nga infrastruktura dhe vendbanimet; Nivelet në rritje të ndotjes që rrjedhin nga aktivitetet industriale, aktivitetet minerare dhe kushtet e florës dhe faunës SKENARI 02 -
SISTEMI BUJQESOR: SKENARI 00 - SKENARI 01 Shfrytëzimi i aktiviteteve të larmishme dhe të specializuara bujqësore; SKENARI 02 Zhvillimi i aktiviteteve bujqësore në një nivel të integruar me përmirësimin e njëkohshëm të niveleve të prodhimit;	SISTEMI BUJQESOR: SKENARI 00 Rritja e niveleve të prapambetjes dhe rënie e prodhimtarisë të zonave bujqësore; SKENARI 01 Ruajtjen e niveleve të prapambetjes dhe rënie e prodhimtarisë të zonave bujqësore; SKENARI 02 Rritja e nivelit të prapambetjes dhe rënie e prodhimtarisë të zonave bujqësore;
SISTEMI UJOR: SKENARI 00 - SKENARI 01 - SKENARI 02 Rizhvillimi i rrjetit lumor dhe rritja e burimeve ujore (përmirësimin e peizazhit dhe niveleve të ndotjes);	SISTEMI UJOR: SKENARI 00 Rruajtja e nivelit të ndotjes në sistemin ujor për shkak të aktiviteteve të njeriut dhe hedhjes së mbeturinave; SKENARI 01 Rritja e nivelit të ndotjes në sistemin ujor për shkak të aktiviteteve të njeriut dhe hedhjes së mbeturinave; SKENARI 02 -
SISTEMI INFRASTRUKTUROR: SKENARI 00 - SKENARI 01 Forcimi i aktiviteteve dhe lidhjeve në lidhje me	SISTEMI INFRASTRUKTUROR: SKENARI 00 Mbajtja e një pozicioni të prapambetur dhe rritja e nivelit të perjashtimit;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

<i>Elbasan dhe lidhjet kombëtare Investimenti;</i>	SKENARI 01 <i>ka nevojë për investime;</i>
SKENARI 02 <i>Riperdorimi i rrjetit hekurudhor dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese rrugore;</i>	SKENARI 02 <i>Mungesa e investimeve në sektorin e infrastrukturës Mbajtja e një pozicioni të prapambetur dhe rritja e nivelit të përjashtimit;</i>

7.3.2. Bashkërendimi midis skenarit Zero dhe fushave të veprimit dhe të vlerësimit të objektivave të VSM.

Skenari (Alternativa) zero nënkupton një situatë pothuajse të ngjashme me gjendjen aktuale në të gjitha parametrat mjedisor dhe zhvillimor të bashkisë Librazhd, madje në përkeqësimin e disa treguesëve. Kjo është e lidhur qoftë me sistemin urban, sistemin e infrastrukturës, sistemin ujor, sistemin natyror dhe atë bujqësor të zhvillimit, por njëkohësisht me komponentët e mjedisit dhe mundësinë për të siguruar një shvillim të qëndrueshëm, sikurse është përdormi i tokës, ruajtja dhe zhvillimi i Biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, menaxhimi i mbetjeve urbane, ruajtja e trashëgimisë natyrore, kulturore, historike, ruajtjen e peisazhit, kontrollin e ndotjes së ajrit dhe të nivelit të zhurmave akustike në normat e kërkuara nga legjislacioni bashkëkohor, në mundësinë e krijimit të aseteve dhe përfitimeve për popullsinë.

Zhvillimi i deritanishëm i Bashkisë (megjithëse njësi administrative e rikonceptuar në 2015) është karakterizuar nga plane studimore të pjeshme, të pa harmonizuara dhe jo me kontekst mjedisor, shpesh pjesore që nuk kanë mundur të harmonizojnë zhvillimin policentrik si koncept dhe njëkohësisht të qëndrueshëm me mjedisin. Megjithëse në qytetin e Librazhdit janë ndërmarrë disa realizime në kontekstin e investimeve dhe të zgjidhjeve imediate, gjithsesi ato nuk integrohen në tërësinë territoriale të bashkisë së re dhe nuk janë shumë të qëndrueshme sepse nuk janë pjesë e një zgjidhje afatgjatë të problemeve të shtrura për zgjidhje dhe të azhornuara me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor..

Efekti mjedisor i këtij skenari përmbledhet në këto pasoja:

MJEDISI TOKËSOR	Objektiva të VSM që impaktohen negativisht
Pritet përkeqësim për shkak të arsyeve të mëposhtme:	I.6;
☐ Intesifikimit të kultivimeve dhe përdorimit të madh të plehrave kimike e pesticideve;	I.5;
☐ Hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve dhe të produkteve të	I.7;
	II.1;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

punimeve; ☐ Shtimi i qarkullimit në njësi sipërfaqe dhe njësi kohore me shtim të ndotjes së tokës; ☐ Rrezikut prej përmbytjeve; ☐ Erozionit; ☐ Fragmentarizimi;	II.2; II.4; III.6; IV.1; IV.3;
CILËSIA E AJRIT	
Priten përkeqësime për shkak të: ☐ Përdormit të automjeteve të vjetra; ☐ Shtimit të sasisë së automjeteve që do të jenë në qarkullim jashtë kushteve mjedisore; ☐ Shtimit të shkarkimeve në ajër për shkak të teknologjisë së mos djegjes së plotë; ☐ Shtim të shkarkimeve atmosferike për shkak të mos zgjedhjeve alternative në sistemin e ndërtimit dhe të ngrohjes; ☐ Shtimi i qarkullimit në njësi sipërfaqe dhe njësi kohore me shtim të ndotjes së ajrit. ☐ Shtim të prezencës së pluhrave për shkak të mos ndërhyrjes në sistemin infrastrukturor rural dhe në zonat hot spote;	I.2; I.3; I.6 II.1; II.2; II.3; IV.1; IV.3; IV.5;
CILËSIA E TRUPIT UJOR	
Pritet përkeqësim në cilësinë edhe sasinë e ujrave për shkak se: ☐ Shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve ujore për çfarëdolloj qëllimi komunitar (vaditje, industri, etj); ☐ Shtim të kërkesave për ujë sidomos të pijshëm për shkak të zgjerimit në sektor primar e terciar. ☐ Ndotje të ujit për shkak të shkarkimeve të pakontrolluara të mbeturinave industriale, familjare, sanitare në lumin Shkumbin apo/dhe degët furnizuese të tij (kryesisht Rrapun dhe Gostimë). ☐ Ndotje e ujit për shkak të përdorimit të intensifikuar dhe të pakontrolluar të kimikateve bujqësore dhe pesticideve. ☐ Shkarkime direkt të ujrave me ngarkesa kimike dhe biologjike si rezultata i proceseve dekompozuese ose teknologjive agrobujqësore të pa studjuara në plan vendosje dhe sistemin e trajtimit të mbetjeve të lëngshme; ☐ Pamundësia e sigurimit të rrjetit funksional të mirëmbatjes së tokës dhe mos përmbytjen e saj. ☐ Mungesa e një rrjeti kanalizimesh të konceptuar funksional në lidhje	II.3; II.4; III.1; III.2; III.3; III.4; III.5; III.6; IV.5.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

me kapacitet gjeneruese të bashkisë	
CILËSIA E BIODIVERSITETIT	
Përkeqësimi jo të jenë në rritje për shkak të: ☐ Shfrytëzimit të pyjeve në mënyrë amatore dhe pa kriter tekniko-inxhinierike (Polis, Lunik, Dardhë, etj); ☐ Prezenca në rritje e mundësisë së rënies së zjarreve të qëllimshme apo aksidentale; ☐ Aplikimi i gjuetisë së paligjshme; ☐ Shfrytëzimi kullosor i tejskajshëm; ☐ Rritja e ndjeshme e stresit mjedisor sidomos në zonat me rëndësi strategjike mjedisore; ☐ Krijimi i aksesit shfrytëzues ndaj natyrës pa kthim investimi me pasoj degradim deri në shtrëhim të burimeve të rigjenerueshme; ☐ Presioni mbi specie, llojet me ndjeshmëri dhe rrezik zhdukje apo në monumente të natyrës, gjeomunamente, hidromonumente, etj.	I.1; I.2; I.3; I.4; I.5; I.6; I.7; II.3; III.1; III.5; III.6;
MENAXHIMI I MBETJEVE	
Pritet që të ruhet situata aktuale në menaxhimin e mbetjeve, shtim të sasisë së tyre dhe përkeqësim të impaktit mjedisor sepse: ☐ Mungojnë vend depozitime sanitare të tipit landfill, duke rritur shkarkimet ndotëse në tokë dhe ujë. ☐ Mungojnë impiantet e trajtimit të ujrave të zeza dhe mbetjeve ujore industriale duke mundësuar shtim të shkarkimit në tokë dhe ujra sipërfaqësore e nëntokësore. ☐ Shpërndarje sporadike të pakontrolluar të mbetjeve në hapësirën e territorit të bashkisë dhe në përbërësve të njësive administrative (fshatrave) duke impaktuar negativisht peisazhin. ☐ Shtim të ndjeshëm të vëllimit fizik të mbetjeve për shkak të shtimit të konsumit shoqëruar me mungesë të veprimtarive ricikluese dhe kompostuese.	I.2; I.7; II.1; II.2; II.3; II.4; III.2; III.3; III.6;
CILËSIA E ZHURMAVE / NDOTJA AKUSTIKE	
Pritet shtim të ndjeshëm të efekteve zanore sidomos në zonat me shtim të përqëndrimit të trafikut të automjeteve sepse: ☐ Mungojnë projektet infrastrukturore rrugore për shpërndarje zonale të qarkullimit; ☐ Mungon planifikimi i qarkullimit sipas tipologjisë së automjetit dhe qëllimit të shërbimit, duke krijuar kaos në qarkullim dhe përqëndrim të zhurmave me impakt negativ mjedisor.	I.1; I.3; III.1; IV.3; IV.6;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

☐ Nuk aplikohen burime alternative, efikase dhe me ndotje minimale si transporti kolektiv, rrjeti hekurudhor, përdormi i biçikletave, etj.	
NDIKIMI NË POPULLSI DHE ASETET E SAJ	
Pritet që të ruhet ose përkeqësohet situata aktuale sepse:	I.1;
☐ Ruhen kushtet natyrore jo atraktive për shkak të mungesës së infrastrukturës teknike e sociale;	I.2;
☐ Pranisë së rrezikut nga fatkeqësi natyrore si erozion, përmbytje, etj për shkak të ndërtimeve të pakontrolluara dhe mungesës së projekteve mbrojtëse ndaj fenomeneve natyrore.	I.3;
☐ Zhvillimi kaotik i urbanizimit me mundësi minimale ofrimi shërbimi komunitar;	I.4;
☐ Mos aplikimi i zhvillimeve me efikasitet energjitike dhe ndotje të reduktuar mjedisore;	I.7;
☐ Mundësi shterimi të burimeve të parinovueshme të energjisë;	II.3;
	III.1;
	III.5;
	IV.1;
	IV.3;
	IV.4;
	IV.5;
	IV.6.
NDIKIMI NË PEISAZH	
Pritet një përkeqësim në vazhdimësi i peisazhit sepse:	I.5;
☐ Ka ndërtime të pakontrolluara dhe zhvillim të sektorit sekondar;	I.6;
☐ Mungesë në kuadrit të integruar institucional të mbrotjes së peisazhit;	II.3;
☐ Invadime sporadike dhe të pakontrolluara të tipologjive shkarkuese në mjedis;	III.1;
☐ Depozitime sporadike me impakt negativ në rritje për impact negative në cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit.	III.5;
	III.6;
	IV.1;
	IV.6;
NDIKIMI NË TRASHËGIMINË KULTURORE/HISTORIKE	
Pritet shtim i mundësisë së humbjes së këtyre elementëve për shkak se:	I.4;
☐ Mungesës së projekteve mirëmbajtëse dhe restauruese;	I.5;
☐ Mungesës së një kuadri institucional të integruar mirëfunksional dhe strik për menaxhimin e tyre;	II;
☐ Mungesës së mundësisë së atraksionit dhe burimit të mirëqënies social-ekonomike;	III;
☐ Mos krijimi i rrjetit të mirëmbatjes, evidentimit dhe krijimit të burimit të punësimit.	IV.6;

7.3.3. Analiza e skenarëve 01 dhe 02.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH D

Skenari 01 dhe skenari 02 janë pjesë e veprimit të grupit të punës të iniciuar sipas kërkesës së Bashkisë për realizimin e studimit në lidhje me hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd 2015-2030.

Hartimi dhe miratimi nga strukturat përkatëse i PPV për Bashkinë Librazhd parashikohet të ketë pritshmëri shumë të mira sepse:

- Zhvilluesit dhe ndërtuesit do të mund të zbatojnë projekte efikase dhe të qëndrueshme;
- Qyteti i Librazhdit por dhe zonat rurale parashikohen të sistemohen nga pikpamja urbanistike, infrastrukturës, të mundësohet shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, çlodhëse, argëtuese, mjediseve kulturore, edukuese e shëndetësore, etj;
- Mundësi ndërhyrje në përmirësimin e cilësive të zonave të nxehta duke i kthyer në pjesë funksionale;
- Mundësi sistemimi dhe kthimi në pjesë të aksesueshme për komunitetin qoftë për qëllimeve zhvillimi ekonomik apo kreativiteti të zonës paralele me lumin Shkumbin.
- Toka të mund të mbrohet nga çdo lloj impakti negativ dhe krijimi i aksesit për të qenë më produktive;
- Mjedi natyror mjaft i bollshëm dhe i larmishëm të bëhet pjesë e aksesueshme për komunitetin por dhe të zhvillohet dhe mbrohet;
- Mundësi krijimi akses punësimi duke shfrytëzuar burime ekzistuese alternative, ekonomike, të qëndrueshme dhe dinamike.
- Mundësi për përmirësim të cilësisë së jetesës duke shfrytëzuar burime në rritje të energjisë së rinovueshme dhe me emetime minimale;
- Mundësi për të përmirësuar në mënyrë të ndjeshme treguesit e mjedisit që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, afatgjatë, me rëndësi ekonomike.

PPV aplikon parime dhe modele zhvillimi të njohura dhe aplikuar masivisht në vendet e BE, sikurse është koncepti policentrik, çka i ofron njerëve shërbime sa më pranë vend banimit dhe siguron efikasitet të gjithanshëm. PPV gjithashtu krijon mundësi zhvillimi ku aktor janë pushteti lokal, bizneset dhe komuniteti. Por njëheraz PPV e shikon zhvillimin hapësinor të Bashkisë të lidhur me cilësinë e mjedisit sikurse të ajrit, ujit, menaxhimit e mbetjeve, mbrotjen e natyrës, të peisazhit, trashëgimisë, etj duke propozuar projekte, masa konkrete për krijim parqesh, shtim të sipërfaqeve gjelbëruese, mbrotje të specieve, qarkullimi me biçikleta, etj, që mundësojnë përmirësimin dhe zgjerimin e parametrave apo treguesëve të tyre për një zhvillim të qëndrueshëm. Jo më pak i rëndësishëm në këtë proces vlerësimi dhe hartimi të PPV dhe të VSM ka qenë mendimi i publikut i përfituar nëpërmjet takimeve, prezantimeve, konsultimeve në fazat e punës përgatitore të raportit final të VSM.

Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë është fokusuar në tre problematika kryesore që janë:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- A. Zhvillimi social ekonomik i infrastrukturës;
- B. Organizimi hapësinor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban;
- C. Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit;

Për secilin prioritet në përputhje me sistemin kornizë të Planifikimit të territorit janë hartuar objektivat specifike të PPV për secilin nga 5 fushat e veprimit si dhe janë pasqyruar projektet konkrete që duhet të implementohen duke përcaktuar afatet kohore, vlerën financiare të përafërt, përfitimet e mundshme dhe ndikimet.

Lidhja midis objektivave të Përgjithshme Kombëtare dhe Projekteve Strategjike të Identifikuara në Bashkinë Librazhd.

Objektivat e përgjithshme	• Zhvillimi i qëndrueshëm; • Integrimi evropian i Shqipërisë ; • Forcimi i kushteve ekonomike dhe i konkurrencës; • Ruajtja e peizazhit historike, kulturore, natyrore dhe urban; • Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve;
Planifikimi dhe zhvillimi i tokës	• Rritja e qëndrueshme dhe e balancuar e territorit; • Kushtet territoriale për zhvillimin rajonal; • Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës publike kombëtare; • Krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversitetit, burimeve natyrore, trashëgiminë natyrore dhe kulturore; • Bilanci i sistemeve të prodhimit të dy sektorëve ekonomikë, bujqësor dhe industriale e të tjerë; • Pajtueshmëria e zgjedhjeve dhe udhëzimet evropiane për zhvillimin e territorit.
Politikat	• Infrastruktura kryesor e dhe infrastruktura e transportit; • Zhvillimi i infrastrukturës energjetike, diversifikimin dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme; • Dendësimi Urban dhe sistemi policentrik, përcaktimi i linjave të transmetimit, dhe qasjet; • Sistemin e turizmit dhe promovimin e zonave dhe ku janë vlerat e peizazhit, trashëgimisë natyrore dhe trashëgimisë kulturore; • Zhvillimi i sistemit të integruar të transportit që tregon integrimin intermodal dhe krijimin e sallave efikase dhe moderne, duke përfshirë përmes krijimit të HUB për menaxhimin e rrjedhjes (qendra logjistike dhe lidhjet);

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Sistemi Urban	• Struktura policentrike, dendësimi dhe hierarkia e Bashkive sipas Ndarjes Territoriale 2014.; • Forcimi dhe zhvillimi i sektorëve të ekonomisë; • Struktura rajonale e specializuar përgjatë vijave të zhvillimit dhe rritjes. • Përdorimi dhe menaxhimi inteligjent i ekosistemeve urbane në veçanti në marrëdhëniet e tyre me rrugët ujore, energjinë dhe mbetjet; • Ruajtja dhe përmirësimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, në drejtim të përmirësimit dhe aktivizimit të këtyre aktiviteteve në zonat urbane.
Sistemi Natyror	• Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemeve natyrore, mjedisit dhe eko-peizazhit të vlerave; • Forcimi i turizmit dhe rritja e nivelit të shërbimeve; • Përcaktimi i një rrjeti çiklistik dhe rrugëve që lejojnë qasjet me vlerat mjedisore, në peizazhet natyraliste të bukurisë së veçantë dhe gjithashtu në zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore; • Zhvillimi i zonave malore dhe pyjore; • Mirëmbajtjen dhe dhe shtimi i sipërfaqeve të zonave natyrore të mbrojtura dhe zonat me vlera të mëdha.
Sistemi Bujqësor	• Rritja e efikasitetit të sektorit bujqësor në funksion të rritjes së konkurrencës së saj; • Rritja, angazhimi dhe ndërhyrjet për sistemin e bujqësisë; • Konsolidimi i sinergjive dhe vlerave e parë nga pikpamja bujqësore; • Modernizimi i sistemeve të prodhimit dhe përpunimit; • Shfrytëzimi maksimal i tokës bujqësore; • Krijimi i një rrjeti bujqësoro-ekonomik (qendra e prodhimit bujqësor: ruajtjes dhe përpunimit); • Rritja e prodhimtarisë (investimet, metodat e reja të prodhimit dhe modernizimi i sektorit); • Integrimi dhe bashkëpunimi me sektorë të tjerë të ekonomisë si: sistemi i turizmit bujqësor, sistemi i infrastrukturës bujqësore, qendra për prodhimin bujqësor (përpunimin dhe organizimin); • Promovimi i prodhimeve vendore, specialiteteve bujqësore dhe i produkteve të prodhuara;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Sistemi i Infrastrukturës	• Perfrocimi i korridoreve strategjike me vendet fqinje; • Organizimi i territorit nëpërmjet sistemit të qendrave urbane dhe hierarkia e rrugëve hyrëse (lëvizja e mallrave, njerëzve dhe ekonomisë përmes krijimit të qendrave të terminalit dhe intermodalitetit); • Organizimi i një sistemi të gjerë të infrastrukturës konkurruese të tipit intermodal • Promovimi i transportit publik ashtu edhe i transportit alternativ urban si edhe i atij jo urban (lëvizshmëria e ngadaltë, çiklizmi dhe këmbësorët); • Promovimi i transportit publik dhe i transportit duke ringjallur përdorimin e hekurudhës; • Infrastruktura efikase dhe të ndryshme të energjisë (burimet e rinovueshme); • Kursimi i energjisë, efikasiteti i energjisë dhe reduktimi i emetimeve të CO₂.
Sistemi Ujor	• Rritja dhe mbrojtja e rrjetit hidrografik (përdorimi i qëndrueshëm, në kundërshtim me shfrytëzimin e burimeve dhe ulja e nivelit të ndotjes); • Forcimi i sistemit të furnizimit me ujë si dhe aktivizimi i Impianteve të trajtimit të ujërave me kapacitet të plotë dhe shtimi i tyre përlllogaritur në secilin qark të ketë të paktën një Impiant të trajtimit të ujërave, në mënyrë që shkarkimet në lumenj e det të jenë evituar plotësisht.

7.3.4. ANALIZA SOFT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
SISTEMI URBAN: • Vendbanimet dhe zonat urbane të konsoliduara. • Zona e konsoliduar industriale. • Aktivitete të shumta minierash. • Shërbimet publike dhe private si në qendrat e mëdha ashtu edhe në fshatra. • Nivelet e larta të marrdhënieve shoqërore.	SISTEMI URBAN: • Cilësia e ulët urbane, arktitektonike dhe estetika e hapësirave dhe ndërtesave. • Aktiviteti industrial në pjesën e braktisur. • Aktivitetet e minierave jo të shfrytëzuara plotësisht. • Mungesa e investimeve në sektorin industrial. • Nivelet e ulëta të punësimit. • Borxhi i sektorëve produktiv. • Furnizimi i shërbimeve publike dhe private jo efikas dhe modern.
SISTEMI NATYROR: • Vlerat mjedisore, ekologjike dhe natyrore: zonat e mbrojtura, Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, pyjet dhe zonat malore.	SISTEMI NATYROR: • Miniera dhe aktivitetet industriale ndotëse. • Mungesa e një sistemi të organizuar për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Vlerat e peisazhit.	- Ulja në zonat e pyllëzuara. - Ndotja e burimeve mjedisore.
SISTEMI BUJQËSOR: - Ekonomia bujqësore e konsoliduar dhe e përhapur. - Ekonomia lidhur me sektorin e blegtorisë dhe përdorimin e burimeve pyjore.	SISTEMI BUJQËSOR: Sistemi i prodhimit bujqësor jo modern dhe efikas.
SISTEMI UJOR: Burimet e cilësisë së ujit.	SISTEMI UJOR: Ndotja e burimeve ujore.
SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: - Vend strategjik (qyteti kryesor, qytetet e mëdha dhe rrjeti rrugor). - Infrastruktura rrugore kombëtare dhe transnacionale (lidhur me Elbasanin dhe Maqedoninë). - Strukturimi i territorit dhe i infrastrukturës.	SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: - Infrastruktura e degraduar. - Mungesa e lidhjeve efikase. - Lidhja e infrastrukturës me nivel të ulët. - Infrastruktura rrugore jo efikase dhe rrjeti hekurudhor i braktisur.
MUNDËSITË	RREZIQET
SISTEMI URBAN: - Rritja e qendrave urbane dhe fshatrave. - Rizhvillimi dhe rritja e qytetit kryesor. - Rritja e vlerave të vendeve publike, shërbimeve dhe aktiviteteve. - Shfrytëzimi i zonave të prodhimit/anijeve ekzistuese dhe përmirësimi i zonave ekzistuese ose të braktisura.	SISTEMI URBAN: - Rënie në cilësinë e qendrave urbane dhe vendeve publike si në qendrat më të mëdha ashtu edhe në fshatra. - Rritja e degradimit lidhur me vëndet vakante dhe aktivitetet që nuk janë në përdorim (degradimi territorial dhe ekonomik). - Rritja e niveleve të papunësisë.
SISTEMI NATYROR: - Potenciali turistik për zonën malore dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. - Potenciali lidhur me vlerat mjedisore të pranishme, natyrore dhe ekologjike.	SISTEMI NATYROR: - Shfrytëzimi i rrëmujshëm dhe rritjet e parregulluara në zonat e pyllëzuara - Rritja e nivelit të ndotjes për shkak të veprimtarive të prodhimit dhe mbeturinave.
SISTEMI BUJQËSOR: Shfrytëzimi i aktiviteteve të larmishme dhe të specializuara bujqësore.	SISTEMI BUJQËSOR: Rritja e nivelit të prapambetjes dhe ulja e produktivitetit të zonave bujqësore.
SISTEMI UJOR: Rizhvillimi i sitemit të lumit (përmirësimi i niveleve të peisazhit dhe	SISTEMI UJOR: Rritja e nivelit të ndotjes (industriale, minierore dhe e mbeturinave)

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

të ndotjes).	
SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: Përmirësimi i rrjetit hekurudhor dhe i rrjetit rrugor.	SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: Prapambetja dhe rritja e nivelit të përjashtimit në lidhje me defiçitin e infrastrukturës.

7.4. KRITERET PËRJASHTUESE TË ZBATIMIT TË PPV-së KONFORM VSM-së

Veprimet operationale të planifikuara në PPV sipas fushës përkatëse të parashikuar në ligjin e Planifikimit Hapësinor duhet që të jenë dhe në përputhje me ligjin për VSM-në. Praktikisht ekzistojnë kritere mjedisore që duhen parashikuar dhe që kufizojnë zhvillimin hapësinor të Bashkisë, kritere që kufizojnë mundësitë në tejkalim të PPV.

Këto kritere përjashtuese kanë të bëjnë me:

Kritere 1: kufizuese, strikte dhe të forta mjedisore dhe shëndetësore;

Këto janë kritere që përcaktojnë dhe kushtëzojnë zona të cilat nuk mund të përfshihen në planin e Përgjithshëm vendor të zhvillimit të Bashkisë, por që duhen mbrojtur dhe të jenë pjesë integrale e PPV në zbatim. Këtu përfshihen:

- a. **Zonat me vlera të veçanta Mjedisore** (zonat e mbrojtura të natyrës sipas statusit që gëzojnë apo parashikohen të propozohen si të tilla, si Parku Kombëtar Shebenik – Jabllonicë, zona e mbrojtur e Kuturmanit, Dardhë-xhyrë, Polisit, baseni i lumit Shkumbin në fashon blu);
- b. **Zonat që paraqesin rrezikshmëri** për zhvillimin urban, infrastrukturor, etj të bashkisë (zonat e cilësuar si me rrezik rrëshqitje si shpatet formuese të shtraterëve të lumit, zonat me pjerrësi më të madhe se 25%);
- c. **Zonat e ndotura ose më saktë ato të paraqitura si hot-spote mjedisore** (zona e ish zonës industriale, pranë vend depozitimit të mbetjeve midis qytetit të Librazhdit dhe fshatit Togës, pranë instalimeve industriale, apo teknologjike me shkarkime sinjifikative në mjedis sikurse linjat e prodhimit të material ndërtimeve apo të përpunimit agrobujqësor e blegtorial)

Gjithashtu përmendim:

- Kështu mund të konsiderohen zonat përgjatë lumenjëve (duke siguruar një fasho blu) apo burimeve të ndryshme hidrike, zonave të identifikuar si biokoridore kryesore apo sekondare, etj.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- Shtretërit e lumenjëve dhe zonat buferike të tyre duke respektuar kërkesat ligjore për vijën blu duke respektuar një distancë sipas relievit, rrjedhjes deri 50m.
- Basenet nëntokësore ujëmbajtëse apo dhe pranë apo në drejtim të rrjedhjes natyrore hidrike të rezervuarëve të përmendur më sipër;
- Mos lejimi i ndërtimeve në tokat produktive për qëllime banimi.
- Zonat me pjerrësi më të madhe se 15 apo 20%.

1. Krite të kushtëzohen nga trashëgimia kulturore/historike;

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhet të evidentohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor (përkojnë me zonat e cituara në pjesën e vlerësimit të monumenteve kulturore, historike, kujtojmë via Egnatia, objekte historike në Kuturman, Polis, Babje, Spathar, etj.).

2. Krite të kushtëzohen nga prezenca dhe kërkesa për zhvillim të peisazhit

Bashkia Librazhd në shtrirjen e saj hapësinore ka vlera të larta dhe të shumta peisazhike të llojeve të ndryshme sikurse janë peisazhet e krijuara nga pyjet, malet, liqenet, livadhet, shtrirjet luginore, sipërfaqet malore apo kombinime të tyre. Kriteret peisazhike është shumë e vështirë të përcaktohen prandaj duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen vlerësuar në bashkëpunim dhe pajtueshmëri ndër-institucionale. Peisazhi duhet konsideruar si pasuri turistike dhe duhet të përbëjnë element të zhvillimit ekoturistik të Bashkisë. Për të mundësuar mbrotjen dhe zgjerimin e tyre zonat peisazhike duhet të trajtohen me kujdes duke minimizuar ndërhyrjen e faktorit antropogjen. Veprimtaria antropogjene më impaktuese e këtyre vlerave është shfrytëzimi minierar, shfrytëzimi i pyjeve, zjarret, hapja e karrierave, etj.

Si zona që duhen mirëmenaxhuar dhe ku duhen ndaluar ndërtimet (me përjashtime studimore të lidhura me përdorim materiale rrethore të lidhura me veprimtari ekoturistike) janë:

- Zona e parkut kombëtar Shebenik – Jabllonicë, zona e mbrojtur e Kuturmanit, Polisit, Dardhë-Zhyrë dhe zonat në studim për tu shpallur si të tilla apo në fashon e gjelbër tampon të tyre.;
- Livadhet dhe zonat kullosore;
- Peisazhet bujqësore që për një periudhë të caktuar të vitit përbëjnë element atraktiv;
- Malet e Shebenikut, Polisit, Letmit, Lugina e Shkumbinit (periferia lumore), etj.

3. Krite me kushtëzim inxhinierik dhe infrastrukturor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Relievi, topografia dhe gjeologjia e shtrijes së bashkisë Librazhd kërkon që paraprakisht për çdo ndërhyrje infrastrukturore të evidentohen zonat që paraqesin rrezikshmëri të lartë sizmologjike, mundësi rrëshiqcje, që nuk kanë strukturë të qëndrueshme dhe kompakte për shmangjen e një investimi të paqëndrueshëm dhe me kosto financiare. Ndërkohë që planifikimi urban duhet të marrë në konsideratë respektimin e distancave ndërtimore nga akset rrugore apo hekurudhore, ndërtimin e korsive për lëvizje me biçikletë, dhe në mënyrë të ngjashme duhen trajtuar ndërtimet e sistemeve të kolektorëve të ujrave të zeza dhe urbane. Sistemi i ujrave të bardha dhe të zeza të jetë evidentuar në sistemin GIS, duke mundësuar ndërhyrje për çdo të papritur të mundshme. Linja elektrike dhe telefonike të jetë e shënuar në sistemin GIS dhe çdo ndërtim duhet të respektoj distancën e kërkuar nga këto sisteme shërbimesh të përbashkëta komunitare.




Figura nr.13. Zonat me kushtëzim mjedisor Bashkia Librazhd

8. OBJEKTIVAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM – PËRFSHIRJA E OBJEKTIVAVE NË PLAN

Ky kapitull paraqet objektivat mjedisore e zhvillimit të qëndrueshëm të përcaktuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Analiza është mbështetur në përdorimin e dy dokumentave themelore që janë dokumentat europiane për objektivat përkatëse të politikës së Bashkimit European (BE), si dhe Strategjitë Mjedisore të qeverisë shqiptare mbi mjedisin. Duke qenë se vendi ynë aspiro për të qenë pjesëtar i familjes europiane Strategjitë mjedisore kombëtare, zhvillimet kombëtare si dhe legjislacioni përkatës janë tërësisht në harmoni dhe të drejtuara në drejtim të harmonizimit me politikën e BE. Duke patur parasysh qëllimin dhe kontekstin e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Librazhd, por dhe ligjet bashkëkohore të cilat plotësojnë më së mirë këtë kuadër përshkrues sikurse janë ligji 91/2013 “Për Vlerësimin strategjik Mjedisor”, ligjin 1040/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” si dhe ligjin 10431/2011 “Për Mbrotjen e Mjedisit”, materialet e paraqitura në këtë raport nuk janë të kufizuara vetëm në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare të mjedisit, por shtrihen edhe në fushën e planifikimit territorial.

8.1. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR

Qeveria shqiptare ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Kombëtare mbi Mjedisin në kuadër të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Po kështu është hartuar dhe miratuar një paketë e tërë ligjore mbi mjedisin tërësisht në përputhje me legjislacionin European dhe ndërkombëtar. Si ligje më të qënësishme që kanë të bëjnë me sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të hartuara dhe miratuara nga qeveria Shqiptare përmendim **ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin strategjik Mjedisor”, ligjin 1040/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”** si dhe **ligjin 10431/2011 “Për Mbrotjen e Mjedisit”**.

Në përputhje me aktet ligjore dhe kërkesat e qeverisë shqiptare në lidhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim janë paraparë masa ndërhyrëse për mundësimin e zhvillimit sa më të qëndrueshëm nga pikpamja mjedisore.

❖ Biodiversiteti.

Përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor dhe ka të bëjë me: *Mbrotjen dhe shtimin e biodiversitetit, të zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe me*

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

ruatjen e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet europiane dhe ndërkombëtare.

Mbrojtja dhe zhvillimi i biodiversitetit përbën një nga elementët më të qënësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm. Qeveria shqiptare që nga viti 1999 ka adaptuar Strategjinë dhe Planin e veprimit për Biodiversitetin (SPVB). SPVB është dokument që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat që duhen marrë lidhur me menaxhimin e biodiversitetit në Shqipëri, masa të pasqyruara dhe në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimi i ruatjes së biodiversitetit është:

- Përfaqësimi i të gjithave zonave të dallueshme natyrore në rrjetin e zonave të mbrojtura dhe në peisazhet e ruajtura;
- Mirëruatja e proceseve evolutive dhe ekologjike që mundësojnë një biodiversitet të qëndrueshëm;
- Ruatja e specieve e llojeve të qëndrueshme;
- Ruatja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore duke siguruar elasticitet në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe afatgjata;
- Përmirësimi i menaxhimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura ekzistuese duke u siguruar që objektivat e zonës janë përmbushur;
- Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura për të siguruar një mbulim të plotë të të gjithave habitateve;
- Përmirësimi dhe përshtatja e ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit;
- Përmirësimi i informacionit dhe i date baze për menaxhimin e biodiversitetit.

Numri i faktorëve dhe veprimtarive me impakt mbi biodiversitetin është shumë i madh, për pasoj dhe numri i masave të parapara dhe ndërmarrë për mbrojtjen dhe zhvillimin e tij është shumë i madh. Por tërësia e masave të ndërmarrë duhet që të kenë si qëllim përmbushjen e objektivave për mbrojtjen e biodiversitetit, të cilat nuk janë të mëvetësuar por të përfshirë në seksione të tjera të strategjisë ku bëjnë pjesë sikurse janë:

- Menaxhimi i burimeve ujore-lidhur me mënyrën e përdorimit dhe ndotjen ujore;
- Menaxhimi i shtretërve të lumenjëve- lidhur me mënyrën e shfrytëzimit;
- Menaxhimi i zonave peisazhore- lidhur me sipërfaqet kufizuese ujore apo hapësira tokësore;
- Planifikimi i kufizimit të përdorimit të tokës – lidhur me peisazhin;
- Menaxhimi i mbetjeve urbane – lidhur me menaxhimin e vendgrumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Prandaj për integrimin dhe konsiderimin e biodiversitetit si prioritet mjedisor në planet apo programet e zhvillimit territorial është e domosdoshme të merren disa masa:

- ❖ Forcimi i kuadrit ligjor për Mbrojtjen e mjedisit;
- ❖ Forcimi i menaxhimit të administratave të mbrotjes natyrore;
- ❖ Zhvillimi i Planeve të menaxhimit për të gjitha zonat e Mbrojtura;
- ❖ Rritja e menaxhimit të specieve të Mbrojtura;
- ❖ Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe specieve;
- ❖ Integrimi i Objektivave të Strategjisë së biodiversitetit dhe plani i veprimt në politikën e Shtetit;
- ❖ Monitorimi i Biodiversitetit dhe menaxhimi i database me të dhënat.

Mbi bazën e kërkesave të sipërcituara dhe të lidhura me Biodiversitetin në Janar të vitit 2016 u miratua **Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plan i saj i Veprimt**, e cila përbën mekanizmin kryesor të zbatimit të Konventës së Diversitetit Biologjik (KDB). Kjo përcakton hapat dhe veprimet që duhet të ndërmerren vendi për të realizuar objektivat e KDB për mbajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin. Në kuadër të kësaj Strategjië, përcaktohen objektiva/prioritete të përgjithshme dhe qëllimet përkatëse:

- Futja e konceptit dhe e nevojës për mbrojtje të biodiversitetit në politikat sektoriale përkatëse;
- Reduktimin/ ujlën e faktorëve që çënojnë biodiversitetin;
- Monitorimin e veprimeve që degradojnë biodiversitetin dhe ndikimet përkatëse;
- Promovimin e ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve;
- Sensibilizimin e opinionit publik, arsimim dhe informim;
- Sigurimi i një qasje për ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjeneruese;
- Rritje dhe përhapje e njohurive shkencore lidhur me biodiversitetin.

Për arritjen e objektivave, propozohen masa/veprime konkrete për një periudhë pesë vjeçare si dhe përcaktohen burimet e financimit.

Kuadri ligjor kombëtar i cili rregullon mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore përmban një numër të madh ligjesh dhe vendimesh, të cilat u hartuan dhe u miratuan kryesisht pas vitit 2001. Pas miratimit të ligjit nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit” u përcaktua kuadri bazë për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, bazuar në Konventën e Diversitetit Biologjik (CBD). Në vitin 2011 u miratuan katër ligje

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

mjedisore, më ndihmën teknike të Bashkimit Evropian dhe në kuadër të programit CARDS 2000- 2006. Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” përcakton parimet, rregullat dhe procedurat për të siguruar mbrojtjen e mjedisit. Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” synon parandalimin dhe trajtimin e degradimit mjedisor si dhe përcakton direktiva, organet dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve në mjedis. Në vitin 2013 u miratua ligji nr. 91, datë 28.2.2013 lidhur me Studimet Strategjike të Ndikimeve në Mjedis. Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për Trashëgiminë kulturore” i ndyshuar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006, ligjin nr. 9882, datë 28.2.2008, ligjin nr. 10137, datë 2009 dhe ligjin nr. 77, datë 2013 përbën kuadrin ligjor bazë që rregullon menaxhimin e trashëgimisë kulturore kombëtare. Identifikon elementët mbrojtës të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, të luajtshme dhe të paluajtshme. Gjithashtu, përcakton detyrat e institucioneve përgjegjëse dhe organeve qeverisëse, si dhe ndëshkimet në rast të shkatërimit të pasurisë kulturore.

❖ Menaxhimi i burimeve ujore

Ky objektivi ka të bëjë me mbrojtjen e të gjithave burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Së dyti ka të bëjë me sigurimin e ujit të pijshëm për të gjithë popullatën. Sektori i ujit është një nga elementët më të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor. Por kërkesat për një menaxhim të qëndrueshëm të trupit ujqor janë mjaft komplekse. Prandaj strategjia e adaptuar për sigurimin e ujit për zonat rurale dhe ato urbane si dhe për ujrat e ndotura urbane bazohet në:

- Implementimi në vazhdimësi të strategjive për ujrat urbane dhe rurale, me përmirësime të vazhdueshme brenda një afati të shkurtër kohor duke aplikuar projekte të ndryshme;
- Tranzicioni drejt zbatimit të projekteve të rrjeteve të furnizimit me ujë krahas implementimit të strategjive ekzistuese duke përfshirë futjen e fondit për mjedisin;
- Identifikimi në vazhdimësi i projekteve të nevojshme në përputhje me udhëzimet e rishikuaradhe me rritjen e mbështetjes teknike në mënyrë të veçantë në zonat rurale;
- Zbatimi i projekteve të rrjeteve të furnizimit.

Me rëndësi të veçantë është mbrojtja e ujrave nëntokësore nga ndotja por dhe nga mbi shfrytëzimi për çfarëdolloj qëllimi qoftë. Kjo kërkon:

- Instalimin e një baze ligjore sa më të plotë, që të mbështesë efikasitetin e përdorimit të ujrave nëntokësore;
- Përmirësimin e të dhënave në lidhje me përdorimin e ujrave nëntokësore duke mbështetur procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të shtretërve të lumenjëve;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- Ndërmarrja e veprimeve prioritare që mundësojnë mbrotjen e ujave nëntokësore nga ndotja dhe mbishfrytëzimi.
- Masat në lidhje me objektivat e strategjisë së burimeve ujore kanë të bëjnë me:
 - ✓ Sistemet efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit në sektorin e ujit;
 - ✓ Zbatimi i projekteve prioritare në sektorin e ujit të pijshëm dhe të ujave të zeza;
 - ✓ Zhvillimi i programeve afatgjatë të investimeve për ujrë të pijshëm dhe ujrë të zeza;
 - ✓ Reduktimi i ndotjes së ujave sipërfaqësore;
 - ✓ Mbrotja e ujave nëntokësore
 - ✓ Monitorimi i ujave.

❖ Mbrotja e tokës.

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me mbrotjen dhe përmirësimin e tokës me qëllim për ta bërë sa më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.

Cështjet për mbrotjen dhe menaxhimin e tokës kanë të bëjnë me: erozionin, ndotjen, lëndët organike, përmytjet, rrëshqitjet, zvogëlimi i biodiversitetit, tharjen, kripëzimin dhe kompaktësimin e saj.

Qëllimi është që:

- Reduktimi i nivelit të erozionit dhe dëmeve që shqërojnë atë;
- Mbajtja e tokës bujqësore në kushte të mira mjedisore dhe bujqësore;
- Reduktimi i ndotjes së tokës;
- Sigurimi i të dhënave për menaxhimin e tokës.

Arritja e këtyre qëllimeve është e lidhur me masa referuese të Strategjisë sipas seksioneve, kryesisht lidhur me cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve që ndikojnë në ndotjen e tokës.

Krijimi i mundësisë së aplikimit të Kodit të Bujqësisë së Mirë do të impaktoj pozitivisht mbrotjen e tokës nga erozioni.

❖ Cilësia e ajrit.

Ky objektivi ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së ajrit në mbarë Shqipërinë në përputhje me nivelet dhe standartet e BE dhe OBSH.

Objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i cilësisë së ajrit në mënyrë të veçantë në zonat urbane dhe përreth zonave industriale me qëllim mbrotjen e shëndetit të publikut, përputhjen me direktivat e BE, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të njohura në lidhje me cilësinë e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

ajrit dhe kontrollin e çlirimit të gazeve. Ky objektiv është i arritshëm duke ju referuar disa çështjeve sikurse:

- Shkarkimi i gazeve i lidhur me transportin dhe i kushtëzuar nga numri i automjeteve, lloji i lëndës djegëse, vjetërsia e mjeteve, mirëmbatja dhe cilësia e mjeteve si dhe alternativat e transportit. Por ndikim ka dhe cilësia e rrugëve të përdorura.
- Grimcat e pluhurit nga aktiviteti i ndërtimit dhe nga rrugët e pa asfaltura.
- Shkarkimi i gazeve me origjinë industriale i cili është aktualisht i limituar por rritja ekonomike, zhvillimi i industrisë dhe rritja e kërkesës për energji do të shtoj sasinë e gazeve që çlirohen.
- Shkarkimi i gazeve rritet dhe për shkak të djegjes së mbetjeve apo përdorimi i burimeve të ndryshme lëndësh djegëse për qëllime familjare.

Implementimi i legjislacionit europian në këtë fushë kërkon kohë, prandaj strategjia e adaptuar ka për qëllim:

- ❖ Ujlen e nivelit të çlirimit të gazeve nga burimet lëvizëse dhe ato fikse në nivelin e legjislacionit të BE;
- ❖ Përmirësimin e monitorimit për të siguruar informacionin e duhur për të mundësuar planet e menaxhimit të cilësisë së ajrit;
- ❖ Implementimi i sistemit të planifikimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit, i cili do të mundësoj në praktikë masat që mundësojnë arritjen e standarteve të BE mbi cilësinë e ajrit.

Objektivat e përgjithshëm mbi cilësinë kërkojnë:

- Monitorimin e cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE;
- Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga automjetet;
- Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga instalimet industriale;
- Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve të pluhurit nga aktiviteti ndërtimor;
- Reduktimi i emetimeve të pluhurit nga burime të tjera (rrugë të pa asfaltuara, zjarre, etj).

❖ Ndryshimet klimaterike.

Ky objektiv mjedisor ka të bëjë me reduktimin e gazeve të efektit serë dhe ato të hollimit të shtresës së ozonit duke kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimaterike.

Shkarkimet e gazeve serë janë të lidhura me disa aktivitete, por në në esencë kanë të bëjmë me reduktimin e shkarkimit të këtyre gazeve në ajër. Kjo kërkon trajtim të integruar ku përfshihet

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

qeverisja me strategjitë e saj për energjinë, ekonominë dhe transportet, industria e tregëtia si dhe individët që të aplikojnë veprime me efikasitet të energjisë. Kjo kërkon të ndërmerren disa masa që kanë të bëjnë me:

- Minimizimi i emetimit të gazeve me efekt serë;
- Menaxhimi dhe reduktimi i emetimeve të substancave që ndikojnë në shtresën e ozonit sipas dispozitave të Konventës së vjenës;
- Futjen e taksës së karbonit si e ardhur në fondin e Mjedisit;

❖ Menaxhimi i mbetjeve

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në mënyrë të tillë që të reduktohen rreziqet për shëndetin e publikut, mjedisin dhe tregëtinë për përputhje me kërkesat ligjore të BE. Megjithatë gjenerimi i mbetjeve në vendin tonë është nën nivelin mesatar me trend rritje, sistemi i grumbullimit, mënyra e menaxhimit, mënyra e depozitimit lënë shumë për të dëshiruar, pranda dhe impakti negativ mjedisor është i ndjeshëm. Masat në lidhje me përmbushjen e këtij objekti kanë të bëjnë me:

- Përcaktimin e praktikave më të mira të menaxhimit të mbetjeve për periudhë afatshkurtër;
- Sistemi i planifikimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;
- Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbetjeve;
- Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme;
- Plotësimi në vazhdimësi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;
- Rritja e ndërgjegjësimin për çështet e trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

❖ Ndotja akustike.

Përbën një nga objektivat strategjik mjedisor kombëtar që ka të bëjë me kontrollin e tyre me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të faunës dhe të sjelljeve biologjike të tyre. Niveli i zhurmave është shqetësues aktualisht. Kjo është e lidhur me gjendjen e automjeteve në përdorim, me struktura e ndërtesave, me teknologjitë e aplikuara, etj. kjo kërkon:

- Hartimin e aktit mbi nivelet e pranueshme të zhurmave urbane (automjete, trena);
 - Monitormi i zonave të ndjeshme akustike;
 - Kufizimi i zhurmave për pajisje të instaluar në mjedise të hapura;
 - Implementimi i ligjeve të Be në lidhje me zhurmat kryesisht i
- Direktivës 2000/14/CE e PE dhe e këshillit, amenduar nga direktiva 2005/88/CE, që përcakton kufirin e zhurmave dhe etiketimin e e një numri pajisjesh për përdorim të jashtëm;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Direktiva 1986/594 mbi zhurmat në ajër të pajisjeve shtëpiake;

Përmbushja e objektivës së ndotjes akustike ka të bëjë me:

- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat në ndërtimin e ndërtesave;
- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat me burim automjetet;
- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat me burim aktivitetet dhe bizneset.

8.2. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar.

Objektivat e zhvillimit kombëtar janë tërësisht në harmoni dhe zbatim të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm ndërkombëtar. Kjo synon arritjen e **Objektivave të zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**, të pranuar nga 189 vende në Konferencën e OKB ë vitin 2000, si dhe detyrat e përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (ËSSD) në Johannesburg. Ky samit ishte kurorëzim i Konferencës së Stokholmit mbi Mjedisin (1972) dhe konferencës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (1992). Ndërkohë që politikat europiane mjedisore udhëhiqen nga parimi i parandalimit dhe se ndotësi paguan duke siguruar instrumentat e duhur për zbatim efektiv. Si pjesë më të rëndësishme të politikave të BE mbi mjedisin konstatojmë:

- ❖ Plani i Veprimit Mjedisor 6-të, adaptuar nga vendimi 1600/2002.CE të Parlamentit Europian, Këshilli i Europës së 22 korrikut 2002, që është korniza bazë e politikave mjedisore të BE. Ky plan është përmbledhur në 7 tematika strategjike mjedisore:
 - Strategjia për mbrotjen e ajrit;
 - Strategjia për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin;
 - Strategjia për mbrojtjen dhe konservimin e ambjentit detar;
 - Strategjia për mbrojtjen e tokës;
 - Strategjia për përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve;
 - Strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve;
 - Strategjia për mjedisin urban.
- ❖ Politika e BE për ndryshimet klimaterike që synon stabilizimin e përqëndrimit të gazeve në atmosferë (reduktimi 20% deri në 2020, përfitimi deri 20% e nergjisë nga burime të rinovueshme- deri 2020, reduktimi i energjisë primare 20% - deri në 2020 nëpërmjet përmirësimit të efiçensës së energjisë).
- ❖ Strategjia e BE për Biodiversitetin duke ndërhyrë në:
 - Ruatjen e burimeve natyrore;
 - Bujqësi;
 - Peshkim;
 - Palitikat rajonale dhe planifikim hapësinor;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Pyjet;
- Energji dhe transport;
- Turizëm;
- Zhvillimi i ndihmës dhe bashkëpunimi ekonomik;
- ❖ Strategjia e BE për zhvillimin e qëndrueshëm, që përmban këto objektiva:
 - Mbrojtjen Mjedisore;
 - Drejtësi sociale dhe ndërveprim;
 - Prosperitet ekonomik;
 - Pranimin e përgjegjësive ndërkombëtare
- ❖ Karta e Laipzingut për qytetet e qëndrueshme europiane, që në zhvillimin e integruar urban të përfshihet publiku.

Objektivat kombëtare kryesore të Shqipërisë për pesëmbëdhjetë vjetet e ardhshme janë si më poshtë:

- Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të transportit për lidhjen e Shqipërisë me korridoret Paneuropiane të transportit.
- Zhvillimi i Shqipërisë si qendër infrastrukturash dhe energjie për të gjithë rajonin e Ballkanit.
- Promovimi i zhvillimit nëpërmjet një sistemi të zhvillimit urban policentrik dhe të decentralizuar.
- Promovimi dhe aksesueshmëria e zonave me mjedis të shquar natyror dhe peisazh, e kombinuar me menaxhimin inteligjent të burimeve natyrore dhe kulturore me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre në kuadër të zhvillimit dhe globalizimit. Shfrytëzimi i njëkohshëm i tyre nëpërmjet përmirësimit të aksesueshmërisë të tyre me qëllim zhvillimin ekonomik.
- Zhvillimi i sistemeve të transportit multimodal, miqësor ndaj mjedisit (transporti multimodal) për të mbështetur zhvillimin rural policentrik, së bashku me përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin ekonomik.
- Nxitja e burimeve të energjisë të rinovueshme në sektorin e energjisë.
- Dizajni dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara në fushën e komunikimit, transportit, bujqësisë dhe energjisë.
- Organizimi hierarkik, specializimi dhe grupimi funksional i qyteteve shqiptare.
- Urbanizimi dhe formalizimi i zonave informale të ndërtimit.

Këto objektiva kombëtare i shërbejnë vizionit të vendit për krijimin e një demokracie vibruese në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese. Pozicioni strategjik i Shqipërisë, favorizon pjesëmarrjen e vendit në një rrjet

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

ndërkombëtar të transportit rrugor, detar, intermodal dhe sot, është koha e duhur që Shqipëria të jetë pjesë e këtij rrjeti ndërkombëtar. Disa korridore të transportit multimodal të interesit Evropian, krijojnë një bazë për zhvillim në degen e transportit si një parametër i rëndësishëm.

Në të njëjtën kohë, kërkohet një përpjekje për të transformuar shoqërinë në shoqëri të të mësuarit dhe informacionit, përmes integritit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë vendin, përmirësimin e shërbimeve elektronike publike dhe krijimin e transparencës në qeverisjen e vendit. Për më tepër, nga pikpamja administrative, Shqipëria synon të forcojë qeverisjen lokale dhe decentralizimin, të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes në përputhje me parimet evropiane të vetëqeverisjes vendore dhe vlerat e modelit të Menaxhimit të Decentralizuar Evropian.

Në sektorin e mjedisit, qëllimi është zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik me mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi përmes menaxhimit të integruar dhe përmirësimin e vlerave mjedisore që kontribuojnë për prosperitetin ekonomik. Qëllimi është i bazuar në parimin e zhvillimit të integruar, mbrojtjen dhe rritjen e burimeve mjedisore, si dhe sigurimin e rritjes ekonomike dhe prosperitet social dhe kohezionit. Sot, zonat e mbrojtura në Shqipëri përbëjnë 15% të sipërfaqes së vendit dhe janë pjesë e Brezit të Gjellbër Evropian, por gjithsesi shumë zona të mbrojtura nuk janë të vizituara dhe nuk kontribuojnë financiarisht në vend. Gjithashtu, është e njohur që mjedisi është pjesë e pasurisë kombëtare dhe ndikohet si nga proceset natyrore edhe nga ndërhyrja e njeriut. Kështu, objektivat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit janë:

- Mbrojtja e zonave ekologjikisht të ndjeshme dhe siguri i një funksionimi të vazhdueshëm të mirë në të ardhmen;
- Krijimi i një sistemi informacioni për mbrojtjen e burimeve natyrore;
- Zhvillimi i rolit të burimeve mjedisore dhe natyrës në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të qendrave urbane, duke lidhur qytetet me zonat natyrore;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për të mbështetur zhvillimin ekonomik në të gjitha fushat, p.sh. bujqësi, pylltari, peshkim, gurore, energji, industri, shërbime, turizëm etj;
- Krijimi i rrjetit evropian Natura 2000 për mbrojtjen e zonave ekologjikisht të ndjeshme dhe ruajtjen e peisazheve të vlefshme natyrore;
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes dhe integrimi i planifikimit hapësinor në vend.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Zhvillimi rural ka nevojë për të promovuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë, me ndihmën e një kornize për të siguruar sektorin agro-ushqimor, inovativ dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionet e tregut dhe kriteret e cilësisë të Bashkimit Evropian. Rezultati do të jetë vende të reja pune, rritje ekonomike, kohezion social dhe mbrojtje e cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale. 40% e sipërfaqes së vendit përbëhet nga tokë bujqësore dhe gjysma e saj është e vendosur në pjesën perëndimore të vendit dhe në zonën bregdetare të saj. Pjesëmarrja e bujqësisë në Produktin Kombëtar Bruto është 20%, me 50% të punësuarve i përkasin veprimtaritë primare. Objektivi kryesor është përmirësimi i bilancit ushqimor të importeve - eksporteve, pasi eksportet janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, por balanca mbetet negative. Gjithashtu thelbësore është ripyllëzimi i zonave të degraduara dhe testimi i kulturave të reja fitimprurëse në zonat rurale, paralelisht me krijimin e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit rural- ekonomik. Reduktimi i kostove të prodhimit, investimeve në teknologji për zonat rurale, menaxhimi i ujit për ujitje dhe ndërtimi i infrastrukturës përkatëse, bashkëpunimi në sektorin e bujqësisë me sektorët e tjerë si p.sh. agroturizmi cilësor, futja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në aktivitetet rurale dhe krijimi i qendrave dhe poleve të prodhimit bujqësor, në varësi të karakteristikave të produkteve, janë faktorët kryesor për zhvillimin rural.

Qëllimi për turizmin parashikon njohjen e Shqipërisë si një destinacion tërheqës turistik në Evropë, autentik dhe mikpritës, bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe burimeve kulturore, të cilat do të jenë të përafuara në tregjet ndërkombëtare.

Për sektorin e energjisë, objektivi kryesor është pavarësia energjetike e Shqipërisë dhe zhvillimi i një ekonomie me karbon të ulët, me përdorimin e burimeve të energjisë të rinovueshme, futjen e teknologjive të reja në energjetikë dhe zhvillimi i kërkimeve përkatëse për këtë qëllim. Objektivat e politikës energjetike janë përdorimi i energjisë me 20% nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë, përmirësimi i efikasitetit të energjisë në masën 20% dhe duke reduktuar emetimet e CO₂ me 20%. Në të njëjtën kohë, është i domosdoshëm zhvillimi i mëtejshëm të hidrocentraleve, pasi Shqipëria ka burime të mjaftueshme të ujit, forcimi i rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe integrimi i tyre në planifikimin hapësinor, përdorimi i energjisë diellore dhe zhvillimi i fushave ekzistuese gjeotermale. Me rëndësi strategjike është edhe gazsjellesi që do të kalojë përmes Shqipërisë.

8.3. OBJEKTIVAT MJEDISORE, TREGUESIT DHE SYNIMET

VSM përdor në analizën e saj një kombinim të objektivave, treguesëve dhe synimeve për të parashikuar efektet si dhe për të përshkruar dhe monitoruar ndryshimin e planeve, programeve dhe projekteve të propozuara në fushën e mjedisit. Objektivat strategjikë Mjedisor dhe synimet përcaktojnë qëllimet dhe kufizimet të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë Vlerësimit të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Ndikimit në Mjedis të Planeve dhe Programeve të propozuara. Indikatorët na ndihmojnë në aspektin e monitorimit të VSM-së, ndërsa synimet e parashkruara në material na afrojnë synime reale dhe të arritshme për të cilat autoritet lokale mund të arrijnë të punojnë. Treguesit përdoren për të ilustruar dhe komunukuar efektin në një mënyrë sa më të thjeshtë dhe efektive. Treguesit mund të përdoren gjithashtu për të formuar bazën për monitorimin e programit të PPV.

Objektivat mjedisore sigurojnë një “qëllim” pikë referuese kundër të cilit efektet mjedisore të PPV mund të testohen. Ato duhet që të jenë përafërsisht të ngjashme me masat që janë paraparë në PPV ose që dalin nga objektivat që të ekzistojnë. Objektivat mjedisore në thelb kanë të bëjnë me parametra të tillë si Biodiversiteti, ndotja e tokës, ujit, ajrit, shkarkimet e CO₂ dhe gazeve të tjera, flora, fauna, zhurmat, mbrotja e trashëgimisë kulturore, etj.

Treguesit ofrojnë mjete për të matur progresin drejt arritjes së objektivave mjedisore me kalimin e kohës si niveli akustik i vlerësuar për një periudhë të caktuar kohore, kualiteti i trupave ujour (sipërfaqësore deh nëntokësore), sasia e CO₂ të shkarkuar, etj.

Qëllimet lidhen me gjendjen mjedisore të parametrave të vlerësuar të lidhura me objektivat dhe të shprehur në terma sasior ose cilësor. E rëndësishme është që treguesit që do të vlerësohen të jenë të matshëm dhe objektivat e përcaktuara sa më real, duke siguruar ekzistencën e rrjeteve të monitorimit për matjen e çdo treguesi ose të disponojnë mjete për ndërtim struktura të reja monitoruese.

8.4. OBJEKTIVAT MJEDISORE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË LIBRAZHD

Në përputhje me objektivat mjedisore ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe në referencë me objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor të hartuar nga grupi i konsulencës kemi përcaktura objektivat kryesore të VSM si dhe objektivat më specifike për cdo fushë mjedisore të lidhur me të pesë fushat e analizës së PPV, përkatësisht me sistemin e infrastrukturës (I), sistemin ujour (W). Sitemin Natyror (N), sistemin urban (U) dhe sistemin bujqësinë (A).

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
I . Biodiversiteti, peizazhi dhe shfrytëzimi i tokës	
I.1.	Mbrojtja, konservimi dhe shmangia e humbjeve të shumëllojshmërisë dhe të shtrirjes së habitateve, specieve dhe korridoreve të kafshëve të egra;
I.2.	Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve duke u bazuar në mjedisin e cilësisë së lartë për banim, të komunitetit, për punë dhe për rekreacion të bazuar në modelet e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës;
I.3	Mbrojtja e cilësisë së jetës së njerëzve duke iu shmangur rreziqeve ose faktorëve përkeqësues (pluhurit, zhurmës, erës) që dalin nga ekspozimi ndaj

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

	shfrytëzimeve/zhvillimeve të papajtueshme të tokës (miniera /nxjerrja e gurëve për zhavorr, etj);
I.4	Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore përfshirë mjedisin dhe ambientet e ndërtuara; arkeologjike, arkitektonike dhe tiparet e peizazhit të krijuara nga njeriu;
I.5	Mbrojtja e peizazheve dhe pamjeve piktoreske të caktuara, rrugëve , shtigjeve dhe tipareve të peizazhit me vlerë lokale;
I.6	Sigurimi i hapësirave të gjelbëruara për atraksion të thjeshtë apo për mundësi krijimi guidash ekoturistike;
I.7	Mbrojtja, përmirësimi dhe mbajtja e cilësisë së tokës si element bazik i diversifikimit dhe zhvillimit natyror të qëndrueshëm;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZH

II. Menaxhimi i mbetjeve

II.1.	Zgjerimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave të ngurta, përkrahja e opsioneve për trajtimin e qëndrueshëm të mbeturinave (ndarja, riciklimi, dërgimi në kontejner, etj);
II.2.	Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohet në pikat e grumbullimit nga vendndodhja nëpërmjet informimit mjedisor;
II.3	Identifikimi i ndotësve mjedisor, i “hot spot”-eve dhe krijimi i një sistemi multifunksional për menaxhimin e tyre;
II.4	Eliminimi i vendeve për hedhjen e mbeturinave në mënyrë kaotike dhe aplikimi i teknologjive Mjedisore;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZH

III. Mbrojtja e ujit dhe burime energjitike

III.1.	Mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së ekosistemeve ujore dhe, në lidhje me nevojat e tyre për ujë, të ekosistemeve tokësore që varen drejtpërdrejt nga ekosistemit ujor (cilësia, niveli, mënyra e rrjedhjes);
III.2.	Zvogëlimi i ndikimit të substancave ndotëse për të gjitha ujërat, të çfarëdolloj tipologjie por sidomos me impakt agrobujqësor e blektorial;
III.3	Parandalimi i ndotjes dhe infektimit të ujit tokësor nga aktivitete e pakontrolluara industriale, sanitare, urbane, bujqësore;
III.4	Mbajtja dhe përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet ndërhyrjes në rrjetin hidrografik;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

III.5	Përkrahja e mbrojtjes afatgjatë të burimeve të disponueshme të ujit përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit;
III.6	Përmirësimi i infrastrukturës për t'i plotësuar nevojat e ardhshme të furnizimit me ujë dhe standardet për pastrimin e ujërave të zeza;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
IV. Ndryshimi Infrastrukturor me impakt në klimës dhe efikasiteti i energjisë	
IV.1.	Zvogëlimi i të gjitha formave të ndotjes së ajrit dhe mbajtja/përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit.
IV.2.	Zvogëlimi i emetimeve të gazrave të serrës dhe kontribuimi në zvogëlimin dhe shmangien e ndryshimit të klimës të shkaktuar nga njeriu.
IV.3	Shtimi i mënyrave të qëndrueshme të transportit dhe sigurimi i lehtësisë së lëvizjes për të gjithë shfrytëzuesit e rrugës dhe përkrahja e modeleve të zhvillimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e sigurisë në rrugë.
IV.4	Zvogëlimi i humbjes së energjisë, përkrahja e shfrytëzimit të burimeve të energjisë së përtëritshme dhe përkrahja e nismave për ruajtjen e energjisë. Përkrahja e ruajtjes së energjisë në të gjithë sektorët. Përkrahja e zhvillimit të tregtisë dhe ndërtesave me karbon të ulët.
IV.5	Përkrahja e burimeve të shfrytëzueshme alternative të energjisë së rinovueshme dhe teknologjive efikase;
IV.6	Zvogëlimi i rrezikut nga aksidente të ndryshme ndaj njerëzve, pronës, faunës, florën, mjedisit tërësor;

8.5. Harmonizimi i objektivave të Mjedisore të VSM/kombëtare/ndërkombëtare me PPV

Një nga momentet më të rëndësishme të hartimit të raportit të VSM është përputhshmëria funksionale midis objektivave kombëtare e ndërkombëtare si dhe të VSM mbi mjedisin me objektivat e Planit të Përgjithshëm vendor (PPV). Sigurisht që zbatimi i PPV është i kushtëzuar nga efekte financiare, burime njerëzore dhe mënyra e implementimit, por përputhshmëria e objektivave jo gjithmonë është tërësisht e mundur për shkak të lidhura me nivelin e zhvillimit, sidoqoftë në rastet kur kjo nuk është e mundur plotësisht janë planifikuar në raportin e VSM aktivitete që e përafrojnë procesin me atë të BE-së. Grupi i punës për hartimin e PPV ka parashikuar objektiva specifike për çdo prioritet dhe njëkohësisht projekte konkrete që bëjnë të mundur realizimin e tyre, të cilët janë listuar më poshtë:

OBJEKTIVAT e PPV-së
BASHKIA LIBRAZHD -VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR 134

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Objektivi strategjik A: Zhvillimi social-ekonomik i infrastrukturës	
Objektivi - A1	Fuqizimi i infrastrukturës lidhëse, rivitalizimi i transportit intermodal;
Objektivi - A2	Promovimi i një sistemi inovativ dhe të larmishëm të prodhimit;
Objektivi - A3	Promovimin e territorit si një destinacion turistik;
Objektivi - A4	Përmirësimi i cilësisë të imazhit urban dhe territorit;
Objektivi - A5	Përmirësimi i shërbimeve për njeriun;

OBJEKTIVAT e PPV-së	
Objektivi strategjik B: Organizimi hapësinor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban.	
Objektivi - B1	Transformimi i territorit të Librazhdit, në një territor të integruar multipolar mes qyteteve dhe fshatrave;
Objektivi - B2	Promovimi i qytetit kompakt dhe përmirësimi i hapësirës publike;
Objektivi - B3	Ribalancimi funksional përmes promovimit të karakteristikave lokale;
Objektivi - B4	Përmirësim arkitektonik, i peizazhit dhe i mjedisit i qendrave dhe tokave bujqësore dhe natyrore;

OBJEKTIVAT e PPV-së	
Objektivi strategjik C: Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit.	
Objektivi- C1	Reduktimi i ndotjes së ujit;
Objektivi -C2	Reduktimi dhe menaxhimi i mbetjeve;
Objektivi -C3	Reduktimi i ndotjes së ajrit;
Objektivi -C4	Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës dhe Burimeve hidrogeologjike;
Objektivi- C5	Promovimi i efijencës së energjisë dhe ruajtjes së energjisë;
Objektivi- C6	Përmirësimi i mjedisit natyror;
Objektivi- C7	Rritja e tokës bujqësore;

Lidhja parashikuese ndërvepruese midis objektivave të përgjithshëm (3), lokale (16), specifike (29), projektet Strategjike (10) dhe projekteve të veprimtarive konkrete (47), të parapara në PPV dhe faktorëve të mjedisit të përfshirë në analizën e objektivave të VSM paraqitet nëpërmjet matricës së mëposhtme. Impakti mjedisor për secilën nga objektivat e PPV në mjedis nuk është i barabartë, por dhe projektet e parashikuara për realizime në konkretizim të objektivave nuk tregojnë të njëjtin impakt, çka pasqyrohet në mënyrën dhe vlerën e ndryshimit mjedisor të njehsuar si impakt i zbatimit të projektit në mjedis.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD




Figura nr. 14. Qyteti i Librazhdit dhe Lumi Shkumbin (R. Shkurti)

8.6. Veprimtaritë e propozuara në lidhje me objektivat dhe projektet strategjike të PPV-së dhe koherenca me objektivat e VSM-së.

Objektivat e PPV	Veprimtaritë e Propozuara	Koherenca me objektivat e VSM
A1; A4-5; B1; B4; C2; C6. A1; A4-5; B4; C2-3; C6. A1; A3-5; B1-B4; C2-3.	Sistemi Urban 1: Rikualifikimi i zones urbane te Librazhdit (projekt pilot) • Projektimi i qendrës urbane, i shërbimeve publike dhe private dhe i aksesit rrugor. • Organizimi i sheshit dhe rrjetit rrugor (lidhjet e brendshme dhe të jashtme me qendrën); • Identifikimi i rrugëve për aksesin dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe të hapësirës publike, duke forcuar dhe organizuar lidhjet mes sheshit pedonal, parkimeve, tregut, fushave sportive dhe zonës (muzeu etnografik). • Rregullimi i rrugëve dhe riorganizimi i shërbimeve publike dhe private (strukturimi i sheshit dhe rrjetit rrugor përreth). • Rikualifikimi i fasadave përgjatë rrugës për në qendër. • Përcaktimi i zonave të mbrojtura dhe heqjen e banesave të papajtueshme me kategorinë e zonës si edhe zhvendosjen e tyre në zona specifike ndërtimi. • Projektimi i fashos përgjate lumit dhe përcaktimi i shtigjeve, hapësirave publike dhe pajisjeve / mobiljeve urbane. • Konvertimi i zonës që aktualisht përdoret si fushë sportive, në një zonë park urban të gjelbëruar dhe zhvendosjen e njëkohëshme të fushës së sportit në një zonë të ngushtë pranë rrjedhes së ujit. • Krijimi i një zone pedonale që lidhet me zonat përreth dhe me rrugët hyrëse.	I2-3; II1; III.4-6; IV.1; IV.3; IV.6 I2-3; II1; III.4-6; IV.1; IV.3; IV.6 I2-7; II1-4; IV.1; IV3; IV6. I2-3; II1; III4-6; IV1; IV3; IV6. I2-3; II1; III4-6; IV.1; IV3; IV6 I4; 15; I6; 17; II2-4; III6; IV.6. I1-3; I6-7; II1-4; III1-2; III4-5; IV1-3; IV6. I2; I7; II1-4;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

A3-5; B1-3;	- Përcaktimi i një strukture urbane të aftë për të organizuar funksionet publike dhe private, dhe duke arritur që në të njëjtën kohë të përmbush funksionet ekzistuese dhe të së ardhmes duke e bërë të shfrytëzueshme qendrën e Librazhdit nëpërmjet krijimit të një vendi të njohur takimesh të karakterizuar me një identitet të fortë. - Realizimi i një projekti kompleks i risistemimit të zonave të zhvilluara përgjate lumit në të cilin parashikohet të eliminohen veprat e papërshtatshme dhe të sigurohen ndërtesat tashmë prezente, si edhe parashikimin për zhvendosjen e rezidencave në zona të përshtatshme për ndërtim, por edhe projektin për arredimin urban dhe përdorimin e brezit përgjate lumit.	IV1,3,6 I2-3; II2-3; III.2; III6; IV.3; IV.6
A1; A3-5; B1-4; C2-3.	Sistemi Urban 2: Rikualifikimi i identitetit dhe funksionalitetit të qendrave dhe fshatrave - Konsolidimi dhe forcimi i pranisë së shërbimeve në qendra, qendrave të mëdha në shërbime, duke përqëndruar shërbimet dhe strukturat e qytetarëve dhe duke krijuar vende takimi mr identitet; - Rritja e pranisë së fshatrave të njohura në këtë zonë, me kusht që në secilin prej tyre të ketë një hapësirë publike në zonën qendrore (vendi i takimit të njohur, shërbimet publike ose private);	I2-3; II2-3; IV.3; IV.6 I2-3; II2-3; III.2; III6; IV.3; IV.6
A1-5; B1; B3-4; C2-3;	Sistemi Urban 3: Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale - Organizimi, rikualifikimi dhe sistemimi i zonave prodhuese aktuale/ artizanale. - Parashikimi i zhvillimit të zonave të reja prodhuese dhe artizanale. - Ndërtimi i infrastrukturës/ impiantet e shërbimit, të aksesit dhe të ndërtimit/ rehabilitimit i ndërtesave dhe objekteve me funksion prodhues/ artizanal. - Brenda zonës ekzistuese artizanale por edhe në zonat e zhvilluara parashikohet vendosja e aktiviteteve të lidhura me punimet artizanale të gurit dhe të drurit.	I2-3; I5-7; II1-4; III2-3; IV1; IV3; IV6.
	Sistemi Urban 4: Riaktivizimi i sistemit prodhues të minierave ne lidhje me	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

A1; A5; B1; B4; C5-6. A2; A5; B3; B4; C3; C6.	prrenjasin • Organizimi, rikualifikimi dhe sistemimi i zonave minerare. • Parashikimi i zhvillimit të minerave (ekzistuese dhe në të ardhmen); • Ndërtimi i infrastrukturës/ impiantet e shërbimit dhe të aksesit. • Ndërtim / rehabilitim i strukturave në lidhje me funksionet e aktiviteteve minerare; • Mbrojtja e vlerave aktuale ekologjike dhe mjedisore si dhe ulja e nivelit të ndotjes.	I2-3; II1; II2-3; ; III.4-6; IV.1; IV.3I; IV.6 I1-3; I6-7; II1; II2-4; III.2-4; IV.1; IV.3I; IV.6
A1; A4-5; B1; B4; C2-4; C6 A1; A4-5; B1; B4; C2-4; C6	Sistemi Natyror 5: Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/ depozitimi/ perpunimi (trajtimi ne Elbasan) • Prezantimi i menaxhimit të integruar dhe të strukturuar të mbledhjes së mbeturinave. • Identifikimi dhe ndërtimi i një vendi për mbledhjen dhe konservimin e mbetjeve deri në pritjen për tu dorëzuar (për çdo njësi Administrative)	I2-3; II1-4; III1-6; IV1--6. I2-3; II1-4; III1-6; IV1-6.
A1; A5; A3-5; B1; B4; C2-6. A1; A5; A3-5; B1; B4; C1-6. A1; A5; A3-5; B1; B4; C2-6.	Sistemi Natyror 6: Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne vleresimin e pejsazhit natyror, historik dhe arkeologjik • Zhvillimi, rikualifikimi dhe krijimi i rrugëve të reja pedonale / shtigjeve per biçikleta per shfrytezimin e zonave malore (si per aksesin ne zonat malore edhe për lëvizjet në zonat me kuota të larta, por edhe për shfrytëzimin e brezit përgjate lumit); • Realizimi i rrugëve të integruara në brendësi të një sistemi që lidh Prrenjasin dhe Librazhdin, duke parashikuar linja ndërlidhjesh mes zonave natyrore të dy Bashkive. • Ndërtimi i pikave të informimit përgjatë rrjetit rrugor kombëtar për të njohur më mirë potencialet turistike; qendra te promovimit dhe informimit turistik (Librazhd/ Stabileve/ Parku Kombetar Shebenik-Jabllanice, Parku Natyror	I1-7; II3; II.4; IV1; IV3; IV6. I1-7; II3; II.4; IV1; IV3; IV6 I1-3;I5; I7; II1; II2-3; III.4-6; IV.1; IV.3I; IV.6 I1-3;I5; I7; II1; II2-3; III.4-6; IV.1; IV.3I; IV.6
A1; A5; A3-5;		

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

B1; B4; C2-6. A1; A5; A3-5; B1; B4; C2-6. A1; A5; A3-5; B1; B4; C2-6. A1; A5; A3-5; B1; B4; C2-6.	Kuturman-Qafë Bushi); • Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në funksion të aksesit të zonave malore. • Ndërtimi i një rrjeti teleferik që lidh Librazhdin (e banuar) me Prevalin. • Ndërtimi i një qendre me struktura turistike që sigurojnë akomodim dhe shërbime në Stablevë. • Ndërtimi dhe integrimi i burimeve mjedisore aktuale dhe lidhjeve të parashikuara në brendësi të sistemit të aksit të gjelbërt me ndërlidhjen kombëtare.	I1-3; I5-7; II1; II2-3; III1; III.4-6; IV.1-3; IV.6; I1-3; I5-7; II1; II2-3; III1; III.4-6; IV.1-3; IV.6;
A1-2; A4-5; B1; B3-4; C2-4; C6-7.	Sistemi bujqësor 7: Zhvillimi i një sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale • Përmirësimi i lidhjeve për të rritur funksionalitetin e aktiviteteve. • Rikualifikimi i strukturave aktuale dhe vendosja e stukturave të reja për mbarëshkrimin e blegtorisë. • Modernizimi i sektorit të blegtorisë dhe parashikimi i stallave fikse dhe tezgave të lira. • Ndërtimi i sistemit të infrastrukturës bujqësore të lidhur me metodat dhe funksionet bujqësore (serra, struktura fikse ose të lëvizshme, makineri, etj...) • Ndërtimi i infrastrukturës/ impiantet e shërbimit dhe të aksesit për në zonat bujqësore me shërbime të dobëta. • Prezantimi i masave dhe ndërhyrjeve me qellim afirmimin dhe konsolidimin e produkteve tipike lokale, krijimi i zinxhirëve të prodhimit vendor duke siguruar masa në varësi nga konteksti por edhe nga karakteristikat e peisazhit të zonës.	I1-3; I6-7; II1-4; III1-3; III6; IV1-6; IV5-6.
A1; A4-5; B1-B4; C1-7;	Sistemi Ujor 8: Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin • Prezantimi i masave kundër ndotjes dhe hedhjes së mbeturinave në rrjetin hidrografik. • Prezantimi i masave për rregullimin e veprimtarive ndotëse si nga sektori	I1-3; I7; II3; III1-

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

	prodhues edhe nga braktisja e mbeturinave. • Përcaktimi i vlerësimit mjedisor për strategjitë e zbatuara dhe veprimet. • Prezantimi i masave dhe udhëzimeve për të luftuar erozionin e lumit dhe për të siguruar zonat e ekspozuara ndaj rrezikut hidrogeologjik.	6; IV2; IV4; IV5; IV6.
A1; A2; A4-5; B1-4; C6-7.	Sistemi Infrastrukturor 9: Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor • Ndërtimi i një stacioni në afërsi të qendrës së Librazhdit me funksione të lidhura si me industrinë edhe me transportin e mallrave, por edhe me transportin e njerëzve. • Sistemi i rrjetit hekurudhor, modernizimi i tij.	I2; I7; IV1; IV2; IV3; IV6;
A1; A3-5; B1-4; C1-4; C6.	Sistemi Infrastrukturor 10: Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore: • Sistemi i rrjetit rrugor kryesor dhe sekondar përmes modernizimit të rrjetit (sigurimi, asfaltimi). • Fuqizimi dhe përmirësimi i rrjeteve dhe i rrugëve lidhëse mes qendrave të Bashkisë dhe qytetit fqinje. • Sistemi i rrjetit rrugor kryesor dhe sekondar duke krijuar një strukturë të aftë për të organizuar territorin përmes lidhjeve të brendshme të Bashkisë.	I2-3; II1; II2-3; III.4-6; IV.1; IV.3I; IV.6

8.7. VËSHIRËSITË E TAKUARA GJATË HARTIMIT TË VSM-SË

Vështirësitë e hasura nga Grupi Konsulent i VSM-së janë të lidhura me mungesën e disponueshmërisë së të dhënave dhe matjeve shkencore, mos disponibiliteti i informacioneve të kërkuara për realizimin e studimit për shkak se bashkia është e re në mënyrën e tashme të konceptimit dhe ka qenë në shumicën e kohës si pjesë funksionale e Elbasanit (qarku) dhe nuk përmban aktualisht tërësinë e informacionit të nevojshëm për realizimin e studimit. Njëkohësisht për shkaqe të lidhura me prezencën e pajisjeve teknologjike për zonën në studim nuk ka zbatime projektsh monitoruese gjithëpërfshirëse për problemet mjedisore, ç'ka na ka detyruar të përdorim metoda ekstrapoluese apo dhe konverguese për vlerësimin sa më të mirë të mundshme të gjendjes mjedisore aktuale. Fusha e monitorimit dhe mbrojtjes të mjedisit ka akoma shumë probleme, me gjithë hapat pozitive të ndërmarra në vitet e fundit drejt përmbushjes së standardeve të BE, siç është miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit. Matje shkencore të aspekteve bazë janë ende të pakta dhe jo të rregullta në kohë. Monitorimi kërkon një përpjekje të koordinuar dhe angazhimin e të dy palëve, në nivel kombëtar e lokal, në mënyrë që të mbajë të dhëna të besueshme dhe të qëndrojnë në bashkëpunim të vazhdueshëm. Procesi i zbatimit të VSM-së do të jetë një përpjekje kolektive që duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në etapa të rëndësishme, por edhe si pjesë e veprimeve rutinë të autoriteteve bashkiake. Ndërtimi i kapaciteteve lokale është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili është evidentuar qartë në zhvillimin e përgjegjësisë dhe që duhet konsideruar në zbatimin e PPV-së dhe të VSM-së. Trajnimi i administratës bashkiake në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të shoqërohet me angazhimin dhe investimet në pozicionet e tyre të punës. Teknologjia është gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm për monitorimin e VSM-së. Zbatimi i Planit në vetvete përmban një mjet shumë të vlefshëm, që është përditësimi i bazës së të dhënave të GIS, i cili mundëson

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

përditësimin e vazhdueshëm të ndryshimit të përdorimit të tokës dhe të procesit të zhvillimit.






Figura nr. 15. Pamje nga Qyteti, Mjedisi natyror, hidrik, alpin dhe historik i territorit të Bashkisë Librazhd (R. Shkurti)

9. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME MJEDISORE, PARASHIKIMI, VLERËSIMI DHE MASAT E DUHURA PËR TRAJTIMIN E TYRE

PPV është rezultante e evidentimit, vlerësimit dhe primarizimit të nevojave strategjike zhvillimore hapësinore dhe mjedisore të Bashkisë së Librazhd. PPV ka për qëllim që vizionin e saj mbi zhvillimin hapësinor të bashkisë ta materializoj nëpërmjet një plani të detajuar veprimesh në përputhje me objektivat dhe projektet kombëtare dhe lokale për Planin e Përgjithshëm Vendor. Sigurisht që realizimi i këtij PPV-je do të shoqërohet me një tërësi planesh zonale sipas specifika dhe vend implementimit të tyre të shoqëruara sipas rastit dhe kërkesave ligjore me VNM-në përkatëse.

Konstatohet se plani i Përgjithshëm Vendor është në tërësi në përputhje me objektivat dhe kërkesat e PPK, si dhe me objektivat e BE, kombëtare dhe vendore të VSM-së mbi mjedisin. PPV do të shërbej njëkohësisht si mundësi adresimi për probleme të zhvillimit dhe mjedisore në të ardhmen.

Zbatimi i PPV-së në bashkinë Librazhd do të shoqërohet me impakt mjedisor në tërësinë dhe për projekt strategjik apo veprimtari të parashikuar nga grupi i konsulentëve.

PPV në strukturën e saj ka marrë në konsideratë të gjithë faktorët mjedisor dhe ka trajtuar nëpërmjet konceptimeve hartuese objektivat kombëtare, europiane dhe të VSM-së për mjedisin.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Proçesi i vlerësimit është bazuar në një strukturë koreluese të matricës dhe metodologjisë së vlerësimit që ballafaqon, krahason, vlerëson, gjykon dhe propozon masa për trajtimin e impakteve mjedisore të PPV (objektivave të përgjithshme, objektivave specifik, projekteve strategjike dhe projekteve e veprimtarive konkrete), duke konfronduar 23 objektivat zhvillimore (pjesa analitike e 4 objektivave të VSM-së dhe 10 elementëve mjedisor të trajtuar në VSM) të VSM me objektivat, strategjitë e zhvillimit dhe projektet apo veprimtaritë e propozuara në PPV.

Së pari është bërë identifikimi i ndikimeve në mjedis të zbatimit të objektivave specifike të PPV-së për secilin nga komponentët mjedisor dhe pjesë e objektivave të VSM-së.


Së dyti është bërë parashikimi sipas indikatëve mjedisor të ndikimit në mjedis të PPV-së

Së treti është bërë vlerësimi analitik sipas treguesëve të impaktit mjedisor të secilit projekt strategjik në kontekstin e veprimtarive të planifikuara në kuadër të objektivave Strategjike.

Së katërti kemi afruar rrugë, sygjerime, masa për minimizimin deri në eliminim të ndikimeve në mjedis të implementimit të PPV-së.

Së fundi, sigurisht që kërkohen indikator dhe tregues që mundësojnë realizimin praktik të kërkesave të PPV-së dhe harmonizimin e tyre me objektivat dhe masat e parashikuara në VSM-së.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD



Elementët e mjedisit të trajtuar në kontekstin e objektivave të VSM-së dhe raporti i tyre me objektivat, planet dhe veprimtaritë e planifikuara në PPV-së – Bashkia LIBRAZHD.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

9.1. Matrica funksionale midis objektivave të PPV-së dhe elementëve përbërë të Mjedisor-BASHKIA LIBRAZHID

OBJEKTIVAT										
Toka	Ajri	Faktoret klimatike	Uji	Biodiversitet	Peizazhi	Trashëgimia kulturore	Mbetjet	Zhurma	Popullsia dhe asetet materiale	
Objektivi strategjik A: Zhvillimi social-ekonomik i infrastrukturës										
Objektivi specifik A1: Fuqizimi i infrastrukturës lidhëse, rivitalizimi i transportit intermodal dhe transportit publik lokal	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik A2: Promovimi i një sistemi inovativ dhe të larmishëm të prodhimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik A3: Promovimin e territorit si një destinacion turistik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik A4: Përmirësimi i cilësisë të imazhit urban dhe territorit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik A5: Përmirësimi i shërbimeve për njeriun	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi strategjik B: Organizimi hapësor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban.										
Objektivi specifik B1: Transformimi i territorit të Librazhd, në një territor të integruar multipolar mes qyteteve dhe fshatrave	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik B2: Promovimi i qytetit kompakt dhe përmirësimi i hapësirës publike	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik B3: Ribalancimi funksional përmes promovimit të karakteristikave lokale	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik B4: Përmirësim arkitektonik, i peizazhit dhe i mjedisit i qendrave dhe tokave bujqësore dhe natyrore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi strategjik C: Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit.										
Objektivi specifik C1: Reduktimi i ndotjes së ujit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

[illegible][illegible]

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

[illegible]

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID




Tabela nr. 16. Efektet mjedisore të zbatimit të Planit të përgjithshëm Vendor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Nëpërmjet analizës së bashkëveprimit të zbatimit të objektivave të PPV-së dhe ndërveprimit të tyre mbi faktorët mjedisor të marrë në analizë në kuadër të konfirmimit të realizimit të objektivave të VSM-së, impakti parashikohet të jetë nga ndikim i papërfillshëm – minimal - negativ – i mirë – shumë i mirë. Mundësia për të shkaktuar ndikime negative mjedisore është shumë e pakët dhe kushtëzuar nga zbatimi i tërësisë së masave të propozuara në VSM për minimizimin e impakteve negative mjedisore. Analiza mjedisore evidenton parashikimin e mundshëm, por zbatimi konkret i çdo aktiviteti ka potencialisht impaktin e tij që në mënyrën e vlerësimit të ndikimit mjedisor shprehet si element i pasigurisë teorike.

Në matricën e mëposhtme paraqitet korelacioni ndërveprues midis objektivave specifike të PPV-së sipas projekteve strategjike dhe planeve të veprimtarive të parashikuara për të realizuar me faktorët mjedisor të përfshirë në strukturën e objektivave të VSM-së.

Konstatohet se PPV-ja në pjesën dërmuese të veprimtarive të parashikuara shoqërohen me përmirësime të konsiderueshme të faktorëve mjedisor, madje rreziku i impaktit negativ është minimal, gati inekzistent. Masat e parashikuara për trajtimin e ndikimeve do të bëjnë të mundur që impakti negativ apo minimal i PPV në mjedis të reduktohen deri në eliminim, çka është e lidhur me procesin e monitorimit nga personat apo autoritetet e përcaktuara nga ligji.

Zbatimi i PPV-së në Bashkinë Librazhd dhe impakti mjedisor konform kërkesave të parashikuara në objektivat e VSM-së për secilin faktor mjedisor mund të ketë shkallë të ndryshme ndikimi, me kohëzgjatje të ndryshme, me mundësi rikthimi ose jo me mundësi ndërveprimi dhe veprimi ndërkufitar meqënëse bashkia ka kufi shtetëror, etj. Kjo pasqyrohet nëpërmjet simbolikave të mëposhtme.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

KARAKTERISTIKA TË NDIKIMIT	SIMBOLE	SHPJEGIME
Probabiliteti i ndikimit	√√	Shumë i mundur
	√	I mundur
	0	Asnjë mundësi
Shkalla e ndikimit	++	Shumë pozitiv
	+	Pozitiv
	0	Asnjajës
	-	Negative
	--	Shumë negative
Kohëzgjatja	>>	Afatgjatë/përhershëm/ i qëndrueshëm
	>	Afatshkurtër/rastësor
	0	Pa ndikim
Reversibiliteti	IR	Të pakthyeshme
	RK	Kthim i kushtëzuar
	R	Të kthyeshme
Ndikimi ndërkufitar	NK	Ndikime të mundshme kufitare
	JNK	Asnjë mundësi ndikimi kufitar
Pasiguria	?	Ndikimi i kushtëzuar nga zbatimi i PPV
Sekuenca	P	Ndikime parësore
	S	Ndikime sekondare
Ndërveprimi	A	Ndikim akumulues/grumbullues
	S	Ndikim sinergjik
	0	Asnjë ndikim me parametrat e tjerë

Tabela nr. 17. Simbolet për shprehjen e impakteve mjedisore

9.2. PARAQITJA ANALITIKE E NDIKIMEVE MJEDISORE TË PPV

Projektet e parashikuara në kuadër të secilit prioritet të zhvillimit të PPV padyshim kanë ndikimin e tyre në mjedis. Për këtë qëllim po paraqesim në mënyrë analitike por dhe në formë të matricave korelacionin dhe ndërveprimin e secilit të projekt të PPV të paraparë në studimin e grupit të punës me secilin prej faktorëve mjedisor përbërës të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, konform kërkesave të përcaktuara në ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin strategjik Mjedisor”

1. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me përmirësimin dhe forcimi i infrastrukturës ka të bëjë me:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- a. Tokën, pasi pasi infrastruktura të tilla si hekurudha, rrugët, etj zënë sipërfaqe të konsiderueshme dhe përshkojnë mjedise mjaft sensibil, ndërkohë që këkojnë sipërfaqe me karakteristika gjeomorfologjike dhe gjeomekanike që nuk rrezikohen nga erozioni, përmbytjet dhe rreziqet e tjera natyrore;
 - b. Ajrin, pasi mjetet e transportit konsumojnë energji dhe njëkohësisht emetojnë ndotës atmosferikë;
 - c. Faktorët klimaterikë, për shkak të lidhjes së saj me ajrin dhe ndotësit atmosferikë duke kontrubuar në ndotjen e atmosferës dhe shfaqjen e fenomenit të njohur “serë”;
 - d. Biodiversitetin, pasi infrastruktura e transportit pozicionohet në sipërfaqe bujqësore, pyjore, peisazhore, duke përshkruar ekosisteme natyrore me impakt në biodiversitet, florë dhe faunë;
 - e. Peisazhin, pasi infrastruktura drenazon tërësinë e sipërfaqeve të diversifikuara të mjedisit natyror dhe urban;
 - f. Trashëgiminë kulturore dhe historike, pasi ndërtimi i infrastrukturës do të mund ti ofroj këtë objekte me turistët për shkak të aksesueshmërisë që do të krijohet;
 - g. Popullsinë dhe asetet e tjera, pasi infrastruktura do të kontriboj në zhvillimin ekonomik të zonës, rajonit dhe më gjerë. Kjo do të mundësoj investime private dhe shtetërore, do të minimizoj fenomenin e migrimit dhe do të mund të evidentohet pritshmëria në rritje ndaj aseteve të pranishme dhe të prekshme.
 - h. Ujrat dhe mbetjet megjithëse nuk kanë një kohezion të drejtëpërdrejtë me infrastrukturën mënyra e konceptimit dhe realizimit do të mund që pjesërisht të krijojnë një impakt të tërthortë pozitiv, sidomos në drejtim të mbetjeve dhe kjo indirekt në cilësinë e ujrave.
2. **Realizimi i projekteve që janë të lidhura me konceptin e përdorimit të tokës** kanë të bëjnë me faktin se toka është një mjet që ka të bëjë me vlerësimet e ardhshme të ndikimeve nga aplikimi i prioriteteve të PPV-së, por në të njëjtën kohë mënyra e konceptimit, shfrytëzimit, organizimit, raporti i kulturave nga pikpamja gjenetike, pedologjike, e suksesioneve dhe përfitime, përpunimi tyre do të impaktojnë direkt ose në mënyrë të tërthortë mjaft faktorë të mjedisit.
3. **Realizimi i projekteve që janë të lidhura me promovimin e aspekteve të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike** ka të bëjë me:
- a. Me ajrin për shkak të rritjes së lëvizshmërisë dhe vizitueshmërisë së këtyre objekteve, ç’ka do të rritë fluksin e mjeteve të transportit qoftë publik dhe privat. Përdorimi i mjeteve të transporti do të shoqërohet me çlirim ndotësish si pasoj e konsumit të energjisë dhe shkaktojnë ndotje të atmosferës;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- b. Me zhurmat për shkak të rritjes së lëvizshmërisë së mjeteve të transportit dhe të njerëzve pritet tendencë rritje të saj;
 - c. Peisazhin, pasi çdo ndërhyrje e propozuar në lidhje me rivitalizimin e monumenteve të kulturës dhe të natyrës do të shoqërohet me përmirësime të konsiderueshme estetike dhe përfituese;
 - d. Trashëgimia kulturore parashikohet të ketë trend rritje pasi plani përmban koncepte rizhvillimi, ruatje dhe përdorimi me përfitim social, kulturor dhe ekonomik;
 - e. Popullsia dhe asetet, pasi ky zhvillim do të mund të krijoj akses në biznesin profesional dhe në mundësitë e komunitetit lokal, përmirësimin e zhvillimit të ekonomisë lokale, në përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë dhe si rrjedhim në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Zhvillimi i këtij prioriteti do të mund të frenoj fenomenin e migrimit duke ndikuar në shpërndrjen e popullsisë në sipërfaqen territoriale të bashkisë;
 - f. Toka, faktorët klimaterikë, ujra, biodiversitet dhe mbetje, impakti i këtij zhvillimi nuk është i lexueshëm direkt por me një korelacion të indirekt, por jo sinjifikativ për vlerësim ndjeshmërie dhe impakti mjedisor.
- 4. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me turizmit natyror, kulturor, historik, arkeologjik dhe të gjitha format alternative të tij kanë të bëjnë me:**
- a. Tokën, pasi ajo përbën mjedisin pritës fizik të ideimit dhe zhvillimit të çdo aktiviteti, por ndjeshmëria më e madhe është në lidhje me mjediset bujqësore dhe veprimtaritë e propozuara në to apo për shfrytëzimin e promovimin e aseteve të tyre;
 - b. Ajrin, pasi promovimi i aktiviteteve të tilla do të shoqërohet me shtim të lëvizshmërisë së mjeteve të motorizuara dhe të njerëzve duke ndikuar në emetimin e ndotësve të tij. Përdormi i formave alternative të lëvizjes të propozuara nga plani do të impaktoj ndjeshëm në mënyrë pozitive këto aktiviteti ndërkohë që përfitimi komunitar dhe promovues do të jetë shumë pozitiv;
 - c. Ujrat, pasi shtimi i aktiveve do të sjell si pasoj shtimin e kërkesës për ujë e cila do të kërkoj një mirëmenaxhim të tyre dhe rezultatja është ndikimi mbi shfrytëzueshmërinë e ujrave sipërfaqësore;
 - d. Zhurmat, pasi shtimi i qarkullimit të mjeteve dhe të turistëve do të pasohet me efekt akumulues në zhurma me impakt në biodiversitet dhe komunitetin përkatës;
 - e. Trashëgimin kulturore, pasi kjo të bëhet pjesë integrale e krijimit të fluiditetit dhe aksesueshmërisë multipotenciale të vizitorëve;
 - f. Popullsia dhe asetet e saj, pasi do të mund të ndikoj drejtëpërsëdrejti në përfitimet ekonomike, në standartet e jetesës, në mënyrën e qëndrueshmërisë hapësinore të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- popullsisë, krijimin e vendeve të punës dhe mundësi punësimi për të rinjtë e arsimuar dhe profesional.
- g. Biodiversitetin, pasi do të krijon rrugë komunikuese dhe asete të tjera të domosdoshme që do të shoqërohen me ndërhyrje në mjediset përkatëse, por që do të varet dhe mënyra e mirëmenaxhimit të tyre gjatë zbatimit konkret;
 - h. Faktorët klimaterikë ky prioritet nuk mund të përcaktohen direkt si impakt mjedisor;
 - i. Mbetjet, pasi shtimi dhe zgjerimi i këtyre veprimtarive promovuese, prodhuese, përfituese do të gjeneroj mbetje më me shumicë dhe impakti do të jetë prezent, por që nga mënyra e mirëmenaxhimit do të varen pasojat;
 - j. Peisazhin, pasi do të realizohen ndërhyrje të drejtëpërdrejta në mjedis, por që do të kushtëzohen nga përqsja mjedisore në strukturë, përbërje dhe imitacion.
- 5. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me mbledhjen dhe logjistikën e sektorit agroushqimor ka të bëjë me:**
- a. Ujin, pasi do të pasohet me shtim të kërkesave për të ç'ka do të kërkoj mirëmenaxhim të tij.
 - b. Mbetjet, pasi shtimi i tyre dhe shpërndarja e tyre hapësinore padyshim do të gjeneroj më shumë mbetje dhe kjo do të kërkoj masa strikte për mirëmenaxhimin kohor dhe hapësinor të tyre;
 - c. Zhurma, pasi shtim veprimtarie shoqërohen në mënyrë automatike me gjenerim shtesë të zhurmave. Kjo do të kërkoj instalime dhe konstruksione të paraparë me efekte mbrojtëse ndaj efektin të pranishëm të shtimit në impaktit të zhurmave në mjedis;
 - d. Trashëgiminë kulturore dhe historike, pasi përbëjnë pjesë të potencialit turistik të bashkisë dhe do të shoqërohet me nevoja të shërbimeve shtesë;
 - e. Popullsinë dhe asetet e saj, pasi do të shoqërohet me shtim të përfitime financiare, mundësi punësimi dhe përmirësim të standartit të jetesës. Kjo do të mundësoj frenimin e fenomenit të migrimit dhe krijim mundësishë punësimi për të rinjtë e arsimuar dhe profesional;
 - f. Tokën, ajrin, biodiversitetin, peisazhi, përcaktimi i impaktit nuk mund të jetë i drejtëpërdrejtë dhe duhet vlerësuar sipas rastit të implementimit të çdo veprimtarie të propozuar.
- 6. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me prodhimin ka të bëjë me:**
- a. Tokën, sepse është marrësi primar i ndotjes nga kulturat bujqësore, ndërkohë që përmbën bazën e zhvillimit të kultivimeve;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHË

- b. Ujin, sepse është faktori bazë i zhvillimit të bujqësisë. Në këtë mënyrë ky prioritet do të mund të impaktoj direkt cilësinë dhe sasinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Por për shkak të mënyrës së zhvillimit të kulturave bujqësore burimet ujore përbëjnë marrësin kryesor të ndotësve të aktivitetit bujqësor, të mbetjeve nga pesticidet dhe plehurat kimike;
 - c. Mbetjet, sepse me grumbullimin në burim të mbetjeve të ngurta organike por dhe konsumatore do të mund të kompostohen dhe të përdoren në tokat bujqësore për pasurimin e tyre me lëndë organike;
 - d. Peisazhin, sepse do të mund të ndryshohet pamja nga kultivimi i kulturave bujqësore njëvjeçare apo dhe shumë vjeçare të ndryshme, por dhe sistemi i vreshtarisë, pemtarisë dhe serave të shumta sipas zonave që mundësojnë zhvillimin e këtyre formave të bujqësisë;
 - e. Popullsinë dhe asetet e saj, sepse do të mund të krijonte mundësi punësimi, përfitimi financiar, rritje të rendimentit në saj të aplikimit të teknologjive bashkëkohore në makineri, sistemin e vaditjes, maturimit, etj;
 - f. Ajër, sepse do të mund të shtohet ndjeshëm sipërfaqja e gjelbër, pra sipërfaqja adsorbuese, dhe pasuruese me oksigjen;
 - g. Faktorët klimaterikë, sepse do të krijohen kushte tërësore në regjimin e erës, intesitetin e dritës, lagështinë ajrore, etj që do të përmirësoj ndjeshëm mjedisin tërësor.
 - h. Biodiversiteti nuk do të mund të ketë një impakt të drejtëpërdrejtë nga ky zhvillim, por indirekt do të mund të krijoj habitate komunikuese me impakt të minimizuar;
 - i. Trashëgiminë kulturore dhe zhurma nuk është e mundur të përcaktoktohet impakti i drejtëpërdrejtë në faktorët mjedisor.
- 7. Realizimi i projekteve të lidhura me mbrotjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore ka të bëjë me:**
- a. Tokën, sepse ajo përbën burimin burimin natyror që shfrytëzohet për implementimin e projekteve të parapara në PPV;
 - b. Biodiversitetin, sepse ai ka të bëjë me cilësinë dhe sasinë e burimeve natyrore të aksesueshme në përputhje me prioritetet dhe projektet e PPV;
 - c. Mbetjet, sepse mënyra e menaxhimit të tyre ka dhe do të ketë pasoja në burimet natyrore, ndërkohë që menaxhimi dhe mënyra e realizimit të saj do të mund të gjeneroj mbetje sikurse është rasti i shfrytëzimit të minierave;
 - d. Peisazhin, sepse ka të bëjë me shfrytëzimin e tij qoftë për kullota deri në mbishfrytëzim apo prerjet masive të pyjeve dhe të pakontrolluara, duke impaktuar morfologjinë,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

hidrografinë si dhe biodiversitetin. Në këtë mënyrë prioritet e parapara dhe projektet e mundshme mundësojnë përmirësim dhe mirëtrajtim të peisazhit të zonës;

- e. Popullsinë dhe asetet e saj, sepse ka të bëj me faktin e të qenurit burim përfitimi ekonomik. Kjo parashikon sipas projekteve që burimet natyrore të mund të jetë të aksesueshme në çdo moment dhe të mos krijohen vështirësi në ekzistencën kohore dhe hapësinore të tyre.
- f. Në lidhje me ajrin, faktorët klimaterikë, ujrat, zhurmat dhe trashëgiminë kulturore nuk është e mundur të vendoset një korelacion i drejtëpërdrejtë midis prioritetit dhe faktorëve të mjedisit.

8. Realizimi i projekteve të lidhura me shfrytëzimin dhe menaxhimi i burimeve ujore lumore apo përpunuese ka të bëj me:

- a. Tokën, sepse mirëmenaxhimi i ujit ndër vaditje, krijimi i mundësisë për mbulimit tërësor të sipërfaqeve të kultivuara dhe teknika e vaditjes ka të bëj me ruatjen dhe mirëmbajtjen e tokës;
- b. Ujin, sepse është faktor me rëndësi i mjedisit, me përdorime të shumëfishta dhe me kërkesa në rritje çka kërkon mirëmenaxhim total;
- c. Biodiversitetin, sepse ekzistenca kohore e burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore ka mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, i cili në kushtet e ndërhyrjes antropogjene për qëllime të ndryshme do të mund të krijonte impakt mbi biodiversitetin. Ndërtimi i pritave, rezervuareve, devijimet ujore, etj., do të mund të impaktojnë në mënyrë të ndjeshme gjendjen e biodiversitetit;
- d. Peisazhin në saj të ndërtimeve për ruatje, trasmetim, devijim, shfrytëzim, etj.
- e. Popullsinë dhe asetet e tyre, sepse ka të bëj me rritjen e rendimentit, krijimin e efekteve financiare të drejtëpërdrejta, zhvillimin e kulturave dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Pra ka impakt të drejtëpërdrejtë pozitiv në mirëqënie dhe mundësi në rritje punësimi me impakt në demografinë e zonës;
- f. Në lidhje me ajrin, zhurmat, faktorët klimaterikë dhe trashëgiminë kulturore nuk është e mundur të vendoset një korelacion i drejtëpërdrejtë midis prioritetit të propozuar dhe faktorëve të mjedisit.

9. Realizimi i projekteve që bazohen në konceptin strategjik të shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ka të bëj me:

- a. Tokën, sepse përbën substratin mbi të cilin do të mund të instalohen të gjitha veprimtaritë apo element të tyre të energjisë së rinovueshme, ku impakti më i ndjeshëm i konstatuar por që do të vazhdojë të jetë prezent është ai i digave apo devijimeve për HEC;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

- b. Ajrin, sepse ka të bëj me reduktimin e shkarkimeve nga burime energjie të fosilizuara dhe zëvendësimin me burime të pastra energjie të rinovueshme. Pra me impakt tërësisht pozitiv në faktorët mjedisor të ajrit;
- c. Faktorët klimaterikë, sepse impakti në ajër pasqyrohet indirekt në cilësinë e faktorëve klimaterikë;
- d. Ujin, sepse shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme ka të bëjë më së shumti me shfrytëzimin e burimeve sipërfaqësore ujore, duke impaktuar regjimin hidrik të tyre;
- e. Biodiversitetin, sepse impaktohen cilësisht nga ana sasiore faktorët që mbështesin cilësinë e biodiversitetit sikurse është toka, uji, etj;
- f. Zhurmat, sepse ka të bëj me natyrën e impianteve të shfrytëzimit të energjisë së rinovueshme dhe raporti me element të mjedisit sikurse është fauna dhe komuniteti;
- g. Popullsinë dhe asetet e tyre do të mund të impaktohen pozitivisht për shkak të gjenerimit të vazhdueshëm kohor, minimizimit të ndotjes, leverdishmërisë ekonomike, etj. Burimet e rinovueshme të energjisë mund të jetë individuale dhe kolektive duke krijuar akses në përmirësimin e nivelit të mirëqënies dhe pa impakt akumulues në tërësinë e faktorëve mjedisor (bëhet fjalë për panelat diellor);
- h. Peisazhin, sepse çdo vepër e energjisë së rinovueshme do të kërkoj ndërhyrje në mjedis duke ndryshuar peisazhin;
- i. Mbetjet dhe trashëgiminë kulturore impakti i këtij zhvillimi në faktorët mjedisor nuk është i koreluar, por kërkon analizë sipas rastit dhe raportit hapsinor ekzistent.

10. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me përmirësimin e rrjetit urban në qendrat urbane dhe zonat e tjera të banuara ka të bëjë me:

- a. Tokën, sepse është treguesi marrës i çfarëdolloj tipologjie funksionale sikurse është marrja e ujit, sistemi i kanalizimeve, sistemi i qarkullimit të ujrave të zeza, por ndërkohë është dhe tregues i gjendjes së pakontrolluar të mbetjeve të lëngëta, kur rrjetet e përfitimit të përbashkët nuk funksionojnë, janë të amortizuar apo akoma më keq kur nuk ekzistojnë;
- b. Ajrin, sepse ka të bëj me praktikën jo efektive të menaxhimit të mbetjeve, djegjen e mundshme dhe të pakontrolluara apo dhe depozitime sipërfaqësore ekspozuese;
- c. Ujin, sepse ka të bëj me ekonomizimin e tij në rrjetet e furnizimit, mbrotjen e burimeve ujore natyrore dhe mos kantaminimin nga ujra e zeza të pakontrolluara;
- d. Biodiversitetin, sepse mund të impaktohet nga ndërtimi i rrjetit të infrastrukturës urbane ku në disa raste shmangen sistemet urbanike të planifikuara;
- e. Mbetjet, sepse ka të bëj me mirëmenaxhimin e tyre (qoftë të ngurta apo të lëngëta) nëpërmjet sistemeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit, ripërdorimit, kompostimit,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

landfillit përkatësisht për mbetjet e ngurta dhe trajtimit e përpunimit aerobiologjik për mbetjet e lëngëta;

- f. Në lidhje me faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore, peisazhin dhe zhurmat ky prioritet nuk mundëson gjetjen e një korelacioni direkt, por të vlerësuar si me impakt indirekt nga veprimtarisë akumuluese të përmbatjes së zbatimit praktik të projekteve të parashikuara në PPV.

11. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me planifikimin urban, rrjetin urban (furnizimi me ujë, kanalizime, energji, menaxhim mbetje, etj) dhe rikualifikimin e zonave të caktuara apo njësive administrative ka të bëjë me:

- a. Tokën, sepse përbën substratin e realizimit të ndërhyrjeve, përmirësimeve dhe zhvillimeve në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban;
- b. Ajrin, sepse ndërhyrjet në sistemin urban konsistojnë ndër të tjera në përmirësime apo investime të energjisë së ndërtesave, reforma dhe ndërhyrje qarkulluese, pra të lidhur drejtëpërdrejtë si veprimtari me faktorët e mbrotjes së mjedisit apo direkt të ajrit nga elementët ndotës me burime të gjenerueshme;
- c. Faktorët klimaterikë për shkak të lidhjes së drejtëpërdrejtë me ajrin si përbërës primar i tyre;
- d. Ujin, sepse lidhet me kërkesat e konsumatorëve, kërkesën në rritje për shkak të shtimit të zonave të gjelbëruara urbane, etj;
- e. Zhurmat, sepse implementimi i projekteve të parapara ka të bëjë me qarkullimin e mjeteve, ndërtime, përdorim toke, ndërhyrje urbane, etj., me pasojë në zhurma;
- f. Popullsinë dhe asetet e saj, sepse ka të bëjë me përmirësimin e ndjeshëm të kushteve të jetesës brenda zonë urbane, me zhvillimet demografike dhe krijimin e aksesave komunitare brenda qytetit apo zonave të banuara. Ndërkohë ky planifikim mundëson përmirësimin e ndjeshëm të rezervës ndërtimore që përbën elementin pasuror të banorëve të bashkisë;
- g. Trashëgiminë kulturore dhe historike, sepse çdo ndërhyrje në sistemin urban do të ketë impakt mbi këta element që janë të pranishëm në hapësirën e territorit të planifikuar për ndërveprim urban;
- h. Peisazhin, sepse çdo ndërhyrje urbane do të krijoj një peisazh të modifikuar tërësisht me impakt pozitiv mjedisor;
- i. Biodiversiteti dhe mbetjet megjithëse nuk vendosin një korelacion të drejtëpërdrejtë me zhvillimin urban, si faktor mjedisor përfitojnë element të zhvillimit të qëndrueshëm.

12. Realizimi i projekteve të lidhura me sistemin e transportit publik ka të bëjë me:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- a. Ajrin, sepse ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme të dhënat e qarkullimit, dmth., ngarkesa në qarkullim, mënyra e lëvizjes, akset e shfrytëzueshme duke ndikuar direkt në cilësinë e ajrit në saj të gazeve që emetojnë mjetet motorike;
- b. Faktorët klimaterike si rezultat i korelacionit të ajrit i impaktuar nga qarkullimi i mjeteve të motorizuara;
- c. Zhurmat, sepse janë të lidhura direkt me qarkullimin dhe transportin ku në projektet e propozuara prioritet i jepet transportit alternativ nëpërmjet përdorimit të biçikletave dhe planifikimit nëpërmjet projekteve të PPV të rrugëve për qarkullimin e tyre. Në këtë mënyrë ky projekt i paraparë në PPV bëhet faktor me impakt të ndjeshëm mjedisor me efekt pozitiv;
- d. Trashëgimë kulturore dhe historike, sepse transporti dhe qarkullimi krijojnë aksesin e duhur për qarkullimin dhe lëvishmërinë pranë këtyre objekteve të cilësuara dhe që përbëjnë pasurinë materiale të Bashkisë dhe njësive vendore;
- e. Popullsinë dhe asetet e saj, sepse përmirësimi i transportit publik do të mund të ndikoj direkt në lehtësimin e qarkullimit publik, si dhe në përdorimin në transport të teknologjive efikente me mjedisin, pra me ndotje minimale, si pasuri materiale për Bashkinë dhe banorët e njësisë vendore;
- f. Peisazhin, pasi çdo ndërhyrje në rrjetin rrugor që ka të bëjë me akset kryesore, sekondare, rurale, asfaltimet, etj do të pasqyrohet direkt në përmirësimin e cilësisë së peisazhit;
- g. Në lidhje me tokën, ujin, biodiversitetin dhe mbetjet nuk mund të përcaktohet impakti i drejtëpërdrejtë por si veprimtari me sens zhvillimimi, reduktimi ndotje, ofrimi shërbimi cilësor dhe bashkëkohor krijojnë impakt indirekt pozitiv në faktorët mjedisor të sipërcituar.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Karakateristikat e ndikimeve të parashikuara për secilin nga përbërësit e planit të zhvillimit Territorial dhe për secilën nga objektivat e PPV-së për Bashkinë Librazhd paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në terren	Karakteristika të ndikimit të parashikuara					
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca Ndërprejimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	R	JNK	P S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	✓✓	+	>>	R	JNK	P S
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	✓✓	++	>>	R	JNK	P S
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	✓✓	-	>>	IR	JNK	P A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	✓✓	+	>>	RK	JNK	P S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	✓✓	++	>>	R	NK/JNK	P S
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	✓✓	++	>>	R	NK	P S
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	✓✓	++	>>	R	JNK	P S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	✓✓	-/+	>>	RK	JNK	P S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore	✓✓	+/-	>>	R	JNK	P S
01.U – Rihvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	R	JNK	P S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritët të ndikojnë në ajër	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rihzhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	A
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	A
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	✓	+	>>	R	JNK	P	A
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	✓	-	>>	R	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	✓✓	+	>>	R	JNK	P	S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	✓✓	-/+	>>	RK	NK	P	A
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe të trajnimit të prodhuesve në zonat rurale	✓✓	++	>>	RK	JNK	P	S
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik të lumit Shkumbin	✓✓	++	>>	RK	JNK	P	S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	A
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	A
01.U – Rihzhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	A

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në faktorët klimaterikë	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	<<	R	JNK	p	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	V	+	<<	IR	JNK	p	S
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	V	-	<<	IR	JNK	p	S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	V	+	<<	R	JNK	p	A
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	V	+	<<	IR	NK	p	A
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	V	+	<<	R	JNK	p	S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore	V	+	<<	R	JNK	p	A
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	<<	R	JNK	p	A

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në ujra	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	<<	R	JNK	p	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	++	<<	R	JNK	p	S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	VV	++	>>	R/IR	JNK	P	S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	++	>>	R	JNK	P	S
06.N – Projekti i zhvillimit te turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	++	>>	R/IR	NK	P	O
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	++	>>	R	JNK	S	A
08.W– Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	VV	++	>>	R	JNK	P	S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	++	>>	R	JNK	P	A

Karakteristika të ndikimit të parashikuara							
Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në Biodiversitet	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi	Sekuenca	Ndëveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	<<	RK	JNK	S	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit te qendrave dhe fshatrave	V	+/-	>>	IR	JNK	S	O
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	V	+/-	>>	IR	JNK	S	O
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	V	+/-	>>	IR	JNK	S	O
06.N – Projekti i zhvillimit te turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	+	>>	R	NK	S	O
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	VV	+	>>		JNK	S	O
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	+/-	>>	IR	JNK	S	O
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	RK	JNK	S	S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në mbetje	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuena	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	A
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	R	JNK	P	A
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me Preenjasin	VV	+	>>	R	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	P	A
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	-	>>	R	JNK	P	C
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	++	>>	RK	JNK	P	S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	-	>>	R	JNK	P	C
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	+	>>	RK	JNK	P	A
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	A

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në Zhurma/Ndryshime akustike	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuena	Ndërveprimi

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	O
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	R	JNK	P	O
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	VV	+	>>	R	JNK	P	O
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	P	C
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	+	>>	R	NK	P	O
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	V	+	>	R	JNK	P	C
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	+	>>	R	JNK	P	C
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	+	>>	R	JNK	P	C

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në peisazh	Karakteristika të ndikimit të parashikuara							
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi	
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	++	<<	RK	JNK	P	A	
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	++	<<	RK	JNK	P	A	
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	VV	+	<<	RK	JNK	P	A	
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	<<	RK	JNK	P	A	
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	++	>>	RK	NK/ JNK	P	A	
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	+	>>	RK	JNK	S	C	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	V	+	>>	RK	JNK	P	A
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	V	+	>>	RK	JNK	P	A
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	V	+	>>	IR	JNK	P	A

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në trashëgiminë kulturore	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	>>	IR	JNK	P	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit te qendrave dhe fshatrave	V	++	>	R	JNK	P	S
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	V	++	>>	IR	JNK	P	S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	V	++	>>	RK	JNK	P	S
06.N – Projekti i zhvillimit te turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te peisazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	V	++	>	RK	JNK	P	S

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në popullsi dhe asetet aktive	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	>>	RK	JNK	P	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit te qendrave dhe fshatrave	V	+	>>	RK	JNK	P	S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	✓	+	>>	R	JNK	P	A
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me Prenjasin	✓	-	>>	R	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	✓✓	+	>>	R	JNK	S	S
06.N – Projekti i zhvillimit te turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	✓✓	-/+	>>	RK	NK/ JNK	P	A
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	✓	+	>>	RK	JNK	S	S
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	✓	+	>>	RK	JNK	S	
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	✓✓	+	>>	RK	JNK	S	A
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (ruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	✓	+	>>	RK	JNK	S	A
01.U – Rihvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	RK	JNK	P	S

9.3. PARASHIKIME TË NDIKIMEVE MJEDISORE TË PPV-SË

VSM si strukturë komplekse dhe vlerësuese kërkon dhe përmban krahas njohjes së ndikimeve në mjedis edhe parashikimin e ndikimeve mjedisore, që përbën atë fazë të studimit që ka të bëjë me Vlerësimin e Ndikimeve pozitive ose/dhe negative të prioriteteve të planifikuara në PPV dhe që parashikohet të zbatohen nëpërmjet projekteve konkrete të materializuara sipas fushave dhe veprimtarive praktike. Vlerësimi i projekteve në raport me impaktin mjedisor ka të bëjë me anën sasiore, cilësore, kohëzgjatjen, intesitetin dhe pasojat apo përfitimet e mundshme. Parashikimi i ndikimeve realizohet për secilin faktor mjedisor sipas kërkesave të parashikuara në ligjin 91/2013 **“Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”**.

Kështu që:

1. **Përmirësimi dhe forcimi i infrastrukturës** do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:
 - a. Toka do të duhet ti nënshtrohet presionit në rritje të përdorimit për infrastrukturë. Sipërfaqe të konsiderueshme toke do të duhet të mbulohen me asfalt nga zgjerimi i sistemit të transportit, apo sipërfaqe tjetër do të duhet të tjetërsohet për shtrim traseje. Kjo do të ketë si pasoj reduktimin e sipërfaqes përthithëse të tokës, çka do të rrisë fenomene atmosferike sikurse erozioni në zona akumuluese, përmbytje, etj. Ndërkohë për të respektuar standartet e ndërtimit duhet të sigurohet drenazhim i mirë i zonës për mirëfunksionim të saj në aspektin diakronik pra të përmirësimit të infrastrukturës së transporti kombëtar e ndërkombëtar por dhe të përmirësimit të aftësisë përthithëse të tokës. Përpos efekteve pozitive ky implementim do të pasohet me pasoja të lehta negative.
 - b. Përmirësimi dhe zhvillimi i transportit nëpërmjet Bashkisë do të kërkoj rritje të lëvizjes së qarkullimit rrugor, respektivisht do të rriten dhe lëvizjet ajrore. Kjo do të shoqërohet me shtim përdorimi karburanti që në kushtet aktuale të cilësisë së tyre do të mund të rrisë shkallën e ndotjes atmosferike. Kjo kërkon si masë përmirësimin e cilësisë së karburantit, kontrollin e vazhduar të tyre dhe të gjendjes teknike të mjeteve motorike, të futjes në qarkullim të mjeteve të reja dhe të përdorimit të formave efikase të transportit.
 - c. Ndikimi në gjendjen e faktorëve klimaterik do të jetë në funksion të prezencës së ndotësve atmosferikë. Duke marrë masat e propozuara në lidhje me mundësitë e shkarkimeve atmosferike ndikimi në këta faktor do të jetë pozitiv me trend rritje. Por ndryshimi në faktorët klimaterikë është i lidhur dhe me trendin e menaxhimit të burimeve ndotëse në rang ndërkombëtar.
 - d. Pjesa ekzistuese por dhe ajo ndërhyrëse është konceptuar që të shmang maksimalisht çdo impakt negativ në biodiversitet, kryesisht në zonat e mbrojtura, por teknologjitë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- zbatuese sidomos në rastin e hekurudhave nuk mund ti mënjanojnë plotësisht duke gjeneruar një ndikim negativ minimal. Praktikisht në zonat e ideura për zhvillime të tilla nuk ekziston kontakti me zonat e mbrojtura apo me status duke mos gjeneruar asnjë impakt negativ.
- e. Mënyra e ndërhyrjeve në mjedis padyshim që do të ndikojnë në peisazh, por shkalla e ndërtimeve, arkitektura e tyre e gjykojmë si jo impakt negativ peisazhor.
 - f. Në lidhje me popullsisë dhe asetet e saj këtë prioritet zhvillimi e konsiderojmë tërësisht pozitiv për shkak të aksesueshmërisë dhe mundësive ekonomike që mund të krijohen.
- 2. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me konceptin e përdorimit të tokës të shoqëruara me ndryshime destinacioni sipas rastit të propozuar, duke përjashtuar instalimin e projekteve të urbanizimit në ish zonën industriale (për shkak të ndotjes së akumuluar e cila kërkon trajtim specifik lidhur me deminimin fiziko-kimik dhe më pas me mbulimin me dhera dhe gjelbërimi), përpos faktit të tjetërsimit që mund të krijojnë një stres sipërfaqësor minimal në tërësinë e veprimtarive të propozuara krijojnë impakt asnjajës.**
- 3. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me promovimin e aspekteve të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:**
- a. Krijimi i mundësive për akses më të madh për vizitueshmërinë e monumenteve të kulturës, historike, arkeologjike dhe të natyrës si sinergji funksionale do të mund të krijoj shtim të qarkullimit të mjeteve motorike dhe të njerëzve duke impaktuar direkt faktorët mjedisor nëpërmjet ndotësve atmosferikë që çlirohen. Duke patur në konsideratë gjendjen aktuale të mjeteve motorike pritet që në fazën fillestare të kemi një përkeqësim të lehtë të faktorëve mjedisor por që me marrjen e masave të propozuara efektet do të jenë pozitive.
 - b. Zhurmat si rezultat i shtimit të qarkullimit do të mund të akumulohen duke prodhuar një impakt mjedisor lehtësisht negativ. Por në kuadër të masave të propozuara dhe projekteve të parashikuara në lidhje me format e transportit minimizohet ndjeshëm si efekt negativ mjedisor.
 - c. Si rezultat i ndërhyrjeve të mundshme për restaurime dhe ripërdorime peisazhi do të ketë impakt të konsiderueshëm pozitiv.
 - d. Trashëgimia kulturore padyshim do të ketë impaktin më të ndjeshëm pozitiv si rezultat i ndërhyrjeve restauruese, mirëmbajtëse por dhe lëvizshmërisë së njerëzve apo turistëve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- e. Në popullsi dhe asetet e saj ky prioritet shoqërohet me impakt pozitiv për shkak të krijimit të mundësive për përfitime ekonomike, punësim, shfrytëzim të aseteve lokale të traditës, etj.
 - f. Në lidhje me tokën, ujin, faktorët klimaterikë, biodiversitetin dhe mbetjet ky prioritet vlerësohet si me impakt asnjajës.
- 4. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me turizmit natyror, kulturor, historik, arkeologjik dhe të gjitha format alternative të tij do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:**
- a. Veprimtaritë praktike në kuadër të prioritetit të propozuar parashikohet që në kenë impakt pozitiv në tokë.
 - b. Në lidhje me ajrin impakti është variabël midis pozitives dhe negatives në varësi të tipogjisë së aktivitetit dhe përqëndrimit kohor e hapësinor.
 - c. Zhvillime të tilla do të shoqërohen padyshim me shtim të ndjeshëm të kërkesës për ujë. Kështu që fillimisht pritet një impakt mjedisor në faktorin ujë të jetë i përkeqësuar. Por marrja në konsideratë e masave të parapara në prioritetin e menaxhimit të ujrave tërësore dhe sidomos sipërfaqësore do të minimizoj ndjeshëm këtë impakt mjedisor.
 - d. Veprimtari të tilla do të krijojnë fluks njerëzor duke gjeneruar mbetje me tipologji të ndryshme. Kjo do të shoqërohet me impakt negativ mjedisor në faktorin mbetje. Por marrja e masave të parapara në menaxhimin e mbetjeve si në grumbullimi, selektim, ripërdorim, riciklim, përpunim do të minimizonte këtë impakt duke e bërë lehtësisht negativ për mjedisin e bashkisë, por gjithësesi do të jetë kurdoherë me karakter lokal.
 - e. Trashëgimia kulturore dhe historike për shkak të cilësive njohëse që ofrojnë do të impaktohet pozitivisht nga projektet e propozuara.
 - f. Në popullsi dhe aset e saj projektet e propozuara në kuadër të prioritetëve përkatëse përbëjnë mundësi përmirësimi ekonomik, përmirësim të performancës profesionale, përmirësim të nivelit të jetesës dhe përpasoj të gjendjes ekonomike. Në këtë pikpamje vlerësohet tërësisht pozitiv.
- 5. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me mbjedhjen dhe logjistikën e sektorit agroushqimor do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:**
- a. Shtimi i aktiviteteve të tilla do të mund të kërkoj shtim të konsumit të ujit duke ndryshuar balancën e përdorimit dhe sasinë e shfrytëzueshme të tij duke përbër për mjedisin faktor me impakt negativ mjedisor. Por realizimi i veprimtarive të parapara në prioritetet e shfrytëzimit të regjimit hidrik, në përmirësimin e rrjetit të tubacioneve, në

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- mirëmenaxhimin e ujit, etj., impakti minimizohet në mënyrë të ndjeshme dhe impakti negativ i këtij prioriteti bëhet i shkallës së papërfillshme.
- b. Natyra dhe madhësia e aktiviteteve të tilla do të gjenerojnë padyshim më shumë mbetje duke e bërë si prioritet me impakt negativ në faktorin përkatës mjedisor. Por masat e propozuara në projektet përkatëse me ngritjen e pikave selektive të grumbullimit, dërgimit në kohë në destinacione, etj do ta bëj këtë veprimtari me shkallë minimale impakti në faktorin përkatës mjedisor. Pra impakti negativ i faktorit mjedisor mbetje është prezent dhe minimal.
 - c. Në zhvillime të tilla zhurmat do të jenë prezente, por lokale dhe me impakt minimal si pasojë e kësaj veprimtarie të propozuar.
 - d. Zhvillime të tilla në faktorin mjedisor popullsi dhe asete të tyre shoqërohet me impakt tërësisht pozitiv për shkak të mundësisë së punësimit, gjenerimit të të ardhurave, forcimit të ekonomisë, përmirësimit të nivelit të jetesës, ruartjen e shpërndarjes demografike si dhe krijim dhe promovim në treg të aseteve lokale e krahinore.
 - e. Për sa i përket tokës, ajrit, faktorëve klimaterik, biodiversitetit dhe peisazhit impakti i veprimtarive të propozuara në kuadër të prioriteti përkatës vlerësohen si neutral.
- 6. Realizimi i projekteve që përmbajnë zhvillimin e veprimtarive të lidhura me prodhimin** do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:
- a. Toka do të impaktohen negativisht nga maksimalizimi i prodhimit bujqësor agrar, vreshtari, pemtari, etj si dhe nga fuqizimi i sektorit parësor lidhur me intesifikimin e përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve. Por nëse ky zhvillim do të harmonizohet me masat agrokimike në lidhje me kohën sasisë, mënyrën e përdorimit, impakti në faktorin tokë minimizohet ndjeshëm, madje ndikimi do të jetë pozitiv sepse përdorimi i praktikave më të mira bujqësore alternuar me sistemin e vaditjes, të kullimit dhe infrastrukturën e duhur krijon zhvillim të ekonomisë bujqësore në korelacion me faktorin mjedisor tokë. Kjo është rezultat i mundësisë për kompostim në kohë dhe në vendet e duhura të mbetjeve organike të gjeneruara duke prodhuar ushqim organik për tokën.
 - b. Mekanizimi i bujqësisë dhe fuqizimi i sektorit primar do të shoqërohet me impakt negativ në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore për shkak të rritjes së kërkesës për ujë por dhe mundësisë së kontaminimit nga plehurat, pesticidet, vajrat e ndryshme, etj., fakti se uji i konsumuar në sektorin parësor është në përqindje maksimale dhe ndërkohë që uji është jetik, konstatojmë prezencën e rrezikut në nivelet maksimale pamvarësisht masave të propozuara dhe bashkërendimit me prioritet e tjera të planifikuara në PPV.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- c. Në lidhje me gjenerimin e mbetjeve si faktor mjedisor veprimtaritë e propozuara vlerësohen si me impakt pozitiv sepse:
 - hedhja e pakontrolluar e mbetjeve do të minimizohet si rezultat i shfrytëzimit maksimal të tokës bujqësore;
 - duke zbatuar një plan mirëmenaxhimi, grumbullimi dhe kompostimi do të mund të prodhohen plehra organike që ndikojnë pozitivisht në cilësinë e tokës;
 - me krijimin e mundësisë së mirëmenaxhimit të ujrave të zeza nëpërmjet trajtimit dhe përpunimit të tyre do të mund të sigurohet burim plehërimi nga llumi të cilësisë shumë të mirë duke shfrytëzuar dekompozuesit e tokës. Pra impakti vlerësohet tërësisht pozitiv.
 - d. Zgjerimi dhe larmishmëria e kulturave bujqësore do të mund të ndikoj ndjeshëm pozitivisht në peisazhin si faktor mjedisor. Por shfrytëzimi tërësor i tokave bujqësore do të mund të eliminoj hedhjen sporadike të mbetjeve duke koreluar në mënyrë pozitive me faktorin mjedisor mbetje.
 - e. Në lidhje me popullsinë dhe asetet e tyre ky prioritet impakton këto faktor mjedisor ndjeshëm në mënyrë pozitive për shkak të mundësisë së punësimit, gjenerimit të ardhurave, përmirësimit të cilësisë së jetesë dhe krijimit të aksesit zhvillimor në sektorin parësor sikurse magazinat, depot, serat, njësitë përpunuese, etj.
 - f. Në lidhje me ajrin, faktorët klimaterike, biodiversitetin, zhurmat dhe trashëgiminë kulturore në mënyrën e propozuar nga PPV-ja impakti mjedisor në faktorët e sipërcituar vlerësohet neutral, por në sinergji funksionale krijojnë impakt pozitiv.
- 7. Realizimi i projekteve të lidhura me mbrotjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore** do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:
- a. Tokën pozitivisht, sepse përbën burimin natyror.
 - b. Biodiversitetin, sepse shtimi i sipërfaqe pyjore (**planifikimi i shtimit të pyjeve në zonat e demtuar, në zonat e reja kryesisht ish toka bujqësore të braktisura dhe të kthyer në djerrina si dhe masivimi i lultimit të geshtenjave**) do të mund të ndikoj ndjeshëm në zhvillimin e faunës. Pra do ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e biodiversitetit.
 - c. Mbetjet duke ndikuar sipas mënyrës së menaxhimit, pasi menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore do të ketë ndikim pozitiv në mbetje duke zvogëluar vëllimin e mbetjeve, por kompostimi dhe riciklimi do të mund të mbrojnë burimet natyrore duke përmirësuar impaktin e faktorit mjedisor.
 - d. Peisazhin, të lidhur me mënyrën e shfrytëzimit të burimeve natyrore (pyjeve, burimeve nëntokësore, hidrike, etj) duke ndikuar në gjeomorfologjinë, hidrografinë e mjedisit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH D

Qëllimi është ruatja dhe përmirësimi i peisazhit duke risistemuar çdo ndërhyrje me impakt në peisazhin natyror.

- e. Popullsinë dhe asetet e saj, pasi burimet natyrore përbëjnë mundësi përfitimi ekonomik, punësimi, përmirësimi të cilësisë së jetës. Në këtë mënyrë impakti është pozitiv.

8. Realizimi i projekteve të lidhura me mbrotjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:

- a. Tokë, duke mundësuar sigurimin e mbulimit të sipërfaqes së mbjellë me sistem vaditje dhe shoqëruar me impakt pozitiv.
- b. Biodiversitet duke siguruar mundësi zhvillimi të faunës dhe florës qoftë në sistemet ujore dinamike dhe statike me impakt pozitiv. **Kjo kërkon ndalimin e shfrytëzimit maksimal të burimeve ujore nga veprat hidrike ekzistuese si dhe shmangja e shfrytëzimit të tyre në zonat me status ku gjendja është ndjeshme e përkeqësuar.**
- c. Peisazhit me impakt pozitiv në saj të projekteve infrastrukturore të lidhura me numrin dhe gjendjen e rezervuarëve apo sistemeve të tubacioneve, duke krijuar një pamje piktoreske.
- d. Popullsinë dhe asetet e saj në saj të mundësisë së zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me pasoj impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe të mirëqënies njerëzore.
- e. Në ajër, faktorë klimaterik, mbetje, zhurma dhe trashëgiminë kulturore e historike nuk mund të vlerësohet impakti i drejtëpërdrejtë por i koreluar si veprim përmirësues i elementëve gjenerues të secilit faktor mjedisor.

9. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të bujqësisë do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:

- a. Tokë, rezulton të jetë pozitiv pasi ka të bëjë me mbrotjen e tokës nga erozioni, fenomeni i përmytjes dhe mbishfrytëzimi arbitrar.
- b. Ujin, rezulton të jetë pozitiv pasi ka të bëjë me shfrytëzimin racional duke mënjanuar mundësinë e përmytjeve, por njëheraz sigurohen kapacitetet e kërkuara për mbulimin e nevojave për vaditje. Ky impakt pozitiv në ujrat sipërfaqësore si rezultat i teknologjisë së vaditjes impakton pozitivisht edhe ujrat nëntokësore (infiltrimi).
- c. Mbetjet, rezulton se sektori i bujqësisë sasinë e tyre të ngarkoj negativisht. Por duke zbatuar kërkesat e lidhura me objektivat e mbrotjes së mjedisit të lidhura me menaxhimin e tyre, trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta nëpërmjet sistemeve

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

të depurinimit dhe impianteve përkatëse përfitohen produkte të shfrytëzueshme dhe me zvogëlim të gjenerimit të mbetjeve, duke evidentuar impakt pozitiv.

- d. Peisazhin, rezulton të jetë pozitiv sepse lidhet me mbrotjen e tokave të kultivuara nga deponime të pakotrolluara të mbetjeve, eliminohen fenomene natyrore të lidhura me erozion apo përmbytje, sistemohet qarkullimi i ujrave të shfrytëzueshme pa krijuar pika qëndrimi jo estetike, etj., duke krijuar një peisazh atraktiv dhe me vlera pozitive.
- e. Popullsinë dhe asetet e saj krijojnë impakt tërësisht pozitiv sepse lidhet me zhvillimin e prodhimit, shtimin e të ardhurave, mundësi punësimi dhe përmirësim të cilësisë së jetesës. Për bashkinë përbën një nga prioritetet e zhvillimit social ekonomik.
- f. Në ajër, faktorë klimaterikë, zhurma, biodiversitet dhe trashëgiminë kulturore e historike ndikimi nuk vlerësohet direkt por fakti i shtimit të sipërfaqeve të gjelbëruara mundëson emetime të oksigjenit, shfrytëzim të CO₂, absorbim të nivelit të zhurmave, kushte zhvillimi të faunës së bujqësisë së kultivuar, pra duke rezultuar në impakt të koreluar pozitivisht.

10. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (ujore, diellore, etj) do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:

- a. Tokën në mënyrë negative me shkallë të ndryshme në varësi të mënyrës së ndërhyrjes. Kjo është e lidhur kryesisht me impaktin e veprave hidrike.
- b. Ajrin tërësisht në mënyrë pozitive pasi janë burime që nuk gjenerojnë ndotës të tij.
- c. Faktorët klimaterikë impaktohen me tendencë nga neutrale në pozitive por njëkohësisht janë të koreluar në nivel global, pra shoqërohen me fenomene kumulative.
- d. Ujin e impaktojnë pozitivisht ose negativisht lidhur me mënyrën e shfrytëzimit. Pra impakti është pozitiv kur shfrytëzohen ujrato të tepërta, por shfrytëzimi i tejskajshëm, devijimi i rrjedhjes impaktojnë negativisht të gjitha asosacionet bimore, shtazore dhe sociale që shtrihen në rrjedhjet e poshtme të tyre. Problematika e konstatuar në zonën e parkut Kombëtar Shebenik – Jabllonice kërkon mbrojtje të ujrave dhe mos dhënie leje shfrytëzimi të metejshme me HEC. Zbatimi i kriterëve të shfrytëzimit të ujit sipas ligjit mënjanon tërësisht impaktin negativ të këtij prioriteti në faktorin mjedisor ujë.
- e. Biodiversitetin, ku impakti mund të rezultojë pozitiv ose negativ. Kjo është e lidhur me masat e zbatuara për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme (**aktualisht HEC kanë impakt negativ të lidhur me numrin dhe mënyrën e shfrytëzimit të ujit**). Pra efekti pozitiv është kur instalimi mundëson dhe krijojnë kushte për zhvillimin e ekosistemeve rrethuese ose periferike, dhe negativ kur shfrytëzimi bëhet në zonë kritike për sasinë e ujit dhe nuk zbatohen kriteret teknike, çka mund të shoqërohet me asgjësim total të ekosistemeve ekzistuese dhe shkratëzim total të mjedisit përreth.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- f. Zhurmat impaktohen relativisht pak negativisht, pasi shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme ka të bëjë me përdorimin e teknologjive me dinamikë të lartë dhe me përdorim mekanizmesh që gjenerojnë zhurma. Minimizimi mund të realizohet duke përzgjedhur vend instalimit dhe duke shmangur pikat e ndjeshme të ekosistemeve natyrore.
 - g. Peisazhin, ku impakti mund të rezultojë pozitiv ose negativ në varësi të përzgjedhjes së vend instalimit të impiantit. Por kjo është e lidhur dhe me shkallën hapësinore të instalimit.
 - h. Popullsinë dhe asetet e saj, ku impakti rezulton të jetë tërësisht pozitiv pasi lidhet me mundësi punësimi (ndërtues, inxhinier, mirëmbajtës, specialistë IT, etj), përfitim ekonomik, përmirësim të cilësisë së jetesës.
 - i. Në mbetje dhe trashëgimi kulturore e historike impakti i këtij prioriteti nuk mund të vlerësohet direkt por sigurisht që është i lidhur me zbatimin e kriterëve teknike dhe studimore në mënjanimin e impakteve të drejtëpërdrejta në përzgjedhjen e pikave instaluese.
- 11. Realizimi i projekteve që janë të lidhura me planifikimin urban, rrjetin urban (furnizimi me ujë, kanalizime, energji, menaxhim mbetje, etj) dhe rikualifikimin e zonave të caktuara apo njësive administrative do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:**
- a. Tokë pasi rivitalimi i këtyre rrjeteve do të mund të shmang rrjedhjet e pakontrolluara të ujrave nëntokësore nga sistemet e kanalizimeve duke evituar fenomenet negative të erozionit, por do të mund të mënjanohen edhe depozitimet nëntokësore të mbetjeve të ndryshme. Pra impakti i këtij prioriteti zhvillimi rezulton që të jetë tërësisht pozitiv në faktorin mjedisor tokë.
 - b. Mbetje, impakti rezulton të jetë pozitiv pasi do të mund të evitohet depozitimi sporadik, djegjet e pakontrolluara shoqëruar me përmirësim të cilësisë së ajrit. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke promovuar reduktim, riciklim, ripërdorim, ndarje në burim impakti mjedisor do të ketë trend pozitiv të qënësishëm. Pra në mbetje, impakti rezulton tërësisht pozitiv sepse do të mund të disiplinojë menaxhimin dhe reduktimin e ndjeshëm të volumit të gjenerimit dhe depozitimit të tyre.
 - c. Ujë, impakti rezulton tërësisht pozitiv pasi do të mund të ndalohet rrjedhja e pakontrolluar e ujit të pijshëm si dhe shpërdorimi i tij. Por njëkohësisht mundësohet riciklimi i ujit nëpërmjet sistemeve të trajtimit bakteriologjikisht të pastër pa efekte negative në florë, faunë, njerëzim.
 - d. Biodiversitet pritet që të ketë një impakt minimal negativ pasi do të shoqërohen me konstruksione për depozitime të menaxhuara. Por përzgjedhja e pikave të grumbullimit


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

apo trajtimit (vend depozitimi i mbetjeve) do të mund të minimizonte ndjeshëm impaktin negativ të këtij prioriteti të vlerësuar në PPV. Por mirëmenaxhimi do të zvogëlojë impaktin hapësinor dhe do të mund ta përqëndrohet në pika të përzgjedhura dhe të mirë menaxhuara.

- e. Popullsinë dhe asetet e saj impakti rezulton të jetë pozitiv qoftë në përmirësimin e cilësisë së jetës por dhe në mundësi punësimi dhe përfitimi financiar.
- f. Në faktorët klimaterikë, peisazh, zhurma, trashëgimi kulturore e historike megjithëse nuk mund të përcaktohet një korelacion i drejtëpërdrejtë, zbatimi i veprimtarive të planifikuara në prioritetin e PPV krijon trend bashkërendues pozitiv.

12. Realizimi i projekteve të lidhura me sistemin e transportit publik do të mund të pasqyrohet me ndikime pozitive dhe negative të faktorëve mjedisor si më mëposhtë:

- a. Ajër, ku impakti është tërësisht pozitiv pasi ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës, me sistemin e qarkullimit, me teknologjinë e mjeteve dhe cilësinë e lëndëve djegëse, duke minimizuar përqëndrimin e ndotësve në atmosferë.
- b. Faktorët klimaterikë si rezultat i korelacionit të tyre me ajrit, duke reduktuar ndjeshëm emetimin e ndotësve që shoqërohen me shfaqjen e fenomenit “serë”.
- c. Zhurma, ku impakti do të jetë pozitiv pasi është i lidhur direkt me sistemin e qarkullimit dhe ekzistencën e kushteve, duke përdorur dhe promovuar formave alternative transporti sikurse janë rrugët e biçikletave.
- d. Popullsinë dhe asetet e saj impakti parashikohet të jetë pozitiv pasi do të ketë si qëllim përfundimtar lehtësimin e qarkullimit, përdorimin e mjeteve të transportit kolektiv dhe të formave alternative që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shëndetit mjedisor dhe të mënyrës e cilësisë së jetesës. Kjo do të mënjanojë fenomenin e migrimit të lidhur me cilësisë urbane.
- e. Trashëgiminë kulturore e historike që do të impaktohet pozitivisht për shkak të krijimit të aksesueshmërisë së këtyre veprave nga vizitorët.
- f. Peisazhi për shkak të ndërhyrjeve do të krijoj një pamje të përmirësuar dhe më estetike.
- g. Uji, biodiversiteti dhe mbetjet, impakti i drejtëpërdrejtë nuk vlerësohet por trendi i veprimtarive të planifikuara do të mund të impaktoj pozitivisht këta faktor mjedisor duke krijuar sinergjinë funksionale të faktorëve mjedisor.



9.4. TRAJTIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.

Mbi bazën e vlerësimit të projekteve të parashikuara nga zbatimi i PPV-së dhe impaktit të tyre në faktorët e mjedisit duhet që të kryhen veprime konkrete me qëllim minimizimin deri në eliminim të ndikimeve mjedisore të këtyre veprimeve. Analiza e impakteve mjedisore dhe mënyra e trajtimit të tyre është analitike për secilin përbës të mjedisit.

Faktorët Mjedor: Terren	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndërtimi dhe funksionimi i zonave urbane dhe qendrave administrative;	Hartimi i studimeve përputhëse hidrogeologjike për mbrotjen e terrenit, por dhe të azhurnuar me projektet e propozuara
Ndërtimi dhe funksionimi i infrastrukturës kombëtare dhe ndërkombëtare;	Hartimi i studimeve hidrogeologjike dhe gjeologjike për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme dhe konfortabëkl me mjedisin
Ndotje të terrenit nga pesticidet dhe plehurat kimike në kuadër të fuqizimit të sektorit agrobujqësor;	Zhvillimi i bujqësisë mbi baza mbështetëse shkencore. Mundësia e krijimit të njëjësive bujqësore të organizuara. Aplikimi i praktikave, rregullave dhe udhëzime të Bashkimit Europian mbi bujqësinë
Ndotje të terrenit nga deponime mbetjesh apo produkte veprimtarie shfrytëzimi dhe/ose prodhimi nga rritja e aksesit të punësimit;	Planifikimi në burim i i tipologjisë dhe mënyrës së menaxhimit të qëndrueshëm sipas politikave më të mira të ciklit të tyre .

Faktorët Mjedor: Ajri	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndotja atmosferike për shkak të rivitalizimit të infrastrukturës së transportit;	Kalimi në përdorimin e mjeteve të teknologjisë anti-ndotje. Përdorimi i lëvizjeve alternative të mundshme me reduktim të emisioneve, qoftë me karakter sportiv apo të qarkullimit kolektiv.
Ndotje atmosferike për shkak të zhvillimit të projekteve të	Zbatimi i projektit sipas parimit të qëndrueshmërisë dhe aplikimi i

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

propozuara lidhur me mundësi punësimi, zgjerimi urban, etj ;	metodave dhe teknologjive bashkëkohore.
Ndotje për shkak të deponime sporadike dhe mos aplikimit të masave trajtuese urbane, sanitare, shtëpiake dhe bujqësore;	Organizimi dhe zbatimi i një skeme funksionale për grumbullim të përqëndruar dhe trajtim në pika të përcaktuara me teknologji sa më rentabël nga pikpamja mjedisore

Faktorët Mjedisor: Ujra	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Përdormi i ujit për qëllime imbotilimi apo për promovimin dhe zhvillim të prodhimeve dhe produkteve bujqësore, si në sektorin primar dhe atë dytësor të prodhimit;	Aplikimi i politikave të përshtashme të faturimit të ujit. Organizimi hapsinor, kohor dhe teknologjik i njësive operuese në rajonet ekonomike me qëllim menaxhimin e burimeve ujore. Organizimi i kontrollit të mënyrave të shfrytëzimit të burimeve apo depozitimeve ujore. Përdormi dhe aplikimi i risive teknologjike në shfrytëzimin e ujit. Përdormi dhe adaptimi nga njësitë operuese të Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor
Ndotje dhe ndikim në sasisë e ujrave nëntokësore nga intesifikimi dhe forcimi i prodhimit primar;	Organizimi dhe zbatimi i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për vaditje. Ndërtimi i një rrjeti hidrografik modern me efencë, rendiment, kosto të ulët dhe produktiv nga pikpamja e qëndrueshmërisë mjedisore. Ndërtimi dhe mirëmbatja e sistemeve ujore të rezervuarëve apo digave. Menaxhimi i shfrytëzimit të burimeve ujore nëntokësore individuale apo kolektive
Ndotje nga shkarkimet sipërfaqësore apo nëntokësore me burime të ndryshme industriale, bujqësore, urbane, etj.	Ndërtimi i sistemeve teknologjike që shkarkimet përfundimtare të jenë me ndotje të papërfillshme. Përdorimi dhe aplikimi i skemave teknologjike që akumulojnë ndotjen sipas parimit të Zhvillimit të qëndrueshëm. Planifikimi i investimeve apo të çfarëdojloj ndërtimi me fashë mbrojtëse ndaj ujrave sipërfaqësore nga 5 deri në 200m. Organizimi i studimeve hidrogeologjike për shmangje maksimale të raportit funksional aktivitet/burim nëntokësor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Faktorët Mjedor: Biodiversiteti	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndërtimi dhe funksionimi i infrastrukturës qarkulluese;	Trajtim parandalues me vendosjen e rrjetave dhe të infrastrukturës teknike e mjedisore
Promovimi i natyrës, kreacionit, guida ekoturistike;	Përcaktimi i zonave me vlera ekoturistike, shkencore dhe ekonomike. Hartimi i një guide dhe aplikimi i një sistemi shfrytëzimi konfortabël me mjedisin dhe që siguron zhvillim të qëndrueshëm. Zhvillimi i studimeve faunistike dhe floristike në përgjithësi por sidomos ornitologjike dhe mamalogjike sidom në zonat e mbrotjtura, me interes ekoturistik, të ndjeshme dhe problematike
Zbatimi i projekteve strategjike me impakt të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë si rezultat i shfrytëzimit të burimeve natyrore;	Aplikimet duhet të shmangin sipas alternative studimore ndërhyrjen drastike në biodiversitet. Të kërkohen dhe zbatohen teknologji që minimizojnë përdorimin e burimeve primare të biodiversitetit me teknologji alternative të efencës energjitike. Shfrytëzimi i biodiversitetit sipas kriterëve shkencore dhe alternuar me metoda e programe të zhvillimit të qëndrueshëm. Projekte bashkëhoqëse me mundësi zhvillimi të biodiversitetit.

Faktorët Mjedor: Mbetje	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Shtimi i prodhimit të mbetjeve nga aktiviteti në sektorin primar dhe sekondar të prodhimit;	Promovimi i riciklimit të materialeve të ndryshme. Promovimi i bio-kompostimit nga sektori primar dhe sekondar i agrobuqësisë. Informimi i banorëve në lidhje me mundësitë dhe mënyrat e menaxhimit të mbetjeve sipas tipologjisë së tyre. Organizmi i një sistemi trajtimi me grumbullim në pika të paracaktuara, përpunim paraprak dhe destinim për në pika përpunuese teknologjike. Mundësi perspektive të ndërtimit të landfillit. Zhvillimi i sistemeve të koordinuara të aktiviteve ekonomike me mundësi

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

	qarkullimi të lëndëve të para e produkteve dhe me mbetje minimale. Aplikimi i sistemeve promovuese dhe motivuese për menaxhimin e mbetjeve.
Shtim të gjenerimit të mbetjeve nga aktiviteti komunitar apo dhe zhvillimi i ekoturizmit;	Informim dhe ndërgjegjësim për menaxhimin e mbetjeve dhe krijimi i aksesit të duhur për grumbullim, ndarje me mundësi përpunimi optimal dhe shfrytëzimi për riciklim.

Faktorët Mjedisor: Mjedi Akustik/Zhurma	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Zhurma nga funksionimi i infrastrukturës së transportit;	Zhvillimi i infrastrukturës policentrike, por njëkohësisht promovimi i teknologjive bashkëkohore dhe konfortabël me mjedisin për përdorim personal apo aktivitete të ndryshme. Të shfrytëzohen në transport format alternative që sigurojnë rentabilitet, minimizojnë koston dhe gjenerojnë për njësi dB më të pakët.
Zhurmat nga aktivitet e propozura industriale (miniera, gurorë, artizale, etj);	Organizimi hapësor i njësive operuese. Përdorimi i teknologjive bashkëkohore, aplikimi i aktiviteteve në distancë nga zonat e banuara apo me impakt akustik, sidomos faunistik. Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse akustike për sigurimin e shëndetit të personelit dhe respektimi ligjor i kohës së ekspozimit ndaj faktorëve akustik. Respektim i normave EU për parametrat teknologjike dhe masat teknike.
Zhurmat nga aktivitetet sekondore të agrobujqësisë;	Aplikimi i izolimit akustik të ndërtesave. Organizimi hapësor i njësive operuese në zonat ekonomike . Shfrytëzimi i hapësirës topografike për planifikimin e instalimit të investimeve me impakt akustik.

Faktorët Mjedisor: Mjedi Peisazh	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndryshime të peisazhit nga aktiviteti në	Zbatimi i projekteve infrastrukturore dhe urbane me arkitekturë zhvillimore

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

infrastrukturë dhe mjedisin urban;	konfortabël me mjedisin.
Ndryshime të peisazhit nga zbatime të sektorit primar industrial;	Organizimi i shfrytëzimeve të tilla me strukturë sipërfaqësore me impakt minimal estetik mjedisor. Zbatimi i teknologjive që gjenerojnë mundësi ndryshimi sa më të vogël të peisazhit. Rritja e efikasitë së shfrytëzimit për njësi sipërfaqe me mundësi ndryshimi minimal të peisazhit. Zbatimi i programeve rehabilituese për formësimin e peisazhit.
Ndryshime të peisazhit nga aktiviteti i sektorit primar të bujqësisë;	Respektimi i distancës minimale të aktiviteteve ndërtimore në zonat rurale me distancë minimale 20m nga kufiri fqinjë për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin, si rezultat i ruatjes së densitetit të ndërtimit-shfrytëzimit-gjenerimit të faktorëve impaktues të mjedisit
Përdormi i burimeve natyrore për qëllime ekoturistike apo ekonomike.	Përzgjedhja e pikave të aksesueshme pa impakt në mjedisin shkencor, të kërcënuar sensibël. Përdormi i teknikave dhe aseteve me më pak mundësi impakti negativ mjedisor. Përdormi i mjeteve natyrore për të ruajtur harmonizimin midis elementëve natyror dhe ndërhyrjes antropogjene.

9.5. VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË FAKTORËT MJEDISOR TË PPV

9.5.1. Ndikime në terren

Faktori mjedisor i terrenit, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV” pritet të ndikohet pozitivisht nga zbatimi i projekteve të lidhura me 4, 7, 8, 9, 11 dhe negativisht pjesërisht nga projektet e lidhura me 1 dhe 10. Ndërkohë që projektet e lidhura me veprimtaritë që i përkasin 2, 3, 5 dhe 11 nuk kanë ndonjë impakt të qënësishëm në faktorët mjedisor të analizuar sipas objektivave dhe projekteve të parashikuara. Lik pra pozitiv dhe negativ në varësi të zbatimit të projekteve të parashikuara për realizimin e këtij objekti të PPV. Por në disa projekte sikurse është 1 dhe 12 impakti mund të rezultojë diabolik pra pozitiv dhe negativ në varësi të zbatimit të projekteve të parashikuara për realizimin e këtij objekti të PPV, si dhe në varësi të parametrave të tjerë dhe në sinergji me zbatimin e objektivave të lidhura me menaxhimin e ujrave.

Pra, në përputhje edhe me analizën u kryer në kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, vlerësohet se praktikë e mira të Agroturizmit, trajtimi i fenomeneve të erozionit të terrenit, menaxhimi i qëndrueshëm i ujit për ujitje, përmirësimi i prodhimit bujqësor dhe harmonizimi i tij me standardet Evropiane, përmirësimi i infrastrukturës për furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimim, përpunimin e mbetjeve dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta, si edhe ndërhyrjet e planifikimit urban dhe rehabilitimit, do të kenë ndikime pozitive mbi terrenin.

Ndikimi negativ që do të shkaktohet nga instalimi dhe funksionimi i infrastrukturave të mëdha për transportet rrugore dhe hekurudhore që ka të bëjë me mbulimin e tokës me qilima artificiale dhe reduktimin e absorbimit së tij, me pasojë rritjen e rrezikut të përmytjeve. Ndërkohë, ndikimi negativ është i kthyeshëm, pasi me respektimin e standardeve strikte të instalimit dhe funksionimit të infrastrukturës së transportit, mbrojtja e tokës do të vijë nga nevoja për mbrojtjen e projekteve të infrastrukturës së transportit. Ndikimi negativ i pritur nga promovimi i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (ujore, diellore) ka të bëjë vetëm me rastin e ndërtimit të një dige hidroelektrike, rast në të cilin do të krijohet një rezervuar të madh, i cili do të shkaktojë një efekt negativ në tokën e këtij rajoni p.sh. me erozion të mundshëm dhe rrëshqitje të tokës.

Së fundi, forcimi i sektorit të prodhimit agrobujqësor, nëse nuk kombinohet me menaxhimin e qëndrueshëm të ujit për ujitje dhe përmirësimin e prodhimit bujqësor, vetëm atëherë mund të shkaktojë efekte negative në tokë, për shkak të përdorimit të maksimizuar të ujit për ujitje dhe ndotjes që do të rezultojë nga përdorimi përkatës i pesticideve dhe plehrave kimike. Edhe për

këtë arsye, efekti është i kthyesëm, duke u kombinuar me zbatimin e propozimeve të lidhura me zhvillimin e sektorit të prodhimit.

9.5.2. Ndikimet në ajër

Faktori mjedisor i ajrit, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dhe kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga zbatimi 6, i projekteve të lidhura me objektivat 1, 6, 8, 9, 10, 11 dhe 12. Ndërkohë që pritet një impakt pjesërisht negativ nga veprimtaritë e lidhura me 4, 7, dhe 12. Veprimtaritë e lidhura me 2, 3, 5, parashikohen me impakt jo të qënësishëm dhe të cilësuar por të kushtëzuar nga zbatimi i veprimtarive të tjera të parapara sipas objektivave të zbërthyer në veprimtari konkrete.

Si rrjedhim, rezulton se nga propozimet e PPV, do të rezultojnë efekte pozitive në ajër, nga përdorimi i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë dhe pavarësinë e pjesshme nga lëndët djegëse minerale, nga menaxhimi i mbetjeve të ngurta me shmangie të metodës së djegies, nga rritja e sipërfaqeve të gjelbra në qytete dhe nga reduktimi i gazrave përmes rregullimeve të trafikut, nga ndikimet e përgjithshme pozitive në lidhje me veprimet për fenomenin "serë" dhe faktorëve të tjerë klimatikë, nga minimizimi i lëvizjeve, duke ofruar zgjidhje ekologjike.

Ndikimi negativ që do të rezultojë nga rritja e lëvizjeve rrugore (automobilistike dhe hekurudhore) të njerëzve dhe mallrave mund të kontrollohet dhe të kufizohet në një masë maksimale vetëm me përmirësimin e cilësisë së karburanteve dhe me zëvendësimin aktual të automjeteve me automjete të teknologjisë më miqësore me natyrën. Lëvizja e turistëve në monumentet kulturore e historike si dhe arkeologjike, numri i të cilëve parashikohet të rritet, do të shkaktojë rritje të ndotësve të ajrit dhe në këtë rast varet nga cilësia e lëndëve djegëse të automjeteve, nga përdorimi i biçikletave dhe nga lëvizja e sigurt dhe tërheqëse e këmbësorëve, përmes rrjetit të trotuareve për këmbësorë. Së fundi ndikimet përkatëse negative që priten nga fuqizimi i aktiviteteve të specializuara të turizmit (agroturizmi, turizmi mjedisor, kulturor, etj), janë gjithashtu të kontrollueshme nga kushtet e përmendura më sipër.

9.5.3. Ndikimet mbi faktorët klimatikë

Faktorët klimatikë, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dhe kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, do të preken vetëm pozitivisht nga veprimtaritë e lidhura me 6, 7 dhe 12, ndërkohë që negativisht nga 1. Veprimtaritë e tjera të parashikuara në zbatim të kërkesave të objektivave të PPV do të jenë me efekt neutral të drejtëpërdrejtë por si veprimtari kumulative do të ndikojnë pozitivisht në rast se zbatohen kërkesat e implementimit të gjithësecilit projekt, por sidomos ato të lidhura me pavarësinë energjetike nga lëndët djegëse minerale (përdorim të Burimeve të rinovueshme të energjisë) dhe nga reduktimi i emetimeve të gazeve “serë”, me fuqizim të transporteve interbashkiake

dhe metodave më miqërore me mjedisin të transporteve. Në veçanti, për mikroklimën urbane përmirësimi do të vijë nga shtimi i gjelbërimit, përmirësimi i trafikut dhe nga rehabilitimi i ndërtesave me efikasitet energjitike brenda zonave të banuara. Sa më e madhe zona e banimit, aq më i dukshëm përmirësimi në mikroklimë.

Për sa i përket ndikimit negativ në faktorët klimatikë nga forcimi i infrastrukturës së transportit, shkalla e tij varet nga përmirësimi i cilësisë së lëndëve djegëse dhe zëvendësimi i mjeteve ekzistuese me mjete të një teknologjie të re më miqësore me mjedisin. Duke pasur parasysh perspektivën e përgjithshme të zhvillimit të Bashkisë, këta faktorë konsiderohen të papritur dhe si rrjedhim, efekti negativ i kontrollueshëm.

9.5.4. Ndikime mbi ujërat

Faktori mjedisor i ujit, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dhe kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga Boshtet e Prioritetit 9, 11, 12, dhe negativ 5, 6, 10. Ndërkohë që veprimtaritë e tjera parashikohen me ndikim pozitiv dhe negativ në varësi të mënyrës së implementimit, pra bëhet fjalë për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë si dhe të menaxhimit të ujit. Pra, në përputhje me analizën e mësipërme në kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dhe kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, është vlerësuar se menaxhimi i qëndrueshëm i ujit kryesisht për ujitje, mbrojtja e tokës bujqësore nga uji tepër (përmytjet), përmirësimi i rrjeteve të infrastrukturës së furnizimit me ujë, kanalizimi, trajtimi i ujërave të zeza dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta do të kenë një efekt pozitiv mbi ujin. Për më tepër, shkencat që kanë lidhje me mjedisin përmirësojnë perspektivën e sistemeve të ardhshme të ujit. Efekte negative parashikohen nga zbatimi i propozimeve për forcimin e aktiviteteve të turizmit dhe aktiviteteve të lidhura me zhvillimin e prodhimit të diversifikuar, forcimin e sektorit sekondar duke rritur njësitë e përpunimit të produkteve të prodhimit primar. Ndërkohë, sinergjia e veprimeve nga boshtet e tjera të prioritetit mund të zvogëlojë ose të kompensojë ndikimin negativ. Për sa i përket ndikimeve në ujë nga veprimtaritë e sektorit të turizmit dhe sektorit terciar janë të kthyeshme duke zbatuar veprimet që përmirësojnë infrastrukturën e furnizimit me ujë, dhe zbatimin e aktiviteteve të buta të ekoturizmit. Efekti negativ nga përdorimi i ujit në sektorin e prodhimit dytësor ka të bëjë kryesisht me nevojat e shtuara për ujë që përdoret nga aktivitete të tilla dhe nga prodhimi i mbetjeve që kërkojnë menaxhim. Edhe në këtë rast, efektet minimizohen nga masa të tilla si menaxhimi - trajtimi i ujërave të ndotura nga njësitë industriale që i prodhojnë ato dhe ripërdorim gjatë funksionimit të tyre. Në fushën e prodhimit primar, menaxhimi racional i ujit për ujitje dhe praktikën e mira bujqësore me përdorim minimal të plehrave dhe pesticideve, mund të ndryshojnë efektet negative. Për sa i përket shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, nëse nuk merren në konsideratë parametrat hidrologjike dhe balanca ujore në basenat ujore që do të shfrytëzohen dhe nuk

bëhet menaxhim racional, efekti mbi ujin në zonat poshtë saj do të jetë negativ, pasi do të ndikohet bilanci hidrologjik dhe mund të vihet re mungesë uji. Nga ana tjetër, mund do të shoqërohet me impakte të rëndësishme të biodiversitetit, faunës, florës dhe jetesës së komunitetit.

9.5.5. Ndikime mbi mbetjet

Mbetjet, të ngurta dhe të lëngshme, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të kenë efekt pozitiv në lidhje me veprimtaritë e objektivave 4, 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12. Ndërkohë që impakti negativ mund të rezultoj nga 5, 9 dhe pjesërisht nga 5. Njëkohësisht veprimtaritë e tjera sipas objektivave sikurse 1, 2, 3 nuk kanë lidhje direkte me mbetjet por aksesohen nga implemetimi i tyre pozitivisht ose negativisht. Veprimtaria që ka lidhje me mbrojtjen e tokës së punueshme dhe të bujqësisë ka efekt pozitiv ose negativ në nivelin që do të parashikohet apo nga përpunimi i mbetjeve të lëngshme nga njësitë e operimit. Në bazë të analizës së përshkruar në kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, vlerësohet se promovimi i kësaj dege të re, do të ketë ndikim pozitiv në mbetjet. Krijimi i një linje që do të absorbojë një pjesë të mbetjeve nga prodhimi, në rast se komplekset bujqësore do të përdorin mbetjen e thatë nga komplekset periferike për përpunimin e mbetjeve, si dhe komposton nga përpunimi i lëndëve organike, duke pasuruar tokën bujqësore me lëndë organike, ndihmon ekonomikisht pasi kultivimi i tokës bujqësore do jetë me kosto më të ulët për sa i përket plehërimit. Veçanërisht efekte pozitive mbi mbetjet ka padyshim zbatimi i propozimeve, që synojnë zvogëlimin e sasisë së mbetjeve dhe riciklimin e nënprodukteve nga shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe përmirësimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore me përdorimin e mbetjeve me trajtim special. Në të njëjtën mënyrë, ndikim pozitiv do të ketë trajtimi i mbetjeve në përgjithësi si mbledhja, përzgjedhja, riciklimi, landilli dhe përdorimi në degë të tjera p.sh. bujqësi. Gjithashtu teknologjitë që lidhen me ambientin përmirësojnë kushtet e sistemeve tokësore. Ndikimet negative nga zhvillimi i turizmit i sektorit të prodhimit parësor dhe atij terciar pavarësisht se pritet të jenë të rëndësishme pasi rritet popullsia dhe konsumimi, sjell si pasojë shtimin e mbetjeve, do të mund të minimizohen me një menaxhim të mirë si për mbetjet e lëngshme ashtu edhe ato të ngurta. Si përfundim bujqësia, me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticidet dhe funksionimin e njësive të organizuara, prodhojnë mbetje të cilat zakonisht përfundojnë në atmosferë, sipërfaqen e tokës dhe në rrjetin ujqor natyror, në qoftë se nuk do të bëhet menaxhimi i përshtatshëm i tyre. Ndikimi i tyre në mbetje është negativ. Në qoftë se praktikojmë veprime si mbrojtja e burimeve natyrore, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e tokave bujqësore dhe kultivimin e tyre me përdorimin e sa më pak plehrave kimike dhe të pesticideve, mbetjet do të minimizohen dhe do të kenë më pak ndikime negative në mjedis.

9.5.6. Ndikime në mjedisin akustik/zhurmat

Faktori mjedisor i zhurmës, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga veprimtaritë e objektivave 6, 8, 9 e 12 dhe negativisht nga 1, 3 e 10. Pjesërisht impakti është negativ ose pozitiv nga 5, ndërkohë që 2, 3, 4 e 7 konsiderohen pa lidhje të drejtëpërdrejtë. Pra, në përputhje me analizën e mësipërme, është vlerësuar se ndërhyrjet e planifikimit urban dhe rehabilitimet, do të kenë efekte pozitive mbi zhurmën, veçanërisht në atë që krijohet nga lëvizja e automjeteve. Gjithashtu, zhvillimi i mëtejshëm i transportit urban, për aq sa do të ndihmojë në uljen e vëllimeve të trafikut në shumë rrugë, vlerësohet se do të reduktojë zhurmën e gjeneruar nga trafiku në rrugët e veçanta, ku paraqiten probleme të ngjashme. Ndikime negative parashikohen nga përmirësimi dhe fuqizimi i infrastrukturës kombëtare të transportit rrugor dhe hekurudhor, pasi mjetet që qarkullojnë, automjetet, trenat do të shkaktojnë zhurmë për shkak të pjesëve të tyre mekanike, ose për shkak të shpejtësisë së tyre. Po ashtu, promovimi i monumenteve historike e kulturore që do të rrisin vizitueshmërinë e tyre do të gjenerojnë vatra zhurme rreth tyre. Problemi mund të kontrollohet dhe të minimizohet me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të projekteve të lidhura me lëvizje këmbësore dhe me biçikleta. Ndikime të ngjashme negative të zhurmës shkaktohen edhe nga përdorimi i të gjitha burimeve të disponueshme (natyrore, kulturore, etj.) për zhvillimin turistik dhe fuqizimi të sektorëve që veprojnë duke mbështetur turizmin. Me fuqizimin e sektorit të përpunimit të produkteve të sektorit bujqësor, faktori zhurmë do të rritet, pasi njësitë e përpunimit do të përdorin makineri që prodhojnë zhurmë në proceset e tyre, por në praktikë zhurma do të ketë ndikim vetëm tek të punësuarit në këto njësi, pasi këto njësi do të vendosen jashtë zonës urbane të vendbanimeve.

9.5.7. Ndikimet në trashëgiminë kulturore dhe historike

Faktori mjedisor në trashëgiminë kulturore, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga veprimtaritë e objektivave 1, 3, 4, 6, 11, 12 ndërkohë që ato të lidhura me 2, 5, 7, 8, 9 dhe 10 nuk kanë lidhje me faktorin mjedisor në trashëgiminë kulturore e historike. Me studime të veçanta që do të kryhen do të jepet mundësia që monumentet kulturore e historike të komunikojnë në mënyrë të tillë që të krijohet një rrjet i shfrytëzueshëm në kohë nga vizitorët i kombinuar me element të turizmit natyror dhe kulinar.

9.5.8. Ndikime mbi peisazhin

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Faktori mjedisor i peizazhit, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga aktivitetet e objektivave 1, 3, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe pjesërisht negativisht nga 1, 10 e 11. Rëndësi në zhvillimin e peisazhit ka shfrytëzimi i të gjithë burimeve (natyrore, kulturore, etj.), për rritjen e aktiviteteve turistike p.sh. promovimi i agroturizmit, pasi të ndërtohen komplekse agroturistike të përshtatura në peisazh dhe me materiale miqësore ndaj peizazhit, sepse aktiviteti i tyre është i varur direkt nga gjendja e mirë e ambientit natyror. Puna në sektorin e prodhimit të kombinuar me përpunimin përmirëson gjendjen e tokës bujqësore, zvogëlohen zonat bujqësore të braktisura, ndërtohet rrjet kanalizimesh i cili mbështet kultivimin dhe vazhdimësinë e tyre dhe krijohen liqene artificiale, të cilat përmirësojnë pamjen e estetikë të peizazhit, pasi uji ndikon pozitivisht në ambient. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore, nënkupton sipërfaqe të pastra, të cilat nuk kanë pësuar dëmtim, pyje të dendura, sipërfaqe të shfrytëzuara dhe të risjella në gjendjen e mëparshme. Ndërhyrja urbanistike është e sigurt se do të ndryshojnë pamjen urbane në të gjitha qendrat e banimit që do të realizohen dhe ndryshimi vlerësohet të jetë pozitiv. Përmirësimi i komunikacionit dhe të shërbimit urban në lidhje me ndryshimet urbanistike do të ndryshojnë pamjen e qytetit në mënyrë pozitive. Ndikime negative parashikohen si pasojë e zhvillimit dhe përforcimit të përpunimit të produkteve bujqësore, pasi qendrat e përpunimit me godinat e tyre do të shkaktojnë ndikim negativ të kufizuar në bujqësi. Gjithashtu dhe akset rrugore, hekurudhore, kur kalojnë përmes natyrës, kryejnë ndërhyrje të mëdha estetike mbi peisazhin, për të pasur një vazhdimësi të aksit rrugor pa pjerrësi të madhe dhe kthesa të hapura, të cilat presupozojnë ndërhyrje të mëdha në peisazh. Promovimi i energjisë nga kushtet natyrore mund të ketë ndikim negativ mbi peisazhin. Përsa i përket energjisë nga kushtet natyrore, vlerësohet se do të ketë ndikim mbi qendrat e banuara veçanërisht nga instalimi i paneleve diellor mbi çatitë e banesave. Ndikimi mbi peisazhin nuk pritet të jetë i rëndësishëm.

9.5.9. Ndikimet mbi popullsinë dhe në asetet e saj

Popullsia dhe elementët asetet e saj, në përputhje me kapitullin “Njohja e ndikimeve mjedisore të PPV” dha kapitullin “Parashikimi i Ndikimeve Mjedisore të PPV”, pritet të ndikohet pozitivisht nga të gjitha veprimtaritë e propozuara sipas objektivave të PPV. Kjo pasi:

- Infrastruktura ndikon në zhvillimin ekonomik të zonës, ndërsa do të lehtësojnë lëvizjen e mallrave tregtare dhe do të forcojnë tregtinë drejt tregjeve të ndryshme. Në vazhdim, pritet shmangia e emigrimit, ndërsa për shkak të kushteve më të mira të zhvillimit ekonomik, njihet ndryshimi, me rritje të mundshme të aseteve pasurore materiale.
- Do të kenë impakt pozitiv në aktivitetet profesionale, me zhvillimin e shërbimeve dhe të punësimeve. Kjo do të krijojë vende të reja pune, përmirësim të ekonomisë lokale,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

përmirësim të nivelit të jetesës së banorëve dhe për rrjedhojë, përmirësim të elementëve pasurorë materiale.

- Ofrimi i shërbime të turizmit në format nga më të ndryshmet do të tërheqë turist, krijoj mundësi për aktivitete të reja profesionale që do të forcojnë ekonominë lokale dhe do të përmirësojnë nivelin e jetesës së banorëve dhe për rrjedhojë, edhe gjendjen e tyre ekonomike.
- Zhvillimi i ekonomisë nëpërmjet sektorëve të përpunimit do të impaktoj pozitivisht popullsisë dhe mundësi krijimi asetesh të shumta.
- Zhvillimi i bujqësisë në të gjitha format e propozuara dhe në sektorin sekondar do të krijoj burim ekonomik, punësimi, mirëqenie dhe minimizim të migrimit.
- Shfrytëzimi i burimeve natyrore përbëjnë burim ekonomik për pjesën e popullsisë si edhe produkt konsumimi jetese. Ky objektiv synon menaxhimin e duhur të burimeve natyrore me qëllim që ato të mos mungojnë në të ardhmen ose të mos krijojnë kushte të këqija jetese për popullsinë.
- Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore i siguron njeriut cilësi të lartë jetese dhe mjedisi ku jeton dhe punon. Gjithashtu, i siguron pjesës agrare aktivitete për të siguruar të ardhura siç janë kultivimi i tokës së tyre, elementi më i rëndësishëm pasuror për ta. Për më tepër, infrastrukturën e menaxhimit të ujit krijojnë edhe vende të reja pune dhe sigurojnë minimizimin e migrimit.
- Përmirësimi dhe modernizimi i sistemit urban të përbashkët do të shkaktojë ndikime në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe zonat e banuara do të bëjnë zonën urbane më atraktive, kështu që do të ketë ndikim pozitiv si në faktorin mjedisor të popullsisë, sikurse dhe në asetet e tyre.

10. PASOJAT E MUNDSHME NDËRKUFITARE NË MJEDIS DHE SHËNDET PUBLIK.

Zbatimi i VSM në përputhje me kërkesat e hartimit të saj dhe në funksion të mbrotjes së mjedisit gjatë implementimi i PPV padyshim që ka të bëj jo vetëm me bashkinë ky zbatohet por dhe më gjerë, pra është i lidhur me njësi të tjera vendore për shkak se mjedisi është një i tërë dhe i pa ndarë në kufinjë territorial si funksion.

Bashkia Librazhd ka një sipërfaqe të konsiderueshme të territorit të saj që kufizohet nga kufiri shtetëror me ish republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM).

Vlerësimi i impaktit mjedisor ndërkufitar në VSM i PPP rezulton që jetë pozitiv ose asnjëherë negativ. Kjo sepse:

- a. Shumica e projekteve dhe veprimtarive të propozuar nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me mjedisin ndërkufitar.
- b. Projektet që lidhen me shfrytëzimin e burimeve hidrike apo pasurive natyrore sikurse minierat kanë rrjedhjen dhe hapësirën e brendshme të bashkisë dhe nuk impaktojnë mjedisin e vendit fqinjë;
- c. Ndërhyrjet në zhvillimin e turizmit natyror, krijimi i pikave për vizitorët jo vetëm që nuk impakton negativisht vendet fqinje por krijon mundësi për akses të përbashkët me mundësi zhvillimi.
- d. Mrotja e mjedisit natyror, pyllëzimet, ndërtimi i veprave mbrojtëse dhe komunikuese ndikon pozitivisht në mjedisin fqinjë dhe zhvillimin ekonomik;
- e. Veprimtaritë e propozuar, vendinstalet e tyre dhe mënyra e manaxhimit do të bëj të mundur që ajri të ndotet më pak me ndotës, faktorët klimaterik lokal dhe ndërkufitar të përmirësohen ndjeshëm, klima të përmirësohet, uji të mund të mbrohet si burime dhe si gjendje pastërtie, të minimizohet gjenerimi i mbetjeve dhe të mundësohet grumbullimi dhe destinimi pa shkakton ndotje mjedisore, ujrat e zeza të mund të trajtohen ose disiplinohen duke mos krijuar shqetësim mjedisor, trashëgimia kulturore dhe historike të bëhet më e frekuentueshme nga vizitor vendas dhe të huaj, peisazhi të përmirësohet ndjeshëm, infrastruktura të jetë më e mirë, banorët të ketë më shumë mundësi punësimi dhe të ardhura financiare. Pra të gjithë këto faktor të përmirësuar dhe të sipërcituar ndikojnë pozitivisht në shëndet publik.

11. MONITORIMI

Si pjesë e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në Raportin VSM duhet të përfshihen masat e parashikuara për monitorimin e efekteve të mundshme të rëndësishme të zbatimit PPV-së. Qëllimi kryesor i monitorimit të rregullt është identifikimi i efekteve të mundshme negative të zbatimit të PPV-së sa më herët që të jetë e mundur dhe të përfshihen mjetet e nevojshme për parandalimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative.

Qëllimi i sugjerimeve të monitorimit është të ofrojë mbështetje për autoritetin përgjegjës (Bashkia Librazhd) që t'i vlerësojë ndryshimet në mjedisin natyror gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd. Gjatë monitorimit, duhet të ketë mundësi të zbulohet nëse qëllimet strategjike, dispozitat e zbatimit, etj. të planit kanë shkaktuar rezultatet ose përmirësimet e pritura. Një element thelbësor i monitorimit VSM është që herë pas here të vëzhgohet përparimi i arritjes së objektivave mjedisore, përmbushja e qëllimeve të caktuara.

Suksesi i PPV-së dhe VSM-së përkatëse do të përcaktohen nga respektimi i kushteve, rregullave dhe objektivave të shpallura dhe të aprovuara. Në mënyrë të veçantë, puna do vijojë me hartimin e Planeve dhe projekteve të tjera që do të detajojnë dhe qartësojnë më tej elementet kryesore të cilat paraqiten përmbledhtas në PPV. Si të tilla, duhet që këto Plane dhe projekte të ndjekin frymën dhe parimet e PPV-së e të mos çenojnë rregullat përkatëse. Monitorimi i respektimit të PPV-së edhe gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve të tjera do jetë përgjegjësi dhe detyrim i bashkisë Librazhd.

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në faza të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE-së për VSM-në. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen duplikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është Ministria e Mjedisit nëpërmjet AKM-së, e cila zbaton monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që PPV-ja të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektiva dhe synimet janë përcaktuar në plan, është e domosdoshme dhe siç e parashikuam dhe më sipër, është kërkesë ligjore, që të monitorohet plani i zbatimit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qënë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre treguesve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbatuese të PPV-së. Plan i monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit. Realizimi me sukses i kësaj ndërmarrjeve kërkon angazhimin e mjaft institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatëse monitoruese nën drejtimin e autoritetit përkatës të ministrisë së linjës. Mbështetur në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, ligjin për VNM-në ka për detyrë të kryejë monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PPV-së. Këtu përfshihen qoftë planet, projektet e infrastrukturës që po hartohen ndërkohë, edhe detajimi i PPV-së në planet rregulluese për vendbanimet policentrike, njësi administrative, etj. Bashkia Librazhd ka karakter administrativ dhe pa struktura të plotësuara në specialist dhe teknologji për të mundësuar kryerjen e procesit të monitorimit, ç'ka e bën të domosdoshme bashkërendimin e veprimtarive të punës për zbatimin e PPV-së dhe të kërkesave të VSM-së me institucionet përkatëse kompetente. Rezultatet e monitorimit, Bashkia Librazhd sipas ligjit të VSM-së duhet ti publikojë në mënyrë periodike cdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM,VNM për monitorimin dhe rezultatet ti përcillen bashkisë Librazhd dhe Ministrisë së Mjedisit. Mbi bazën e informacioneve të marra ka detyrim ligjor ti publikojë në kuadër të raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Matricat funksionale midis masave të propozuara, treguesëve të monitorimit, kohës së hartimit të raportit dhe autoritetet përgjegjëse për realizimin e zbatimit të VSM-së - Bashkia LIBRAZHID.

Faktorë mjedisorë: Terren			
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit	Përgjegjësi i Programit të Monitorimit
Hartimi i studimeve përputhëse hidrogeologjike për mbrojtjen e terrenit, por dhe të azhurnuar me projektet e propozuara;	Gjetje dhe konkluzione të studimeve geologjike. Numri i njësive të strukturuar sipas koncepteve bashkëkohore	Studimet geologjike do të zhvillohen për cdo veprimtari të planifikuar sipas PDV.	Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
Hartimi i studimeve hidrogeologjike dhe geologjike për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme dhe konfortabël me mjedisin.	Numri i familjeve të përfshira në strukturat e organizuara bujqësore / njësi kohore vjetore.	Raport vjetor ku do të përshkruhet objekti i trajnimit për secilin Work Shop, numri i kooperativave dhe objekti i veprimtarisë së tyre, numri i anëtarëve të kooperativave me rregjistrim të prodhimit bujqësor të gjithësecilit dhe numrin dhe llojin e produkteve organike.	Cdo njësi e organizuar, në bashkëpunim me Bashkinë që do të ketë mbikëqyrjen e tyre.
Zhvillimi i bujqësisë mbi baza mbështetese shkencore.			
Mundësia e krijimit të njësive bujqësore të organizuara. Aplikimi i praktikave, rregullave dhe udhëzime të Bashkimit Europian mbi bujqësinë.	Numri i produkteve bujqësore të certifikuara /njësi kohore vjetore.		
Planifikimi në burim i i tipologjisë dhe mënyrës së menaxhimit të qëndrueshëm sipas politikave më të mira të riciklimit të tyre.	Numri i Work shop të organizuara për akreditimin sipas normave të BE / njësi kohore vjetore		

Faktorë mjedisorë: Ajri			
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit	Përgjegjësi i Programit të Monitorimit
Kalimi në përdormin e mjeteve të teknologjisë anti-ndotje. Përdormi i	Përqindje të automjeteve të teknologjisë Euro V e lart, në lidhje me	Raport vjetor me të dhëna nga Ministria e	Bashkia në bashkëpunim me Ministrinë e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

lëvizjeve alternative të mundshme me reduktim të emisioneve, qoftë me karakter sportiv apo të qarkullimit kolektiv.	totalin e automjeteve në Bashki. Zbatim të Sistemit të Menaxhimit MJedisor nga institucioni menaxhues i funksionimit të aeroportit.	Transportit dhe nga INSTAT. Në kuadër të Sistemit të Menaxhimit MJedisor, do të publikohet Deklarata MJedisore, strategjia mjedisore e Institucionit, objektivat mjedisore dhe rezultatet në vit. Raport vjetor me citim të dhënash për treguesit.	Transportit dhe INSTAT. Institucionet bashkiake dhe qeveritare lokale mbi menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor. Shërbim profesional i Bashkisë
Zbatimi i projektit sipas parimit të qëndrueshmërisë dhe aplikimi i metodave dhe teknologjive bashkëkohore.	Kilometra të rrjetit të rrugëve për bicikleta për vit Kilometra të rrjetit të trotuarëve për vit		
Organizmi dhe zbatimi i një skeme funksionale për grumbullim të përqëndruar dhe trajtim në pika të përcaktuara me teknologji sa më rentabël nga pikpamja mjedisore.	Përqindje të lëvizjes që shërbejnë nga mjete të transportit publik në Bashki Mënyra e funksionimit dhe teknologjia e pikave të trajtimit tipologjik pikave të grumbullimit.		

Faktorë mjedisorë: Ujra			
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit	Përgjegjësi i Programit të Monitorimit
Zbatim i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për ujtitje – mbështetje shkencore të fermerëve – ndërtim të rrjeteve kolektive të ujtitjes – ndërtim të rezervuarëve dhe digave – kontrolli i puseve të shpërndara të fermerëve.	Kodifikim të propozimeve të planit të menaxhimit të ujit për ujtitje Numri i seminareve/vit Kilometra të rrjeteve të ujtitjes kolektive/vit Vëllimi i ujit të rezervuarëve dhe digave Vendndodhja dhe sigurimi i shpimeve private të ujtitjes	Raport vjetor me përmbledhjen e propozimeve të planit të menaxhimit të ujit për ujtitje, objektin e trajnimit në çdo seminar, evoluimin e përmasave të rrjeteve të ujtitjes, evoluimin e vëllimit të rezervuarëve të ujit dhe tabelë me vendndodhjen dhe sigurimin e puseve	Bashkia në bashkëpunim me shërbimin kompetent të ujrave të Prefekturës apo të Ministrisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Ushtrim i politikës së përshtatshme të faturimit të ujit – organizim hapësinor dhe përqëndrim i njësive prodhuese në rajonet ekonomike për menaxhimin kolektiv të ujit – kontroll të shpimeve individuale nga njësitë – përdorim të makinerive bashkëkohore nga njësitë prodhuese – adaptim të Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor prej këtyre njësive prodhuese.	Kostoja e ujit për ujitje/m ³ në vit për konsumatorët Konsumimi i ujit m ³ /vit për përpunuesit Vendndodhja dhe sigurim i shpimeve private industrial Përshkrim i makinerive dhe pajisjeve në Studimet e Ndikimit në Mjedis Numri i ndërmarrjeve me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit	private të ujitjes. Raport vjetor me koston e ujit për ujitje/m ³ vit për konsumatorët, konsumin e ujit m ³ /vit për përpunuesit, vendndodhjen dhe sigurimin e shpimeve private industriale, si edhe numri i kompanive me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit.	Bashkia në bashkëpunim me shërbimin kompetent të ujrave të Prefekturës apo të Ministrisë. Shënim: Në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis që do të miratohet nga agjencia kompetente e llicencimit mjedisor, të shqyrtohen me kujdes makineritë.
Ndërtimi apo mirëmbatja e sistemeve ujore të rezervuarëve apo digave. Menaxhimi i shfrytëzimit të burimeve ujore nëntokësore individuale apo kolektive Ndërtimi i sistemeve teknologjike që shkarkimet përfundimtare të jenë me ndotje të papërfillshme. Përdorimi dhe aplikimi i skemave teknologjike që akumulojnë ndotjen sipas parimit të Zhvillimit të qëndrueshëm. Planifikimi i investimeve apo të çfarëdolloj ndërtimi me fushë mbrojtëse ndaj ujrave sipërfaqësore nga 5 deri në 200m sipas tipologjisë. Organizmi i studimeve hidrogeologjike për	Numri i rezervuarëve, kapaciteti, disponibiliteti i tyre. Përshkrimi i masave inxhinerike mbi shkarkimet tipologjike në mjedisin ujor. Evidentimi i ndërtimeve me impakt në mjedisin ujor dhe monitorimi i ndërtimeve të reja në periferi të fashos mbrojtëse (tampone). Evidentimi dhe planifikimi i studuar i ndërtimeve me shmangje impakti të drejtëpërdrejtë në mjedisin	Raport vjetor për konsumin e ujit m ³ /vit për cdo njësi të Agroturizmit. Numri dhe kapaciteti i njësive agroturistike dhe numri i njësive të agroturizmit me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit. Numri i instalimeve me impakt të drejtëpërdrejtë në mjedisin ujor. Numri i baseve ujore, kapaciteti i tyre dhe gjendja. Numri i ndërtimeve ekzistuese në fashon	Bashkia në bashkëpunim me shërbimin kompetent të ujrave të Prefekturës ose të Ministrisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

shmangje maksimale të raportit funksional aktivitet/burim nëntokësor.	ujor.	mbrojtëse.
Kostoja e ujit në m^3 /vit sipas tipologjisë së përdorimit. Përshkrimi i makinerive dhe pajisjeve në Studimet e Ndikimit në Mjedis. Numri i njësive vepruse me sistem Menaxhimi Mjedisor. Gjatësia dhe gjendja e sistemit hidrik.	Raport vjetor me përmbledhje e propozime të planit të menaxhimit të ujit. Raportime sistematike për gjendjen e rrjetin hidrologjik. Sistemi i informimit mbi vendodhjeen e burime hidrike të shfrytëzueshme sipas tipologjisë së tyre. Raporte mbi koston e ujit/ m^3 /vit. Raporte mbi mirëfunksionimin e instalimeve, implanteve, burimeve të shfrytëzueshme,, etj. Raporte mbi shfrytëzimin e burimeve ujore sipas konceptit mjedisor të qëndrueshmërisë mjedisore.	Bashkia në bashkëpunim me shërbimin kompetent të ujrave të Prefekturës ose të Ministritë.
Aplikimi i politikave të përshtashme të faturimit të ujit. Organizmi hapsinor, kohor dhe teknologjik i njësive operuese në rajonet ekonomike me qëllim menaxhimin e burimeve ujore. Organizimi	Përshkrimi i masave të menaxhimit të ujit në njësitet agroturistike në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Numri i njësive agroturistike	Raport vjetor për konsumin e ujit m^3 /vit për cdo njësi të Agroturizmit. Numri dhe kapaciteti i

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

i kontrollit të mënyrave të shfrytëzimit të burimeve apo depozitimeve ujore. Përdormi dhe aplikimi i risive teknologjike në shfrytëzimin e ujit. Përdormi dhe adaptimi nga njësitë operuese të Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor Organizimi dhe zbatimi i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për vaditje. Ndërtimi i një rrjeti hidrografik modern me efencë, rendiment, kosto të ulët dhe produktiv nga pikpamja e qëndrueshmërisë mjedisore.	me sisteme të kursimit të ujit Numri i njësive të agroturizmit me Sistem të Menaxhimit të Mjedisit. Numri i instalimeve sipas tipologjive që shfrytëzojnë burimet ujore. Numri i rezervuarëve, kapaciteti, disponibiliteti i tyre. Përshkrimi i masave inxhinerike mbi shkarkimet tipologjike në mjedisin ujor. Evidentimi i ndërtimeve me impakt në mjedisin ujor dhe monitorimi i ndërtimeve të reja në periferi të fashos mbrojtëse (tampone). Evidentimi dhe planifikimi i studjuar i ndërtimeve me shmangje impakti të drejtëpërdrejtë në mjedisin ujor. Kostoja e ujit në m ³ /vit sipas tipologjisë së përdorimit. Përshkrimi i makinerive dhe pajisjeve në Studimet e Ndikimit në Mjedis.	njësive agroturistike dhe numri i njësive të agroturizmit me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit. Numri i instalimeve me impakt të drejtëpërdrejtë në mjedisin ujor. Numri i baseve ujore, kapaciteti i tyre dhe gjendja. Numri i ndërtimeve ekzistuese në fashon mbrojtëse. Raport vjetor me përmbledhje e propozime të planit të menaxhimit të ujit. Raportime sistematike për gjendjen e rrjetin hidrologjik. Sistemi i informimit mbi vendodhjen e burime hidrike të shfrytëzueshme sipas tipologjisë së tyre. Raporte mbi koston e ujit/m ³ /vit. Raporte mbi mirëfunksionimin e instalimeve, impianteve, burimeve të
---	--	---

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

	Numri i njësive vepruse me sistem Menaxhimi Mjedisor. Gjatësia dhe gjendja e sistemit hidrik.	shfrytëzueshme,, etj. Raporte mbi shfrytëzimin e burimeve ujore sipas konceptit mjedisor të qëndrueshmërisë mjedisore.
--	---	--

Faktorë mjedisorë: Biodiversiteti		
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit
Trajtim parandalues me vendosjen e rrjetave dhe të infrastrukturës teknike e mjedisore. Përcaktimi i zonave me vlera ekoturistike, shkencore dhe ekonomike. Hartimi i një guide dhe aplikimi i një sistemi shfrytëzimi konfortabël me mjedisin dhe që siguron zhvillim të qëndrueshëm. Zhvillimi i studimeve faunistike dhe floristike në përgjithësi por sidomos ornitologjike dhe mamalogjike sidom në zonat e mbrotjtura, me interes ekoturistik, të ndjeshme dhe problematike. Aplikimet duhet të shmangin sipas alternative studimore ndërhyrjen drastike në biodiversitet. Të kërkohen dhe zbatohen teknologji që minimizojnë përdorimin e burimeve primare të biodiversitetit me teknologji alternative të efikacës energjitike. Shfrytëzimi i biodiversitetit sipas kritereve shkencore dhe alternuar me metoda e programe të zhvillimit të	Rajone ku do të pozicionohen parqet ekoturistike dhe zona të rëndësishme për mbrojtjen e faunës. Përmbledhje e kritereve për zhvillimin e ekoturizmit. Zbatimi i studimeve Mjedisore për projektet e infrastrukturës dhe urbanistike. Raporte mbi gjendjen e biodiversitetit dhe mënyrat e shfrytëzimit të tij.	Ministria e Energjisë dhe Industrisë për hartimin e Planit Kombëtar. Ministria e Mjedisit Inspektoriati mjedisor i njësive vendore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

qëndrueshëm.

Faktorë mjedisorë: Mbetje			
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit	Përgjegjësi i Programit të Monitorimit
Promovimi i riciklimit të materialeve të ndryshme Promovimi i bio-kompostimit nga sektori primar dhe sekondar i agrobujqësisë. Informimi i banorëve në lidhje me mundësitë dhe mënyrat e menaxhimit të mbetjeve sipas tipologjisë së tyre. Organizmi i një sistemi trajtimi me grumbullim në pika të paracaktuara, përpunim paraprak dhe destinim për në pika përpunuese teknologjike. Mundësi perspektive të ndërtimit të landfillit. Informim dhe ndërgjegjësim për menaxhimin e mbetjeve dhe krijimi i aksesit të duhur për grumbullim, ndarje me mundësi përpunimi optimal dhe shfrytëzimi për riciklim.	Numri i landfilleve të mbetjeve. Hapësirë e disponueshme e mbetur për varrosje e mbetjeve në cdo njësi. Regjistrim të numrit të eventeve informative, të përmbajtjes dhe numri i pjesëmarrësve. Sasia e mbetjeve organike që ndahen, me qëllim kompostimin e tyre. Sasia e materialeve që ndahen për riciklim (qelqi, metali, plastike, letër, etj)	Raport vjetor me të dhënat ku referohen treguesit, në lidhje me ambientet e landfilleve, por edhe të eventeve informative. Raport vjetor mbi sasitë e mbetjeve sipas treguesve, sipas të dhënave të marra nga prodhuesit e mbetjeve.	Prefektura në bashkëpunim edhe me Bashkinë. Bashkia në bashkëpunim me Prefekturat, duke mbledhur të dhëna nga prodhuesit e mbetjeve dhe njësitë e menaxhimit të tyre.

Faktorë mjedisorë: Mjedisi akustik/Zhurma		
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit
		Përgjegjësi i Programit të Monitorimit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Zhvillimi i infrastrukturës policentrike, por njëkohësisht promovimi i teknologjive bashkëkohore dhe konfortabël me mjedisin.	Ekzaminimi i projekteve të ndërtimit për njësitë e përpunimit, në mënyrë për të kontrolluar pajisjet mekanike dhe masat e izolimit akustik.	Përpos hartimit të Raportit të vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (PDV) nuk kërkohet raportim i veçantë.	Institucionet kompetente të Bashkisë për licencim do të marrin në konsideratë dhe do të shqyrtojnë studimet e ndërtimit të njësive operuese.
Organizimi hapsinor i njësive operuese. Përdormi i teknologjive bashkëkohore, aplikimi i aktiviteteve në distancë nga zonat e banuara apo me impakt akustik, sidomos faunistik. Aplikimi i izolimit akustik të ndërtesave. Organizimi hapsinor i njësive operuese në zonat eknomike	Regjistrim i numrit të njësive operuese në Bashki dhe theksim të distancës së tyre nga kufiri i zonave të banuara.	Nuk kërkohet ndonjë raport, por regjistrimi do të bëhet në sistem informativ. Raportimi i respektimin e normative aplikuese.	Regjistrimi do të bëhet nga Bashkia në bashkëpunim me Prefekturën. Ministria e Transportit dhe Bashkia, e cila do të jap mendimin e vet në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis që do të hartohen në kuadër të ndërtimit të projekteve të infrastrukturës të transportit kombëtar.

Faktorë mjedisorë: Peisazhi			
Masa të propozuara të trajtimit	Tregues monitorimi	Shpeshësia e hartimit të raportit	Përgjegjësi i Programit të Monitorimit
Zbatimi i projekteve infrastrukturore dhe urbane me arkitekturë zhvillimore konfortabël me mjedisin.	Raporti midis arkitekturës urbane dhe instrakturës me peisazhin ekzistues Shkalla e ndërhyrjes në mjedisin natyror.	Raporte sistematike për cdo projekt të aplikuar	Bashkia në bashkëpunim me Autoritetin Drejtues dhe zbatues të projekteve
Organizimi i shfrytëzimeve të tilla me strukturë	Teknologjia e zbatuar në	Raporte vjetore	Shërbimet kompetente

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

sipërfaqësore me impakt minimal estetik mjedisor. Zbatimi i teknologjive që gjenerojnë mundësi ndryshimi sa më të vogël të peisazhit. Rritja e efikasitë së shfrytëzimit për njësi sipërfaqe me mundësi ndryshimi minimal të peisazhit. Zbatimi i programeve rehabilituese për formësimin e peisazhit	hapësirën e Bashkisë. Efikasiteti i pajisjeve teknologjike. Programet e hartuara për përmirësimin e cilësisë së mjedisit.	analitike teknologjinë, gjendjen, shkakrimet, impaktet dhe sipërfaqet në m ² të përmirësuar.	të të Bashkisë. Specialistët e Ministrisë së Mjedisit
Respektimi i distancës minimale të aktiviteteve ndërtimore në zonat rurale me distancë minimale 20m nga kufiri fqinjë për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin, si rezultat i ruatjes së densitetit të ndërtimit-shfrytëzimit-gjenerimit të faktorëve impaktues të mjedisit	Numri i njësive të organizuar në hapësirën e agrobisnevit. Respektimi i kërkesave projektuese dhe ndërtuese sipas distancave paraprahe.	Raporti vjetor mbi numrin, vendodhjen dhe harta topografike e secilit objekt.	Shërbimet profesionale të Bashkisë.
Përzgjedhja e pikave të aksesueshme pa impakt në mjedisin shkencor, të kërcënuar sensibël. Përdorimi i teknikave dhe aseteve me më pak mundësi impakti negativ mjedisor. Përdorimi i mjeteve natyrore për të ruajtur harmonizimin midis elementëve natyror dhe ndërhyrjes antropogjene	Zonimi i pikave të përzgjedhura për ushtrim apo zbatim projekti. Natyra e lëndëve dhe materialeve të përdorura.	Paraqitja paraprahe me plan vendosje e pikave të përzgjedhura. Raportimi mbi teknologjinë e aplikuar	Specialistët e Bashkisë sipas sektorëve përkatës

Matrica funksionale midis Objektivave, Synimeve, Indikatorëve dhe Mënyrës së raportimit për gjendjen mjedisore nga implementimi i PPV-së sipas objektivave të VSM-së-Bashkia Librazhd.

Mjedisi	Objektivat	Synimet	Indikatorët	Raportimi	Institucioni përgjegjës
---------	------------	---------	-------------	-----------	-------------------------

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Ajri	1. Përmirësimi i cilësisë së ajrit 2. Rrugë të asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelit të zhurmave në zonat problematike të Bashkisë 4. Aplikimi në banesat e reja i materialeve termoizoluese dhe mbrojtje akustike	1. Ulja e nivelit të ndotjes së ajrit për NO₂; NO_x; CO₂; PM10; PM2.5; = deri 50% 2. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara rishtas 3. Respektim i niveleve të lejuara të zhurmës gjatë ditës dhe natës 4. Ulja e nivelit të zhurmave në mjediset e banimit.	1. Arritja e vlerave të standartit për cilësinë e ajrit lidhur me tregusit mbi normë 2. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara rishtas 3. Respektim i niveleve të lejuara të zhurmës gjatë ditës dhe natës 4. Ulja e nivelit të zhurmave në mjediset e banimit	1 & 3 raportimi 1 herë në 6 muaj 2 & 4 raportimi 1 herë në vit	1-4 Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe strukturat përgjegjëse të Bashkia Librazhd
Uji	Cilësia e ujrave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjisllacionit të Shqipërisë dhe Direktivës kuadër për ujin të BE	1. Shmangja e shkarkimeve të ujrave të ndotur në lumë. 2. Sigurimi i mos hedhjes së mbeturinave në lumë, me qëllim ruajtjen e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vëllimi i ujrave që shkarkohen në lumë apo ujra sipërfaqësore; 1b. Vëllimi i ujrave mbi normat e lejuara që shkarkohen në ujë. 2. Sipërfaqja e ndotjes (m²), vëllimi i mbeturinave (kg ose m³), lloji i mbeturinave (shkruhet emri i saktë i mbeturinave të gjetura në shtrat të lumit)	Të paktën dy herë në vit	1-2 Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Strukturat përgjegjëse të Bashkia Librazhd

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Faktorët klimatik	Kursimi i energjisë	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat për çdo projekt 2. Promovimi i paneleve diellore për gjenerim energjie në ndërtesat rezidenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	1.Sipërfaqja e objekteve (m²) me izolim adekuat 2.Sipërfaqja (m²) e paneleve të instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m²)	Raportimi 1 herë në vit	1-2 Bashkia Librazhd
-------------------	---------------------	--	--	-------------------------	----------------------

Mjedisi	Objektivat	Synimet	Indikatorët	Raportimi	Institucioni përgjegjës
Biodiversiteti	1.Identifikimi dhe krijimi i habitateve të reja dhe korridoreve të gjelbra.	1.Zgjerimi dhe permirësimi i parkut kombëtar midis zonave të ruajtura dhe tampon. Krijimi i parqeve tokësor të reja nëpër disa mjedise, Stravaj, Rrajcë, etj 2. Krijimi i mjediseve të gjelbra sipas Vendbanimeve. 3.Rehabilitimi i sipërfaqeve pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra në zonat e banimit 4.Mbjellja e drurëve, pemëve dhe shkurreve dekorative përgjatë rrugëve regjionale,	1.Sipërfaqet e reja të krijuara, sip. M² –drejt normës 8-9m²/person 2.Sipërfaqet të rehabilituara, m² = 1000-150m²/vit 3.Numri i drurëve, pemëve dhe shkurreve dekorative të mbjella = mesatarisht 1pemë /person/vit 4.Sipërfaqe të kthyer në zona të gjelbra, pjesë e koridorrit dhe zonës	1-4 Raportimi të paktën 1 herë në vit	1. Bashkia Librazhd 2. Drejtoria dhe inspektorati rajonal i mjedisit 3. Ministria e mjedisit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

		shtratit të lumit dhe mjediseve me atraksion human	tampon, në m ² .	
		5. Krijimi i korridoreve të gjelbëra dhe të zonave tampon.	Instalimi i një brezi prej 25-50 në periferi të zonës Park të shpalluar dhe zonave të propozuara në Stravaj, Rrajcë, Qukës.	

Mjedis	Objektivat	Synimet	Indikatorët	Raportimi	Institucioni përgjegjës
Mbeturinat	1. Pakesimi i sasisë së mbetjeve dhe manaxhimi i qëndrueshëm i tyre 2. Shndërrimi i hot spoteve mjedisore në sipërfaqe të gjelbra/parqe ose zona urbane	1.a. Pakësimi në burim dhe riciklimi i mbetjeve 1.b. Vendosja e sistemit me disa konteniere për ndarjen në burim të mbetjeve urbane = qyteti i Librazhdit dhe qendrat kryesore rurale, Xhyrë, Polis dhe Kuturman, Orenjë. 2. Rehabilitim/inkapsulimi i hot -spoteve në territoret industrial të mbyllura – mbyllja	1.a. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve të ricikluara. 1.b. Numri i banorëve që mbulohej nga shërbimi me konteniier. 2. sipërfaqja e pikave hot spot të rehabilitura në m ² .	1. Raportimi 1 herë në vit	2. Strukturat përgjegjëse të bashkisë 3. Operatori i trajtimit të mbetjeve Librazhd

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

		e pikës aktuale të qytetit Librazhd-2018.			
Peisazhi pyjet dhe toka	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peisazhor. 2.Mbrojtja e mjedisit natyror në hapësirat përreth vendbanimeve. 3.Ripërdorimi i tokave të ndotura. 4.Miërmëbajtje dhe zhvillim i pyjeve. 5.Kultivim i pyjeve të reja.	1. Shtimi i hapësirave të reja dhe numrit të pemëve e shkurreve. 2. Dhënie e statusit mbrojtje dhe hartimi i një plani menaxhimi mjedisor i këtyre hapësirave= Qukës, Stravaj, Rrajcë. 3. Rehabilitimi i tokave të ndotura (hot spotet mjedisore) dhe vënia në efencë për zona të gjelbëra/parqe ose banim. 4. Zhvillimi i pyjeve ekzistuese	1. Sipërfaqet në m² dhe numuri i pemëve të mbjella. 2. Progresi i zbatimit të planit. 3. Sipërfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m²) dhe e vënë në përdorim sipas PPV. 4. Sipërfaqe toke të zhvilluar pyjore (ha). 5. Sipërfaqe toke të re pyjore (ha).	Të paktën një herë në vit	Bashkia Prrënjas dhe strukturat përgjegjëse lokale e qendrave për zhvillimin e peisazhit, pyjeve dhe tokës

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

		= shtimi 40-50%		
		5. Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura = 15-25%		

Mjedisi	Objektivat	Synimet	Indikatorët	Raportimi	Institucioni përgjegjës
Trashëgimia kulturore	1.Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë ato arkeologjike.	1. Rehabilitimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore.	1. Numri i objekteve / ndërtesave me status mbrojtës 2. Numri i objekteve / ndërtesave të restauruara	1 herë në vit	Bashkia Librazhd Instituti i mbrojtjes së Monumenteve të Kulturës

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Rrugët dhe transporti	2. Riedukimi i intesitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, qarkullimi me biçikleta ku është e mundur të ndodhë	1. Zgjerimi i rrjetit rrugor për trafikun publik. 2. Zgjerimi i rrjetit të korsive për biçikleta = me sipërfaqen e infrastrukturës rehabilituese të qytetit Librazhd 3. Ndërtimi i rrugëve të reja me hapësira të përshtatshme trotuaresh (përfshirë korsitë e biçikletave). Zgjerimi i trotuareve gjatë rehabilitimit të rrugëve ekzistuese. 4. Rehabilitimi/asfaltimi i rrugëve lokale = me trend 1 njësi administrative/2 vjet	1. Km rrugë shtesë që mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsi shtesë për lëvizje me biçikleta. Numri i biçikletave në qarkullim. 3. Km rrugë të reja dhe të rehabilituara, trotuaresh dhe korsi biçikletash të shtruara, në m². 4. Km rrugë lokale të rehabilituara ose/dhe të asfaltuara.	1 herë në vit	Bashkia Librazhd Ministria e Transportit Autoritete përgjegjëse sipas linjës përkatese
-----------------------	--	--	---	---------------	--

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Mjedisi	Objektivat	Synimet	Indikatorët	Raportimi	Institucioni përgjegjës
Shëndeti banorëve	1. Promovimi për krijimin e një bashkie me të gjitha njësitë administrative dhe të qëndrueshme dhe të shëndetshme.	1. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm Konform standarteve të BE për ujrat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të destinuara për ujë të pijshëm. 2. Cilësia e ujit të pijshëm konform standartit - pa coliform, enterobacter, me mineralogji të normuar 3. Dendësia e popullsisë së qëndrueshme në vendbanimet me trend të rritjes së popullsisë = statistika vjetore e qytetit por dhe njësive administrative periferike.	1. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm kundrejt standartit të BE. 2. Cilësia e ujit të pijshëm në përputhje me standartin. 3. Dendësia mesatare për keto vendbanime.	Raportim vjetor	Drejtoria e shërbimit publik Ministria e Mjedisit Bashkia Librazhd

12. KONKLUZIONE

Plani i Përgjithshëm Vendor bazohet dhe konsideron kriteret e zhvillimit të Qëndrueshëm. Sipas analizës dhe vlerësimit, PPV-ja në përmbatje, strategji dhe objektiva ka në tërësi orientim miqësor në lidhje me mjedisin. Vlerësimi i impakteve mjedisore të implementimit të PPV-së evidenton një bilanc pozitiv në shumicën e elementëve. Në mënyrën e strukturimit, konceptimit dhe idesë së materializimit PPV-ja unifikon dimensionin mjedisor – parametrat e mbrotjes dhe mekanizmat përmirësues të mjedisit natyror, kulturor dhe social.

Gjatë implementimit të PPV shkalla e shfaqjes dhe mundësia impaktuese e ndikimeve negative është e kushtëzuar nga mënyra e zbatimit të PPV-së dhe jo nga përmbatja propozuese e saj.

Ndërkohë që nëpërmjet VSM kemi identifikuar, vlerësuar dhe parashikuar të gjitha impaktet e mundshme mjedisore të PPV-së, në referencat e kushteve të propozimeve përmbajtëse. Për zhvillimin e PPV-së në harmoni të plotë dhe të qëndrueshme me mjedisin, konform kërkesave të VSM si garanti i zhvillimit mjedisor janë propozuar masa konkrete për mënyrën e trajtimit të impakteve mjedisore. Ndërkohë për vlerësimin e zhvillimit përputhës midis veprimeve të propozuara në PPV dhe kërkesave të VSM-së për zhvillim të qëndrueshëm është hartuar program i monitorimit të impakteve mjedisore sipas përmbatjes propozuese të PPV-së dhe kërkesave të matshme të legjislacionit Mjedisor.

Vlerësimi tërësor mjedisor i PPV evidenton se impaktet pozitive të planit janë shumë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me tërësinë vepruese të faktorëve Mjedisor. Kjo është pritshmëria e hartuesëve të PPV që në ideimin e planit dhe më tej në formulimin e propozimeve përkatëse, ç'ka konfirmohet dhe garantohet akoma më tej nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

IMPLEMENTIMI I KËTIJ PLANI TË PËRGJITHSHËM VENDOR PËR BASHKINË LIBRAZHD DO TË MUND:

- Të krijoj një imazh tërësish të transformuar të qytetit të Librazhd;
- Të japë zgjidhje përfundimtare për probleme të infrastrukturës, sistemit të kanalizimeve, sistemit social, kulturor dhe mjedisit gjelbërues, çlodhës, argëtues të qytetit të Librazhd;
- Të trajtoj me efikasitet mjedisore dhe urbane zonat përreth qyteti që konsiderohen si pika të nxehta, duke i kthyer në pjesë funksionale dhe lidhëse të qytetit;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Do të mund të ndryshoj tërësisht cilësia e parametrave mjedisor të qytetit si ajri, uji, klima, zhurma, etj duke shmangur qarkullimin nacional nga qendra e qytetit dhe duke instaluar rrjetin urban të periferisë;
- Do të mund tju krijohen kushte urbane më të shëndetshme për banorët nga sistemimi i trotuareve, rrjeteve komunikuese, energjitike dhe krijimi i korsive për biçikletat;
- Zonat rurale nëpërjet sistemit infrastrukturor do të jenë pjesë e rrjetit funksional të bashkisë me tërësinë e shërbimeve sipas konceptit policentrik;
- Performanca dhe disponibiliteti i aseteve do të jetë më i madh në bashki në saj të instalimit të sistemit të menaxhimit dhe ruatjes cilësore të sistemit hidrik dhe mirëmenaxhimit të mbetjeve urbane;
- Evidentohen më së mirë asetet kulturore, historike, tradicionale, kulinare, etj duke u kthyer një nga atraksionet dhe burimet e zhvillimit ekonomik;
- Turizmi malor, ekoturizmi, pylltaria, agrobujqësia, etj tipare zotëruese dhe përshtatëse të zonës bëhen burim atraksioni vendas dhe për të huaj, burim zhvillimi ekonomik dhe social.

Përmbushja e misionit të PPV dhe të kërkesave sipas objektivave të VSM-së mbështett në faktin se:

1. Bashkia Librazhd karakterizohet nga pasuri të mëdha natyrore (flora, fauna, biodiversitet, pyje, zonave të mbrojtura, burime ujore, etj)
2. Bashkia Librazhd ka një pasuri të konsiderueshme dhe me vlera zhvillimore turistike të tipologjisë kulturore, historike, gastronomike, etj.
3. Shpërndarja hapësinore e pasurive natyrore mundëson zhvillim policentrik dhe mundësi integrimi multifunksional.
4. Pasuritë/monumentet e natyrore & kulturore përbëjnë bazën dhe mundësi potenciale të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit malor, kulinar, familjar, kulturor, etj
5. Relievi, klima, pedologjia, regjimi hidrik përbëjnë një bazë zhvillimore të sukseshme për bashkinë e Librazhdit në fushën e mbarështrimit të blegtorisë dhe të prodhimit mishit e qumështit si dhe të nëprodukteve të tyre (Zona e Polisit).
6. Menaxhimi i sfidave mjedisore ekzistuese por dhe potenciale do të krijonte suport të qëndrueshëm për zhvillimin e mirëqënies së komunitetit, të jetës urbane dhe rurale, infrastrukturës, agroturizmit, etj.

13. REFERENCA

1. Arce, R. and Gullon, N. (2000). The application of strategic Environmental Assessment to sustainable assessment of infrastructure development" Environmental Impact Assessment. Review 20, pp. 393-402
2. Çullaj A., Hasko A., Miho A., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., 2005: The quality of Albanian natural waters and the human impact (Review article). Environment International, 31, p. 133-146 (www.sciencedirect.com)
3. Çullaj A., Miho A., Baraj B., Hasko A. Bachofen R., Brandl H., Schanz F. (2003): Preliminary water quality report for some important Albanian Rivers. Journal of Environmental Protection and Ecology (JEPE), Special Issue. p. 5-11.
4. Dalal – Clayton, B. & Sadler, B. (1999). Strategic Environmental Assessment. A Rapidly Evolving Approach, London: International Institute for Environment and development.
5. Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara", Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37.
6. Fisher, T.B. (2002a). Strategic Environmental assessment Performance Criteria. The same Requirements for Every Assessment. Journal of Environmental Assessment Policy and Management, 4(1), pp83-99.
7. Fisher, T.B. (2002b). Strategic Environmental assessment in Transport and Land Use Planning, London: Earthscan Publications Ltd.
8. Glasson, J., Therivel, R. and Chadwick, A. (2012). Introduction to Environmental Impact Assessment. London.
9. Handbook on SEA for Cohesion Policy 2007-2013, Greening Regional Development Programmes Network, 2006
10. Implementation of Directive 2001/42 on the Assessment of the Effects of Certain Plans and Programmes on the Environment, European Commission, DG Environment.
11. INSTAT.GOV.AL
12. INSTITUTI METEOROLOGJIK
13. Methods of Environmental Impact Assessment, Edited by Peter Morris and Riki Therivel, 3rd Edition, 2009.
14. Morrison – Saunders, A., Arts, J. (2004). Assessing Impact – handbook of EIA and SEA Follow-up, London: Earthscan Publications Ltd.
15. Noble, B.F. (2010). Introduction to Environmental Impact Assessment. A guide to Principles and practices . oxford University Press.
16. Pani, N. (1984). Hidrology of Albania. Science Academy of Albania.
17. Qirjazi, P. (2001). Gjeografia fizike e Shqipërisë

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

18. Relacioni teknik i Planit të Përgjithshëm Vendor
19. Rise, N., Crowley, M., Vincke, Ph., Waaub, J-PH. (2003). Implementing the European SEA Directive: The member States. "Margin of discretion". Environmental impact assesement. Review, 23, pp 453-470.
20. Sadler. B. & Verheem, R. (1996). Strategic environmental assessment status. Challengers and future directions. The Hague, Ministry of housing.
21. Shërbimi gjeologjik Shqiptar. Drejtoria e Hidrogjeologjisë. Sektori i Monitorimit të Rrjetit lumor (shkurtime), 2016.
22. The Relationship between the EIA and SEA Directives, Imperial College of London, Final Report to the European Commission, 2005.
23. Therivel, R. & Partidario, M.R. (1996). The Praticce of Strategic Envinronmental Assesement, London: Earthscan Publications Ltd.
24. Therivel, R. (2004). Strategic Envinronmental assesement in action. London: Earthscan Publications Ltd.
25. Von Seht, H. (1999). Requirements of a Comprehensive Strategic Environmental Assessment System". Landscape and Urban planning, 45, pp 1-14.
26. Wood, Ch. (2003). Environmental Impact Assesement - a Comparative. Review 2. Pearson Prentice Hall.
27. www.bashkialibrazhd.gov.al
28. www.mjedis.gov.al
29. www.qpmt.al

14. PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

Qëllimi i Raportit

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë humane që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit” sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Raporti i Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të VSM për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd (PPV/2017-2030)

Hartimi i Raportit të VSM për Programe Plane Zhvillimore dhe Projekte të mëdha është detyrim ligjor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një nga kërkesat për aprovimin e çdo plani të përgjithshëm vendor (PPV) në Shqipëri, bazuar në *Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar*, si dhe në përputhje me specifikimet e Ligjit 91/2013 për “*Vlerësimin strategjik Mjedisor*” dhe ligjin 10440/2011 për *Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”.

Ligji 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor ka ratifikuar direktivën e BE 2001/42/EC (EU Directive 2001/42/EC, Mbi Vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe Programeve në Mjedis) e njohur si direktiva VSM (SEA Directive), e cila kërkon hartimin dhe miratimin e një seri planesh e programesh për një proces Vlerësimi Mjedisor në nivel strategjik. Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi është ndërthurja e kërkesave mjedisore në përgatitjen e planifikimeve dhe në procesin e vendimmarrjes, në përmirësimin e planeve që bëjnë të mundur mbrotjen dhe zhvillimin e mjedisit, sikurse dhe rritja e pjesmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes për problematika të lidhura me mjedisin. Ky proces ka të bëjë me përgatitjen e Raportit Strategjik Mjedisor dhe miratimin e tij nga autoritetet përkatëse të Shtetit Shqiptar. Përgatitja e Raporti të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për bashkinë Librazhd si pjesë argumentuese dhe shoqëruese e PPV, ka mbajtur në konsideratë kërkesat e nenit 7 të ligjit 91/2013 për fazat nëpër të cilat duhet të kalojë procesi si dhe kërkesat e nenit 10, po të njëjtë ligj, lidhur me përmbajtjen si dhe gjithë informacionin që duhet të përmbaj ky raport studimor.

Mbështetur në referencat ligjore të sipërcituara VSM përfshinë këto kërkesa:

1. Përmbledhje të informacionit bazë të përdorur për hartimin e Raportit të VSM.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

2. Përmbatja dhe objektivat kryesore të planit të Përgjithshëm Vendor dhe lidhjet e tij me planet dhe programet e tjera.
3. Një përshkrim i metodikës së zbatuar në hartimin e Raportit të Vlerësimit strategjik Mjedisor.
4. Aspekte të rëndësishme të kushteve ekzistuese mjedisore dhe shëndetsore si dhe zhvillimet e mundshme në rast se ky plan nuk aplikohet.
5. Karakteristikat mjedisore dhe shëndetsore të zonës të cilat mund të impaktohen në mënyrë të konsiderueshme nga zbatimi i planit të PPV të hartuar nga grupi i konsulencës.
6. Çështjet mjedisore që janë të përfshira në implementimin e planit dhe të programit.
7. Objektivat mjedisore të vendosura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe ato që janë të rëndësishme për planin apo programet dhe mënyrën sesi këto objektiva dhe çështje të tjera mjedisore janë marrë në konsideratë në realizimin e këtij plani apo program.
8. Pasojat mjedisore më të qënësishme, ku përfshihen ato mbi shëndetin publik, florën dhe faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, cilësinë e ujit dhe të ajrit, peisazhin, trashëgiminë natyrore, trashëgiminë kulturore, asetet materiale, etj, si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve, ku këto efekte duhet të përfshijnë edhe efekte anësore, kumulative, sinergjike, efekte afat shkurtër, të mesëm apo të gjatë; të përhershme apo të përkohshme, pozitive apo negative;
9. Masat që duhen të ndërmerren për të evituar, parandaluar, reduktuar çdo impakt mbi mjedisin dhe shëndetin, që mund të nevojiten gjatë zbatimit të planit apo programit;
10. Një përshkrim të arsyeve të përzgjedhjes së alternativave së bashku më përshkrimin se si është kryer vlerësimi, duke përfshirë këtu edhe vështirësitë e hasura në grumbullimin e informacioneve, të metat teknike dhe mungesa e njohurive;
11. Identifikimi i investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor të propozuar;
12. Masat e marra për monitorimin e pasojave mjedisore dhe shëndetësore në vënien në zbatimin të planit apo programit;
13. Pasojat e mundshme ndërkufitare në mjedis dhe shëndet publik; si dhe
14. Një përmbledhje jo teknike të informacionit të grumbulluar.

Plani i Përgjithshëm Vendor për numrin e madh dhe diversitetin e problematikave që trajton kërkon konsultim me një gamë të konsiderueshme materiali të dokumentuar. Pra bëhet fjalë për studimin e planeve, programeve, raporteve, projekteve, studimeve dhe literature teknike nga sektor të ndryshëm të ekonomisë, social, etj. Ky dokumentacion që u siguroa nga bashkëpunimi me Bashkinë Librazhd, institucione të tjera publike, kërkime në internet së bashku me materialet që posedonte grupi i punës shërbeu si suport për hartimin e raportit të VSM.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd përbën dokumentin e parë të këtij lloji që hartohet për këtë qëllim, dhe si i tillë besohet se do të mundësojë që zhvillimet e ardhshme hapësinore vendore të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin vendor mbi Mjedisin si dhe direktivat e konventat ndërkombëtare.

Proçesi i hartimit të VSM sipas metodologjisë së konceptuar kalon në disa faza që mundësojnë shkrimin e një produkti që të pasqyrojë saktë impaktin në mjedis të PPV të hartuar nga grupi i punës dhe që të mundësojë implementimin e tij sa më të qëndrueshëm nga pikpamja ekologjike (Mjedisore).

Mbi bazën e faktit të domosdoshmërisë së hartimit të raportit të VSM për Planin e përgjithshëm Vendor (PPV) për Bashkinë Librazhd u realizua faza para-vlerësuese, që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave bazike për mjedisin dhe analiza e planeve dhe programeve të tjera përkatëse nga nivele të ndryshme vendimarrëse. Mbi këto të dhëna u identifikuan një tërësi të dhënash shqetësuese por njëheraz dhe të rëndësishme për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm në hapësirën e shtrirjes së bashkisë së Librazhd. Ndër çështjet më të qënësishme të identifikuara konstatojmë: menaxhimi i mbetjeve të ngurta, cilësia e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, trajtimi i ujrave të zeza, mbrotja dhe zhvillimi i biodiversitetit, pyjeve dhe zonave të mbrojtura, trashëgimia natyrore dhe kulturore, modele të shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës, cilësia e ajrit, etj. Vlerësimi i gjendjes aktuale mjedisore dhe ballafaqimi i zhvillimit të tij në përputhje me planin e Përgjithshëm vendor u trajtua në bazë të tre skenarëve mjedisore të cilat zhvillohen në koherencë me alternativat (skenarët) e PPV dhe që analizohen në fazën vlerësuese të VSM, përkatësisht **alternativa (skenari) zero**, alternativa e të mos bërit asgjë, pa ndërhyrje strukturale strategjike në reliev, **alternativa (skenari) 01** që parashikon maksimizimin e zonave të transformimit dhe zonave në rritje brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të konsoliduar, si ato banuese ashtu edhe ato prodhuese me një sistem, të përqendruar fuqishëm tek infrastruktura lidhëse. Si dhe **alternativa (skenari) 02** që parashikon maksimizimin e ndërhyrjeve me karakter ekologjik ambienta dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban dhe ambienta në tërësi, në mënyrë të veçantë me qëllim të zvogëlimit të presioneve antropike, duke favorizuar rigjenerimin e ndërtesave në një sistem me performancë më të mirë të energjisë.

Gjithashtu kjo fazë përgatitore u shoqërua me përcaktimin e **objektivave mjedisore, qëllimet dhe treguesit** në mënyrë që të parashikohen ndikimet, por dhe njëkohësisht të përshkruhen hollësisht mundësitë e minimizimit apo eliminimit të impaktit negativ të PPV - 2030 në mjedis.

Objektivat Mjedisore të analizuar ndahen në **katër grupe**:

I - Biodiversiteti, peisazhi dhe shfrytëzimi i tokës,

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

II - Menaxhimi i mbetjeve të ngurta,

III - Mbrojtja e ujit dhe

IV - Ndryshimi i klimës dhe efikasiteti i energjisë.

Ato në pjesën më të madhe karakterizohen nga qëllimi për ta përmirësuar gjendjen aktuale të mjedisit në Bashkinë Librazhd, pjesa më e madhe e treguesve dhe e objektivave janë të matshëm dhe ato duhet të shfrytëzohen herë pas here për ta mbikëqyrë përparimin e arritjes së objektivave të caktuara.

Përkufizime për VSM

Një nga vizionet më moderne për vlerësimin e ndikimit në mjedis është institucioni i Vlerësimit Strategjik Mjedor, i cili zbatohet përmes hartimit të një studimi mjedor, në fazën primare të një plani strategjik zhvillimi, në nivel politik, projekti, programi, d.m.th jo të një projekti individual. Ky studim mjedor quhet Vlerësim Strategjik Mjedor (VSM) dhe në Evropë gjen zbatim vetëm në plane dhe programe - dhe jo në politika - në përputhje me Direktivën 2001/42 KE. Në literaturën ndërkombëtare referimi i parë për Vlerësimin Strategjik Mjedor, sipas Noble (2010), kryhet nga Wood (1989), i cili e përmend si vlerësim mjedor të politikave, planeve dhe programeve, i cili ka një karakter strategjik në lidhje me atë të projekteve individuale.

VSM merr parasysh objektivat e përgjithshme të zhvillimit të një vendi apo rajoni, efektet kumulative të planifikimit strategjik të propozuar, problemet globale mjedimore, duke lidhur planifikimin strategjik me to (p.sh. efekti serë), por edhe gjithë çështjet e tjera të zhvillimit të qëndrueshëm, për të cilat janë zhvilluar strategji evropiane dhe kombëtare dhe janë vendosur objektiva konkrete p.sh. reduktim të ndotësve serë, menaxhim të integruar të burimeve ujore në nivel baseni, menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, etj

Vlerësimi Strategjik Mjedor është një proces sistematik dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të ndikimeve mjedimore të një politike, të një plani apo programi, duke përfshirë një raport me rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit dhe me konkluzionet e studimit, me qëllim për të ndihmuar në vendimmarrje të një planifikimi strategjik (Therivel dhe Partidario, 1996). VSM është një vlerësim i parë i skenarëve alternativë dhe i propozimeve që kanë lidhje me planet e propozuara apo tashmë të miratuara, me programe dhe politika, në kuadër të një vizioni më të gjerë strategjik mjedor dhe të një sërë objektivash që duhen plotësuar. Qëllimi është që ky vlerësim të drejtojë për nga përzgjedhja e alternativave më të mira, me qëllim që në planifikim të arrihet efekti i dëshiruar (Noble, 2000).

Rëndësia e VSM

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

VSM kërkohet që të mbulojë një "boshllëk" të institucionit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve, dmth, VSM kanë mundësinë të mbulojnë disa të meta të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis. (Therivel & Partidario, 1996):

VSM janë të dobishme për shkak se ato kontribuojnë në konfigurimin e një kuadri strategjik – plani ose programi - më miqësor për mjedisin, brenda të cilit do të ndërtohen në të ardhmen projekte të ndryshme zhvillimore dhe projektete infrastrukturës (Wood, 2003). Është karakteristike, ndërsa në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shqyrtohen ndikimet mjedisore të një veprimi të planifikuar zhvillimi, me qëllim minimizimin e tyre, me VSM ngrihen pyetje me karakter parandalues, në lidhje me cilat alternativë zhvillimi është më e mirë dhe cilat objektiva duhet të plotësohen në të ardhmen (Noble, 2010).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nuk marrin parasysh efektet kumulative që rezultojnë nga projekte të tjera dhe aktivitetet në zonën e studimit, të cilat mund të jenë në fazë ndërimit apo funksionimit (Glasson et al., 2012), ndërsa VSM kanë mundësinë të vlerësojnë ndikimet kumulative.

VSM kanë mundësi për të vlerësuar në mënyrë mjedisore propozimet alternative të planeve dhe programeve, në mënyrë që zgjidhet për çdo herë ajo që është më miqësore me mjedisin, ndërsa Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shpesh herë nuk mund të merren me projekte alternative apo masa alternative për trajtimin e ndikimeve, sepse variantet e skenarëve alternativë kufizohen nga hartimi i projektit në nivel strategjik, i cili është paraprirë në kohë (Glasson et al., 2012).

Përfitimet konkrete nga zbatimi i VSM kanë lidhje me:

- Rrit ndjeshëm promovimin e parimit parandalues në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve.
- Detyron planet dhe programet strategjike për të shqyrtuar akoma edhe më shumë zgjidhje alternative, skenarë dhe propozime.
- Rrit shanset për vlerësimin e efekteve kumulative, ndikimeve sinergjike dhe indirekte, në krahasim me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve.
- Lidh ndikimet e pritura me problemet rajonale dhe globale të mjedisit.
- Forcon transparencën dhe besueshmërinë e proceseve vendimmarrëse, pasi nxit konsultimet dhe kontribuon në ndërgjegjësimin social.
- Ofron më shumë besim tek investitorët e mundshëm dhe të kushtëzuar, kontribuon në hartimin e Studimeve më të mira të Ndikimeve në Mjedis, ndërsa njëkohësisht në disa raste është i mundur edhe reduktimi i kohës së nevojshme për lejen mjedisore të disa projekteve dhe aktiviteteve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Koncepti i zhvillimit urban dhe Planit i Përgjithshëm Vendor

Njësitë e organizuara vendore janë të ngjashme me organizmat në atë ç'ka konsumojnë, burimet natyrore dhe të energjisë, proceset e përpunimit dhe nxjerrjen e mbeturinave. Shoqëria e organizuar në format e saj transformon materialet e papërpunuara pjesë e mjedisit, lëndët djegëse dhe ujin, në mjedisin e ndërtuar, biomasës të njeriut dhe të mbeturinave. Sipas Wolman metabolizmi urban është një metodë për analizimin e komuniteteve përmes kuantifikimit të inputeve - të ujit, ushqimit dhe energjisë, në outputet - ujëra të zeza, mbetje të ngurta dhe ndotës të ajrit dhe mjedisit tërësor, duke ndjekur transformin e këtyre tre flukseve në territor. Tre janë sfidat me të cilat përballen zonat urbane: 1) *menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë*; 2) *largimi i ujërave të zeza dhe* 3) *kontrollin e ndotjes së ajrit*. Në legjislacion shqiptar koncepti i Metabolizmit bazohet në përcaktimet e Nenit 2 të VKM nr. 671 datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, gjithashtu në nenin 53 përcaktohet detyrimi i hartimit të Analizës Metabolike dhe asaj të Thelluar si pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Relacioni i grupit të konsulentëve të PPV është përqëndruar në analizën e Fluksit të energjisë, fluksit të ujit, fluksit të ushqimit dhe fluksit të mbetjeve, duke identifikuar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, të cilat krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionoj si një i tërë.

Përmbatja e Planit të përgjithshëm vendor

Qëllimi primar i projektit për hartimin e Planit të Përgjithshëm vendor është rritja e kapaciteteve të menaxhimit dhe shfrytëzimit të hapësirës së bashkisë duke hartuar dhe implementuar plane dhe programe rregulluese.

Përgatitjen e planeve të fizibilitetit strategjik, programeve rregullatore dhe investimeve kapitale në përputhje me ligjet e miratuara, standardet kombëtare, të mbështetura nga qeveritë lokale bashkiake. Zbatimi i konsultimit të vazhdueshëm publik për informimin dhe edukimin e aktorëve lokal, në lidhje me rëndësinë e planifikimit bazuar në treg, të menaxhimit urban të hapësirës dhe mjedisit.

Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014, Datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe në akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe referuar VKM nr.671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, një ndër analizat e para që zhvillohet në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi, është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë, konkretisht për territorin e bashkisë Librazhd. Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bërë duke i strukturuar ato në disa kategori kryesore. Ato janë ndarë në plane apo strategji të nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor. Prej secilit dokument, janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore, të cilat mund të kenë implikime në hartimin e Planit të ri të Përgjithshëm Vendor të bashkisë së re Librazhd.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

SKENARI 00 *siguron ruajtjen e gjendjes aktuale të territorit, pa ndërhyrje strukturale strategjike në reliev.*

SKENARI 01 parashikon maksimizimin e zonave të transformimit dhe zonave në rritje brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit të konsoliduar, si ato banuese ashtu edhe ato prodhuese me një sistem, të përqendruar fuqishëm tek infrastruktura lidhëse.

SKENARI 02 parashikon maksimizimin e ndërhyrjeve me karakter ekologjik ambienta dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban dhe ambienta në tërësi, në mënyrë të veçantë me qëllim të zvogëlimit të presioneve antropike, duke favorizuar rigjenerimin e ndërtesave në një sistem me performancë më të mirë të energjisë.

METODOLOGJIA DHE PËRMBAJTJA E RAPORTIT MJEDISOR TË VSM

VSM është një metodë sistematike për marrjen në konsideratë të efekteve të planeve dhe programeve strategjike si dhe për reduktimin e disa presioneve ekzistuese ose të parashikuara mbi mjedisin në zonën ku ato do të zbatohet. Metodologjia e hartimit të VSM është në përputhje me ligjin 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili është në përputhshmëri me direktivën e BE 2001/42/CE “Mbi Vlerësimin e efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis” si dhe me ligjin 10440/2011 si dhe dokumentet në nivel BE, por edhe qasje të tjera të suksesshme që janë përdorur sot në vlerësime Planesh të ngjashme në Evropë, duke pasur si qëllim një kornizë të kuptueshme vlerësimi që identifikon pikat kritike dhe thelbësore që duhen drejtuar në vlerësimin e impakteve të mundshme në mjedis të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd.

VSM mund të konsiderohet si mjeti i përshtatshëm për të arritur në vendime të drejta mbi planifikimin për çështjet si:

- Integrimi e konsideratave mjedisore në planet strategjike/planifikimin territorial si dhe në procesin e vendimmarrjes për investimet në zonën në studim.
- Vlerësimin e alternativave të planeve të zhvillimit dhe në kontributin për orientimin e rritjes, përdorimit të tokës dhe zgjedhjeve për investimet e infrastrukturës.
- Përmirësimi i komponentëve mbrojtës të Planit ndaj mjedisit.
- Ndikimet sasiore dhe cilësore mbi burimet natyrore dhe kapacitetet mbajtëse të këtyre burimeve me qëllim pranueshmërinë e implementimit të qëndrueshëm të planit të Përgjithshëm Vendor në bashkinë Librazhd.

Ky raport i VSM ka për qëllim sigurimin e një mjeti të nevojshëm që mund të kuptohet nga të gjithë, si nga publiku ashtu edhe nga autoritetet kompetente, në përputhje me **parimet e**

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

transparencës dhe konsultimeve efektive me publikun në procesin e vendimmarrjes, që nënvizohet edhe në ligjin 91/2013 dhe në direktivën e BE 2001/42/EC.

Ky studim VSM-je është kryer në lidhje të ngushtë me Planin e Përgjithshëm vendor të Bashkisë Librazhd, i cili përmban tre komponentë kryesore:

- a. Zhvillimi social ekonomik i infrastrukturës**
- b. Organizimi hapësinor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban**
- c. Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit**

Kështu që VSM duhet që patjetër të përfshij këto tre komponentë bazë të PPV-së që në relacionin përkatës janë zbërthyer në objektiva specifike dhe projekte konkrete që materializojnë Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd. Por njëkohësisht VSM-ja synon përputhshmërinë midis elementëve struktural të PPV-së dhe kërkesave mjedisore për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj, të materializuara nëpërmjet objektivave, veprimtarive konkrete, masave të parashikuara dhe monitorimit mjedisor.

Struktura metodologjike e hartimit të VSM-së në lidhje me Planin e përgjithshëm Vendor të bashkisë Librazhd përmban këto element dhe njëpasnjëshmëri veprimi për prodhimin e produktit

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Hartimi i VSM-së është mbështetur në një paketë tërësore ligjore të miratuar në lidhje me Mjedisin nga qeveria Shqiptare dhe mjaft ligje e direktiva të BE dhe Ndërkombëtare.

Baza ligjore Shqiptare

- Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- Ligji Nr.10448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 107/2014, Datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Ligji Nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis";
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja";
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";
- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave";
- Ligji Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen ndaj zjarrit";
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, date 11.05.2009;
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- Ligji nr. 8752, datë 26-3-2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji nr. 9244, datë 2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore";
- Ligji nr. 9426, datë 2005 "Për mbarështimin e blegtorisë";
- Ligji nr. 9817, datë 22-10-2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural";
- Ligji nr. 10257, datë 25-3-2010 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji nr. 69, datë 2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore";
- Ligji nr. 130, datë 2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8752/2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji nr. 131, datë 2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9244, datë 2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore";
- Ligji nr. 9700, datë 26-3-2007 "Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimi Ndërkufikar";
- Ligji nr. 111 i vitit 2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore";
- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit";
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor";
- V.K.M. nr.587, datë 07.07.201 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike";
- V.K.M Nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore";
- VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit";
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor";
- Vendimi Nr. 99, datë 18.02.2005 i K.M. "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve";

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Udhëzim, Nr.6, datë 27.11.2007 “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”.

Direktiva, konventa mareveshje ndërkombëtare mbi të cilat bazohet VSM-ja

- **Direktiva VSM e BE-së**
- **Strategjia 2020 e BE-së**
- **Konventa Arhus, Konventa Espoo dhe Protokoli i Kievit**
- **Konventa Arhus**
- **Konventa ESPOO**
- **Protokoli i Kievit**
- **Axhenda Territoriale e B.E.-së 2020 (Territorial Agenda)**
- **Harta Leipzig për Zhvillimin e Qendrueshëm Urban**
- **Politika e Përbashkët Bujqësore 2014-2020**
- **Programi i Shtatë i Veprimt për Mjedisin që përmban:**
 - **Mbrojtja, ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror**
 - **Shndërrimi i Bashkimit në një ekonomi “të gjelbër” dhe konkurrues**
 - **Presione mjedisore dhe rreziqe për shëndetin dhe mirëqënien**
 - **Përfitimet e legjislacionit mjedisor**
 - **Përmirësimi i bazës së dijeve dhe të dëshmive për politikën mjedisor**
 - **Investime në politikën mjedisore dhe klimaterike**
 - **Inkuadrimi i distancës mjedisore në politika**
 - **Forcimi i qëndrueshëm i qyteteve**
 - **Përballja e sfidave ndërkombëtare mjedisore dhe klimaterike**

POZICIONI GJEOGRAFIK I BASHKISË LIBRAZHD

Bashkia Librazhd sipas ndarjes së re territoriale është rikonceptuar në vitin 2015. Bashkia e Librazhdit, është pozicionuar në Qarkun e Elbasanit, me një sipërfaqe totale 1 404,87 km². Kufizimet hapësinore të bashkisë Librazhd janë: në veri Bashkia Bulqizë, në jug Bashkia Prenjas, në perëndim Bashkia Elbasan dhe Tiranë dhe në lindje ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM). Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit me 10,158 banorë. Qyteti i Librazhdit, që është edhe qendra më e rëndësishme urbane Bashkisë është i ndërtuar në një terren kodrinor me pjerrësi mesatare, i cili ndërpritet nga përrenj të vegjël, por me shpate të thepisur, që sjellin ujin nga lartësitë dhe e derdhin atë në lumin Shkumbin. E gjithë forma e terrenit ku është ndërtuar Librazhdi, është “modeluar” nga bashkëveprimi i këtyre përrenjve me kodrën. Janë pikërisht fashat natyrore të këtyre përrenjve, që e ndajnë qytetin në sektorë banimi, në të cilët mbizotërojnë këto tipologji banimi:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- “apartamente banimi kolektive 4-5 kate”
- “vila individuale ose disa-familjare”
- “qyteti organik-spontan në kodër”
- “vargëzim i hapur apartamentesh 5 katëshe në kodra”

Koordinatat e bashkisë Librazhd janë: **X = 44 42 670.618805 dhe Y = 45 61 222.827519**. Lartësia 249 m mbi nivelin e detit.

Organizimi i sotëm i Bashkisë Librazhd përfshin në strukturën hapsinore të saj ish Bashkinë Librazhd dhe njësitë administrative Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis dhe Orenjë. Popullsia totale është 44,181 (censusi 2011, 31,892) banorë, me sipërfaqja shtrirje 793.36 km².

Qendra administrative e Bashkisë, qyteti i Librazhd është një qytet i shpallur si qendër administrative në vitin 1958 dhe si qytet më 18 Shkurt 1960 me dekret Nr. 3060 të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërsë. Librazhdi ka një pozicion të lidhur me rrugën “Via Egnatia” një nga nyjet më të rëndësishme midis Konstandinopojës dhe Romë. Gjurmët e zhvillimit takohen që në periudhën e Gurit të Vjetër (Paleolit). Materialet arkelogjike të periudhës së Mezolitit dhe Neolitit tregojnë për historinë ekonomike, shoqërore të këtij vend banimi. si ri dhe nuk mbart ndonjë trashëgimi kulturore të spikatur nga e kaluara. Në 50 vitete e fundit qyteti është karakterizuar nga një dinamizëm zhvillimi kulturor, ekonomik, tregëtar, industrial, etj. Ndërkohë që nuk mund të konstatohet e njëjta gjë në lidhje me zhvillimin e turizmit, ekoturizmit, shfrytëzimin e burimeve hidrike, promovimin e e pasurive natyrore dhe historike si vlera atraktive për potencial ekonomik.

Aktivitet kryesore të zhvilluara në qytetin e Librazhdit janë tregëtia, zejtaria, industria e përpunimit të rrushit, drurit, etj. Ndërkohë që territori aktual i Bashkisë që përfshin disa njësi administrative paraqitet mjaft i larmishëm në relief, kulturë, traditë, zhvillim, biodiversitet, vlera kulturore dhe historike, të cilat nuk janë kthyer plotësisht në element të atraksionit dhe zhvillimit social-ekonomik. Sipërfaqet pyjore janë mjaft të zhvilluara dhe përbëjnë një nga elementët më të qënësishëm për zhvillimin rajonal.

E pozicionuar në zonën midis Bashkisë Prrenjas dhe Elbasan si pjesë e korridorit VIII, nga linja hekurudhore, nga shtrati i Lumit Shkumbin dhe mjaft lumenj të tjerë më të vegjël (Rrapuni, Gostime, etj), kjo bashki duhet konsideruar si një njësi me rëndësi në rajon. Njësia administrative Librazhd, gjithashtu merr rolin kryesor administrativ në bashki, pasi në territorin e saj është pozicionuar institucioni administrativ i bashkisë, dhe të gjitha aktivitetet dhe njësitë operuese kryesore duke e bërë një qendër dytësore rajonale me mjaft rëndësi.

Shtrirja e Bashkisë është karakteristikë e zonave neotektonike në pjesën kontinentale. Bashkia shtrihet në dy nivele strukturale: Zona e horsteve formuar nga malet rrethuese të luginës dhe

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

grabeneva që është pellgu i Librazhdit dhe më gjerë. Pellgu i Librazhdit është krijuar në miocen. Ndërkohë që në pliocen – Kuaternar është formuar relievi kodrinor i Librazhdit. Struktura gjeotektonik e maleve e kodrave si dhe pellgut të Shkumbinit është sinklane. Zona e bashkisë përfaqëson një trevë me rëndësi historike dhe kulturore. Midis gjurmëve historike ajo çka përbën më të qënësishme dhe burim rivitalizimi të zonës në aspektin turistik është rruga Egnatia, ku përgjatë lumit Shkumbin si në Mirak, Babje gjenden gjurmë të rëndësishme. Por dhe në njësitë administrative ka plot gjurmë të kulturës së Kandravisë.

Mjedisi biologjik

Referuar informacioneve zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Rrjetit të zonave të mbrojtura te vitit 2014 të përgatitur nga *Drejtoria e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura, sektori i zonave të mbrojtura, ne territorin e bashkise se re Librazhd ndodhen Zonat e mbrojtura si më poshtë:*

- **Parku Kombëtar Shebenik – Jabllanicë**, kategoria II, me sip. 33,927.7 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.640, datë 21.05.2008;
- **Parku Natyror Rajonal Kuturman**, kategoria IV, me sip. 3,600.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri shpallur me Rreg. MB nr.1, datë 27.7.1977;
- **Parku Natyror Rajonal Polis**, kategoria IV, me sip. 45.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- **Parku Natyror Rajonal Dardhë - Xhyrë**, kategoria IV, me sip. 400.0 ha pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Harta e Monumenteve të Natyrës



Figura 8. Harta e shpërndarjes së monumenteve të Natyrës.

ZONAT PROBLEMATIKE TË NDOTURA, “HOT SPOT”ET

Një nga problematikat e ndotjes mjedisore është krijimi i zonave të ndotjes që njihen si Hot Spot. Për shkak të gjenerimit në rritje të prodhimit të mbetjeve të ngurta dhe depozitimi i pakontrolluar i tyre kryesisht me origjinë industriale, urbane, bujqësore, teknologjike, etj janë krijuar zona të ndjeshme mjedisore. Praktikisht zonat më problematike ndodhen atje ku përqëndrimi i popullsisë është më i lartë, pra kryesisht në zonat urbane, qytete, kështu si pika më të ndjeshme të ndotjes mjedisore nga ky proces vlerësohet **vend grumbullimi i mbetjeve urbane të qytetit Librazhd**. Kjo është e lidhur me:

- ❖ **Së pari mbetjet urbane të gjeneruara nga aktiviteti familjar apo shërbimet sociale** të cilat kanë ngarkesë mekanike, kimike, fizike, bakteriologjike, organike, etj
- ❖ **Së dyti mbetjet me origjinë spitalore** të cilat përmbajnë përpos elementëve të zakonshëm edhe mbetje profesionale apo kirurgjikale që ngarkesës fizike të tyre i shtojnë potencën dhe aktualitetin e infeksioneve të ndryshme.
- ❖ **Së treti Mbetjet industriale dhe ndërtimore** përbëjnë një burim në rritje të ndotjes. Kjo është e lidhur me shtimin e veprimtarive industriale dhe ndërtimore të cilat karakterizohen nga gjenerimi i mbetjeve me ngarkesë fizike dhe me ngarkesa kimike specifike (lëndë kimike, solucione, kimikate, përmbatje elementesh kimikë, etj) të konsiderueshme çka krijojnë premisa për zhvillime procesesh agresive me emetime ajrore, infiltrime tokësore dhe nëntokësore, ndotje ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, me krijimin e aromave të pakëndshme, etj. duke impaktuar negativisht fenomenin e aerobiozës.

Këto mbetje në mënyrën e grumbullimit, transportit, depozitimit dhe trajtimit të tyre krijojnë zona me ndjeshmëri mjedisore dhe komunitare të lartë. Praktikisht depozitimi i tyre është problematik sepse:

- ❖ Së pari lidhet me pozicionin dhe mënyrën e depozitimit të tyre me hedhje sipërfaqësore në një zonë në dalje të qytetit, pjesa veriore dhe në raport me rrjedhjet ujore të shoqëruara me pjerrësi.
- ❖ Sipas studimit të realizuar rezulton se banorët e qyteti të Librazhdit gjenerojnë një sasi të konsiderueshme mbetjesh të ngurta të vlerësuar në 466kg/banor/vit, llogaritur me 4 700 000 kg mbetje vjetor (vlerësimi merr në konsideratë numrin e popullsisë).
- ❖ Pozicioni gjeografik dhe hidrologjia e zonës nuk favorizojnë krijimin e pikave grumbulluese të përshtatshme. Pjerrësia e zonës, aftësia infiltruese, prezenca e ujrave nëntokësore të shumta dhe njëkohësisht e burimeve sipërfaqësore nuk favorizojnë depozitimin tradicional të mbetjeve të ngurta.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- ❖ Kohë qëndrimi në pikat e grumbullimit, ekspozimi ndaj fenomeneve atmosferike, kontakti afat gjatë me ajrin, mundësia për zhvendosje të lirë, mos sigurimi i kërkesave të kërkuara për mjedise landfilli rritin ndjeshëm rrezikun mjedisor dhe antropogjen.
- ❖ Regjimi klimatik i zonës me reshje të shumta dhe intesive mundëson zhvendosje mekanike dhe krijimin e rrjedhjeve me ngarkesë që kalojnë me infiltrim në strukturën e tokës duke tjetërsuar parametrat fiziko-kimik të saj por dhe të ujrave nëntokësore.
- ❖ Mbetjet e ekspozuara në vendgrumbullim tërheqin shpendët që ushqehen me to, shpesh tufa shpendësh që siç dihet përmbajnë shumë krimba zorrësh, një numër të madh baktere fekalesh koliform (*coliform*) dhe baktere kamfilobakter (*camphylobacter*), të cilat për një kohë të shkurtër mund të kontaminojnë burimet ujore. Evidencat sugjerojnë se shpendët, dhe jo ujërat e trajtuara të kanalizimeve, janë përgjegjëse për kamfilobakterin në ujin e pijshëm dhe ujin për larje. Gjithashtu ekziston rreziku i infektimit të njerëzve nga Gripi i Shpendëve (*CDC Avian Influenza*). Këto zona gjithashtu tërheqin kafshët parazitare që mbartin sëmundje, përfshi minjtë e kanaleve, të cilët janë në vetvete transmetues të sëmundjeve. Prandaj janë të domosdoshme masat për reduktimin e ndikimeve nga shpendët dhe kafshët parazitare dhe më në përgjithësi rehabilitimi i vendgrumbullimit të mbetjeve në bashkinë Librazhd.

Sipërfaqet ujore të ndotura

Bashkia e Librazhdit karakterizohet nga sipërfaqe ujore të konsiderueshme për shkak të prezencës së lumit Shkumbin dhe furnizuesëve kryesor të tij si Rrapuni, Bushtrica, Gostima dhe mjaft burime të tjera më të vogla që rrjedhin në të dy shpatet formuese të tij, por jo vetëm në territorin e Bashkisë Librazhd por edhe më lart që përkon me Bashkinë Përrenjas. Praktikisht si sipërfaqe ujore më e ndotur paraqitet rrjedhja e lumit **Shkumbin** dhe ajo **Rrapun** që mund ti konsiderojmë si **pika ujore “hot spot-e”**. Kjo lidhet me faktin se:

- I gjithë sistemi i kanalizimeve urbane (familjare, sociale, spitalore, tregëtare, etj) derdhen direkt në shtratin e lumit Shkumbin duke patur ngarkesa kimike, fizike e bakteriologjike mjaft të lartë çka krijon një zonë nga Dragostunja deri në kthesat e Murrashit mjaft kritike dhe me ndotje të lartë. Kujtojmë se vetë Shkumbini karakterizohet nga shkallë e lartë turbullimi për shkak të **tre faktorëve kryesor**:
 - Veprimtaria industriale e pakontrolluar në strukturë menaxhuese sipërfaqësore të minierave që ushtrojnë aktivitet kryesisht në zonën e Bashkisë Përrenjas dhe pjesërisht Librazhd;
 - Prezenca e dukshme e fenomenit të erozionit shkaktuar për vetë natyrën e relievit por dhe si pasoj e ndërhyrjes agresive të njeriut qoftë për hapje rrugësh të pa studjuara gjeologjikisht, ndërtime spontane, shpyllëzime masive, etj;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Shtimi dhe përdorimi i metodave tradicionale në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

- Aktiviteti agrokimik (përdorimi i pesticide dhe plehra kimike), zhvendosja masive e dherave me ngarkesë kimike përbëjnë faktor me impakt në ndotjen ujore sipërfaqësore.

Ndërkohë si pikë me shkallë të lartë ndotje paraqitet pjesa fundore e zonës së Rrapunit për shkak të shkallës së lartë të erozionit dhe raportit të afërt me pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane.

Së fundi ndjeshmëria e saj zone është rritur për shkak të ndërtimit të hidrocentralit të Rrapunit i cili ka ndryshuar debitin ujor dhe mundësinë për vetfiltrim dhe pastrim duke krjuar një hot spot të dytë potencialisht në rritje.

Mbetjet ujore dhe ujrave të zeza

Komuniteti dhe shërbimet e aktiviteteve ekonomike, gjenerojnë mbetje ujore të patrajtura me tipologji të ndryshme:

- Mbetje ujore shtëpiake;
- Mbetje ujore industriale;
- Mbetje ujore sanitare;

Problemi kryesor ka të bëjë me sistemin e kanalizimeve dhe destinacioni përfundimtar i tyre. Secila tipologji mbetje e lëngët nuk i nënshtrohet paratrajtimit në burim por kalojnë direkt në sistemin e kanalizimeve, ndërkohë që ky rrjet jo vetëm nuk është i mirë por dhe kapaciteti i tij nuk i përgjigjet ritmit të ndryshimit demografik dhe aktiviteteve të instaluar. Ndërkohë që në zonat rurale trajtimi i mbetjeve ujore dhe ujrave të zeza nuk ekziston dhe shkarkimi i tyre bëhet me anë të gropave septike ose direkt në rrjedhje të lirë. Kjo krijon predispozitë për infeksione të ndryshme.

Toka dhe erozioni

Toka e zonës paraqet strukturë komplekse dhe me relieve variacionale nga fushore në kodrinore deri malore. Një pjesë e tyre janë rezultat i shpyllëzimeve të cilat tashmë kanë filluar të popullohen nga flora natyrale barishtore, shlikurore dhe drunore. Ndërkohë që një pjesë e mirë janë kthyer në vreshtari apo kultivuar me drurëfrutor autokton apo të introduktuar.

Por krahas këtij fenomeni me impakt pozitiv, konstatohet shpyllëzime masive jo vetëm nga prerja por dhe mënyra e transportit duke hapur rrugë kalimi me rrëshiqte, ç'ka ka rritur ndjeshëm erozionin dhe njëheraz pamundësi rigjenerimi të biodiversitetit duke kërcënuar seriozisht llojet endemike apo subendemike me status. Erozioni vepron në kundërshtim me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Ky është i lidhur me mos mirëmbajtjen apo dhe shkatërrimin e veprave me karakter inxhinierik e agronomik për parandalimin e erozionit sidomos në zonat hidrike dhe me pjerrësi të madhe, si dhe nga ndërtimi i HEC-ve në shtratin e lumit Stravaj (7), Lingajca (2) dhe Bushtricë (7).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Në tërësinë e faktorëve që ndikojnë në fenomenin e erozionit sikurse janë faktorët klimaterike, tokësor, relievi, vegjetacioni, etj, rezulton se faktori antropogjen ka ndikuar së tepërmi në ndryshimin e mjedisit vegjetativ sidomos në zonat larg qendrave të banuara, në mos disiplinimin dhe menaxhimin e ujrave sipërfaqësore e nëntokësore, në mbishfrytëzimin e kullotave, në hapjen e rrugëve pa studime gjeologjike paraprake, etj.

Erozini i ndjeshëm në zonë është i lidhur me:

- Degradimi i mbulesës natyrore (mbikullotje, zjarre, shpyllëzime)
- Modifikimi i topografisë (qendra urbane, ndërtimi i rrugëve)
- Politika e administrimit të ujrave (kanalizime, vepra hidrike, barriera, etj)

Si dhe mos marrjen e masave të lidhura me:

- Ruatja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të rrezikuara nga erozioni nëpërmjet pyllëzimit, ndërtimit të brezave mbrojtës, ndërtimit të barrierave, etj
- Ndërhyrja topografike duke ndërtuar taraca dhe mure mbrojtëse
- Modifikimi natyral i profilit të rrjedhjes së ujrave sipërfaqësore
- Parandalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve
- Ndërtimi veprave mbrojtëse
- Parandalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve

Një tjetër fenomen i konstatuar është fragmentarizimi i tokës dhe uzurpimi i tokës aktive për sipërfaqe ndërtimi banese apo çdo lloj objekti tjetër me karakter ekonomik apo depozitues (magazina).

Mjedisi biologjik.

Sikurse është përmendur më lart territori i bashkisë Librazhd është shumë i pasur në mjedis biologjik. Problematika e hasur ka të bëjë me mënyrën e menaxhimit, shfrytëzimit të natyrës dhe krijimit të ballancave të qëndrueshme. Në lidhje me biodiversitetin si çështje të ndjeshme madje të konsideruara si hot spot i akumuluar është shfrytëzimi masiv dhe pa krite i pyjeve (kryesisht në zonën e Polist, dardhës, Lunikut, etj) dhe mënyra e menaxhimit të burime hidrike nga ndërtimi i hidrocentraleve ku praktikisht gjenden në stade të ndryshme pune:

- | | |
|------------------------------------|------------------------------|
| ➤ Rrjedha e lumit Gostimë (Gaferr) | 7 HEC-e ish-komuna Polis |
| ➤ Rrjedha e lumit Gurakuqit | 9 HEC-e ish-komuna Orenjë |
| ➤ Rrjedha e lumit Sheh Librazhd | 6 HEC-e ish-komuna Qendër |
| ➤ Rrjedha e lumit Lunikut | 5 HEC-e ish-komuna Lunik |
| ➤ Rrjedha e lumit Rrapun Qarrishtë | 9 HEC-e ish-komuna Qendër |
| ➤ Rrjedha e lumit She Hotolisht | 5 HEC-e ish-komuna Hotolisht |
| ➤ Rrjedha e lumit Gurrëshpatë | 2 HEC-e ish-komuna Polis |
| ➤ Rrjedha e lumit Stebleve | 2 HEC-e ish-komuna Stebleve |
| ➤ Rrjedha e lumit Borove | 2 HEC-e ish-komuna Stebleve |

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

- | | |
|---------------------------------------|-------------------------|
| ➤ Rrjedha e lumit Gurrëkuqe | 1 HEC ish-komuna Qendër |
| ➤ Rrjedha e lumit Fushë-Gurrë Zdrajsh | 1 HEC ish-komuna Orenjë |

Praktikisht konstatohet një shfrytëzim pa kriter madje i tejskajshëm me ndërhyrje drastike në regjimin hidrik duke devijuar gati në 100% të totalit ujëmbajtës për në veprat hidrike të ndërtuara (kujtojmë se 33% e regjimit ekzistues ujqor nuk duhet prekur), por dhe koha e shfrytëzimit në ditë pune vjetore. Kjo ka sjellë pasoja të rënda për mjedisin biologjik (florën dhe faunën akuatike). Problematike paraqitet biodiversiteti i lumit Shkumbin për shkak të mënyrës së shfrytëzimit dhe depozitimit të inerteve, derdhjeve urbane, bujqësore dhe industriale të kontaminuara të cilat modifikojnë parametrat fiziko-kimik dhe mikrobiologjik të trupit ujqor duke kërcënuar ekosistemet ujqore dhe lloje të caktuara sikurse është trofta e malit. Vlen të konstatojmë gjendjen e rrapishtë përgjatë rrjedhjes së lumit Shkumbin ku gati 15-17% e drurëve ekzistues kryesisht me moshë të madhe janë tharë.

Objektivat e planit të Përgjithshëm Vendor

Në nenin 20 të ligjit Nr. 107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcaktohet:

1. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:

- a) Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
- b) Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;
- c) Drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;
- ç) Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- d) Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- dh) Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike dhe shërbimet publike, sipas këtij ligji;
- e) Rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

2. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

OBJEKTIVAT DHE VIZIONET PRIORITARE TË BASHKISË LIBRAZHID

Objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Librazhdit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHDI

Bazuar në punën e grupit të projektimit në bashkepunim edhe me autoritetet vendore dhe të qarkut, janë shtruar qëllimet strategjike të cilat më pas janë zbërthyer në objektiva. Këto janë frut i analizave të informacionit të grumbulluar gjatë seminareve ku me kontributin e të gjithë aktoreve pjesëmarrës janë përcaktuar prioritetet dhe vizioni i ardhshëm i qytetit të Librazhdit.

- Fuqizimi i sektorit privat në Librazhd me fokus kryesor magazinimin dhe tregëtinë rajonale;
- Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Librazhdit;
- Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet, si elementi më i domosdoshëm për rritjen e kapaciteteve të komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale;
- Rikonceptimi i mënyrës së menaxhimit të territorit në bashkinë Librazhd bazuar në pjesëmarrjen demokratike dhe transparente të gjithë aktorëve të fushës së zhvillimit me qëllimin kryesor zhvillimin ekonomik të qytetit;
- Përmirësimi i kualitetit të banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Librazhdit;
- Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin qytetarit si "klient";

Objektivat e Planit

Ky plan rregullues duhet të përcaktoj strukturën më të favorshme të zhvillimit të ardhshëm të qytetit të Librazhdit. Kjo strukturë duhet të respektojë në maksimum vlerat natyrore dhe historike të territorit ku ndodhet qyteti. Përveç kësaj objektivat kryesore që duhet të mbahen parasysh gjatë hartimit të Planit janë si më poshtë:

- Shfrytëzimit të **avantazheve që vijnë si rezultat i rajonit** ku është vendosur Librazhdi si edhe **rivitalizimit dhe bërjes së lexueshme të elementëve qytetformues**;
- Rikonceptimit të "makrostrukturës" së qytetit përmes konceptimit dhe **krijimit të "fashës së pajisur" multifunksionale** që do të mbështes tezën e "Librazhdit qytet Rajonal". Kjo do të kërkoj kryesisht ndërtimin e strukturave të reja me këtë përjasje;
- Realizimit të **lidhjeve sa më optimale të qytetit me superstradën dhe përcaktimi i funksioneve dhe kufinjve në qasjen direkte me të**;
- **Rritjes së gamës së funksioneve ekzistuese** në qytet, me fokus kryesor rritjen e hapësirave publike, të gjelbra dhe argëtuese;
- Identifikimit të hapësirave të nevojshme për **vendosjen e bizneseve** brenda territoreve të qytetit dhe në zona të reja;
- **Integritimit të vendbanimeve të parregullta** në periferi me pjesën tjetër të qytetit ;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Identifikimit të mekanizmave të nevojshëm teknike / urbanistike dhe administrative për përmirësimin e hapësirave të brendshme të njësive të banimit;
- Përcaktimit të mekanizmave të nevojshëm urbanistike për sigurimin e banesave sociale;
- Përcaktimit të përdorimeve sa më optimale për sipërfaqet e pashfrytëzuara brenda vijës kufizuese ekzistuese, si edhe të zonave apo objekteve ish-ekonomike të cilat aktualisht janë jashtë funksionit;
- Identifikimit të hapësirave të reja të shtrirjes së qytetit dhe të përcaktimit të destinacioneve të tyre;
- Përcaktimit të skemës së përgjithshme të rrjetit rrugor dhe mënyrës së funksionimit me synim kryesor lehtësimin e lidhjeve nga sektori në sektor;
- Përcaktimit të kufirit të sipërm (në kodra) të rritjes së qytetit;
- Përcaktimit të një “lidhësi lumor” që do të shërbej për të “afruar” qytetin me lumin si elementi kryesor qytetformues;
- Bashkërendimit të skemës së re të zhvillimit të qytetit me rrjetin e përgjithshëm të infrastrukturave (ujësjelles, kanalizime, furnizim me energji elektrike, telefoni);
- Përcaktimit të qartë të njësive strukturore të qytetit sipas të cilave do të hartohen studimet urbanistike pjesore për të gjitha pjesët e qytetit; dhe formulimit të qartë për secilën prej tyre të kushtëzimeve urbanistike, treguesve urbanistike e shërbimeve sociale të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të studimeve urbanistike pjesore.

VIZIONI I BASHKISË

Bashkia Librazhd është e pozicionuar në korridoret më të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare, me historinë e tij, bukuritë natyrore të pakrahasueshme, biodiversitetin e rrallë e të larmishëm, vlerat etnografike dhe folklorike, mikpritjen, qetësinë dhe ajrin e pastër. Nëpërmjet hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor synohet që Bashkia Librazhd të jetë vendi i mundësive të shumta për zhvillimin ekonomik dhe turistik duke u mbështetur në elementët e mëposhtëm:

- ❖ Aksesit dhe lidhja shumë e mirë me rrjetin kombëtar dhe korridoret më të rëndësishme ndërkombëtare;
- ❖ Toka bujqësore do të trajtohet si resurs primar për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, për rritjen e punësimit në këtë sektor dhe rritjen e mirëqenies.
- ❖ Librazhdi si pikë stacionimi historike;
- ❖ Ekzistenca e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe mjaft zonave të mbrojtura në të dyja anët e lumit Shkumbin;
- ❖ Shtrirja dhe aksesueshmëria e luginës së Shkumbinit si vendosje mbis dy shtrirjeve varg malore;
- ❖ Traditat kulturore – historike;
- ❖ Potencialet që ofron Bashkia për popullsinë vendase.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Lidhja midis Projekteve Strategjike të parashikuar në Planin Strategjik dhe objektivave të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Projektet strategjike	OBJEKTIVAT E PLANIT TË PËRGJITHSHËM KOMBËTAR							
	Objektivat e përgjithshme	Planifikimi dhe zhvillimi i territorit	Politikat	Sistemi Urban	Sistemi Natyror	Sistemi Bujqësor	Sistemi Ujor	Sistemi Infrastruktural
01.U	✓	✓	✓	✓				
02.U	✓	✓	✓	✓				
03.U	✓	✓	✓	✓				
04.U	✓	✓	✓	✓				
05.N	✓	✓	✓	✓	✓			
06.N	✓	✓	✓		✓			
07.N	✓	✓	✓		✓			
08.A	✓	✓				✓		
09.A	✓	✓				✓		
10.W	✓	✓					✓	
11.I	✓	✓	✓					✓
12.I	✓	✓	✓					✓
13.I	✓	✓	✓					✓

KRITERET PËRJASHTUESE TË ZBATIMIT TË PPV-së KONFORM VSM-së

Veprimet operationale të planifikuara në PPV sipas fushës përkatëse të parashikuar në ligjin e Planifikimit Hapësinor duhet që të jenë dhe në përputhje me ligjin për VSM-në. Praktikiht ekzistojnë kriteret mjedisore që duhen parashikuar dhe që kufizojnë zhvillimin hapësinor të Bashkisë, kriteret që kufizojnë mundësitë në tejkalim të PPV.

Këto kriteret përjashtuese kanë të bëjnë me:

Kriteret 1: kufizuese, strikte dhe të forta mjedisore dhe shëndetësore;

Këto janë kriteret që përcaktojnë dhe kushtëzojnë zonat të cilat nuk mund të përfshihen në planin e Përgjithshëm vendor të zhvillimit të Bashkisë, por që duhen mbrojtur dhe të jenë pjesë integrale e PPV në zbatim. Këtu përfshihen:

- f. Zonat me vlera të veçanta Mjedisore** (zonat e mbrojtura të natyrës sipas statusit që gëzojnë apo parashikohen të propozohen si të tilla, si Parku Kombëtar Shebenik – Jabllonicë, zona e mbrojtur e Kuturmanit, Dardhë-xhyrë, Polisit, baseni i lumit Shkumbin në fashon blu);

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

- g. Zonat që paraqesin rrezikshmëri** për zhvillimin urban, infrastrukturor, etj të bashkisë (zonat e cilësuar si me rrezik rrëshqitje si shpatet formuese të shtraterëve të lumit, zonat me pjerrësi më të madhe se 25%);
- h. Zonat e ndotura ose më saktë ato të paraqitura si hot-spote mjedisore** (zona e ish zonës industriale, pranë vend depozitimit të mbetjeve midis qytetit të Librazhdit dhe fshatit Togës, pranë instalimeve industriale, apo teknologjike me shkarkime sinjifikative në mjedis sikurse linjat e prodhimit të material ndërtimeve apo të përpunimit agrobujqësor e blegtorial)

Gjithashtu përmendim:

- Kështu mund të konsiderohen zonat përgjatë lumenjëve (duke siguruar një fasho blu) apo burimeve të ndryshme hidrike, zonave të identifikuara si biokoridore kryesore apo sekondare, etj.
- Shtretërit e lumenjëve dhe zonat buferike të tyre duke respektuar kërkesat ligjore për vijën blu duke respektuar një distancë sipas relievit, rrjedhjes deri 50m.
- Basenet nëntokësore ujëmbajtëse apo dhe pranë apo në drejtim të rrjedhjes natyrore hidrike të rezervuarëve të përmendur më sipër;
- Mos lejimi i ndërtimeve në tokat produktive për qëllime banimi.
- Zonat me pjerrësi më të madhe se 15 apo 20%.

4. Kriteria që kushtëzohen nga trashëgimia kulturore/historike;

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhet të evidentohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor (përkojnë me zonat e cituara në pjesën e vlerësimit të monumenteve kulturore, historike, kujtojmë via Egnatia, objekte historike në Kuturman, Polis, Babje, Spathar, etj.).

5. Kriteria që kushtëzohen nga prezenca dhe kërkesa për zhvillim të peisazhit

Bashkia Librazhd në shtrirjen e saj hapësinore ka vlera të larta dhe të shumta peisazhike të llojeve të ndryshme sikurse janë peisazhet e krijuara nga pyjet, malet, liqenet, livadhet, shtrirjet luginore, sipërfaqet malore apo kombinime të tyre. Kriteret peisazhike është shumë e vështirë të përcaktohen prandaj duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen vlerësuar në bashkëpunim dhe pajtueshmëri ndër-institucionale. Peisazhi duhet konsideruar si pasuri turistike dhe duhet të përbëjnë element të zhvillimit ekoturistik të Bashkisë. Për të mundësuar mbrotjen dhe zgjerimin e tyre zonat peisazhike duhet të trajtohen me kujdes duke minimizuar ndërhyrjen e faktorit antropogjen. Veprimtaria antropogjene më impaktuese e këtyre vlerave është shfrytëzimi minerar, shfrytëzimi i pyjeve, zjarret, hapja e karrierave, etj.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Si zona që duhen mirëmenaxhuar dhe ku duhen ndaluar ndërtimet (me përjashtime studimore të lidhura me përdorim materiale shpallur si të tilla apo në fashon e gjelbër tampo të tyre.;

- Zona e parkut kombëtar Shebenik – Jabllonicë, zona e mbrojtur e Kuturmanit, Polisit, Dardhë-Zhyrë dhe zonat në studim për tu shpallur si të tilla apo në fashon e gjelbër tampo të tyre.;
- Livadhet dhe zonat kullosore;
- Peisazhet bujqësore që për një periudhë të caktuar të vitit përbëjnë element atraktiv;
- Malet e Shebenikut, Polisit, Letmit, Lugina e Shkumbinit (periferia lumore), etj.

6. Kritere me kushtëzim inxhinierik dhe infrastrukturor.

Relievi, topografia dhe gjeologjia e shtrijes së bashkisë Librazhd kërkon që paraprakisht për çdo ndërhyrje infrastrukturore të evidentohen zonat që paraqesin rrezikshmëri të lartë sizmologjike, mundësi rrëshiqtje, që nuk kanë strukturë të qëndrueshme dhe kompakte për shmangjen e një investimi të paqëndrueshëm dhe me kosto financiare. Ndërkohë që planifikimi urban duhet të marrë në konsideratë respektimin e distancave ndërtimore nga akset rrugore apo hekurudhore, ndërtimin e korsive për lëvizje me biçikletë, dhe në mënyrë të ngjashme duhen trajtuar ndërtimet e sistemeve të kolektorëve të ujrave të zeza dhe urbane. Sistemi i ujrave të bardha dhe të zeza të jetë evidentuar në sistemin GIS, duke mundësuar ndërhyrje për çdo të papritur të mundshme. Linja elektrike dhe telefonike të jetë e shënuar në sistemin GIS dhe çdo ndërtim duhet të respektoj distancën e kërkuar nga këto sisteme shërbimesh të përbashkëta komunitare.

OBJEKTIVAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM – PËRFSHIRJA E OBJEKTIVAVE NË PLAN

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR

Qeveria shqiptare ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Kombëtare mbi Mjedisin në kuadër të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Po kështu është hartuar dhe miratuar një paketë e tërë ligjore mbi mjedisin tërësisht në përputhje me legjislacionin Europian dhe ndërkombëtar. Si ligje më të qënësishme që kanë të bëjnë me sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të hartuara dhe miratuara nga qeveria Shqiptare përmendim *ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin strategjik Mjedisor”, ligjin 1040/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”* si dhe *ligjin 10431/2011 “Për Mbrotjen e Mjedisit”*.

Masat ndërhyrëse për mundësimin e zhvillimit sa më të qëndrueshëm nga pikpamja mjedisore.

❖ Biodiversiteti.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Mbrotjen dhe shtimin e biodiversitetit, të zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe me ruatjen e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet europiane dhe ndërkombëtare.

.Qëllimi i ruatjes së biodiversitetit është:

- Përfaqësimi i të gjithave zonave të dallueshme natyrore në rrjetin e zonave të mbrojtura dhe në peisazhet e ruajtura;
- Mirëruatja e proceseve evolutive dhe ekologjike që mundësojnë një biodiversitet të qëndrueshëm;
- Ruatja e specieve e llojeve të qëndrueshme;
- Ruatja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore duke siguruar elasticitet në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe afatgjata;
- Përmirësimi i menaxhimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura ekzistuese duke u siguruar që objektivat e zonës janë përmbushur;
- Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura për të siguruar një mbulim të plotë të të gjithave habitateve;
- Përmirësimi dhe përshtatja e ligjeve ekzistuese për mbrotjen e mjedisit;
- Përmirësimi i informacionit dhe i date baze për menaxhimin e biodiversitetit.

Objektivat që duhen përmbushur

- Menaxhimi i burimeve ujore-lidhur me mënyrën e përdorimit dhe ndotjen ujore;
- Menaxhimi i shtretërve të lumenjëve- lidhur me mënyrën e shfrytëzimit;
- Menaxhimi i zonave peisazhore- lidhur me sipërfaqet kufizuese ujore apo hapësira tokësore;
- Planifikimi i kufizimit të përdormit të tokës – lidhur me peisazhin;
- Menaxhimi i mbetjeve urbane – lidhur me menaxhimin e vendgrumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve.

Kerkohet:

- ❖ Forcimi i kuadrit ligjor për Mbrotjen e mjedisit;
- ❖ Forcimi i menaxhimit të administratave të mbrotjes natyrore;
- ❖ Zhvillimi i Planeve të menaxhimit për të gjitha zonat e Mbrojtura;
- ❖ Rritja e menaxhimit të specieve të Mbrojtura;
- ❖ Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe specieve;
- ❖ Integrimi i Objektivave të Strategjisë së biodiversitetit dhe plani i veprimit në politikën e Shtetit;
- ❖ Monitorimi i Biodiversitetit dhe menaxhimi i database me të dhënat.

Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plan i Veprimit lidhen me:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHË

- Futja e konceptit dhe e nevojës për mbrojtje të biodiversitetit në politikat sektoriale përkatëse;
- Reduktimin/ ujlën e faktorëve që çenojnë biodiversitetin;
- Monitorimin e veprimeve që degradojnë biodiversitetin dhe ndikimet përkatëse;
- Promovimin e ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve;
- Sensibilizimin e opinionit publik, arsimim dhe informim;
- Sigurimi i një qasje për ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjeneruese;
- Rritje dhe përhapje e njohurive shkencore lidhur me biodiversitetin.

Për arritjen e objektivave, propozohen masa/veprime konkrete për një periudhë pesë vjeçare si dhe përcaktohen burimet e financimit.

❖ Menaxhimi i burimeve ujore

Ky objektivi ka të bëjë me mbrojtjen e të gjithave burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Së dyti ka të bëjë me sigurimin e ujit të pijshëm për të gjithë popullatën.

Strategjia përban:

- Implementimi në vazhdimësi të strategjive për ujrat urbane dhe rurale, me përmirësime të vazhdueshme brenda një afati të shkurtër kohor duke aplikuar projekte të ndryshme;
- Tranzicioni drejt zbatimit të projekteve të rrjeteve të furnizimit me ujë krahas implementimit të strategjive ekzistuese duke përfshirë futjen e fondit për mjedisin;
- Identifikimi në vazhdimësi i projekteve të nevojshme në përputhje me udhëzimet e rishikuar dhe me rritjen e mbështetjes teknike në mënyrë të veçantë në zonat rurale;
- Zbatimi i projekteve të rrjeteve të furnizimit.

Kjo kërkon:

- Instalimin e një baze ligjore sa më të plotë, që të mbështesë efikasitetin e përdorimit të ujrave nëntokësore;
- Përmirësimin e të dhënave në lidhje me përdorimin e ujrave nëntokësore duke mbështetur procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të shtretërve të lumenjëve;
- Ndërmarrja e veprimeve prioritare që mundësojnë mbrojtjen e ujrave nëntokësore nga ndotja dhe mbishfrytëzimi.
- Masat në lidhje me objektivat e strategjisë së burimeve ujore kanë të bëjnë me:
 - ✓ Sistemet efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit në sektorin e ujit;
 - ✓ Zbatimi i projekteve prioritare në sektorin e ujit të pijshëm dhe të ujrave të zeza;
 - ✓ Zhvillimi i programeve afatgjatë të investimeve për ujrat e pijshëm dhe ujrat e zeza;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- ✓ Reduktimi i ndotjes së ujrave sipërfaqësore;
- ✓ Mbrotja e ujrave nëntokësore
- ✓ Monitorimi i ujrave.

❖ Mbrotja e tokës.

Ky objektiv strategjik ka të bëjë me mbrotjen dhe përmirësimin e tokës me qëllim për ta bërë sa më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.

Cështjet për mbrotjen dhe menaxhimin e tokës kanë të bëjnë me: erozionin, ndotjen, lëndët organike, përmytjet, rrëshqitjet, zvogëlimi i biodiversitetit, tharjen, kripëzimin dhe kompaktësimin e saj.

Qëllimi është që:

- Reduktimi i nivelit të erozionit dhe dëmeve që shoqërojnë atë;
- Mbajtja e tokës bujqësore në kushte të mira mjedisore dhe bujqësore;
- Reduktimi i ndotjes së tokës;
- Sigurimi i të dhënave për menaxhimin e tokës.

❖ Cilësia e ajrit.

Ky objektiv ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së ajrit në mbarë Shqipërinë në përputhje me nivelet dhe standartet e BE dhe OBSH.

Problematika:

- Shkarkimi i gazeve i lidhur me transportin dhe i kushtëzuar nga numri i automjeteve, lloji i lëndës djegëse, vjetërsia e mjeteve, mirëmbajtja dhe cilësia e mjeteve si dhe alternativat e transportit. Por ndikim ka dhe cilësia e rrugëve të përdorura.
- Grimcat e pluhurit nga aktiviteti i ndërtimit dhe nga rrugët e pa asfaltura.
- Shkarkimi i gazeve me origjinë industriale i cili është aktualisht i limituar por rritja ekonomike, zhvillimi i industrisë dhe rritja e kërkesës për energji do të shtoj sasinë e gazeve që çlirohen.
- Shkarkimi i gazeve rritet dhe për shkak të djegjes së mbetjeve apo përdorimi i burimeve të ndryshme lëndësh djegëse për qëllime familjare.

Qëllimi:

- ❖ Ujlen e nivelit të çlirimit të gazeve nga burimet lëvizëse dhe ato fikse në nivelin e legjisllacionit të BE;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- ❖ Përmirësimin e monitorimit për të siguruar informacionin e duhur për të mundësuar planet e menaxhimit të cilësisë së ajrit;
- ❖ Implementimi i sistemit të planifikimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit, i cili do të mundësoj në praktikë masat që mundësojnë arritjen e standarteve të BE mbi cilësinë e ajrit.

Objektivat e përgjithshëm mbi cilësinë kërkojnë:

- Monitorimin e cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE;
 - Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga automjetet;
 - Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga instalimet industriale;
 - Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve të pluhurit nga aktiviteti ndërtimor;
 - Reduktimi i emetimeve të pluhurit nga burime të tjera (rrugë të pa asfaltuara, zjarre, etj).
- ❖ **Ndryshimet klimaterike.**

Ky objektiv mjedisor ka të bëjë me reduktimin e gazeve të efektit serë dhe ato të hollimit të shtresës së ozonit duke kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimaterike.

Masat:

- Minimizimi i emetimit të gazeve me efekt serë;
- Menaxhimi dhe reduktimi i emetimeve të substancave që ndikojnë në shtresën e ozonit sipas dispozitave të Konventës së vjenës;
- Futjen e taksës së karbonit si e ardhur në fondin e Mjedisit;

❖ **Menaxhimi i mbetjeve**

Ky objektiv strategjik ka të bëjë me përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në mënyrë të tillë që të reduktohen rreziqet për shëndetin e publikut, mjedisin dhe tregëtinë për përputhje me kërkesat ligjore të BE.

Masat:

- Përcaktimin e praktikave më të mira të menaxhimit të mbetjeve për periudhë afatshkurtër;
- Sistemi i planifikimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;
- Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbetjeve;
- Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme;
- Plotësimi në vazhdimësi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit për çështet e trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

❖ Ndotja akustike

Përbën një nga objektivat strategjik mjedisor kombëtar që ka të bëjë me kontrollin e tyre me qëllim mbrotjen e shëndetit të njerëzve, të faunës dhe të sjelljeve biologjike të tyre.

Masat:

- Hartimin e aktit mbi nivelet e pranueshme të zhurmave urbane (automjete, trena);
- Monitormi i zonave të ndjeshme akustike;
- Kufizimi i zhurmave për pajisje të instaluar në mjedise të hapura;
- Implementimi i ligjeve të BE në lidhje me zhurmat kryesisht i
- Direktivës 2000/14/CE e PE dhe e këshillit, amenduar nga direktiva 2005/88/CE, që përcakton kufirin e zhurmave dhe etiketimin e një numri pajisjesh për përdorim të jashtëm;
- Direktiva 1986/594 mbi zhurmat në ajër të pajisjeve shtëpiake;

Përmbushja e objektivës së ndotjes akustike ka të bëjë me:

- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat në ndërtimin e ndërtesave;
- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat me burim automjetet;
- Reduktimin e ndotjes nga zhurmat me burim aktivitetet dhe bizneset.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar.

Objektivat e zhvillimit kombëtar janë tërësisht në harmoni dhe zbatim të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm ndërkombëtar. Kjo synon arritjen e **Objektivave të zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**, të pranuar nga 189 vende në Konferencën e OKB ë vitin 2000, si dhe detyrat e përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (ËSSD) në Johaneshburg. Ky samit ishte kurorëzim i Konferencës së Stokholmit mbi Mjedisin (1972) dhe konferencës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (1992). Ndërkohë që politikat europiane mjedisor udhëhiqen nga parimi i parandalimit dhe se ndotësi paguan duke siguruar instrumentat e duhur për zbatim efektiv. Si pjesë më të rëndësishme të politikave të BE mbi mjedisin konstatojmë:

- ❖ Plani i Veprimit Mjedisor 6-të, adaptuar nga vendimi 1600/2002.CE të Parlamentit Europian, Këshilli i Europës së 22 korrikut 2002, që është korniza bazë e politikave mjedisore të BE. Ky plan është përmbledhur në 7 tematika strategjike mjedisore:
 - Strategjia për mbrotjen e ajrit;
 - Strategjia për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Strategjia për mbrojtjen dhe konservimin e ambjentit detar;
- Strategjia për mbrojtjen e tokës;
- Strategjia për përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve;
- Strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve;
- Strategjia për mjedisin urban.
- ❖ Politika e BE për ndryshimet klimaterike që synon stabilizimin e përqendrimit të gazeve në atmosferë (reduktimi 20% deri në 2020, përfitimi deri 20% e nergjisë nga burime të rinovueshme- deri 2020, reduktimi i energjisë primare 20% - deri në 2020 nëpërmjet përmirësimit të efijensës së energjisë).
- ❖ Strategjia e BE për Biodiversitetin duke ndërhyrë në:
 - Ruatjen e burimeve natyrore;
 - Bujqësi;
 - Peshkim;
 - Palitikat rajonale dhe planifikim hapësinor;
 - Pyjet;
 - Energji dhe transport;
 - Turizëm;
 - Zhvillimi i ndihmës dhe bashkëpunimi ekonomik;
- ❖ Strategjia e BE për zhvillimin e qëndrueshëm, që përmban këto objektiva:
 - Mbrojtjen Mjedisore;
 - Drejtësi sociale dhe ndërveprim;
 - Prosperitet ekonomik;
 - Pranimin e përgjegjësive ndërkombëtare
- ❖ Karta e Laipzingut për qytetet e qëndrueshme europiane, që në zhvillimin e integruar urban të përfshihet publiku.

Objektivat kombëtare kryesore të Shqipërisë për pesëmbëdhjetë vjetet e ardhshme janë si më poshtë:

- Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të transportit për lidhjen e Shqipërisë me korridoret Paneuropiane të transportit.
- Zhvillimi i Shqipërisë si qendër infrastrukturash dhe energjie për të gjithë rajonin e Ballkanit.
- Promovimi i zhvillimit nëpërmjet një sistemi të zhvillimit urban policentrik dhe të decentralizuar.
- Promovimi dhe aksesueshmëria e zonave me mjedis të shquar natyror dhe peisazh, e kombinuar me menaxhimin inteligjent të burimeve natyrore dhe kulturore me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre në kuadër të zhvillimit dhe globalizimit. Shfrytëzimi i

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

njëkohshëm i tyre nëpërmjet përmirësimit të aksesueshmërisë të tyre me qëllim zhvillimin ekonomik.

- Zhvillimi i sistemeve të transportit multimodal, miqësor ndaj mjedisit (transporti multimodal) për të mbështetur zhvillimin rural policentrik, së bashku me përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin ekonomik.
- Nxitja e burimeve të energjisë të rinovueshme në sektorin e energjisë.
- Dizajni dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara në fushën e komunikimit, transportit, bujqësisë dhe energjisë.
- Organizimi hierarkik, specializimi dhe grupimi funksional i qyteteve shqiptare.
- Urbanizimi dhe formalizimi i zonave informale të ndërtimit.

Në sektorin e mjedisit, qëllimi është zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik me mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi përmes menaxhimit të integruar dhe përmirësimin e vlerave mjedisore që kontribuojnë për prosperitetin ekonomik. Qëllimi është i bazuar në parimin e zhvillimit të integruar, mbrojtjen dhe rritjen e burimeve mjedisore, si dhe sigurimin e rritjes ekonomike dhe prosperitet social dhe kohezionit. Sot, zonat e mbrojtura në Shqipëri përbëjnë 15% të sipërfaqes së vendit dhe janë pjesë e Brezit të Gjellbër Evropian, por gjithsesi shumë zona të mbrojtura nuk janë të vizituara dhe nuk kontribuojnë financiarisht në vend. Gjithashtu, është e njohur që mjedisi është pjesë e pasurisë kombëtare dhe ndikohet si nga proceset natyrore edhe nga ndërhyrja e njeriut. Kështu, objektivat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit janë:

- Mbrojtja e zonave ekologjike të ndjeshme dhe siguri i një funksionimi të vazhdueshëm të mirë në të ardhmen;
- Krijimi i një sistemi informacioni për mbrojtjen e burimeve natyrore;
- Zhvillimi i rolit të burimeve mjedisore dhe natyrës në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të qendrave urbane, duke lidhur qytetet me zonat natyrore;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për të mbështetur zhvillimin ekonomik në të gjitha fushat, p.sh. bujqësi, pylltari, peshkim, gurore, energji, industri, shërbime, turizëm etj;
- Krijimi i rrjetit evropian Natura 2000 për mbrojtjen e zonave ekologjike të ndjeshme dhe ruajtjen e peisazheve të vlefshme natyrore;
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes dhe integrimi i planifikimit hapësinor në vend.

Zhvillimi rural ka nevojë për të promovuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë, me ndihmën e një kornize për të siguruar sektorin agro-ushqimor, inovativ dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionet e tregut dhe kriteret e cilësisë të Bashkimit Evropian. Rezultati do

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

të jetë vende të reja pune, rritje ekonomike, kohezion social dhe mbrojtje e cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale. 40% e sipërfaqes së vendit përbëhet nga tokë bujqësore dhe gjysma e saj është e vendosur në pjesën perëndimore të vendit dhe në zonën bregdetare të saj. Pjesëmarrja e bujqësisë në Produktin Kombëtar Bruto është 20%, me 50% të punësuarve i përketin veprimtaritë primare. Objektivi kryesor është përmirësimi i bilancit ushqimor të importeve - eksporteve, pasi eksportet janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, por balanca mbetet negative. Gjithashtu thelbësore është ripyllëzimi i zonave të degraduara dhe testimi i kulturave të reja fitimprurëse në zonat rurale, paralelisht me krijimin e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit rural- ekonomik. Reduktimi i kostove të prodhimit, investimeve në teknologji për zonat rurale, menaxhimi i ujit për ujitje dhe ndërtimi i infrastrukturës përkatëse, bashkëpunimi në sektorin e bujqësisë me sektorët e tjerë si p.sh. agroturizmi cilësor, futja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në aktivitetet rurale dhe krijimi i qendrave dhe poleve të prodhimit bujqësor, në varësi të karakteristikave të produkteve, janë faktorët kryesor për zhvillimin rural.

Qëllimi për turizmin parashikon njohjen e Shqipërisë si një destinacion tërheqës turistik në Evropë, autentik dhe mikpritës, bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe burimeve kulturore, të cilat do të jenë të përafëruara në tregjet ndërkombëtare.

Për sektorin e energjisë, objektivi kryesor është pavarësia energjetike e Shqipërisë dhe zhvillimi i një ekonomie me karbon të ulët, me përdorimin e burimeve të energjisë të rinovueshme, futjen e teknologjive të reja në energjetikë dhe zhvillimi i kërkimeve përkatëse për këtë qëllim. Objektivat e politikës energjetike janë përdorimi i energjisë me 20% nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë, përmirësimi i efikasitetit të energjisë në masën 20% dhe duke reduktuar emetimet e CO₂ me 20%. Në të njëjtën kohë, është i domosdoshëm zhvillimi i mëtejshëm të hidrocentraleve, pasi Shqipëria ka burime të mjaftueshme të ujit, forcimi i rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe integrimi i tyre në planifikimin hapësinor, përdorimi i energjisë diellore dhe zhvillimi i fushave ekzistuese gjeotermale. Me rëndësi strategjike është edhe gazsjellesi që do të kalojë përmes Shqipërisë.

OBJEKTIVAT MJEDISORE, TREGUESIT DHE SYNIMET

VSM përdor në analizën e saj një kombinim të objektivave, treguesëve dhe synimeve për të parashikuar efektet si dhe për të përshkruar dhe monitoruar ndryshimin e planeve, programeve dhe projekteve të propozuara në fushën e mjedisit. Objektivat strategjikë Mjedisor dhe synimet përcaktojnë qëllimet dhe kufizimet të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të Planeve dhe Programeve të propozuara. Indikatorët na ndihmojnë në aspektin e monitorimit të VSM-së, ndërsa synimet e parashikuara në material na afrojnë synime reale dhe të arritshme për të cilat autoritet lokale mund të arrijnë të punojnë. Treguesit përdoren për të ilustruar dhe komunikuar efektin në një mënyrë sa më të thjeshtë dhe efektive. Treguesit mund të përdoren gjithashtu për të formuar bazën për monitorimin e programit të PPV.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Objektivat mjedisore sigurojnë një “qëllim” pikë referuese kundër të cilit efektet mjedisore të PPV mund të testohen. Ato duhet që të jenë përafërsisht të ngjashme me masat që janë paraparë në PPV ose që dalin nga objektivat që të ekzistojnë. Objektivat mjedisore në thelb kanë të bëjnë me parametra të tillë si Biodiversiteti, ndotja e tokës, ujit, ajrit, shkarkimet e CO₂ dhe gazeve të tjera, flora, fauna, zhurmat, mbrotja e trashëgimisë kulturore, etj.

Treguesit ofrojnë mjete për të matur progresin drejt arritjes së objektivave mjedisore me kalimin e kohës si niveli akustik i vlerësuar për një periudhë të caktuar kohore, kualiteti i trupave ujqor (sipërfaqësore deh nëntokësore), sasia e CO₂ të shkarkuar, etj.

Qëllimet lidhen me gjendjen mjedisore të parametrave të vlerësuar të lidhura me objektivat dhe të shprehur në terma sasior ose cilësor. E rëndësishme është që treguesit që do të vlerësohen të jenë të matshëm dhe objektivat e përcaktuara sa më real, duke siguruar ekzistencën e rrjeteve të monitorimit për matjen e çdo treguesi ose të disponojnë mjete për ndërtim struktura të reja monitoruese.

OBJEKTIVAT MJEDISORE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË LIBRAZHD

Në përputhje me objektivat mjedisore ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe në referencë me objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor të hartuar nga grupi i konsulencës kemi përcaktura objektivat kryesore të VSM si dhe objektivat më specifike për çdo fushë mjedisore të lidhur me të pesë fushat e analizës së PPV, përkatësisht me sistemin e infrastrukturës (I), sistemin ujqor (W). Sistemin Natyror (N), sistemin urban (U) dhe sistemin bujqësinë (A).

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
I . Biodiversiteti, peizazhi dhe shfrytëzimi i tokës	
I.1.	Mbrojtja, konservimi dhe shmangia e humbjeve të shumëllojshmërisë dhe të shtrirjes së habitateve, specieve dhe korridoreve të kafshëve të egra;
I.2.	Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve duke u bazuar në mjedisin e cilësisë së lartë për banim, të komunitetit, për punë dhe për rekreacion të bazuar në modelet e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës;
I.3	Mbrojtja e cilësisë së jetës së njerëzve duke iu shmangur rreziqeve ose faktorëve përkeqësues (pluhurit, zhurmës, erës) që dalin nga ekspozimi ndaj shfrytëzimeve/zhvillimeve të papajtueshme të tokës (miniera /nxjerrja e gurëve për zhavorr, etj);
I.4	Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore përfshirë mjedisin dhe ambientet e ndërtuara; arkeologjike, arkitektonike dhe tiparet e peizazhit të krijuara nga njeriu;
I.5	Mbrojtja e peizazheve dhe pamjeve piktoreske të caktuara, rrugëve , shtigjeve dhe tipareve të peizazhit me vlerë lokale;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

I.6	Sigurimi i hapësirave të gjelbëruara për atraksion të thjeshtë apo për mundësi krijimi guidash ekoturistike;
I.7	Mbrojtja, përmirësimi dhe mbajtja e cilësisë së tokës si element bazik i diversifikimit dhe zhvillimit natyror të qëndrueshëm;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
II. Menaxhimi i mbetjeve	
II.1.	Zgjerimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave të ngurta, përkrahja e opsioneve për trajtimin e qëndrueshëm të mbeturinave (ndarja, riciklimi, dërgimi në kontenjer, etj);
II.2.	Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohet në pikat e grumbullimit nga vendndodhja nëpërmjet informimit mjedisor;
II.3	Identifikimi i ndotësve mjedisor, i “hot spot”-eve dhe krijimi i një sistemi multifunksional për menaxhimin e tyre;
II.4	Eliminimi i vendeve për hedhjen e mbeturinave në mënyrë kaotike dhe aplikimi i teknologjive Mjedisore;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
III. Mbrojtja e ujit dhe burime energjitike	
III.1.	Mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së ekosistemeve ujore dhe, në lidhje me nevojat e tyre për ujë, të ekosistemeve tokësore që varen drejtpërdrejt nga ekosistemit ujor (cilësia, niveli, mënyra e rrjedhjes);
III.2.	Zvogëlimi i ndikimit të substancave ndotëse për të gjitha ujërat, të çfarëdolloj tipologjie por sidomos me impakt agrobujqësor e blektorial;
III.3	Parandalimi i ndotjes dhe infektimit të ujit tokësor nga aktivitete e pakontrolluara industrial, sanitare, urbane, bujqësore;
III.4	Mbajtja dhe përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet ndërhyrjes në rrjetin hidrografik;
III.5	Përkrahja e mbrojtjes afatgjatë të burimeve të disponueshme të ujit përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit;
III.6	Përmirësimi i infrastrukturës për t’i plotësuar nevojat e ardhshme të furnizimit me ujë dhe standardet për pastrimin e ujërave të zeza;

OBJEKTIVAT E VSM-së – BASHKIA LIBRAZHD	
IV. Ndryshimi Infrastrukturor me impakt në klimës dhe efikasiteti i energjisë	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

IV.1.	Zvogëlimi i të gjitha formave të ndotjes së ajrit dhe mbajtja/përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit.
IV.2.	Zvogëlimi i emetimeve të gazrave të serrës dhe kontribuimi në zvogëlimin dhe shmangien e ndryshimit të klimës të shkaktuar nga njeriu.
IV.3	Shtimi i mënyrave të qëndrueshme të transportit dhe sigurimi i lehtësisë së lëvizjes për të gjithë shfrytëzuesit e rrugës dhe përkrahja e modeleve të zhvillimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e sigurisë në rrugë.
IV.4	Zvogëlimi i humbjes së energjisë, përkrahja e shfrytëzimit të burimeve të energjisë së përtëritshme dhe përkrahja e nismave për ruajtjen e energjisë. Përkrahja e ruajtjes së energjisë në të gjithë sektorët. Përkrahja e zhvillimit të tregtisë dhe ndërtesave me karbon të ulët.
IV.5	Përkrahja e burimeve të shfrytëzueshme alternative të energjisë së rinovueshme dhe teknologjive efikase;
IV.6	Zvogëlimi i rrezikut nga aksidente të ndryshme ndaj njerëzve, pronës, faunës, florën, mjedisit tërësor;

VËSHTIRËSITË E TAKUARA GJATË HARTIMIT TË VSM-SË

Vështirësitë e hasura nga Grupi Konsulent i VSM-së janë të lidhura me mungesën e disponueshmërisë së të dhënave dhe matjeve shkencore, mos disponibiliteti i informacioneve të kërkuara për realizimin e studimit për shkak se bashkia është e re në mënyrën e tashme të konceptimit dhe ka qenë në shumicën e kohës si pjesë funksionale e Elbasanit (qarku) dhe nuk përmban aktualisht tërësinë e informacionit të nevojshëm për realizimin e studimit. Njëkohësisht për shkaqe të lidhura me prezencën e pajisjeve teknologjike për zonën në studim nuk ka zbatime projektesh monitoruese gjithëpërfshirëse për problemet mjedisore, ç'ka na ka detyruar të përdorim metoda ekstrapoluese apo dhe konverguese për vlerësimin sa më të mirë të mundshme të gjendjes mjedisore aktuale. Fusha e monitorimit dhe mbrojtjes të mjedisit ka akoma shumë probleme, me gjithë hapat pozitive të ndërmarra në vitet e fundit drejt përmbushjes së standardeve të BE, siç është miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit. Matje shkencore të aspekteve bazë janë ende të pakta dhe jo të rregullta në kohë. Monitorimi kërkon një përpjekje të koordinuar dhe angazhimin e të dy palëve, në nivel kombëtar e lokal, në mënyrë që të mbajë të dhëna të besueshme dhe të qëndrojnë në bashkëpunim të vazhdueshëm. Procesi i zbatimit të VSM-së do të jetë një përpjekje kolektive që duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në etapa të rëndësishme, por edhe si pjesë e veprimeve rutinë të autoriteteve bashkiake. Ndërtimi i kapaciteteve lokale është një

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

faktor shumë i rëndësishëm, i cili është evidentuar qartë në zhvillimin e përgjegjësisë dhe që duhet konsideruar në zbatimin e PPV-së dhe të VSM-së. Trajnimi i administratës bashkiake në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të shoqërohet me angazhimin dhe investimet në pozicionet e tyre të punës. Teknologjia është gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm për monitorimin e VSM-së. Zbatimi i Planit në vetvete përmban një mjet shumë të vlefshëm, që është përditësimi i bazës së të dhënave të GIS, i cili mundëson përditësimin e vazhdueshëm të ndryshimit të përdorimit të tokës dhe të procesit të zhvillimit.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME MJEDISORE, PARASHIKIMI, VLERËSIMI DHE MASAT E DUHURA PËR TRAJTIMIN E TYRE

Konstatohet se plani i Përgjithshëm Vendor është në tërësi në përputhje me objektivat dhe kërkesat e PPK, si dhe me objektivat e BE, kombëtare dhe vendore të VSM-së mbi mjedisin. PPV do të shërbejë njëkohësisht si mundësi adresimi për probleme të zhvillimit dhe mjedisore në të ardhmen.

Zbatimi i PPV-së në bashkinë Librazhd do të shoqërohet me impakt mjedisor në tërësinë dhe për projekt strategjik apo veprimtari të parashikuar nga grupi i konsulentëve.

PPV në strukturën e saj ka marrë në konsideratë të gjithë faktorët mjedisor dhe ka trajtuar nëpërmjet konceptimeve hartuese objektivat kombëtare, europiane dhe të VSM-së për mjedisin.

Proçesi i vlerësimit është bazuar në një strukturë koreluese të matricës dhe metodologjisë së vlerësimit që ballafaqon, krahason, vlerëson, gjykon dhe propozon masa për trajtimin e impakteve mjedisore të PPV (objektivave të përgjithshme, objektivave specifike, projekteve strategjike dhe projekteve të veprimtarive konkrete), duke konfronduar 23 objektivat zhvillimore (pjesa analitike e 4 objektivave të VSM-së dhe 10 elementëve mjedisor të trajtuar në VSM) të VSM me objektivat, strategjitë e zhvillimit dhe projektet apo veprimtaritë e propozuara në PPV.

Së pari është bërë identifikimi i ndikimeve në mjedis të zbatimit të objektivave specifike të PPV-së për secilin nga komponentët mjedisor dhe pjesë e objektivave të VSM-së.

Së dyti është bërë parashikimi sipas indikatorëve mjedisor të ndikimit në mjedis të PPV-së

Së treti është bërë vlerësimi analitik sipas treguesëve të impaktit mjedisor të secilit projekt strategjik në kontekstin e veprimtarive të planifikuara në kuadër të objektivave Strategjike.

Së katërti kemi afruar rrugë, sygjerime, masa për minimizimin deri në eliminim të ndikimeve në mjedis të implementimit të PPV-së.

Së fundi, sigurisht që kërkohen indikator dhe tregues që mundësojnë realizimin praktik të kërkesave të PPV-së dhe harmonizimin e tyre me objektivat dhe masat e parashikuara në VSM-së.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Matrica funksionale midis objektivave të PPV-së dhe elementëve përbërë të Mjedisor-BASHKIA LIBRAZHID

OBJEKTIVAT										
	Toka	Ajri	Faktoret klimatike	Uji	Biodiversitet	Peizazhi	Trashëgimia kulturore	Mbetjet	Zhurma	Popullsia dhe asetet materiale
Objektivi strategjik A: Zhvillimi social-ekonomik i infrastrukturës										
Objektivi specifik A1: Fuqizimi i infrastrukturës lidhëse, rivitalizimi i transportit intermodal dhe transportit publik lokal	✓	✓	✓	X	✓	✓	✓	X	✓	✓
Objektivi specifik A2: Promovimi i një sistemi inovativ dhe të larmishëm të prodhimit	✓	✓	X	X	✓	✓	X	X	X	✓
Objektivi specifik A3: Promovimin e territorit si një destinacion turistik	✓	✓	X	✓	X	✓	✓	✓	✓	✓
Objektivi specifik A4: Përmirësimi i cilësisë të imazhit urban dhe i territorit	✓	✓	✓	X	✓	✓	✓	X	✓	✓
Objektivi specifik A5: Përmirësimi i shërbimeve për njeriun	✓	✓	X	✓	✓	✓	X	✓	X	✓
Objektivi strategjik B: Organizimi hapësiror i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban.										
Objektivi specifik B1: Transformimi i territorit të Librazhd, në një territor të integruar multipolar mes qyteteve dhe fshatrave	✓	X	X	X	✓	✓	✓	X	X	✓
Objektivi specifik B2: Promovimi i qytetit kompakt dhe përmirësimi i hapësirës publike	X	X	X	✓	X	✓	✓	X	X	✓
Objektivi specifik B3: Ribalancimi funksional përmes promovimit të karakteristikave lokale	✓	X	X	X	✓	✓	X	✓	X	✓
Objektivi specifik B4: Përmirësim arkitektonik, i peizazhit dhe i mjedisit i qendrave dhe tokave bujqësore dhe natyrore	✓	✓	X	✓	✓	✓	✓	X	X	✓
Objektivi strategjik C: Cilësia mjedisore dhe mbrojtja e territorit.										
Objektivi specifik C1: Reduktimi i ndotjes së ujit	✓	X	X	✓	✓	✓	X	X	X	✓
Objektivi specifik C2: Reduktimi dhe menaxhimi i mbetjeve	✓	✓	X	✓	X	✓	X	✓	X	✓

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID


Objektivi specifik C3: Reduktimi i ndotjes së ajrit	✓	✓	X	✓	X	X	X	X	X	X	✓
Objektivi specifik C4: Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës dhe Burimeve hidrogeologjike	✓	X	X	✓	X	✓	X	✓	X	✓	✓
Objektivi specifik C5: Promovimi i efikasitetit të energjisë dhe ruajtjes së energjisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X	X	X	✓	✓
Objektivi specifik C6: Përmirësimi i mjedisit natyror	✓	✓	X	X	✓	✓	X	✓	✓	X	✓
Objektivi specifik C7: Rritja e tokës bujqësore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	X	X	X	✓	✓

OBJEKTIVAT	Toka	Ajri	Faktorët klimaterikë	Uji	Biodiversitet	Peizazhi	Trashëgimia kulturore	Mbetjet	Zhurma	Popullsia dhe asetet materiale
Objektivi strategjik A: Zhvillimi social-ekonomik i infrastrukturës										
Objektivi specifik A1: Fuqizimi i infrastrukturës lidhëse, rivitalizimi i transportit intermodal dhe transportit publik lokal										
Objektivi specifik A2: Promovimi i një sistemi inovativ dhe të larmishëm të prodhimit										
Objektivi specifik A3: Promovimi i territorit si një destinacion turistik										
Objektivi specifik A4: Përmirësimi i cilësisë të imazhit urban dhe territorit										
Objektivi specifik A5: Përmirësimi i shërbimeve për njeriun										
Objektivi strategjik B: Organizimi hapësor i bashkisë dhe rikualifikimi i imazhit urban.										
Objektivi specifik B1: Transformimi i territorit të Librazhdit, në një territor të integruar multipolar mes qyteteve dhe fshatrave										

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

[illegible]

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID



Efektet mjedisore të zbatimit të Planit të përgjithshëm Vendor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

KARAKTERISTIKA TË NDIKIMIT	SIMBOLE	SHPJEGIME
Probabiliteti i ndikimit	VV	Shumë i mundur
	V	I mundur
	0	Asnjë mundësi
	++	Shumë pozitiv
Shkalla e ndikimit	+	Pozitiv
	0	Asnjajës
	-	Negative
	--	Shumë negative
	>>	Afatgjatë/përhershëm/ i qëndrueshëm
Kohëzgjatja	>	Afatshkurtër/rastësor
	0	Pa ndikim
	IR	Të pakthyeshme
Reversibiliteti	RK	Kthim i kushtëzuar
	R	Të kthyeshme
	NK	Ndikime të mundshme kufitare
Ndikimi ndërkufitar	JNK	Asnjë mundësi ndikimi kufitar
	?	Ndikimi i kushtëzuar nga zbatimi i PPV
Pasiguria	P	Ndikime parësore
Sekuenca	S	Ndikime sekondare
Ndërveprimi	A	Ndikim akumulues/grumbullues
	S	Ndikim sinergjik
	0	Asnjë ndikim me parametrat e tjerë

Simbolet për shprehjen e impakteve mjedisore

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Karakteristikat e ndikimeve të parashikuara për secilin nga përbërësit e planit të zhvillimit Territorial dhe për secilën nga objektivat e PPV-së për Bashkinë Librazhd paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në terren	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuencë	Ndërveprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	<<	R	JNK	P	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	R	JNK	P	S
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	VV	++	>>	R	JNK	P	S
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	VV	-	<<	IR	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	<<	RK	JNK	P	S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	VV	++	>>	R	NK/JNK	P	S
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	++	>>	R	NK	P	S
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	VV	++	>>	R	JNK	P	S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	-/+	>>	RK	JNK	P	S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore	VV	+/-	>>	R	JNK	P	S
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në ajër	Karakteristika të ndikimit të parashikuara					
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	RK	JNK	P A
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	RK	JNK	P A
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	V	+	>>	R	JNK	P A
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	V	-	>>	R	JNK	P A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	P S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar ne trajtimin dhe vleresimin e sistemit te pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	-/+	>>	RK	NK	P A
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe të trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	++	>>	RK	JNK	P S
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	VV	++	>>	RK	JNK	P S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	+	>>	RK	JNK	P A
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	+	>>	RK	JNK	P A
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	RK	JNK	P A

	Karakteristika të ndikimit të parashikuara
--	--

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në faktorët klimaterikë							
Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndëvëprimi	
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	<<	R	JNK	p	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	V	+	<<	IR	JNK	p	S
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	V	-	<<	IR	JNK	p	S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	V	+	<<	R	JNK	p	A
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	V	+	<<	IR	NK	p	A
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	V	+	<<	R	JNK	p	S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	V	+	<<	R	JNK	p	A
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	<<	R	JNK	p	A

Karakteristika të ndikimit të parashikuara							
Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndëvëprimi	
Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në ujra							
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	<<	R	JNK	p	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	++	<<	R	JNK	p	S
04.U – Sistemi prodhues i minierave ne lidhje me prrenjasin	VV	++	<<	R/IR	JNK	p	S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	++	<<	R	JNK	p	S

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	✓✓	++	>>	R/IR	NK	P	O
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	✓✓	++	>>	R	JNK	S	A
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	✓✓	++	>>	R	JNK	P	S
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe ruget mes qendrave kryesore	✓✓	++	>>	R	JNK	P	A

Projekti	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndërveprimi
Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në Biodiversitet							
01.U – Rihvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	RK	JNK	S	S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	✓	+/-	>>	IR	JNK	S	O
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	✓	+/-	>>	IR	JNK	S	O
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	✓	+/-	>>	IR	JNK	S	O
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	✓✓	+	>>	R	NK	S	O
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	✓✓	+	>>		JNK	S	O
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe ruget mes qendrave kryesore	✓✓	+/-	>>	IR	JNK	S	O
01.U – Rihvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	✓✓	+	>>	RK	JNK	S	S

	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
--	--	--	--	--	--	--	--

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në mbetje	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndëvëprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	A
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	R	JNK	P	A
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me Prrenjasin	VV	+	>>	R	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	P	A
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	VV	-	>>	R	JNK	P	C
07.A – Zhvillimi i nje sistemi të produkteve tipike lokale dhe të trajnimit të prodhuesve në zonat rurale	VV	++	>>	RK	JNK	P	S
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	-	>>	R	JNK	P	C
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rrugët mes qendrave kryesore	VV	+	>>	RK	JNK	P	A
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	A

Karakteristika të ndikimit të parashikuara							
Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në Zhurma/Ndryshime akustike	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuenca	Ndëvëprimi
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	>>	R	JNK	P	O
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	R	JNK	P	O
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	VV	+	>>	R	JNK	P	O

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	P	C
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	VV	+	>>	R	NK	P	O
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	V	+	>	R	JNK	P	C
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	VV	+	>>	R	JNK	P	C
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	VV	+	>>	R	JNK	P	C

	Karakteristika të ndikimit të parashikuara						
Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritet të ndikojnë në peisazh	Probabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkultur	Sekuenca	Ndërveprimi
01.U – Rihvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	++	>>	RK	JNK	P	A
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	++	>>	RK	JNK	P	A
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me prrenjasin	VV	+	>>	RK	JNK	P	A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	RK	JNK	P	A
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombetar, mali Polis, etj)	VV	++	>>	RK	NK/ JNK	P	A
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	VV	+	>>	RK	JNK	S	C
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik të lumit Shkumbin	VV	+	>>	RK	JNK	P	A
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	V	+	>>	RK	JNK	P	A
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (rruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	V	+	>>	IR	JNK	P	A

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritët të ndikojnë në trashëgiminë kulturore	Karakteristika të ndikimit të parashikuara					
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuena
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	V	+	<<	IR	JNK	P S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	V	++	>>	R	JNK	P S
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	V	++	>>	IR	JNK	P S
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	V	++	<<	RK	JNK	P S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit, natyror, historik dhe arkeologjik (Stableve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)	V	++	>>	RK	JNK	P S

Projektet strategjike në përputhje me objektivat e PPV të cilat pritët të ndikojnë në popullsi dhe asetet aktive	Karakteristika të ndikimit të parashikuara					
	Propabiliteti	Shkalla	Frekuenca/ kohëzgjatja	Reversibiliteti	Ndikimi ndërkufitar	Sekuena
01.U – Rizhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	VV	+	<<	RK	JNK	P S
02.U – Rikualifikimi i identitetit dhe i funksionimit të qendrave dhe fshatrave	VV	+	>>	RK	JNK	P S
03.U – Zhvillimi dhe rikualifikimi i zonave prodhuese/ artizanale	V	+	>>	R	JNK	P A
04.U – Sistemi prodhues i minierave në lidhje me Prrënjasin	V	-	>>	R	JNK	P A
05.U - Realizimi i sistemit të integruar të mbetjeve mbledhja/depozitimi/ bartja (në Elbasan)	VV	+	>>	R	JNK	S S
06.N – Projekti i zhvillimit të turizmit i orientuar në trajtimin dhe vlerësimin e sistemit të pejsazhit,	VV	-/+	>>	RK	NK/ JNK	P A

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

naturor, historik dhe arkeologjik (Stabileve, Parku Kombëtar, mali Polis, etj)									
07.A – Zhvillimi i nje sistemi te produkteve tipike lokale dhe te trajnimit te prodhuesve ne zonat rurale	V	+	>>	RK	JNK	S	S		
08.W – Restaurimi i rrjetit hidrografik te lumit Shkumbin	V	+	>>	RK	JNK	S			
09.I – Riaktivizimi i rrjetit hekurudhor	W	+	>>	RK	JNK	S	A		
10.I – Rikualifikimi i aksit rrugor kryesor (ruga nacionale) dhe rruget mes qendrave kryesore	V	+	>>	RK	JNK	S	A		
01.U – Rihzhvillimi i zonës urbane të Librazhdit (projekti pilot)	W	+	>>	RK	JNK	P	S		

14.4. TRAJTIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.

Mbi bazën e vlerësimit të projekteve të parashikuara nga zbatimi i PPV-së dhe impaktit të tyre në faktorët e mjedisit duhet që të kryhen veprime konkrete me qëllim minimizimin deri në eliminim të ndikimeve mjedisore të këtyre veprimeve. Analiza e impakteve mjedisore dhe mënyra e trajtimit të tyre është analitike për secilin përbës të mjedisit.

Faktorët Mjedor: Terren		
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim	
Ndërtimi dhe funksionimi i zonave urbane dhe qendrave administrative;	Hartimi i studimeve përputhëse hidrogeologjike për mbrojtjen e terrenit, por dhe të azhurnuar me projektet e propozuara	
Ndërtimi dhe funksionimi i infrastrukturës kombëtare dhe ndërkombëtare;	Hartimi i studimeve hidrogeologjike dhe gjeologjike për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme dhe konfortabël me mjedisin	
Ndotje të terrenit nga pesticidet dhe plehtrat kimike në kuadër të fuqizimit të sektorit agrobujqësor;	Zhvillimi i bujqësisë mbi baza mbështetëse shkencore. Mundësia e krijimit të njëjësive bujqësore të organizuara. Aplikimi i praktikave, rregullave dhe udhëzime të Bashkimit Europian mbi bujqësinë	
Ndotje të terrenit nga deponime mbetjesh apo produkte veprimtarie shfrytëzimi dhe/ose prodhimi nga rritja e aksesit të punësimit;	Planifikimi në burim i i tipologjisë dhe mënyrës së menaxhimit të qëndrueshëm sipas politikave më të mira të riciklimit të tyre .	

Faktorët Mjedor: Ajri		
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim	
Ndotja atmosferike për shkak të rivitalizimit të infrastrukturës së transportit;	Kalimi në përdorimin e mjeteve të teknologjisë anti-ndotje. Përdorimi i lëvizjeve alternative të mundshme me reduktim të emisioneve, qoftë me karakter sportiv apo të qarkullimit kolektiv.	
Ndotje atmosferike për shkak të zhvillimit të projekteve të propozuara lidhur me mundësi punësimi, zgjerimi urban, etj ;	Zbatimi i projektit sipas parimit të qëndrueshmërisë dhe aplikimi i metodave dhe teknologjive bashkëkohore.	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Ndotje për shkak të deponime sporadike dhe mos aplikimit të masave trajtuese urbane, sanitare, shtëpiake dhe bujqësore;	Organizmi dhe zbatimi i një skeme funksionale për grumbullim të përqëndruar dhe trajtim në pika të përcaktuara me teknologji sa më rentabël nga pikpamja mjedisore
---	--

Faktorët Mjedor: Ujra	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Përdormi i ujit për qëllime imbotilimi apo për promovimin dhe zhvillim të prodhimeve dhe produkteve bujqësore, si në sektorin primar dhe atë dytësor të prodhimit;	Aplikimi i politikave të përshtashme të faturimit të ujit. Organizmi hapsinor, kohor dhe teknologjik i njësive operuese në rajonet ekonomike me qëllim menaxhimin e burimeve ujore. Organizimi i kontrollit të mënyrave të shfrytëzimit të burimeve apo depozitimeve ujore. Përdormi dhe aplikimi i risive teknologjike në shfrytëzimin e ujit. Përdormi dhe adaptimi nga njësitë operuese të Sistemeve të Menaxhimit Mjedor
Ndotje dhe ndikim në sasisë e ujrave nëntokësore nga intesifikimi dhe forcimi i prodhimit primar;	Organizimi dhe zbatimi i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për vaditje. Ndërtimi i një rrjeti hidrografik modern me efencë, rendiment, kosto të ulët dhe produktiv nga pikpamja e qëndrueshmërisë mjedisore. Ndërtimi dhe mirëmbatja e sistemeve ujore të rezervuarëve apo digave. Menaxhimi i shfrytëzimit të burimeve ujore nëntokësore individuale apo kolektive
Ndotje nga shkarkimet sipërfaqësore apo nëntokësore me burime të ndryshme industriale, bujqësore, urbane, etj.	Ndërtimi i sistemeve teknologjike që shkarkimet përfundimtare të jenë me ndotje të papërfillshme. Përdormi dhe aplikimi i skemave teknologjike që akumulojnë ndotjen sipas parimit të Zhvillimit të qëndrueshëm. Planifikimi i investimeve apo të çfarëdolloj ndërtimi me fashë mbrojtëse ndaj ujrave sipërfaqësore nga 5 deri në 200m. Organizmi i studimeve hidrogeologjike për shmangje maksimale të raportit funksional aktivitet/burim nëntokësor.

Faktorët Mjedor: Biodiversiteti

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZH

Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndërtimi dhe funksionimi i infrastrukturës qarkulluese;	Trajtim parandalues me vendosjen e rrjetave dhe të infrastrukturës teknike e mjedisore
Promovimi i natyrës, kreacionit, guida ekoturistike;	Përcaktimi i zonave me vlera ekoturistike, shkencore dhe ekonomike. Hartimi i një guide dhe aplikimi i një sistemi shfrytëzimi konfortabël me mjedisin dhe që siguron zhvillim të qëndrueshëm. Zhvillimi i studimeve faunistike dhe floristike në përgjithësi por sidomos ornitologjike dhe mamalogjike sidom në zonat e mbrojtura, me interes ekoturistik, të ndjeshme dhe problematike
Zbatimi i projekteve strategjike me impakt të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë si rezultat i shfrytëzimit të burimeve natyrore;	Aplikimet duhet të shmangin sipas alternative studimore ndërhyrjen drastike në biodiversitet. Të kërkohen dhe zbatohen teknologji që minimizojnë përdorimin e burimeve primare të biodiversitetit me teknologji alternative të eficientës energjitike. Shfrytëzimi i biodiversitetit sipas kriterëve shkencore dhe alternativ me metoda e programe të zhvillimit të qëndrueshëm. Projekte bashkëshoqëruese me mundësi zhvillimi të biodiversitetit.

Ndikime të parashikuara negative	Faktorët Mjedisor: Mbetje
Shtimi i prodhimit të mbetjeve nga aktiviteti në sektorin primar dhe sekondar të prodhimit;	Masat e propozuara për trajtim Promovimi i riciklimit të materialeve të ndryshme. Promovimi i bio-kompostimit nga sektori primar dhe sekondar i agrobujqësisë. Informimi i banorëve në lidhje me mundësitë dhe mënyrat e menaxhimit të mbetjeve sipas tipologjisë së tyre. Organizimi i një sistemi trajtimi me grumbullim në pika të paracaktuara, përpunim paraprak dhe destinim për në pika përpunuese teknologjike. Mundësi perspektive të ndërtimit të landfillit. Zhvillimi i sistemeve të koordinuara të aktiviteve ekonomike me mundësi qarkullimi të lëndëve të para e produkteve dhe me mbetje minimale. Aplikimi i sistemeve promovuese dhe motivuese për menaxhimin e mbetjeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

Shtim të gjenerimit të mbetjeve nga aktiviteti komunitar apo dhe zhvillimi i ekoturizmit;	Informim dhe ndërgjegjësim për menaxhimin e mbetjeve dhe krijimi i aksesit të duhur për grumbullim, ndarje me mundësi përpunimi optimal dhe shfrytëzimi për riciklim.
---	---

Faktorët Mjedisor: Mjedi i Akustik/Zhurma	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Zhurma nga funksionimi i infrastrukturës së transportit;	Zhvillimi i infrastrukturës policentrike, por njëkohësisht promovimi i teknologjive bashkëkohore dhe konfortabël me mjedisin për përdorim personal apo aktivitete të ndryshme. Të shfrytëzohen në transport format alternative që sigurojnë rentabilitet, minimizojnë koston dhe gjenerojnë për njësi dB më të pakët.
Zhurmat nga aktivitetet e propozuara industriale (miniera, gurore, artizale, etj);	Organizimi hapësiror i njësive operuese. Përdorimi i teknologjive bashkëkohore, aplikimi i aktiviteteve në distancë nga zonat e banuara apo me impakt akustik, sidomos faunistik. Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse akustike për sigurimin e shëndetit të personelit dhe respektimi ligjor i kohës së ekspozimit ndaj faktorëve akustik. Respektim i normave EU për parametrat teknologjike dhe masat teknike.
Zhurmat nga aktivitetet sekondore të agrobujqësisë;	Aplikimi i izolimit akustik të ndërtesave. Organizimi hapësiror i njësive operuese në zonat ekonomike . Shfrytëzimi i hapësirës topografike për planifikimin e instalimit të investimeve me impakt akustik.

Faktorët Mjedisor: Mjedi i Peisazh	
Ndikime të parashikuara negative	Masat e propozuara për trajtim
Ndryshime të peisazhit nga aktiviteti në infrastrukturë dhe mjedisin urban;	Zbatimi i projekteve infrastrukturore dhe urbane me arkitekturë zhvillimore konfortabël me mjedisin.
Ndryshime të peisazhit nga zbatime të sektorit primar industrial;	Organizimi i shfrytëzimeve të tilla me strukturë sipërfaqësore me impakt minimal estetik mjedisor.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHID

	Zbatimi i teknologjive që gjenerojnë mundësi ndryshimi sa më të vogël të peisazhit. Rritja e efikasitetit të shfrytëzimit për njësi sipërfaqe me mundësi ndryshimi minimal të peisazhit. Zbatimi i programeve rehabilituese për formësimin e peisazhit.
Ndryshime të peisazhit nga aktiviteti i sektorit primar të bujqësisë;	Respektimi i distancës minimale të aktivitetëve ndërtimore në zonat rurale me distancë minimale 20m nga kufiri fqinjë për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin, si rezultat i ruatjes së densitetit të ndërtimit-shfrytëzimit-gjenerimit të faktorëve impaktues të mjedisit
Përdorimi i burimeve natyrore për qëllime ekoturistike apo ekonomike.	Përzgjedhja e pikave të aksesueshme pa impakt në mjedisin shkencor, të kërcënuar sensibil. Përdorimi i teknikave dhe aseteve me më pak mundësi impakti negativ mjedisor. Përdorimi i mjeteve natyrore për të ruajtur harmonizimin midis elementëve natyror dhe ndërhyrjes antropogjene.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

MONITORIMI

Si pjesë e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në Raportin VSM duhet të përfshihen masat e parashikuara për monitorimin e efekteve të mundshme të rëndësishme të zbatimit PPV-së. Qëllimi kryesor i monitorimit të rregullt është identifikimi i efekteve të mundshme negative të zbatimit të PPV-së sa më herët që të jetë e mundur dhe të përfshihen mjetet e nevojshme për parandalimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative.

Qëllimi i sugjerimeve të monitorimit është të ofrojë mbështetje për autoritetin përgjegjës (Bashkia Librazhd) që t'i vlerësojë ndryshimet në mjedisin natyror gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Librazhd. Gjatë monitorimit, duhet të ketë mundësi të zbulohet nëse qëllimet strategjike, dispozitat e zbatimit, etj. të planit kanë shkaktuar rezultatet ose përmirësimet e pritura. Një element thelbësor i monitorimit VSM është që herë pas here të vëzhgohet përparimi i arritjes së objektivave mjedisore, përmbushja e qëllimeve të caktuara.

Suksesi i PPV-së dhe VSM-së përkatëse do të përcaktohen nga respektimi i kushteve, rregullave dhe objektivave të shpallura dhe të aprovuara. Në mënyrë të veçantë, puna do vijojë me hartimin e Planeve dhe projekteve të tjera që do të detajojnë dhe qartësojnë më tej elementet kryesore të cilat paraqiten përmbledhtas në PPV. Si të tilla, duhet që këto Plane dhe projekte të ndjekin frymën dhe parimet e PPV-së e të mos çënojnë rregullat përkatëse. Monitorimi i respektimit të PPV-së edhe gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve të tjera do jetë përgjegjësi dhe detyrim i bashkisë Librazhd.

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “**Vlerësimit Strategjik Mjedisor**”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në faza të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE-së për VSM-në. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen duplikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është Ministria e Mjedisit nëpërmjet AKM-së, e cila zbaton monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që PPV-ja të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektiva dhe synimet janë përcaktuar në plan, është e domosdoshme dhe siç e parashikuam dhe më sipër, është kërkesë ligjore, që të monitorohet plani i zbatimit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

Për të qënë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre treguesve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbatuese të PPV-së. Plani i monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit. Realizimi me sukses i kësaj ndërrmarjeve kërkon angazhimin e mjaft institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatëse monitoruese nën drejtimin e autoritetit përkatës të ministrisë së linjës. Mbështetur në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, ligjin për VNM-në ka për detyrë të kryejë monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PPV-së. Këtu përfshihen qoftë planet, projektet e infrastrukturës që po hartohen ndërkohë, edhe detajimi i PPV-së në planet rregulluese për vendbanimet policentrike, njësi administrative, etj. Bashkia Librazhd ka karakter administrativ dhe pa struktura të plotësuara në specialist dhe teknologji për të mundësuar kryerjen e procesit të monitorimit, ç'ka e bën të domosdoshme bashkërendimin e veprimtarive të punës për zbatimin e PPV-së dhe të kërkesave të VSM-së me institucionet përkatëse kompetente. Rezultatet e monitorimit, Bashkia Librazhd sipas ligjit të VSM-së duhet ti publikojë në mënyrë periodike cdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM,VNM për monitorimin dhe rezultatet ti përcillen bashkisë Librazhd dhe Ministrisë së Mjedisit. Mbi bazën e informacioneve të marra ka detyrim ligjor ti publikojë në kuadër të raportit vjetor për gjendjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

KONKLUZONE

Plani i Përgjithshëm Vendor bazohet dhe konsideron kriteret e zhvillimit të Qëndrueshëm. Sipas analizës dhe vlerësimit, PPV-ja në përmbajtje, strategji dhe objektiva ka në tërësi orientim miqësor në lidhje me mjedisin. Vlerësimi i impakteve mjedisore të implementimit të PPV-së evidenton një bilanc pozitiv në shumicën e elementëve. Në mënyrën e strukturimit, konceptimit dhe idesë së materializimit PPV-ja unifikon dimensionin mjedisor – parametrat e mbrotjes dhe mekanizmat përmirësues të mjedisit natyror, kulturor dhe social.

Gjatë implementimit të PPV shkalla e shfaqjes dhe mundësia impaktuese e ndikimeve negative është e kushtëzuar nga mënyra e zbatimit të PPV-së dhe jo nga përmbajtja propozuese e saj.

Ndërkohë që nëpërmjet VSM kemi identifikuar, vlerësuar dhe parashikuar të gjitha impaktet e mundshme mjedisore të PPV-së, në referencat e kushteve të propozimeve përmbajtëse. Për zhvillimin e PPV-së në harmoni të plotë dhe të qëndrueshme me mjedisin, konform kërkesave të VSM si garanti i zhvillimit mjedisor janë propozuar masa konkrete për mënyrën e trajtimit të impakteve mjedisore. Ndërkohë për vlerësimin e zhvillimit përputhës midis veprimeve të propozuara në PPV dhe kërkesave të VSM-së për zhvillim të qëndrueshëm është hartuar program i monitorimit të impakteve mjedisore sipas përmbajtjes propozuese të PPV-së dhe kërkesave të matshme të legjislacionit Mjedisor.

Vlerësimi tërësor mjedisor i PPV evidenton se impaktet pozitive të planit janë shumë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me tërësinë vepruese të faktorëve Mjedisor. Kjo është pritshmëria e hartuesëve të PPV që në ideimin e planit dhe më tej në formulimin e propozimeve përkatëse, ç'ka konfirmohet dhe garantohet akoma më tej nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

IMPLEMENTIMI I KËTIJ PLANI TË PËRGJITHSHËM VENDOR PËR BASHKINË LIBRAZHD DO TË MUND:

- Të krijoj një imazh tërësish të transformuar të qytetit të Librazhd;
- Të japë zgjidhje përfundimtare për probleme të infrastrukturës, sistemit të kanalizimeve, sistemit social, kulturor dhe mjedisit gjelbërues, çlodhës, argëtues të qytetit të Librazhd;
- Të trajtoj me efikasitet mjedisore dhe urbane zonat përreth qyteti që konsiderohen si pika të nxehta, duke i kthyer në pjesë funksionale dhe lidhëse të qytetit;
- Do të mund të ndryshoj tërësisht cilësia e parametrave mjedisor të qytetit si ajri, uji, klima, zhurma, etj duke shmangur qarkullimin nacional nga qendra e qytetit dhe duke instaluar rrjetin urban të periferisë;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR – BASHKIA LIBRAZHD

- Do të mund tju krijohen kushte urbane më të shëndetshme për banorët nga sistemimi i trotuareve, rrjeteve komunikuese, energjitike dhe krijimi i korsive për biçikletat;
- Zonat rurale nëpërjet sistemit infrastrukturor do të jenë pjesë e rrjetit funksional të bashkisë me tërësinë e shërbimeve sipas konceptit policentrik;
- Performanca dhe disponibiliteti i aseteve do të jetë më i madh në bashki në saj të instalimit të sistemit të menaxhimit dhe ruatjes cilësore të sistemit hidrik dhe mirëmenaxhimit të mbetjeve urbane;
- Evidentohen më së mirë asetet kulturore, historike, tradicionale, kulinare, etj duke u kthyer një nga atraksionet dhe burimet e zhvillimit ekonomik;
- Turizmi malor, ekoturizmi, pylltaria, agrobujqësia, etj tipare zotëruese dhe përshtatëse të zonës bëhen burim atraksioni vendas dhe për të huaj, burim zhvillimi ekonomik dhe social.

Përmbushja e misionit të PPV dhe të kërkesave sipas objektivave të VSM-së mbështett në faktin se:

1. Bashkia Librazhd karakterizohet nga pasuri të mëdha natyrore (flora, fauna, biodiversitet, pyje, zonave të mbrojtura, burime ujore, etj)
2. Bashkia Librazhd ka një pasuri të konsiderueshme dhe me vlera zhvillimore turistike të tipologjisë kulturore, historike, gastronomike, etj.
3. Shpërndarja hapësinore e pasurive natyrore mundëson zhvillim policentrik dhe mundësi integrimi multifunksional.
4. Pasuritë/monumentet e natyrore & kulturore përbëjnë bazën dhe mundësi potenciale të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit malor, kulinar, familjar, kulturor, etj
5. Relievi, klima, pedologjia, regjimi hidrik përbëjnë një bazë zhvillimore të sukseshme për bashkinë e Librazhdit në fushën e mbarështimit të blegtorisë dhe të prodhimit mishit e qumështit si dhe të nëprodukteve të tyre (Zona e Polisit).
6. Menaxhimi i sfidave mjedisore ekzistuese por dhe potenciale do të krijonte suport të qëndrueshëm për zhvillimin e mirëqënies së komunitetit, të jetës urbane dhe rurale, infrastrukturës, agroturizmit, etj.